

DEKLARATA E PEKINIT DHE PLATFORMA PËR VEPRIM
KONFERENCA E KATËRT BOTËRORE PËR GRATË:
AKSION PËR BARAZINË, ZHVILLIMIN DHE PAQEN

(15 Shtator 1995)

PËRMBAJTJA

Deklarata e Pekinit

Platforma për Veprim

Kapitulli I	Misioni i Deklaratës
Kapitulli II	Korniza Globale
Kapitulli III	Fushat kritike të interesit
Kapitulli IV	Objektivat dhe Veprimet strategjike
Kapitulli V	Rregullimet Institucionale
Kapitulli VI	Rregullimet financiare

DEKLARATA E PEKINIT

1. Ne, Qeveritë, pjesëmarrëse në Konferencën e Katërt Botërore për Gratë,
2. Të mbledhura këtu në Pekin në shtator të vitit 1995, në përvjetorin e pesëdhjetë të themelimit të Kombeve të Bashkuara,
3. Të vendosura për të çuar më tej objektivat e barazisë, zhvillimit dhe paqes për të gjitha gratë kudo që ndodhen në interes të gjithë njerëzimit,
4. Duke njohur zërat e të gjitha grave kudo që ndodhen dhe duke marrë parasysh dallimet e grave dhe rolet e rrethanat e tyre, duke nderuar gratë që përgatitën truallin të frymëzuara nga shpresa të cilën posedojnë rinia e botës,

5. Njohim se statusi i grave ka përparuar në disa drejtime të rëndësishme në dhjetëvjeçarin e shkuar, por që progresi ka qenë i pabarabartë, pabarazitë midis grave e burrave kanë mbetur dhe pengesat më të mëdha ende qëndrojnë, me pasoja serioze për mirëqenien e të gjithë njerëzve.

6. Gjithashtu njohim se kjo gjendje është përkeqësuar nga rritja e varfërisë e cila është duke ndikuar në jetën e shumicës së njerëzve të botës, veçanërisht të grave e të fëmijëve, si në sferën kombëtare ashtu edhe në atë ndërkombëtare,

7. T'i përkushtojmë veten pa rezervë në adresimin e këtyre kufizimeve dhe pengesave, duke zgjeruar kështu më tej përparimin dhe fuqizimin e grave në të gjithë botën, si dhe pajtohemi se kjo kërkon veprim të menjëhershëm me shpirt vendosmërie, shprese, bashkëpunimi dhe solidariteti, si tani ashtu edhe për të na çuar përpara drejt shekullit tjetër.

riafirmojmë angazhimin tonë për:

8. Të drejta të barabarta dhe dinjitet njerëzor të grave dhe burrave dhe qëllimeve e parimeve të tjera të mishëruara në Kartën e Kombeve të Bashkuara, në Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut dhe në instrumentet tjera ndërkombëtarë për të drejtat e njeriut, në mënyrë të veçantë në Konventën për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit kundër Grave dhe në Konventën për Të Drejtat e Fëmijëve, si dhe në Deklaratën për Eliminimin e Dhunës kundër Grave dhe në Deklaratën për të Drejtën për Zhvillim;

9. Për të siguruar zbatimin e plotë të të drejtave njerëzore të grave dhe të vajzave të mitura si një pjesë e patjetërsueshme, tërësore dhe e pandashme e të gjitha të drejtave të njeriut dhe lirive themelore;

10. Për të ndërtuar mbi konsensusin dhe progresin e bërë në konferencat dhe samitet e mëparshme të Kombeve të Bashkuara – për gratë në Najrobi më 1985, për fëmijët në Nju Jork më 1990, për mjedisin dhe zhvillimin në Rio De Zhaneiro në 1992, për të drejtat e njeriut në Vjenë më 1993, për popullsinë dhe zhvillimin në Kajro më 1994 dhe për zhvillimin social në Kopenhagë më 1995, me objektivat e arritjes së barazisë, zhvillimit dhe paqes;

11. Për të arritur zbatimin e plotë dhe efektiv të Strategjive të së Ardhmes për Përparimin e Grave të Najrobit;

12. Për fuqizimin dhe përparimin e grave, duke përfshirë të drejtën për lirinë e mendimit, të ndërgjegjes, të fesë dhe të besimit, duke kontribuar kështu në nevojat morale, etike, shpirtërore dhe intelektuale të grave dhe burrave, individualisht ose në komunitet me të tjerët dhe, në këtë mënyrë, duke u siguruar mundësinë e realizimit

të potencialit të plotë në shoqëri dhe formësimin e jetës së tyre në përputhje me aspiratat e tyre.

jemi të bindura se:

13. Fuqizimi i grave dhe pjesëmarrja e plotë e tyre mbi bazën e barazisë në të gjitha sferat e shoqërisë, duke përfshirë pjesëmarrjen në vendimmarrje dhe qasjen në pushtet, janë themelore për arritjen e barazisë, zhvillimit dhe paqes.

14. Të drejtat e grave janë të drejtat e njeriut;

15. Të drejtat e barabarta, mundësitë dhe qasja ndaj burimeve, ndarja e barabartë e përgjegjësiave për familje për burrat dhe gratë, si dhe një partneritet harmonik midis tyre, janë kritike për mirëqenien e tyre si dhe të familjeve të tyre, po ashtu edhe për konsolidimin e demokracisë;

16. Zhdukja e varfërisë bazuar në rritjen e qëndrueshme ekonomike, zhvillimin social, mbrojtjen mjedisore dhe drejtësinë sociale, kërkon përfshirjen e grave në zhvillimin ekonomik dhe social, si dhe mundësi të barabarta e pjesëmarrje të plotë e të barabartë të grave e burrave si agentë dhe si përfitues të zhvillimit të qëndrueshëm të përqendruar te njerëzit;

17. Njohja e qartë dhe ritheksimi i së drejtës të të gjitha grave për të kontrolluar të tëra aspektet e shëndetit të tyre, veçanërisht atë të lindshmërisë së tyre, është themelore për fuqizimin e tyre;

18. Paqja lokale, kombëtare, rajonale dhe globale, është e arritshme dhe e lidhur në mënyrë të pandashme me përparimin e grave, të cilat janë një forcë themelore për udhëheqje, për zgjidhjen e konflikteve dhe promovimin e paqes afatgjatë në të gjitha nivelet;

19. Është thelbësore të dizajnojmë, zbatojmë dhe monitorojmë, politika dhe programe efikase dhe efektive të ndjeshme në çështje gjinore me pjesëmarrjen e plotë të grave, duke përfshirë politika dhe programe zhvillimore, në të gjitha nivelet që do të ushqejnë fuqizimin dhe përparimin e grave;

20. Pjesëmarrja dhe kontributi i të gjithë aktorëve të shoqërisë civile, veçanërisht i grupeve dhe rrjeteve të grave, i organizatave të tjera joqeveritare dhe organizatave të komuniteteve, me respektin e plotë për autonominë e tyre, në bashkëpunim me Qeveritë, janë të rëndësishme për zbatimin efektiv dhe ndjekjen e Platformës për Veprim;

21. Zbatimi i Platformës për Veprim kërkon angazhimin e Qeverive dhe të bashkësisë ndërkombëtare. Duke bërë zotimet kombëtare dhe ndërkombëtare për veprim, duke përfshirë edhe zotimet e bëra në këtë

Konferencë, Qeveritë dhe bashkësia ndërkombëtare njohin nevojën për të ndërmarrë veprime prioritare për fuqizimin dhe përparimin e grave.

Ne jemi të vendosur që të:

22. Intensifikojmë përpjekjet dhe veprimet për të arritur synimet e Strategjive të së Ardhmes për Përparimin e Grave të Najrobit deri në fund të këtij shekulli.

23. Sigurojmë që gratë dhe vajzat e mitura të gëzojnë plotësisht të gjitha të drejtat e njeriut dhe liritë themelore, si dhe për të ndërmarrë veprime efektive kundër shkeljes së këtyre të drejtave dhe lirive.

24. Të marrim të gjitha masat e nevojshme për të eliminuar të gjitha format e diskriminimit kundër grave dhe vajzave të mitura, si dhe për të shmangur të gjitha pengesat për barazinë gjinore dhe përparimin dhe fuqizimin e grave;

25. Të nxisim burrat të marrin pjesë plotësisht në të gjitha veprimet drejt barazisë;

26. Të promovojmë pavarësinë ekonomike të grave, duke përfshirë punësimin, si dhe duke zhdukur barrën gjithnjë e më të madhe të varfërisë së grave, duke adresuar shkaktarët strukturorë të varfërisë përmes ndryshimeve në strukturat ekonomike, duke siguruar qasje të barabartë për të gjitha gratë, duke i përfshirë ato në zonat rurale, si agjentë jetësorë të zhvillimit për resurset e prodhimit, mundësitë dhe shërbimet publike;

27. Të promovojmë zhvillimin e qëndrueshëm të përqendruar te njerëzit, duke përfshirë rritjen e qëndrueshme ekonomike përmes ofrimit të arsimit themelor, arsimit jetëgjatë, shkrim-leximit dhe trajnimit, si dhe kujdesit shëndetësor parësor për vajzat dhe gratë;

28. Të marrim hapa pozitivë për të siguruar paqen për përparimin e grave dhe njohjen e rolit udhëheqës që gratë kanë luajtur në lëvizjen paqësore, të punojmë aktivisht për çarmatimin e përgjithshëm dhe të plotë nën kontrollin e rreptë dhe efektiv ndërkombëtar, dhe të mbështesim negociatat për përfundimin pa vonesë të një traktati të gjithanshëm për ndalimin e provave bërthamore i cili do të ishte universal dhe i verifikueshëm në mënyrë shumëpalëshe dhe efektive, e i cili kontribuon për çarmatimin bërthamor dhe parandalimin e shtimit të armëve bërthamore në të gjitha aspektet;

29. Të parandalojmë dhe zhdukim të gjitha format e dhunës kundër grave e vajzave;

30. Të sigurojmë qasje të barabartë si dhe trajtim të barabartë të grave dhe burrave në arsimim, kujdes shëndetësor dhe në shtimin e shëndetit seksual dhe riprodhues të grave, si dhe arsimimit të tyre;

31. Të promovojmë dhe mbrojmë të gjitha të drejtat njerëzore për gratë dhe vajzat;

32. Të intensifikojmë përpjekjet që të sigurojmë gëzimin e të drejtave të njeriut dhe të lirive themelore për të gjitha gratë dhe vajzat, të cilat përballen me pengesa të shumëfishta në fuqizimin dhe përparimin e tyre për shkak të faktorëve të tillë, si janë raca, mosha, gjuha, etnia, kultura, feja, paaftësia, ose se janë popuj indigjenë;

33. Të sigurojmë respektin për të drejtën ndërkombëtare, duke përfshirë të drejtën humanitare, me qëllim të mbrojtjes së grave dhe të vajzave në veçanti;

34. Të zhvillojmë potencialin më të plotë të grave dhe vajzave të të gjitha moshave, që siguron pjesëmarrjen e tyre të plotë dhe të barabartë për ndërtimin e një bote më të mirë për të gjithë dhe për të zgjeruar rolin e tyre në procesin e zhvillimit.

Ne jemi të vendosur:

35. Të sigurojmë grave qasje të barabartë në resurset ekonomike përfshirë tokën, kredinë, shkencën dhe teknologjinë, trajnimin profesional, informacionin, komunikimin dhe tregjet, si një mjet për të çuar më tej përparimin dhe fuqizimin e grave dhe vajzave, përfshirë edhe përmes zgjerimit të kapaciteteve të tyre për të gëzuar përfitimet e qasjes së barabartë në këto resurse, në mes të tjerash edhe përmes bashkëpunimit ndërkombëtar;

36. Të sigurojmë suksesin e Platformës për Veprim, e cila do të kërkojë një angazhim të fuqishëm nga ana e qeverive, organizatave ndërkombëtare dhe institucioneve në të gjitha nivelet. Ne jemi thellësisht të bindur se zhvillimi ekonomik, zhvillimi social dhe mbrojtja mjedisore janë të ndërvarura dhe në mënyrë reciproke përforcojnë komponentët e zhvillimit të qëndrueshëm, e cila është baza e të gjitha përpjekjeve tona për të arritur një cilësi më të lartë të jetës për të gjithë njerëzit. Zhvillimi i drejtë social, që njeh fuqizimin e të varfërve, veçanërisht të grave të cilat jetojnë në varfëri, për të shfrytëzuar burimet mjedisore në masë të qëndrueshme është një themel i nevojshëm për zhvillimin e qëndrueshëm. Ne pranojmë gjithashtu se zhvillimi ekonomik me bazë të gjerë dhe i vazhdueshëm në kontekstin e zhvillimit të qëndrueshëm, është e nevojshme të ushqejë zhvillimin social dhe drejtësinë sociale. Për sukses të Platformës për Veprim gjithashtu nevojitet edhe mobilizimi i mjaftueshëm i resurseve në nivele kombëtare dhe ndërkombëtare, po ashtu edhe resurse të reja dhe aso shtesë për vendet në zhvillim nga të gjitha mekanizmat financues në dispozicion, duke përfshirë resurset shumëpalëshe, dypalëshe dhe private për përparimin e grave; resurset financiare për të fuqizuar kapacitetin e institucioneve kombëtare, nën-rajonale, rajonale dhe ndërkombëtare; një zotim për të drejta të barabarta, përgjegjësi të barabarta si dhe mundësi të

barabarta dhe për pjesëmarrje të barabartë të grave e burrave në të gjitha organizmat kombëtarë, rajonalë dhe ndërkombëtare dhe në proceset e politikëbërjes; ngritjen ose fuqizimin e mekanizmave në të gjitha nivelet për llogaridhënie ndaj grave të botës.

37. Të sigurojmë gjithashtu suksesin e Platformës për Veprim në të gjitha vendet me ekonomi në tranzicion, që do të kërkojë bashkëpunimin dhe asistencën e vazhdueshme ndërkombëtare;

38. përmes këtij dokumenti miratojmë dhe zotohemi si Qeveri për të zbatuar Platformën për Veprim në vijim, duke siguruar se perspektiva gjinore do të pasqyrohet në të gjitha politikat dhe programet tona. Ne nxisim sistemin e Kombeve të Bashkuara, institucionet financiare rajonale dhe ndërkombëtare, institucionet e tjera relevante rajonale dhe ndërkombëtare dhe të gjithë gratë dhe burrat, po ashtu edhe organizatat joqeveritare, me respekt të plotë për autonominë e tyre, si dhe të gjithë sektorët e shoqërisë civile, në bashkëpunim me Qeveritë, të zotohen plotësisht dhe të kontribuojnë në zbatimin e kësaj Platforme për Veprim.

PLATFORMA PËR VEPRIM

Kapitulli I – DEKLARATA E MISIONIT

1. Platforma për Veprim është një agjendë për fuqizimin e grave. Ajo synon përshtetimin e zbatimit të Strategjive të së Ardhmes për Përparimin e Grave¹ të Najrobit dhe heqjen e të gjitha pengesave të pjesëmarrjes aktive të grave në të gjitha sferat e jetës publike dhe private përmes një ndarjeje të plotë e të barabartë në vendimmarrjen ekonomike, sociale, kulturore dhe politike. Kjo do të thotë që të vendoset parimi i ndarjes së pushtetit dhe përgjegjësisë midis burrave dhe grave në shtëpi, në vendin e punës dhe në komunitete më të gjera kombëtare dhe ndërkombëtare. Barazia midis grave dhe burrave është një çështje e të drejtave të njeriut dhe një kusht për drejtësi sociale, ajo është gjithashtu një parakusht i nevojshëm dhe themelor për barazinë, zhvillimin dhe paqen. Një partneritet i transformuar i bazuar në barazinë midis grave dhe burrave është një kusht për zhvillimin të qëndrueshëm të përqendruar te njerëzit. Një zotim i qëndrueshëm dhe afatgjatë është thelbësor, ashtu që gratë dhe burrat të mund të punojnë së bashku për veten e tyre, për fëmijët e tyre dhe për shoqërinë për të përmbushur sfidat e shekullit njëzet e një.

¹ Raport i Konferencës Botërore për Rishikimin dhe Vlerësimin e Arritjeve të Dhjetëvjeçarit për Gratë i Kombeve të Bashkuara: Barazia, Zhvillimi dhe Paqja, Nairobi 15-26 Korrik 1985 (Botim i Kombeve të Bashkuara, Sales n°. E.85.IV.10), Kapitulli I, seksioni A.

2. Platforma për Veprim riafirmon parimet themelore të shpallura në Deklaratën dhe Programin e Veprimit të Vjenës,² të miratuar nga Konferenca Botërore për të Drejtat e Njeriut, se të drejtat njerëzore të grave dhe vajzave të mitura janë pjesë e patjetërsueshme, integrale dhe e pandashme e të drejtave universale të njeriut. Si një agjendë për veprim, Platforma kërkon të nxisë dhe mbrojë gëzimin e plotë të të drejtave të njeriut dhe lirive themelore të të gjitha grave gjatë ciklit të jetës së tyre.

3. Platforma për Veprim thekson se gratë ndajnë shqetësimet e përbashkëta, që mund të adresohen vetëm duke punuar së bashku dhe në partneritet me burrat drejt një qëllimi të përbashkët të barazisë gjinore në mbarë botën. Ajo respekton dhe vlerëson ndryshueshmërinë e plotë të gjendjes dhe kushteve të grave dhe pranon se disa gra përballen me pengesa të veçanta drejt fuqizimit të tyre.

4. Platforma për Veprim kërkon veprim të menjëhershëm e të bashkërenduar nga të gjithë për të krijuar një botë paqësore, të drejtë dhe njerëzore të bazuar në të drejtat e njeriut dhe liritë themelore, duke përfshirë parimet e barazisë për të gjithë njerëzit e të gjitha moshave dhe profesioneve, dhe si përfundim, pranon se rritja ekonomike e mbështetur dhe e bazuar gjerësisht në kontekstin e zhvillimit të qëndrueshëm, është e nevojshme për të mbështetur zhvillimin social dhe drejtësinë sociale.

5. Suksesi i Platformës për Veprim do të kërkojë një zotim të fuqishëm nga ana e Qeverive, organizatave dhe institucioneve ndërkombëtare në të gjitha nivelet. Ajo gjithashtu kërkon mobilizim adekuat të resurseve në nivelet kombëtare dhe ndërkombëtare, po ashtu edhe resurse të reja dhe resurse shtesë për vendet në zhvillim prej të gjitha mekanizmave financuese, përfshirë resurset shumëpalëshe, dypalëshe dhe private për përparimin e grave; resurset financiare për të fuqizuar kapacitetin e institucioneve kombëtare, nën-rajonale, rajonale dhe ndërkombëtare, një zotim për të drejtat e barabarta, përgjegjësitë e barabarta dhe mundësitë e barabarta dhe të pjesëmarrjes së barabartë të grave dhe burrave në të gjitha organizmat kombëtare, rajonale dhe ndërkombëtare, si dhe proceseve politikëbërëse; dhe themelimi ose fuqizimi i mekanizmave në të gjitha nivelet për llogaridhënie kundrejt grave të botës.

Kapitulli II - KORNIZA GLOBALE

² Raport i Konferencës Botërore për të Drejtat e Njeriut, Vjenë, 14-25 Qershor 1993 (A/CONF.157/24 (Pjesa I)), kap. III.

6. Konferenca e Katërt Botërore për Gratë: Veprimi për Barazi, Zhvillim dhe Paqe është duke u mbajtur në kohën kur bota qëndron e gatshme në prag të një mijëvjeçari të ri.

7. Platforma aktuale për Veprim mbështet Konventën Për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit kundër Grave³ dhe ndërtohet mbi Strategjitë e së Ardhmes për Përparimin e Grave të Najrobit, po ashtu dhe rezolutat përkatëse të miratuara nga Këshilli Ekonomiko-Social dhe Asambleja e Përgjithshme. Formulimi i Platformës për Veprim synon krijimin e një grupi bazë të veprimeve prioritare që duhet të ndërmerren në pesë vitet në vijim.

8. Platforma për Veprim njeh rëndësinë e marrëveshjeve të arritura në Samitin Botëror për Fëmijët, Konferencën e Kombeve të Bashkuara për Mjedisin dhe Zhvillimin, Konferencën Botërore për të Drejtat e Njeriut, Konferencën Ndërkombëtare për Popullsinë dhe Zhvillimin dhe Samitin Botëror për Zhvillimin Social, që shpallën qasjet dhe zotimet specifike për të nxitur zhvillimin e qëndrueshëm dhe bashkëpunimin ndërkombëtar, dhe për të fuqizuar rolin e Kombeve të Bashkuara për arritjen e këtij qëllimi. Ngjashëm, Konferenca Globale për Zhvillimin e Qëndrueshëm të Shteteve të Vogla Ishuj në Zhvillim, Konferenca Ndërkombëtare për Ushqimin, Konferenca Ndërkombëtare për Kujdesin Primar Shëndetësor dhe Konferenca Botërore mbi Arsimin për të Gjithë, kanë adresuar forma të ndryshme të zhvillimit dhe të drejtave të njeriut, duke i kushtuar vëmendje të posaçme, brenda perspektivave të tyre specifike, rolit të grave dhe vajzave. Për më tepër, Viti Ndërkombëtar për Popujt Indigjenë të Botës,⁴ Viti Ndërkombëtar i Familjes,⁵ Viti i Kombeve të Bashkuara për Tolerancë,⁶ Deklarata e Gjenevës për Gratë Rurale,⁷ dhe Deklarata për Eliminimin e Dhunës kundër Grave⁸ kanë theksuar çështjet e fuqizimit të grave dhe barazisë.

9. Objektivi i Platformës për Veprim, i cili është në përputhje të plotë me qëllimet dhe parimet e Kartës së Kombeve të Bashkuara dhe të drejtës ndërkombëtare, është fuqizimi i të gjitha grave. Realizimi i plotë i të gjitha të drejtave të njeriut dhe lirive themelore për të gjitha gratë, është thelbësor për fuqizimin e grave. Ndërsa rëndësia e veçantive kombëtare dhe rajonale dhe sfondet e larmishme historike, kulturore e fetare, duhet të merren në konsiderim, ajo është detyrë e shteteve, pa marrë parasysh sistemet e tyre politike, ekonomike, dhe kulturore, që të promovojnë dhe mbrojnë të gjitha të drejtat e njeriut dhe liritë themelore.⁹ Zbatimi i kësaj Platforme, përfshirë edhe përmes ligjeve kombëtare edhe formulimit të strategjive, politikave,

³ Rezoluta e Asamblesë se Përgjithshme, 34/180, aneks.

⁴ Rezoluta e Asamblesë se Përgjithshme 45/164.

⁵ Rezoluta e Asamblesë se Përgjithshme 44/82.

⁶ Rezoluta e Asamblesë se Përgjithshme 48/126.

⁷ /A/47/308-E/1992/97, aneks.

⁸ Rezoluta e Asamblesë se Përgjithshme 48/104.

⁹ Deklarata dhe Programi i Veprimit të Vjenës, Raport i Konferencës Botërore për të drejtat e Njeriut, kap. III, par. 5.

programeve dhe prioriteteve zhvillimore, është përgjegjësi sovrane e çdo shteti, në përputhje me të gjitha të drejtat e njeriut dhe liritë themelore, dhe rëndësinë e sajë dhe respektin të plotë për fetë e ndryshme dhe vlerat etike, sfondet kulturore dhe bindjet filozofike të individëve dhe komuniteteve të tyre do të kontribuojë në gëzimin e plotë të të drejtave të njeriut nga gratë me qëllim të arritjes së barazisë, zhvillimit dhe paqes.

10. Që nga Konferenca Botërore Për Rishikimin dhe Vlerësimin e Arritjeve të Dhjetëvjeçarit për Gratë të Kombeve të Bashkuara: Barazi, Zhvillim dhe Paqe, të mbajtur në Najrobi në vitin 1985, dhe miratimi i Strategjive të së Ardhmes për Përparimin e Grave të Najrobit, bota ka pësuar ndryshimeve të thella politike, ekonomike, sociale dhe kulturore, të cilat kanë pasur si efekte pozitive ashtu dhe negative mbi gratë. Konferenca Botërore mbi të Drejtat e Njeriut pranoi se të drejtat njerëzore të grave dhe vajzave të mitura, janë një pjesë e patjetërsueshme, tërësore dhe e pandashme e të drejtave universale të njeriut. Pjesëmarrja e plotë dhe e barabartë e grave në jetën politike, civile, ekonomike, sociale dhe kulturore në nivelet kombëtare, rajonale dhe ndërkombëtare, dhe zhdukjen e të gjitha formave të diskriminimit bazuar në gjini, janë objektiva primare të bashkësisë ndërkombëtare. Konferenca Botërore për të Drejtat e Njeriut riafirmoi zotimin solemn të gjitha shteteve që të përmbushin detyrimet e tyre për të promovuar respektimin universal, vëzhgimin dhe mbrojtjen e të gjitha të drejtave të njeriut dhe lirive themelore për të gjithë në përputhje me Kartën e Kombeve të Bashkuara, instrumentet e tjera që lidhen me të drejtat e njeriut dhe të drejtën ndërkombëtare. Natyra universale e këtyre të drejtave dhe lirive është jashtë çdo dyshimi.

11. Fundi i luftës së ftohtë rezultoi me ndryshime ndërkombëtare dhe zvogëlimin e konkurrencës midis superfuqive. Kërcënimi i një konflikti global të armatosur është ulur, ndërsa marrëdhëniet ndërkombëtare janë përmirësuar dhe shpresat për paqen midis kombeve janë rritur. Megjithëse kërcënimi i konfliktit global është zvogëluar, luftërat e agresionit, konfliktet e armatosura, kolonializmi dhe format tjera të dominimit dhe pushtimit të huaj, luftërat civile, terrorizmi dhe dhuna ekstremiste, vazhdojnë të molepsin shumë pjesë të botës. Ndodhin shkelje ekstreme të të drejtave njerëzore të grave, veçanërisht në kohën e konflikteve të armatosura, dhe përfshijnë vdekjen, torturën, përdhunimin sistematik, shtatzëninë e detyruar dhe abortin e detyruar, veçanërisht sipas politikave të “spastrimit etnik”.

12. Ruajtja e paqes dhe sigurisë në nivele globale, rajonale dhe lokale, së bashku me parandalimin e politikave të agresionit dhe të spastrimit etnik dhe zgjidhjes së konfliktit të armatosur, është qenësore për mbrojtjen e të drejtave njerëzore të grave dhe vajzave të mitura, si dhe eliminimin e të gjitha formave të dhunës ndaj tyre dhe përdorimit të tyre si armë lufte.

13. Shpenzimet e tepërta ushtarake, që përfshijnë shpenzimet globale ushtarake dhe tregtinë ose trafikimin e armëve, dhe investimet për prodhimin dhe blerja e armëve kanë zvogëluar resurset në dispozicion për zhvillimin global. Si rezultat i borxhit të rëndë dhe vështirësive tjera ekonomike, shumë vende në zhvillim kanë ndërmarrë politika të përshtatjes strukturore. Për më tepër, ka programe të përshtatjes strukturore që janë ideuar e zbatuar dobët, që kanë rezultuar me efekte të dëmshme në zhvillimin social. Numri i njerëzve që jetojnë në varfëri është rritur në mënyrë të shpërpjesëtuar në shumicën e vendeve në zhvillim, veçanërisht në vendet me borxhe të rënda në dhjetëvjeçarin e fundit.

14. Në këtë kontekst, përmasat sociale të zhvillimit duhen theksuar. Rritja e përshtatjes ekonomike, sado e nevojshme për zhvillimin social, nuk mund të përmirësojë në vetvete cilësinë e jetës së popullsisë. Në disa raste, mund të rezultojnë kushte të cilat rëndojnë pabarazinë sociale dhe marginalizimin. Prandaj, është e domosdoshme të kërkojmë alternativa të reja që sigurojnë se të gjithë anëtarët e shoqërisë do të përfitojnë nga rritja ekonomike e bazuar në një qasje gjithëpërfshirëse në të gjitha aspektet e zhvillimit: rritjen, barazinë midis grave e burrave, drejtësinë sociale, ruajtjen dhe mbrojtjen e mjedisit, qëndrueshmërinë, solidaritetin, pjesëmarrjen, paqen dhe respektin për të drejtat e njeriut.

15. Një lëvizje e gjerë botërore drejt demokratizimit ka hapur procesin politik në shumë kombe, por pjesëmarrja popullore e grave në pozita kyçe vendimmarrëse si partnere të plota dhe të barabarta me burrat, veçanërisht në politikë, ende nuk është arritur. Politika e Afrikës së Jugut e racizmit të institucionalizuar – aparteidi - u shpërbë dhe ka ndodhur një transferim paqësor dhe demokratik i pushtetit. Në Evropën Qendrore e Lindore tranzicioni i demokracive parlamentare ka qenë i shpejtë dhe ka rezultuar me një sërë përvojash, varësisht nga rrethanat specifike të çdo vendi. Përderisa ky tranzicion ka qenë kryesisht paqësor, në disa vende ky proces është penguar nga konfliktet e armatosura që kanë rezultuar me shkelje të rënda të të drejtave të njeriut.

16. Rënia ekonomike e përhapur gjerësisht, po ashtu edhe mungesa e stabilitetit politik në disa rajone, janë përgjegjëse për ngecjen e objektivave të zhvillimit në shumë vende. Kjo ka çuar në shtrirjen e varfërisë së papërshtatshme. Më tepër se një miliard njerëz jetojnë në gjendje të mjerueshme të varfërisë, shumica e të cilëve janë gra. Procesi i shpejtë i ndryshimit dhe i rregullimit në të gjithë sektorët, ka çuar në papunësi të rritur dhe punësimin e ulët, me ndikim të veçantë në gratë. Në shumë raste programet e përshtatjes strukturore nuk janë dizajnuar të minimizojnë efektet negative të tyre në grupet e cenuara dhe të pafavorizuara ose në gratë, gjithashtu nuk janë planifikuar për të siguruar efekte pozitive në këto grupe duke parandaluar marginalizimin e tyre në veprimtaritë ekonomike e

sociale. Akti Përfundimtar i Raundit të Uruguait të negociatave për tregtinë shumëpalëshe¹⁰ nënvizoi ndërvarësinë gjithnjë e më të madhe të ekonomive kombëtare, si dhe rëndësinë e liberalizimit të tregut dhe qasjen në tregjet e hapura dhe dinamike. Gjithashtu ka pasur shpenzime të mëdha ushtarake në disa rajone. Edhe përkundër rritjes në asistencë zyrtare për zhvillimi (ODA) në disa vende, ODA ka rënë kohët e fundit në përgjithësi.

17. Varfëria absolute dhe feminizimi i varfërisë, papunësia, rritja e brishtësisë së mjedisit, dhuna e vazhdueshme kundër grave dhe përjashtimi i përhapur gjerësisht i gjysmës së njerëzimit nga institucionet e pushtetit dhe qeverisjes, nënvizon nevojën për të vazhduar kërkime për zhvillimin, paqen, sigurinë dhe për mënyrat e sigurimit të zhvillimit të qëndrueshëm të përqendruar tek njerëzit. Pjesëmarrja dhe udhëheqësia e gjysmës së njerëzimit që është femëror, është thelbësor për suksesin e këtij kërkimi. Prandaj vetëm një periudhë e re e bashkëpunimit ndërkombëtar midis Qeverive dhe popujve, bazuar në shpirtin e partneritetit, në një mjedis social dhe ekonomik ndërkombëtar të barabartë, dhe një transformim i marrëdhënieve midis grave e burrave drejt një partneriteti të plotë e të barabartë, do të bëjë të mundur që bota t'i përmbush sfidat e shekullit të njëzet e një.

18. Zhvillimet e fundit ndërkombëtare ekonomike kanë pasur në shumë raste një ndikim të shpërpjestuar mbi gratë dhe fëmijët, shumica e të cilëve jetojnë në vendet në zhvillim. Për këto shtete, që kanë bartur një barrë të madhe të borxhit të jashtëm, programet dhe masat e përshtatjes strukturore, sado që janë përfituese me afat të gjatë, kanë çuar drejt një uljeje në shpenzimet sociale, duke ndikuar kështu negativisht në gratë, veçanërisht në Afrikë dhe shtetet më pak të zhvilluara. Kjo është përkeqësuar edhe më shumë kur përgjegjësitë për shërbimet themelore janë bartur nga Qeveria tek gratë.

19. Rënia ekonomike në shumë vende të zhvilluara dhe në zhvillim, po ashtu edhe në vendet me ekonomi në tranzicion të cilat janë në ristrukturim, kanë pasur një ndikim negativ të shpërpjestuar në punësimin e grave. Gratë shpesh nuk kanë zgjidhje, por të pranojnë një punësim ku mungon sigurimi afatgjatë në punë ose me kushte pune të rrezikshme, të punojnë në prodhimin e pambrojtur bazuar në shtëpi ose të jenë të papuna. Shumë gra hyjnë në tregun e punës në punë të nënvlerësuar dhe të nënpaguara, duke dëshiruar të përmirësojnë të ardhurat e familjes së tyre; të tjerat vendosin të emigrojnë për të njëjtin qëllim. Pa një zvogëlim të përgjegjësive të tjera të tyre, kjo ka rritur ngarkesën e përgjithshme të punës për gratë.

20. Politikat dhe programet makro dhe mikroekonomike, duke përfshirë përshtatjet strukturore, jo gjithmonë janë hartuar për të

¹⁰ Shiko Rezultatet e Negociatave Shumëpalëshe të Tregtisë së Tryezës së Rrumbullakët të Uruguait, Tekste Ligjore (Sekretariati i GATT-it, Gjeneve, 1994).

marrë në konsiderim ndikimin e tyre mbi gratë dhe vajzat e mitura, veçanërisht ato që jetojnë në varfëri. Varfëria është rritur në të dy termat, si absolute ashtu edhe relative, dhe numri i grave që jetojnë në varfëri është rritur në shumicën e rajoneve. Ka shumë gra urbane të cilat jetojnë në varfëri; megjithatë, kërkesa për përkujdes nga gratë që jetojnë në zonën rurale dhe në krahinat e largëta, meritojnë vëmendje të veçantë përballë amullisë së zhvillimit në zona të tilla. Në vendet në zhvillim, madje në ato në të cilat indikatorët kombëtarë kanë treguar përmirësim, shumica e grave rurale vazhdojnë të jetojnë në kushtet e moszhvillimit ekonomik dhe marginalizimit social.

21. Gratë janë kontribuuesit kyç të ekonomisë dhe të luftës kundër varfërisë edhe përmes punës së paguar dhe punës së papaguar në shtëpi, në komunitet dhe në vendin e punës. Një numër gjithnjë më i madh i grave ka arritur pavarësi ekonomike përmes punësimit fitimprurës.

22. Një e katërta e të gjitha familjeve në mbarë botën kanë si kryefamiljarë gratë dhe shumë ekonomi të tjera familjare varen nga të ardhurat e grave edhe atëherë kur burrat janë të pranishëm. Ekonomitë shtëpiake kryefamiljarë janë gratë, shumë shpesh janë ndër më të varfërat për shkak të diskriminimit në pagë, të modeleve të ndarjes së punës në tregun e punës dhe nga barrierat tjera me bazë gjinore. Shpërbërja e familjeve, lëvizjet e popullsisë ndërmjet zonave urbane dhe rurale përbrenda shteteve, emigracioni ndërkombëtar, lufta dhe zhvendosjet e brendshme janë faktorë që kontribuojnë në ngritjen e numrit të grave kryefamiljare.

23. Duke pranuar që arritja dhe mbajtja e paqes dhe e sigurisë janë një parakusht për përparimin ekonomik e social, gratë po e vendosin bindshëm veten si aktorë qendrorë në një numër të madh të pozitave në lëvizjen e njerëzimit për paqe. Pjesëmarrja e tyre e plotë në vendimmarrje, në parandalimin dhe zgjidhjen e konflikteve dhe të gjitha nismat e tjera për paqe, janë thelbësore për realizimin e një paqeje afatgjate.

24. Feja, spiritualiteti dhe besimi luajnë një rol qendror në jetët e miliona grave dhe burrave, në mënyrën si ata jetojnë dhe aspiratat që ata kanë për të ardhmen. E drejta e lirisë së mendimit, e ndërgjegjes dhe fesë është e patjetërsueshme dhe duhet të gëzohet në mënyrë universale. Kjo e drejtë përfshin lirinë për të pasur ose adoptuar fenë ose besimin e zgjedhur prej secilit individualisht ose në komunitet me të tjerët, në publik ose privatisht, dhe për të manifestuar fenë ose besimin e tyre në adhurimin, respektimin, praktikimin dhe mësimin. Me qëllim të arritjes së barazisë, zhvillimit dhe paqes, është e nevojshme të respektojmë plotësisht këto të drejta dhe liri. Feja, mendimi, ndërgjegjja dhe besimi, mund të kontribuojnë për të plotësuar nevojat morale, etike dhe shpirtërore të grave e burrave dhe për të realizuar potencialin e plotë të tyre në shoqëri. Megjithatë, është

e njohur që çdo formë ekstremizmi mund të ketë ndikim negativ mbi gratë dhe mund të çojë në dhunë e diskriminim.

25. Konferenca e Katërt Botërore për Gratë: Veprimi për Barazi, Zhvillim dhe Paqe, do të duhej të përshpejtonte procesin që zyrtarisht filloi në vitin 1975, i cili u shpall si Viti Ndërkombëtar i Grave nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara. Ai vit ishte një pikë kthese për shkak se vendosi rendin e ditës çështjet e grave. Dhjetëvjeçari i Kombeve të Bashkuara për Gratë (1976-1985) ishte një përpjekje mbarëbotërore për të shikuar gjendjen e grave dhe të drejtat e grave, si dhe për ta vendosur gruan në vendimmarrje në të gjitha nivelet. Në vitin 1979 Asambleja e Përgjithshme miratoi Konventën për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit kundër Grave, e cila hyri në fuqi në vitin 1981 dhe vendosi një standard ndërkombëtar se çfarë duhet kuptuar me barazi ndërmjet grave e burrave. Në vitin 1985, Konferenca Botërore për të Rishikuar dhe Vlerësuar Arritjet e Dhjetëvjeçarit të Kombeve të Bashkuara për Gratë: Barazi, Zhvillim dhe Paqe, miratoi Strategjitë e Najrobit për të Ardhmen dhe Përparimin e Grave për t'u zbatuar deri në vitin 2000. Është bërë një përparim i rëndësishëm në arritjen e barazisë gjinore midis grave dhe burrave. Shumë Qeveri kanë hartuar ligje për të nxitur barazinë midis grave e burrave dhe kanë themeluar mekanizmat kombëtarë për të siguruar kyçjen e perspektivës gjinore në të gjitha sferat e shoqërisë. Agjencitë ndërkombëtare kanë fokusuar vëmendje më të madhe në statusin dhe rolet e grave.

26. Fuqizimi gjithnjë më shumë i sektorit joqeveritar, veçanërisht organizatave të grave dhe grupeve feministe, është bërë një forcë që sjell ndryshim. Organizatat joqeveritare kanë luajtur një rol të rëndësishëm avokimi në përparimin e legjislacionit ose mekanizmave për të siguruar promovimin e grave. Ato janë bërë gjithashtu edhe kataliste për qasje të reja drejt zhvillimit. Shumë Qeveri kanë njohur gjithnjë më shumë rolin e rëndësishëm që organizatat joqeveritare luajnë dhe rëndësinë e punës me to për përparimin. Mirë, në disa vende Qeveritë vazhdojnë të kufizojnë mundësinë e organizatave joqeveritare për te vepruar lirisht. Gratë, përmes organizatave joqeveritare, kane marrë pjesë dhe kanë ndikuar fuqimisht në debatet dhe forumet në komunitet, kombëtare, rajonale, globale dhe ndërkombëtare.

27. Prej vitit 1975, njohuritë për gjendjen e grave dhe burrave, janë rritur përkatësisht dhe është kontribuar për veprime të mëtejshme që promovojnë barazinë midis grave e burrave. Në disa vende, janë arritur ndryshime të rëndësishme në marrëdhëniet midis grave e burrave, veçanërisht atje ku ka pasur përparime të mëdha në arsimin për gratë dhe rritje të dukshme në pjesëmarrjen e tyre në fuqinë punëtore të paguar. Kufijtë e ndarjes gjinore të punës midis roleve prodhuese dhe riprodhuese, janë gradualisht duke u tejkaluar, pasi që gratë kanë filluar të hyjnë në fushat e punës të dominuar më parë

nga burrat dhe burrat kanë filluar të pranojnë më tepër përgjegjësitë e detyrave shtëpiake, përfshirë kujdesin për fëmijët. Megjithatë, ndryshimet në rolet e grave kanë qenë më të mëdha e më të shpejta se ndryshimet në rolet e burrave. Në shumë vende, dallimet midis të arriturave dhe veprimtarive të grave e burrave ende nuk janë të pranuar si pasojë e roleve gjinore shoqërisht të ndërtuara e jo për shkak të dallimeve të pandryshueshme biologjike.

28. Për më tepër, edhe 10 vite pas Konferencës së Najrobot, barazia midis grave dhe burrave ende nuk është arritur. Mesatarisht gratë përfaqësojnë 10% të të gjithë ligjbërësve të zgjedhur në tërë botën dhe në shumicën e strukturave administrative kombëtare e ndërkombëtare, në publike dhe në ato private, ato ende mbeten të nënpërfaqësuar. Kombet e Bashkuara nuk janë përjashtim. Edhe pesëdhjetë vite pas krijimit Kombet e Bashkuara vazhdojnë të mohojnë vetë përfitimet e udhëheqjes së grave me nënpërfaqësimin e tyre në nivelet e vendimmarrjes brenda Sekretariatit dhe agjencive të specializuara.

29. Gratë luajnë një rol kritik në familje. Familja është njësi bazë e shoqërisë dhe si e tillë duhet fuqizuar. Ajo ka të drejtë të marrë mbrojtje dhe mbështetje të gjithanshme. Në sisteme të ndryshme politike, sociale dhe kulturore, ekzistojnë larmi formash të familjes. Të drejtat, aftësitë dhe përgjegjësitë e anëtarëve të familjes, duhet të respektohen. Gratë japin një kontribut të madh në mirëqenien e familjes dhe në zhvillimin e shoqërisë, e cila ende nuk njihet ose nuk konsiderohet në rëndësinë e saj të plotë. Dallimi social i maternitetit, të qenit nënë dhe roli i prindërve në familje dhe në edukimin e fëmijëve, duhet njohur. Edukimi i fëmijëve kërkon përgjegjësi e përbashkët të prindërve, të grave dhe burrave dhe të shoqërisë si e tërë. Materniteti, të qenit nënë, prindërsia dhe roli i grave si krijuese të jetës, nuk duhet të jetë bazë për diskriminim ose kufizim për pjesëmarrjen e plotë të tyre në shoqëri. Duhet të njihet gjithashtu roli i rëndësishëm, që luajnë gratë në disa vende për kujdesin për anëtarët e tjerë të familjes së tyre.

30. Përderisa niveli i rritjes së popullsisë së botës është në rënie, në të njëjtën kohë numri absolut i popullsisë së botës është më i larti, me një shtesë aktuale prej afërsisht 86 milion njerëz në vit. Dy trende të tjera të mëdha demografike kanë pasur efekte të thella anësore në raportin e varësisë brenda familjeve. Në shumë vende në zhvillim, 45 deri 50 % e popullsisë është më e re se 15 vjeç, ndërsa në kombet e industrializuara edhe numri edhe proporcioni i popullsisë së moshuar është në rritje. Sipas projeksioneve të Kombeve të Bashkuara, deri në vitin 2025 72% e popullsisë mbi 60 vjeç do të jetojnë në vendet në zhvillim, dhe më shumë se gjysma e kësaj popullsie do të jenë gra. Kujdesi për fëmijët, të sëmurët dhe të moshuarit, është një përgjegjësi që bie në masë joproporcionale mbi gratë, si shkak i mungesës së

barazisë dhe shpërndarjen e pabalancuar të punës së paguar dhe të papaguar midis grave dhe burrave.

31. Shumë gra ballafaqohen me barriera të veçanta për shkak të faktorëve të ndryshëm përveç atyre gjinorë. Shpesh këta faktorë të ndryshëm izolojnë ose marginalizojnë gratë. Atyre, me fjalë të tjera, u mohohen të drejtat e njeriut, ose kanë mungesë qasjeje ose u është mohuar qasja në arsimim, trajnim profesional, punësim, banim dhe vetëmjaftueshmëri ekonomike si dhe janë të përjashtuara nga proceset e vendimmarrjes. Këtyre grave u është mohuar edhe mundësia për të kontribuar në komunitetin e tyre si pjesë e integritit.

32. Dhjetëvjeçari i kaluar gjithashtu ka qenë dëshmi e një njohjeje në rritje të interesave dhe shqetësimeve të dallueshme të grave indigjene, identiteti, traditat kulturore dhe format e organizatave shoqërore të cilave, zgjerojnë dhe fuqizojnë komunitetet në të cilat jetojnë. Gratë indigjene shpesh ballafaqohen me barriera edhe si gra edhe si anëtare të komuniteteve indigjene.

33. Në 20 vitet e shkuara, bota ka parë një shpërthim në fushën e komunikimit. Me përparimet në teknologjinë e kompjuterit dhe televizionin satelitor dhe kabllor, qasja globale në informata vazhdon të rritet dhe të zgjerohet, duke krijuar mundësi të reja për pjesëmarrjen e grave në komunikime dhe masmedia, si dhe për shpërndarjen e informatave lidhur me gratë. Nga ana tjetër, rrjetet e komunikimit global janë përdorur për të përhapur imazhet stereotipe dhe nënçmuese për gratë për qëllime të ngushta komercializmi e konsumi. Përderisa gratë të mos marrin pjesë edhe në fushën teknike dhe të vendimmarrjes edhe në atë të komunikimit dhe në masmedia, duke përfshirë artet, ato do të vazhdojnë të keqprezantohen dhe vetëdija lidhur me realitetin e jetës së grave do të vazhdojë të jetë e mangët. Mediat kanë një mundësi të madhe për të nxitur përparimin e grave dhe barazinë e grave dhe të burrave duke i portretizuar gratë dhe burrat në një mënyrë jostereotipe, të ndryshme dhe të balancuar, si dhe duke respektuar dinjitetin dhe vlerën e individit njerëzor.

34. Degradimi i vazhdueshëm i mjedisit, që ndikon në jetën e të gjithë njerëzve, shpesh ka një ndikim më të drejtpërdrejtë në gratë. Shëndeti i grave dhe jetesa e tyre kërcënohen nga ndotja dhe mbeturinat toksike, shpyllëzimi në shkallë të gjerë, shkretëtirat, thatësira dhe harxhimi i dheut dhe të resurseve detare e bregdetare, me rastet gjithnjë më të shpeshta të problemeve shëndetësore të shkaktuara nga ndotja mjedisore, madje edhe me raste të raportuara të vdekjes së grave dhe vajzave. Më të infektuarat janë gratë rurale dhe ato indigjene, jetesa e të cilave dhe mbijetesa e përditshme varet drejtpërdrejt nga ekosistemet e qëndrueshme.

35. Varfëria dhe degradimi i mjedisit janë të ndërlidhur ngushtë. Përderisa varfëria shkakton disa lloje të stresit mjedisor, një shkak madhor i përkeqësimit të vazhdueshëm të mjedisit global janë modelet

e paqëndrueshme të konsumit dhe të prodhimit, veçanërisht në vendet e industrializuara, të cilat janë arsye për shqetësim serioz dhe përkeqësojnë varfërinë dhe mosbalancimet.

36. Trendet globale kanë sjellë ndryshime qenësore në strukturat dhe strategjitë e mbijetesës së familjes. Migracioni nga fshati në qytet është rritur së tepërmi në të gjitha rajonet. Popullsia globale urbane parashihet të arrijë 47% të popullsisë së përgjithshme në vitin 2000. Sipas vlerësimeve 125 milionë njerëz janë emigrantë, refugjatë dhe njerëz të zhvendosur, gjysma e të cilëve jetojnë në vendet në zhvillim. Këto lëvizje masive të njerëzve kanë pasoja të thella për strukturat dhe mirëqenien e familjes, si dhe kanë pasoja të pabarabarta në gratë dhe burrat, duke përfshirë në shumë raste shfrytëzimin seksual të grave.

37. Sipas vlerësimeve të Organizatës Botërore të Shëndetësisë (OBSH) prej fillimit të 1995-ës numri i rasteve të grumbulluara të sindromës së mungesës imunitare të përfutur (AIDS) ishte 4,5 milion. Llogaritet se rreth 19.5 milion burra, gra dhe fëmijë, janë infektuar me virusin e deficiencës imunitare njerëzore (HIV) qëkur ai u diagnostikua për herë të parë dhe llogaritet që edhe rreth 20 milionë të tjerë do të infektohen deri në fund të këtij dhjetëvjeçari. Tek rastet e reja, gratë janë dy herë më shumë të infektuara se burrat. Në shkallën e hershme të pandemisë së SIDA-s nuk ishin të infektuara aq shumë gra; megjithatë tani janë të infektuara rreth 8 milionë gra. Gratë e reja dhe adoleshentët janë veçanërisht të cenuar. Është vlerësuar se deri në vitin 2000 më se 13 milion gra do të jenë të infektuara dhe rreth 4 milion gra do të vdesin nga sëmundjet e lidhura me SIDA-n. Përveç kësaj vlerësohet se edhe rreth 250 milion raste të reja të sëmundjeve seksualisht të transmetueshme do të shfaqen çdo vit. Shkalla e transmetimit të sëmundjeve seksualisht të transmetueshme, përfshirë HIV/AIDS, është në rritje në një shkallë alarmante midis grave dhe vajzave, veçanërisht në vendet në zhvillim.

38. Prej vitit 1975, janë përhapur njohuri dhe informata të spikatura rreth statusit të grave dhe kushteve në të cilat ato jetojnë. Nëpër tërë ciklin e jetës së tyre, ekzistenca e përditshme e grave dhe aspiratat afatgjatë janë kufizuar nga qëndrimet diskriminuese, strukturat e padrejta sociale dhe ekonomike, si dhe nga mungesa e burimeve në shumicën e vendeve të cilat pengojnë pjesëmarrjen e tyre të plotë dhe të barabartë. Në një numër vendesh, praktika e përzgjedhjes së gjinisë para lindjes, shkalla e lartë e vdekshmërisë midis vajzave shumë të reja dhe përqindja më e ultë e regjistrimit të vajzave në shkollë krahasuar me djemtë tregojnë që “preferenca për djalin” zvogëlon qasjen vajzave në ushqim, arsimim dhe kujdes shëndetësor, madje edhe në vetë jetesë. Diskriminimi kundër grave fillon që në shkallët më të hershme të jetës dhe për këtë arsye duhet të adresohet që nga ajo periudhë e tutje.

39. Vajza e të sotmes është gruaja e të nesërme. Aftësitë, idetë dhe energjitë e vajzave, janë jetësore për arritjen e plotë të synimeve të

barazisë, zhvillimit dhe paqes. Që të zhvillohen mundësitë e plota të vajzave ato duhet të zhvillohen në një mjedis i cili bën të mundur përmbushjen e nevojave të saja shpirtërore, intelektuale dhe materiale për mbijetesë, mbrojtje dhe zhvillim dhe ku mbrohen të drejtat e saj të barabarta. Nëse gratë do të jenë partnere të barabarta me burrat në çdo aspekt të jetës dhe të zhvillimit, tani është koha për të njohur dinjitetin njerëzor dhe vlerën e fëmijëve vajza dhe për të siguruar gëzimin e plotë të të drejtave njerëzore dhe lirive themelore, duke përfshirë të drejtat e siguruara nga Konventa për të Drejtat e Fëmijës,¹¹ ratifikimi universal i së cilës inkurajohet fuqimisht. Mirëpo, ende ekzistojnë dëshmi në mbarë botën se diskriminimi dhe dhuna kundër vajzave fillon në fazat më të hershme të jetës dhe vazhdon e pazvogëluar gjatë gjithë jetës së tyre. Ato shpesh kanë më pak qasje në ushqim, kujdes shëndetësor fizik e mendor dhe arsimim dhe gëzojnë më pak të drejta, mundësi dhe përfitime të fëmijërisë dhe adoleshencës sesa djemtë. Ato shpesh u nënshtrohen formave të ndryshme të shfrytëzimit ekonomik dhe seksual, pedofilisë, prostitucionit të detyruar dhe ndoshta shitjes së organeve dhe indeve të tyre, dhunës dhe praktikave të dëmshme siç janë vrasja e foshnjave të gjinisë femërore dhe përzgjedhja e gjinisë para lindjes, incesti, gjymtimi gjeneral femëror dhe martesë e hershme, përfshirë martesën e fëmijëve.

40. Gjysma e popullsisë së botës është nën moshën 25 vjeç dhe shumica e rinisë së botës – më tepër se 85% – jetojnë në vendet në zhvillim. Politikëbërësit duhet të njohin implikimet e këtyre faktorëve demografikë. Duhet të merren masa të veçanta për të siguruar që gratë e reja të kenë aftësitë jetësore të nevojshme për pjesëmarrje aktive dhe efektive në të gjitha nivelet e udhëheqjes sociale, kulturore, politike dhe ekonomike. Do të jetë kritike për komunitetin ndërkombëtar të demonstrojë një zotim të ri për të ardhmen – një zotim që frymëzon një brez të ri të grave dhe burrave për të punuar së bashku për një shoqëri më të drejtë. Ky brez i ri udhëheqësish duhet të pranojë dhe promovojë një botë në të cilën çdo fëmijë është i lirë nga padrejtësia, shtypja dhe pabarazia, i lirë të zhvillojë potencialin e saj/tij. Për këtë qëllim, parimi i barazisë së grave dhe burrave duhet të jetë pjesë përbërëse e procesit të shoqërorizimit.

Kapitulli III – FUSHAT KRITIKE TE INTERESIT

41. Përparimi i grave dhe arritja e barazisë midis grave dhe burrave është një çështje e të drejtave të njeriut dhe një kusht për drejtësi sociale dhe nuk duhet parë i izoluar si një çështje e grave. Ato janë mënyra e vetme për të ndërtuar një shoqëri të qëndrueshme, të drejtë dhe të zhvilluar. Fuqizimi i grave dhe barazia midis burrave dhe grave

¹¹ Rezolutë e Asamblesë së Përgjithshme 44/25, aneks

janë të parakushte për arritjen e sigurisë politike, sociale, kulturore dhe mjedisore ndërmjet të gjithë popujve.

42. Shumica e objektivave të ngritura në Strategjitë e Najrobit për të Ardhmen dhe Përparimin e Grave, ende nuk janë arritur. Pavarësisht nga përpjekjet e qeverive, po ashtu edhe të organizatave joqeveritare dhe grave e burrave kudo në botë barrierat për fuqizimin e grave ende ekzistojnë. Krizat e gjera politike, ekonomike dhe ekologjike, vazhdojnë në shumë pjesë të botës. Ndërmjet tyre janë luftërat e agresionet, konfliktet e armatosura, kolonizimi ose forma të tjera të dominimit të huaj ose pushtimit të huaj, luftërat civile dhe terrorizmi. Këto situata, të kombinuara me diskriminimin sistematik ose atë de facto, shkelja e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore të të gjitha grave apo mos mbrojtja e këtyre të drejtave, si dhe të drejtave të tyre civile, kulturore, ekonomike, politike dhe sociale, duke përfshirë edhe të drejtën për zhvillim dhe qëndrimet e përfshira paragjyquese ndaj grave dhe vajzave janë vetëm disa nga pengesat të hasura që nga Konferenca Botërore për Rishikimin dhe Vlerësimin e Arritjeve të Dhjetëvjeçarit të Kombeve të Bashkuara për Gratë: Barazi, Zhvillim dhe Paqe, të vitit 1985.

43. Një rishikim i progresit që nga Konferenca e Najrobit nënvizon fushat që kërkojnë vëmendje të veçantë, sidomos ato fusha urgjente, që përbëjnë prioritet për veprim. Të gjithë aktorët duhet të fokusojnë veprimet dhe resurset e tyre drejt objektivave strategjikë, që lidhen me fushat kritike të interesit, të cilat janë, në mënyrë të nevojshme, të ndërlydhura, të ndërvarura dhe të një prioriteti të lartë. Ekziston nevoja që këta aktorë të zhvillojnë dhe zbatojnë mekanizmat e përgjegjësive për të gjitha fushat e interesit.

44. Për të arritur këtë qëllim, Qeveritë, bashkësia ndërkombëtare dhe shoqëria civile, duke përfshirë organizatat joqeveritare dhe sektorin privat, janë thirrur të ndërmarrin veprim strategjik në fushat kritike të interesit në vijim:

- Ngarkesa në e vazhdueshme dhe gjithnjë më e madhe e varfërisë mbi gratë,
- Pabarazitë dhe pamjaftueshmëritë dhe qasja e pabarabartë në arsimim dhe trajnim,
- Pabarazitë dhe pamjaftueshmëritë dhe qasja e pabarabartë në përkujdes shëndetësor dhe shërbimet që lidhen me të,
- Dhuna kundër grave,
- Efektet e konfliktit të armatosur ose llojet e tjera të konfliktit në gratë, duke përfshirë edhe ato të cilat jetojnë nën pushtimin e huaj,

- Pabarazia në strukturat dhe politikat ekonomike, në të gjitha format e aktiviteteve prodhuese dhe në qasjen në resurse,
- Pabarazia midis grave dhe burrave në ndarjen e pushtetit dhe vendimmarrjes në të gjitha nivelet,
- Mekanizmat e pamjaftueshëm në të gjitha nivelet për të nxitur përparimin e grave,
- Mungesa e respektit, dhe promovimi dhe mbrojtja e pamjaftueshme e të drejtave njerëzore të grave,
- Krijimi i stereotipave për gratë në media dhe pabarazia në qasjen e grave në media dhe në pjesëmarrjen e tyre në të gjitha sistemet e komunikimit
- Pabarazitë gjinore në menaxhimin e resurseve natyrore dhe në mbrojtjen e mjedisit,
- Diskriminimi i vazhdueshëm dhe shkelja e të drejtave të vajzave të mitura.

Kapitulli IV - OBJEKTIVAT DHE VEPRIMET STRATEGJIKE

45. Në secilën nga fushat kritike të interesit, është bërë diagnoza e problemit dhe janë propozuar objektivat strategjike me Veprime konkrete që duhet të ndërmerren nga aktorë të ndryshëm me qëllim të arritjes së këtyre objektivave. Objektivat strategjike nxirren nga fushat kritike të interesit dhe veprimet specifike që duhet të ndërmerren për t'i arritur ato në të gjitha nivelet e barazisë, zhvillimit dhe paqes – që janë qëllimet e Strategjitë së Najrobit për të Ardhmen dhe Përparimin e Grave – dhe pasqyrojnë ndërvarësinë e tyre. Objektivat dhe veprimet janë të ndërlidhura, janë të një prioriteti të lartë dhe përforcojnë njëra tjetrën. Platforma për Veprim synon të përmirësojë gjendjen e të gjitha grave, pa përjashtim, që shpesh përballen me pengesa të njëjta. Vëmendje e veçantë u duhet kushtuar grupeve që janë më së shumti të lëna anash.

46. Platforma për Veprim pranon se gratë përballen me barriera drejt barazisë së plotë dhe përparimit për shkak të faktorëve të tillë si: racës, moshës, gjuhës, etnisë, kulturës, fesë ose paaftësisë, sepse ato janë gra indigjene ose për shkak se kanë status tjetër. Shumë gra ndeshen me pengesa specifike, që lidhen me statusin e tyre familjar, veçanërisht si nëna kryefamiljare, për shkak të statusit të tyre socio-ekonomiko, përfshirë kushtet e tyre të jetesës në zonat rurale, të izoluara dhe të varfëra. Ka edhe pengesa të tjera shtesë për gratë refugjate, gratë e shpërngulura, përfshirë gratë e zhvendosa brenda vendit si dhe gratë emigrante dhe të shpërngulura, përfshirë gratë

punëtore që migrojnë. Shumë gra gjithashtu janë të ndikuara nga shkatërrimet mjedisore, sëmundjet serioze infektive, dhe forma të ndryshme të dhunës kundër grave.

A. Gratë dhe Varfëria

47. Më shumë se 1 miliardë njerëz në botë, shumica e të cilëve janë gra, jetojnë në kushte të papranueshme të varfërisë, dhe kryesisht në vendet në zhvillim. Varfëria ka shkaktarë të ndryshëm, duke përfshirë edhe ata strukturorë. Varfëria është një problem kompleks, shumëdimensional, me origjinë si në domenin kombëtar ashtu edhe në atë ndërkombëtar. Globalizimi i ekonomisë botërore dhe ndërvarësia gjithnjë më e thellë ndërmjet kombeve, paraqet sfida dhe mundësi për rritjen dhe zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik, si dhe rreziqe dhe pasiguri për të ardhmen e ekonomisë botërore. Klima e pasigurtë globale ekonomike është shoqëruar me ristrukturimin ekonomik, dhe në një numër vendesh me nivelet ngulmuese dhe të pamënaxhueshme të borxhit të jashtëm dhe programeve të përshtatjes strukturore. Përveç kësaj, të gjitha llojet e konfliktit, shpërngulja e njerëzve dhe degradimi i mjedisit, kanë dobësuar kapacitetin e Qeverive për të përmbushur nevojat bazë të popullatave të tyre. Transformimet globale të ekonomisë botërore janë duke ndryshuar rrënjësisht parametrat e zhvillimit social në të gjitha vendet. Një trend i dukshëm ka qenë varfëria e rritur e grave, shtrirja e së cilës ndryshon nga rajoni në rajon. Pabarazitë gjinore në ndarjen e pushtetit ekonomik, janë gjithashtu një faktor i rëndësishëm, që kontribuon në varfërinë e grave. Migracioni dhe ndryshimet që i shkakton në strukturat e familjes krijuar pengesat shtesë për gratë, veçanërisht ato që kujdesen për disa anëtarë të familjes. Politikat makroekonomike duhet të rimendohen dhe riformulohen për të adresuar këto trende. Këto politika përqendrohen thuajse në mënyrë ekskluzive në sektorin formal. Ato gjithashtu kanë tendencë të pengojnë iniciativat e grave dhe nuk marrin në konsiderim ndikimin e ndryshëm në gratë dhe burrat. Për këtë arsye zbatimi i analizave gjinore në një spektër më të gjerë të politikave dhe programeve është kritik për strategjitë e zbutjes së varfërisë. Me qëllim të zhdukjes së varfërisë dhe arritjes të një zhvillimi të qëndrueshëm, gratë dhe burrat duhet të marrin pjesë plotësisht dhe në mënyrë të barabartë në formulimin e strategjive dhe politikave makroekonomike e sociale për zhdukjen e varfërisë. Zhdukja e varfërisë nuk mund të arrihet vetëm përmes programeve kundër varfërisë, por kërkon pjesëmarrje demokratike dhe ndryshime në strukturat ekonomike me qëllim që të sigurojnë qasje për të gjitha gratë në resurse, mundësi dhe shërbime publike. Varfëria manifestohet në mënyra të ndryshme, përfshirë mungesën e të ardhurave dhe të resurseve të mjaftueshme prodhuese për të siguruar një jetesë të qëndrueshme; urinë dhe mosushqyerjen; shëndetin e dobët; mungesën të qasjes apo qasje të kufizuar në arsimim dhe shërbime të tjera bazë; shkallën në rritje të morbiditetit dhe vdekshmërisë nga sëmundjet; pastrehshmërinë dhe vendet

joadekuante për jetesë; mjediset e pasigurta; dhe diskriminimin dhe përjashtimin social. Gjithashtu kjo karakterizohet me mungesën e pjesëmarrjes në vendimmarrje dhe në jetën qytetare, sociale dhe kulturore. Kjo paraqitet në të gjitha vendet – si varfëri masive në vendet e varfëra dhe ato në zhvillim, por edhe si xhepa të varfërisë në mes të pasurisë në vendet e zhvilluara. Varfëria mund të shkaktohet nga një rënie ekonomike që rezulton në humbjen e jetesës, ose nga një katastrofë natyrore apo konflikt. Ka gjithashtu varfëri të punëtorëve me paga të ulëta dhe varfëri absolute të njerëzve që nuk janë pjesë e sistemeve të mbështetjes familjare, institucioneve sociale dhe rrjeteve të sigurisë.

48. Në dhjetëvjeçarin e kaluar numri i grave, që jetonin në varfëri, u rrit në mënyrë të shpërpjesëtuar me numrin e burrave, veçanërisht në vendet në zhvillim. Kohëve të fundit feminizimi i varfërisë është kthyer gjithashtu në një problem të dukshëm në vendet me ekonomi në tranzicion si një pasojë afatshkurtër e proceseve politike, ekonomike dhe transformimit social. Përveç faktorëve ekonomikë, ashpërsisë së roleve gjinore të përcaktuara nga shoqëria dhe qasjes së kufizuar të grave në pushtet, arsimim, trajnime dhe resurse prodhuese, përgjegjësi mund të kenë edhe faktorët tjerë që mund të shfaqen dhe që mund të çojnë drejt pasigurisë për familjet. Mungesa për integrimin e mjaftueshëm të perspektivës gjinore në të gjitha analizat ekonomike dhe në planifikimin dhe adresimin e shkaktarëve strukturorë të varfërisë është gjithashtu një faktor kontribuues.

49. Gratë kontribuojnë në ekonomi dhe në luftimin e varfërisë përmes të punës së paguar dhe asaj të papaguar në shtëpi, në komunitet dhe në vendin e punës. Fuqizimi i grave është një faktor vendimtar në zhdukjen e varfërisë.

50. Përderisa varfëria ndikon ekonomitë shtëpiake si tërësi, për shkak të ndarjes gjinore të punës dhe përgjegjësive për mirëmbajtjen e ekonomisë shtëpiake, gratë bartin një ngarkesë të shpërpjesëtuar, duke u përpjekur të menaxhojnë konsumin dhe prodhimin e ekonomisë shtëpiake në kushtet e mungesës gjithnjë më të madhe. Varfëria është veçanërisht akute për gratë që jetojnë në ekonomitë shtëpiake rurale.

51. Varfëria e grave lidhet drejtpërdrejtë me mungesën e mundësive dhe autonominë ekonomike, mungesën e qasjes në resurset ekonomike, duke përfshirë kreditë, pronësinë e tokës dhe trashëgiminë, mungesën e qasjes në arsimim dhe resurset përkrahëse dhe pjesëmarrjen e tyre minimale në procesin e vendimmarrjes. Varfëria gjithashtu mund t'i detyrojë gratë në situata të tilla ku ato bëhen të cenueshme ndaj shfrytëzimit seksual.

52. Në një numër tepër të madh të vendeve, sistemet e mirëqenies sociale nuk marrin në konsideratë në masë të mjaftueshme kushtet specifike të grave që jetojnë në varfëri, dhe ka një tendencë për të

zvogëluar numrin e shërbimeve të ofruara nga sisteme të tilla. Rreziku i rënies në varfëri është më i madh për gratë sesa për burrat, veçanërisht në moshë të shtyrë, kur sistemet e sigurimit shoqëror bazohen në parimin e punësimit të vazhdueshëm të paguar. Në disa raste gratë nuk e plotësojnë këtë kërkesë për shkak të ndërprerjeve në punën e tyre, për shkak të shpërndarjes së pabarabartë të punës së paguar dhe punës së papaguar. Për më tepër, gratë e moshuara, përballen me pengesa më të mëdha për të rihyrë në ekonominë e tregut.

53. Në shumë vende të zhvilluara, ku niveli i arsimimit të përgjithshëm dhe trajnimit profesional të grave dhe burrave është i ngjashëm dhe ku ekzistojnë sistemet e mbrojtjes kundër diskriminimit, në disa sektorë transformimet ekonomike gjatë dhjetëvjeçarit të shkuar kanë rritur fuqimisht ose papunësinë e grave ose natyrën e pasigurt të punësimit të tyre. Si pasojë përqindja e grave në nivelin e varfërisë është rritur. Në vendet me një nivel të lartë të regjistrimit të vajzave në shkollë, janë ato që lënë sistemin e arsimit më herët, pa ndonjë kualifikim që janë ndërmjet grupeve më të cenueshme në tregun e punës.

54. Në vende me ekonomi në tranzicion dhe në vende të tjera të cilat po përjetojnë transformime fundamentale sociale, ekonomike e politike, këto transformime shumë shpesh kanë çuar në një zvogëlim në të ardhurat e grave ose i kanë privuar gratë nga të ardhurat.

55. Veçanërisht në vendet në zhvillim, kapaciteti prodhues i grave duhet të rritet përmes qasjes të kapitali, resurset, kredia, toka, teknologjia, informatat, asistenca teknike dhe trajnimet, me qëllim të rritjes së të ardhurave të tyre dhe përmirësimit të të ushqyerit, arsimimit, kujdesit shëndetësor dhe statusit përbrenda ekonomive shtëpiake. Shfrytëzimi i potencialit produktiv të grave është qenësore për të thyer ciklin e varfërisë në mënyrë që gratë të mund të shfrytëzojnë plotësisht përfitimet e zhvillimit dhe produktet e vetë punës së tyre.

56. Zhvillimi i qëndrueshëm dhe rritja ekonomike e cila është edhe mbështetëse dhe e qëndrueshme, janë të mundshme vetëm përmes përmirësimit të statusit ekonomik, shoqëror, politik, ligjor dhe kulturor të grave. Zhvillimi i drejtë shoqëror që pranon fuqizimin e të varfërve, veçanërisht të grave, për shfrytëzimin e resurseve mjedisore në mënyrë të qëndrueshme, është një themel i nevojshëm për zhvillimin e qëndrueshëm.

57. Suksesi i politikave dhe masave që synojnë përkrahjen apo fuqizimin e promovimit të barazisë gjinore dhe përmirësimi i statusit të grave, do të bazohen në integrimin e perspektivës gjinore në politikat e përgjithshme që kanë të bëjnë me të gjitha sferat e shoqërisë si dhe zbatimin e masave pozitive me përkrahje adekuate institucionale dhe financiare në të gjitha nivelet.

Objektivi strategjik A.1.

Të rishikohen, të miratohen dhe të përkrahen politikat makroekonomike dhe strategjitë zhvillimore të cilat adresojnë nevojat dhe përpjekjet e grave në varfëri.

Aksionet që duhen ndërmarrë

58. Nga Qeveritë:

- a) Me pjesëmarrje të plotë dhe barabartë të grave të rishikohen dhe të modifikohen politikat sociale dhe makroekonomike me qëllim të arritjes së objektivave të Platformës për Veprim;
- b) Të analizohen nga perspektiva gjinore, politikat dhe programet – duke përfshirë ato që kanë të bëjnë me stabilitetin ekonomik, përshtatjen strukturore, problemet e borxhit të jashtëm, taksimin, investimet, punësimin, tregjet dhe të gjithë sektorët relevantë të ekonomisë – në lidhje me ndikimin e tyre në varfëri, në pabarazi dhe veçanërisht atë mbi gratë; vlerësimin e ndikimit në mirëqenien dhe në kushtet e familjes, përshtatja e tyre, sipas nevojës, për të promovuar një shpërndarje më të barabartë të resurseve prodhuese, pasurisë, mundësive, të ardhurave dhe shërbimeve;
- c) Të ndjekin dhe zbatojnë politika sektoriale dhe makroekonomike të qëndrueshme, që janë hartuar dhe monitoruar me pjesëmarrjen e plotë dhe të barabartë të grave, të inkurajojnë rritjen e qëndrueshme ekonomike me bazë të gjerë, të adresojnë shkaqet strukturore të varfërisë dhe të punojnë drejt zhdukjes së varfërisë dhe zvogëlimit të pabarazisë gjinore përbrenda kornizës së përgjithshme të arritjes së zhvillimit të qëndrueshëm të përqendruar tek njerëzit.
- d) Të ristrukturojnë dhe të bëjnë si cak ndarjen e shpenzimeve publike me qëllim të promovimit të mundësitë ekonomike për gratë dhe qasjen e barabartë në burimet e prodhimit dhe për të adresuar nevojat themelore sociale, arsimore dhe shëndetësore të grave, veçanërisht të atyre që jetojnë në varfëri;
- e) Të zhvillojnë sektorët bujqësorë dhe të peshkimit, kudo që është e nevojshme, me qëllim të garantimit të duhur të ushqimit të përshtatshëm të ekonomive shtëpiake dhe kombëtare dhe vetëmjaftueshmërinë ushqimore, përmes ndarjes së resurseve të nevojshme financiare, teknike dhe njerëzore;

- f) Të zhvillojnë politikat dhe programet, për promovimin e shpërndarjes së barabartë të ushqimit brenda ekonomive shtëpiake;
- g) Të sigurojnë rrjete adekuate sigurie dhe të fuqizojnë sistemet përkrahëse shtetërore dhe të komunitetit, si një pjesë përbërëse e politikës sociale, me qëllim që t'u bëjë të mundur grave që jetojnë në varfëri t'i bëjnë ballë mjediseve ekonomike të pafavorshme dhe të mbrojnë jetesën e tyre, pasuritë e tyre dhe të ardhurat në kohë krize;
- h) Të gjenerojnë politika ekonomike që kanë ndikim pozitiv mbi punësimin dhe të ardhurat e punëtoreve gra edhe në sektorin formal edhe atë joformal, dhe të adoptojnë masat specifike për të adresuar papunësinë e grave, veçanërisht papunësinë e tyre afatgjatë;
- i) Të formulojnë dhe të zbatojnë, kudo që është e nevojshme, politika specifike ekonomike, sociale, bujqësore dhe të tjera të ndërlidhura, si mbështetje të familje me gratë si kryefamiljare.
- j) Të zhvillojnë dhe zbatojnë programet kundër varfërisë, duke përfshirë skemat e punësimit, që përmirësojnë qasjen në ushqim për gratë të cilat jetojnë në varfëri, përfshirë edhe përmes përdorimit të mekanizmave për krijimin e çmimeve të përshtatshme dhe atyre për shpërndarje;
- k) Të garantojnë realizimin e plotë të të drejtave të njeriut të gjitha grave emigrante, përfshirë punëtoreve emigrante, dhe mbrojtjen e tyre kundër dhunës dhe shfrytëzimit; të prezantojnë masa për fuqizimin grave të cilat janë të dokumentuara si emigranteve, duke përfshirë punëtorët emigrante, dhe të lehtësojnë punësimin produktiv të grave të dokumentuara si emigrante përmes njohjes më të madhe të të gjitha aftësive të tyre, arsimimit dhe dokumenteve në një vend të huaj, dhe të ndihmojnë integrimin e plotë të tyre në fuqinë punëtore;
- l) Të prezantojnë masat për integrim ose reintegrim të grave që jetojnë në varfëri dhe atyre shoqërisht të marginalizuara, në punësimin produktiv dhe integrimin ekonomik, të garantojnë që gratë e zhvendosura të kenë qasje të plotë në mundësitë ekonomike, dhe që kualifikimet dhe aftësitë e grave emigrante dhe refugjate të njihen;
- m) T'u bëjnë të mundur grave që të përfitojnë banesa me çmim të volitshëm qasje në tokë, mes të tjerave duke hequr të gjitha pengesat për t'u qasur këtyre, me theks të veçantë në

plotësimin e nevojave të grave, sidomos atyre që jetojnë në varfëri, dhe grave kryefamiljare;

- n) Të formulojnë dhe të zbatojnë politikat dhe programet të cilat zgjerojnë mundësinë e qasjes së grave që merren me prodhime bujqësore dhe të peshqve (duke përfshirë fermerët dhe prodhuesit e vegjël, veçanërisht në zonat rurale) në shërbimet financiare, teknike, të zgjerimit dhe marketingut; të ofrojnë qasje dhe kontroll të tokës, infrastrukturës dhe teknologjisë së përshtatshme me qëllim të rritjes së të ardhurave të grave dhe promovimit të sigurisë së ushqimit të ekonomive shtëpiake, posaçërisht në zonat rurale dhe, ku është e nevojshme, të inkurajojnë zhvillimin e kooperativave të prodhuesve të bazuara në tregun ekzistues;
- o) Të krijojnë sistemet e sigurimeve sociale kudo që ato nuk ekzistojnë, ose t'i rishikojnë ato me një këndvështrim në të cilin të vendosen mbi një bazament të njëjtë gratë dhe burrat, në çdo shkallë të jetës së tyre;
- p) Të garantojnë qasje në shërbimet pa pagesë ose shërbimet ligjore me kosto të ulët, duke përfshirë literaturën ligjore, veçanërisht ato që janë hartuar për të përfshirë gratë që jetojnë në varfëri;
- q) Të marrin masa të veçanta për të nxitur dhe fuqizuar politikat dhe programet për gratë indigjene me pjesëmarrjen e tyre të plotë dhe respektimin e shumëllojshmërisë kulturore të tyre, në mënyrë që ato të kenë mundësi zgjedhjeje në procesin e zhvillimit me qëllim që të zhdukin varfërinë që ndikon mbi to.

59 Nga institucionet multilaterale financiare dhe ato për zhvillim, përfshirë Bankën Botërore, Fondin Monetar Ndërkombëtar dhe institucionet rajonale të zhvillimit, dhe përmes bashkëpunimit bilateral për zhvillim:

- a) Në pajtim me zotimet e bëra në Samitin Botëror për Zhvillim Social, duhet të kërkojnë të mobilizojnë resurse të reja dhe shtesë financiare, që janë adekuate dhe të parashikueshme dhe të cilat mobilizohen në atë mënyrë që të maksimizojnë disponueshmërinë e resurseve të tilla dhe të shfrytëzimit të të gjitha resurseve dhe mekanizmave monetarë, me qëllim të kontributit drejt qëllimit të zhdukjes së varfërisë dhe që si cak të kenë gratë që jetojnë në varfëri;
- b) Të fuqizohet kapaciteti analitik me qëllim të fuqizimit më sistematik të perspektivave gjinore dhe integritet të tyre në hartimin dhe zbatimin e programeve të huave, duke përfshirë

programet për përshtatje strukturore dhe ato të rimëkëmbjes ekonomike;

- c) Të gjejnë zgjidhje efektive zhvillimore dhe të qëndrueshme për problemet e borxhit të jashtëm me qëllim që të ndihmojë ato për të financuar programet dhe projektet që si çak kanë zhvillimin, duke përfshirë përparimin e grave, në mes tjerash edhe përmes zbatimit të menjëhershëm të kushteve të faljes së borxhit të rënë dakord në Klubin e Parisit në Dhjetor të vitit 1994, i cili parashikon zvogëlimin e borxhit, përfshirë anulimin e borxhit ose masa të tjera të lehtësimit të borxhit, dhe të zhvillimit të teknikave të shndërrimit të borxhit, të cilat janë zbatuar në programet dhe projektet e zhvillimit social në përputhje me prioritetet e Platformës;
- d) Të ftojnë institucionet financiare ndërkombëtare që të ekzaminonjë qasjet inovative për të ndihmuar vendet me të ardhura të ulëta me një raport të lartë të borxhit multilateral, me qëllim të zbutjes së ngarkesës së borxhit të tyre.
- e) Të garantojnë që programet e përshtatjes strukturore janë hartuar për të minimizuar efektet e tyre negative mbi grupet dhe komunitetet e cenueshme ose të pafavorizuara dhe të sigurojë efektet pozitive në grupe dhe komunitete të tilla duke parandaluar marginalizimin e tyre në veprimtaritë ekonomike e sociale dhe duke sajuar masa për të siguruar që ato të fitojnë qasje dhe kontroll mbi resurset ekonomike dhe veprimtaritë ekonomike e sociale; të ndërmarrin veprime për të zvogëluar pabarazinë dhe pabarazinë ekonomike;
- f) Të rishikojnë ndikimin e programeve të përshtatjes strukturore në zhvillimin social me anën e vlerësimeve të ndikimit social nga këndvështrimi gjinor dhe metoda të tjera relevante, me qëllim që të zhvillojë politika për të zvogëluar efektet e tyre negative dhe për të përmirësuar ndikimin e tyre pozitiv, duke siguruar që gratë nuk do të mbajnë një ngarkesë të shpërpjestuar të kostos së tranzicionit; duke përmbytur përshtatjen e huazimit me huadhënie të shtuar që ka si çak zhvillimin social;
- g) Të krijojnë një mjedis të përshtatshëm që do t'u lejojë grave të ndërtojnë dhe të mirëmbajnë jetesë të qëndrueshme;

60. Nga organizatat joqeveritare kombëtare dhe ndërkombëtare dhe grupet e grave:

- (a) Të gjitha palët e përfshira në procesin e zhvillimit, përfshirë institucionet akademike, organizatat joqeveritare dhe grupet e komuniteteve dhe të grave, të mobilizojnë për të përmirësuar efektivitetin e programeve kundër varfërisë të

dedikuara grupeve më të varfra e më të pafavorizuara të grave, siç janë gratë rurale dhe ato indigjene, gratë kryefamiljare, gratë e reja dhe gratë e moshuara, gratë emigrante dhe ato refugjate, si dhe gratë me paaftësi, duke pranuar se zhvillimi social është në radhë të parë përgjegjësi e Qeverive;

- (b) Të angazhohen në lobimin dhe themelimin e mekanizmave monitorues, sipas nevojës, dhe veprimtari të tjera relevante për të garantuar zbatimin e rekomandimeve për zhdukjen e varfërisë të nënvizuara në Platformën për Veprim dhe që synojnë sigurimin e llogaridhënies dhe transparencës nga Shteti dhe sektorët privatë;
- (c) Të përfshijnë në veprimtaritë e tyre gratë me nevoja të ndryshme; të njohin se organizatat rinore janë duke u bërë gjithnjë e më tepër partnerë efektivë në programet e zhvillimit;
- (d) Në bashkëpunim me Qeverinë dhe sektorët privatë, të marrin pjesë në zhvillimin e strategjisë gjithëpërfshirëse kombëtare për përmirësimin e shërbimeve shëndetësore, arsimore dhe sociale, në mënyrë që vajzat dhe gratë e të gjitha moshave të cilat jetojnë në varfëri të kenë qasje të plotë për shërbimet e tilla. Të kërkojnë financimin për të siguruar qasje në shërbime e cila ka një perspektivë gjinore dhe për të zgjeruar këto shërbime më qëllim që të arrijnë zonat rurale dhe të largëta të cilat nuk janë të mbuluara nga institucionet qeveritare;
- (e) Në bashkëpunim me Qeveritë, punëdhënësit, partnerët e tjerë socialë dhe palët relevante, të kontribuojnë në zhvillimin e politikave të arsimit, trajnimit dhe ritrajnimit për të siguruar që gratë të mund të përfitojnë një varg të gjerë aftësish për ti përmbushur kërkesat e reja;
- (f) Të mobilizohen për të mbrojtur të drejtat e grave për qasje të plotë dhe të barabartë në resurset ekonomike, duke përfshirë të drejtën e trashëgimisë dhe pronësisë së tokës dhe pronësi të tjera, kredi, resurse natyrore dhe teknologji të përshtatshme.

Objektivi strategjik A.2.

Të rishikohen ligjet dhe praktikat administrative për të siguruar të drejta të barabarta dhe qasje të barabartë të grave në resurset ekonomike.

Aksionet që duhen ndërmarrë:

61. Nga Qeveritë:

- a) Të sigurojnë qasje në shërbimet ligjore pa pagesë ose me kosto të ulët, duke përfshirë literaturë ligjore, veçanërisht të hartuar për të arritur gratë që jetojnë në varfëri;
- b) Të ndërmarrin reforma legjislativë dhe administrative për t'u dhënë grave qasje të plotë dhe të barabartë në resurset ekonomike, duke përfshirë të drejtën e trashëgimisë dhe pronësisë së tokës dhe pronësi të tjera, kredi, resurse natyrore dhe teknologji të përshtatshme;
- c) Të marrin në konsideratë ratifikimin e Konventës Nr. 169 të Organizatës Ndërkombëtare të Punës (ILO), si pjesë e përpjekjeve të tyre për të promovuar dhe për të mbrojtur të drejtat e popujve indigjenë.

Objektivi strategjik A.3.

T'u sigurojë grave qasje në kurse dhe mekanizma dhe institucione kreditore.

Aksionet që duhen ndërmarrë

62. Nga Qeveritë:

- a) Të rrisin qasjen e grave të pafavorizuara, duke përfshirë ndërmarrëset, në zonat rurale, të largëta dhe ato urbane në shërbimet financiare përmes fuqizimit të lidhjeve midis bankave formale dhe organizatave ndërmjetëse të huazimit, duke përfshirë mbështetjen legjislativë, trajnimin për gratë dhe fuqizimin institucional për institucionet ndërmjetëse me qëllim të mobilizimit të kapitalit për këto institucione dhe rritjen e sasisë së kredisë në dispozicion;
- b) Të inkurajojnë lidhjet midis institucioneve financiare dhe organizatave joqeveritare dhe të mbështesin praktika të reja të huazimit, duke përfshirë ato që integrojnë kredinë me shërbimet dhe trajnimet për gratë dhe që sigurojnë mundësi kredie për gratë rurale.

63. Nga Bankat komerciale, institucionet e specializuara financiare dhe nga sektori privat në ekzaminimin e politikave të tyre:

- a) Të përdorin metodologjitë e kredisë dhe të kursimeve që janë efektive në arritjen e grave në varfëri dhe novatore në zvogëlimin e kostove të transaksionit dhe ripërcaktimin e rrezikut;
- b) Të hapin dritare të veçanta për kredi për gratë, duke përfshirë gratë e reja, të cilave u mungon qasja në resurset tradicionale dhe kolaterali;
- c) Të thjeshtësojnë praktikat bankare, për shembull me zvogëlimin e depozitës minimale dhe kërkesat tjera për hapjen e llogarive bankare;
- d) Të sigurojnë pjesëmarrjen dhe pronësinë e përbashkët, ku është e mundur, të klienteve në vendimmarrje të institucioneve që sigurojnë kredi dhe shërbime financiare.

64. Nga organizatat e multilaterale dhe bilaterale të bashkëpunimit zhvillimor:

Përmes ofrimit të kapitalit dhe/ose resurseve të mbështesin, institucionet financiare të cilat u shërbejnë grave ndërmarrëse dhe prodhuese të cilat kanë të ardhura të ulëta, të cilat kanë ndërmarrje të vogla dhe mikro, edhe në sektorin formal edhe në atë joformal.

65. Nga Qeveritë dhe institucionet financiare multilaterale, ku është e mundshme:

Të mbështesin institucionet që përmbushin standardet e larta në përfshirjen e një numri të lartë të grave dhe burrave me të ardhurave të ulëta përmes kapitalizimit, rifinancimit dhe mbështetjes për zhvillim institucional në format që përkrahin vetëmjaftueshmërinë.

66. Nga organizatat ndërkombëtare:

Të rrisin sasinë e financimit për programet dhe projektet e hartuara për promovimin e aktiviteteve të qëndrueshme dhe prodhuese të ndërmarrëseve për gjenerim të ardhurash të grave të pafavorizuara dhe grave që jetojnë në varfëri.

Objektivi strategjik A.4.

Të zhvillojë metodologjitë me bazë gjinore dhe të kryej kërkime që do të adresojnë çështjen e feminizimit të varfërisë.

Aksionet që duhen ndërmarrë:

67. Nga Qeveritë, organizatat ndërqeveritare, institucionet akademike dhe kërkimore dhe nga sektori privat:

- a) Të zhvillojnë metodologji konceptuale dhe praktike për përfshirjen e perspektivës gjinore në të gjitha aspektet e politikëbërjes ekonomike, duke përfshirë edhe planifikimin dhe programet për përshtatje strukturore;
- b) T'i zbatojnë këto metodologji në kryerjen e analizave me ndikim gjinor të të gjitha politikave dhe programeve, duke përfshirë programet e përshtatjes strukturore, dhe shpërndarjen e gjetjeve të kërkimit.

68. Nga organizatat statistikore kombëtare dhe ndërkombëtare:

- a) Të mbledhin të dhëna të ndara në bazë të gjinisë lidhur me varfërinë si dhe të gjitha aspektet e veprimtarisë ekonomike dhe të zhvillojnë treguesit statistikore cilësorë dhe sasiorë për të lehtësuar vlerësimin e performancës ekonomike nga një perspektivë gjinore;
- b) Të zhvillojnë mjete të përshtatshme statistikore për të njohur dhe për të bërë të dukshme të tërë paletën e punëve që kryejnë gratë dhe të gjitha kontributet e tjera për ekonominë kombëtare, duke përfshirë kontributin e tyre në sektorët shtëpiakë dhe të papaguar, dhe për të shqyrtuar marrëdhëniet e punës së papaguar të grave në lidhje me shfaqjen e varfërisë së grave apo cenueshmërisë së tyre kundrejt varfërisë.

B. ARSIMIMI DHE TRAJNIMI I GRAVE

69. Arsimimi është një e drejtë e njeriut dhe një mjet thelbësor për arritjen e qëllimit të barazisë, zhvillimit dhe paqes. Që të dy palët, vajzat dhe djemtë, do të përfitojnë nga arsimimi jo-diskriminues dhe kështu kjo do të kontribuonte drejt marrëdhënieve më të barabarta midis grave dhe burrave. Qasja e barabartë në arsimim dhe fitimi i kualifikimeve arsimore është e nevojshme pasi që më shumë gra do të bëhen agjente të ndryshimit. Dituria e grave është një çelës i rëndësishëm për të përmirësuar shëndetin, ushqyerjen dhe arsimimin

në familje dhe për të fuqizuar gratë për të marrë pjesë në vendimmarrje në shoqëri. Investimi në arsimimin formal e joformal dhe trajnimin për gratë dhe vajzat, i cili ka shkallën jashtëzakonisht të lartë të kthimit ekonomik e social, ka treguar të jetë një nga mjetet më të mira të arritjes së zhvillimit të qëndrueshëm dhe rritjes ekonomike e cila është edhe e vazhdueshme edhe e qëndrueshme.

70. Në nivelin rajonal vajzat dhe djemtë kanë arritur qasje të barabartë në ndjekjen e shkollimit fillor, përveç në disa pjesë të Afrikës, veçanërisht në Afrikën e sub-Saharës dhe Azinë Qendrore, ku qasja në arsimim është ende joadekuate. Vërehet përparim në arsimin e mesëm, ku është arritur qasja e barabartë për vajzat dhe djemtë në disa vende. Regjistrimi i vajzave dhe i grave në arsimin e lartë gjithashtu është rritur në masë të konsiderueshme. Në shumë vende, shkollat private kanë luajtur gjithashtu një rol të rëndësishëm plotësues në përmirësimin e qasjes në arsimim në të gjitha nivelet. Mirëpo, më shumë se pesë vjet pasi që Konferenca Botërore për Arsimim për të Gjithë (Jomtien, Tailandë, 1990) miratoi Deklaratën Botërore për Arsimim për të Gjithë dhe Kornizën për Veprim për të Përbushur Nevojat Themelore të të Mësuarit,¹² për afërsisht 100 milion fëmijë, përfshirë së paku 60 milion vajza, janë pa qasje në shkollimin fillor, dhe më se dy të tretat e 960 milion të rriturve analfabetë të botës janë gra. Shkalla e lartë e analfabetizmit gjendet në shumicën e vendeve në zhvillim, veçanërisht në Afrikën e sub-Saharës dhe disa Shtete Arabe, mbetet një pengesë e ashpër në përparimin e grave dhe në zhvillim.

71. Diskriminimi i qasjes së vajzave në arsimim vazhdon në shumë hapësira, për shkak të qëndrimeve zakonore, martesave dhe shtatzënie të hershme, materialeve arsimore joadekuate me paragjykimet gjinore, ngacmimit seksual dhe mungesës së objekteve shkollore dhe qasjes fizike në objekte të tilla shkollore. Vajzat fillojnë me punë të rënda shtëpie që në moshë tepër të hershme. Vajzat dhe gratë e reja pritet të përkujdesen edhe për përgjegjësitë e edukimit edhe ato shtëpiake, shpesh duke rezultuar me një performancë të varfër shkollore dhe largim të hershëm nga sistemi arsimor. Kjo ka pasoja afatgjata për të gjitha aspektet e jetës së grave.

72. Krijimi i një mjedisi arsimor dhe social ku gratë dhe burrat, vajzat dhe djemtë, do të trajtohen njëllëj dhe do të inkurajohen për të realizuar potencialin e tyre të plotë, duke respektuar lirinë e tyre të mendimit, të ndërjegjes, fesë dhe besimit, dhe ku burimet arsimore promovojnë imazhet jo-stereotipe për gratë dhe burrat, do të jetë efektive në zhdukjen e shkaqeve të diskriminimit të grave dhe pabarazive midis grave dhe burrave.

¹² Raporti përfundimtar i Konferencës Botërore për Arsimim për të Gjithë: Përbushja e Nevojave Themelore të të Mësuarit, Jomtien, Tailandë, 5-9 Mars 1990, Komisioni i Ndër-Agjencive (UNDP, UNESCO, UNICEF, Banka Botërore) për Konferencën Botërore për Arsimim për të Gjithë, Nju Jork, 1990, shtojca 1.

73. Grave duhet t'u mundësohet të përfitojnë nga përvetësimi i vazhdueshëm i njohurive dhe aftësive përtej atyre të përftuara në rini. Ky koncept i të mësuarit jetëgjatë përfshin njohuritë dhe aftësitë e fituara në arsimin dhe trajnimin formal, si edhe të mësuarit që ndodh në mënyra joformale, përfshirë veprimtaritë vullnetare, punën e papaguar dhe njohuritë tradicionale.

74. Programi shkollor dhe materialet mësimore mbeten në një shkallë të lartë me paragjykime gjinore, dhe janë rrallë të ndjeshme ndaj nevojave specifike të grave e vajzave. Kjo përforcon rolet tradicionale femërore e mashkullore, të cilat u mohojnë grave mundësitë për partneritet të plotë dhe të barabartë në shoqëri. Mungesa e vetëdijesimit gjinor të edukatorëve në të gjitha nivelet, fuqizon pabarazitë ekzistuese midis meshkujve dhe femrave duke përforcuese tendencat diskriminuese dhe duke dobësuar vetëbesimin e vajzave. Mungesa e edukatës shëndetësore riprodhuese e seksuale ka një ndikim të thellë në gratë dhe burrat.

75. Programet shkencore në veçanti janë me paragjykime gjinore. Tekstet shkencore nuk i referohen përvojave të përditshme të grave e vajzave dhe nuk shprehin njohuri për gratë shkencëtare. Vajzat shpesh janë të privuara nga arsimit bazë në matematikë dhe trajnime shkencore dhe teknike, të cilat ofrojnë njohuri që ato do të mund të aplikojnë për të përmirësuar jetën e tyre të përditshme dhe për të zgjeruar mundësitë e tyre për punësim. Studimi i lartë në shkencë dhe teknologji përgatit gratë për të marrë një rol aktiv në zhvillimin industrial e teknologjik të vendeve të tyre, që si rrjedhim ka nevojën për një qasje të ndryshme për trajnimin profesional dhe teknik. Teknologjia po ndryshon botën në mënyrë marramendëse dhe ka ndikuar gjithashtu edhe në vendet në zhvillim. Është thelbësore që gratë të mos përfitojnë vetëm nga teknologjia, por gjithashtu të marrin pjesë në proces që nga projektimi deri fazat e zbatimit, monitorimit dhe vlerësimit.

76. Qasja dhe mbajta e vajzave dhe grave në të gjitha nivelet e arsimimit, duke përfshirë nivelin e lartë dhe të gjitha fushat akademike, është një ndër faktorët e përparimit të tyre të vazhdueshëm në veprimtaritë profesionale. Megjithatë, mund të vërehet që vajzat janë ende të përqendruara në një numër të kufizuar të fushave të studimit.

77. Masediat janë një mënyrë e fuqishme e edukimit. Si një mjet edukues masmedia mund të jetë një instrument për edukatorët dhe institucionet qeveritare e joqeveritare për përparimin e grave dhe për zhvillim. Edukimi i kompjuterizuar dhe sistemet e informacionit janë duke u bërë gjithnjë e më shumë një element të rëndësishëm në mësimin dhe përhapjen e njohurive. Veçanërisht televizioni ka ndikimin më të madh tek të rinjtë dhe si i tillë ka mundësi të formojë vlera, qëndrime dhe perceptime të grave dhe vajzave si në mënyrë pozitive ashtu edhe atë negative. Për këtë arsye është qenësore që

edukatorët të mësojnë të tjerët për gjykimin kritik dhe aftësitë analitike.

78. Resurset e ndara për arsimin, veçanërisht për vajzat dhe gratë, në shumë vende janë të pamjaftueshme dhe në disa raste janë zvogëluar edhe më tepër, duke përfshirë edhe kontekstin e politikave dhe programeve të përshtatjes. Ndarja e tillë e pamjaftueshme e resurseve ka një efekt të dëmshëm afatgjatë në zhvillimin njerëzor, veçanërisht në zhvillimin e grave.

79. Në adresimin e qasjes së pabarabartë dhe joadekuate në mundësitë për arsimim, Qeveritë dhe aktorë e tjerë duhet të promovojnë një politikë aktive dhe të dukshme të përfshirjes së perspektivës gjinore në të gjitha politikat dhe programet, në mënyrë që para se të merren vendimet, të bëhet një analizë e efekteve të tyre mbi gratë, përkatësisht burrat.

Objektivi strategjik B.1.

Të sigurohet qasje e barabartë në arsimim.

Aksione që duhen ndërmarrë

80. Nga Qeveritë:

- a) Të përparojnë qëllimin e qasjes së barabartë në arsimim duke ndërmarrë masa për të zhdukur diskriminimin në arsim në të gjitha nivelet që bëhet me bazë gjinore, race, gjuhe, feje, kombi, origjine, moshe ose paaftësie, ose ndonjë formë tjetër diskriminimi dhe, nëse është e nevojshme, të marrin në konsiderim vendosjen e procedurave për ngritjen e ankesave;
- b) Deri në vitin 2000, të arrihet qasje universale për arsimim themelor dhe përfundim të arsimit fillor nga së paku 80% e fëmijëve të moshës së shkollimit fillor; deri në vitin 2005 të eliminohet ndryshimi gjinor në arsimin fillor dhe të mesëm; para vitit 2015 arsimit fillor të jetë gjithëpërfshirës në të gjitha vendet;
- c) Të eliminojnë dallimet gjinore në qasje në të gjitha fushat e arsimit të lartë duke siguruar që gratë të kenë qasje të barabartë në zhvillimin e karrierës, trajnim, bursa dhe specializim, dhe kur është e nevojshme edhe duke adoptuar veprime pozitive;
- d) Të krijojnë një sistem edukimi i ndjeshëm gjinor me qëllim që të sigurojnë mundësi të barabarta arsimimi dhe trajnimit, si dhe pjesëmarrje të plotë e të barabartë të grave në

administratën arsimore, dhe në politikëbërje dhe vendimmarrje;

- e) Në bashkëpunim me prindërit, organizatat joqeveritare, përfshirë organizatat rinore, komunitetet, sektorin privat – t'u ofrojnë grave të reja trajnime akademike e teknike, planifikim karriere, aftësi shoqërore e udhëheqjeje dhe përvojë pune për t'i përgatitur ato që të marrin pjesë plotësisht në shoqëri;
- f) Të rrisin shkallën e regjistrimit dhe vazhimit të shkollimit të vajzave përmes ndarjes së resurseve të nevojshme buxhetore dhe duke kërkuar mbështetjen e prindërve dhe komunitetit, si dhe përmes fushatave, orareve fleksibile shkollore, nxitjes së tyre, bursave dhe mënyrave tjera që do të minimizonin koston e arsimimit të vajzave për familjet e tyre si dhe të ngritin aftësinë e prindërve për të zgjedhur arsimimin për vajzën e tyre; duke siguruar që të drejtat e grave dhe vajzave për lirinë e ndërgjegjes dhe të fesë në institucionet arsimore respektohen përmes shfuqizimit të ndonjë ligji diskriminues ose legjislacioni bazuar në fenë, racën ose kulturën;
- g) Të promovohet një ambient arsimor i cili eliminon të gjitha barrierat të cilat pengojnë shkollimin e adoleshenteve shtatzëna dhe të nënave të reja, duke përfshirë, ku është e mundshme, edhe ofrimin e objekteve për përkujdes të fëmijëve dhe edukimin prindëror me kosto të lirë dhe ku ato mund të kenë qasje fizike, me qëllim të inkurajimit të atyre që janë përgjegjës për përkujdesjen e fëmijëve të tyre apo motrave dhe vëllezërve gjatë kohës së shkollimit të tyre, që të kthehen apo të vazhdojnë me shkollim deri në kompletimin e tij.
- h) Të përmirësojnë cilësinë e arsimimit dhe të mundësive të barabarta midis grave dhe burrave sa i përket qasjes dhe të sigurojnë që gratë e të gjitha moshave mund të fitojnë njohuri, të zhvillojnë kapacitetet, prirjet dhe aftësitë si dhe vlerat etike të nevojshme për të zhvilluar dhe për të marrë pjesë plotësisht në kushte të barabarta në procesin e zhvillimit politik, ekonomik dhe social;
- i) Të vejnë në dispozicion programe për këshillimin profesional për shkollim dhe për edukim për karrierë i cili do të ishte jodiskriminues dhe i ndjeshëm nga këndvështrimi gjinor për t'i inkurajuar vajzat të ndjekin programe akademike dhe teknike me qëllim që të zgjerojnë mundësitë e karrierës së tyre të ardhshme;

- j) Të inkurajojnë ratifikimin e Marrëveshjes Ndërkombëtare për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore¹³ atje ku ende nuk është bërë.

Objektivi strategjik B.2.

Të zhduket analfabetizmi te gratë.

Aksionet që duhen ndërmarrë.

81. Nga Qeveritë, organizmat kombëtarë, rajonalë dhe ndërkombëtarë, donatorët bilateralë dhe multilateralë, si dhe organizatat joqeveritare:

- a) Të zvogëlojnë shkallën e analfabetizmit të femrave së paku deri në gjysmën e nivelit të vitit 1990, me theks tek gratë rurale, emigrante, refugjate dhe të zhvendosura brenda vendit dhe gratë me paaftësi;
- b) Të sigurojnë qasje universale dhe të kërkojnë garantimin e barazisë gjinore në përfundimin e arsimit fillor për vajzat, deri në vitin 2000;
- c) Të zhdukin dallimet gjinore në literaturën bazë dhe atë funksionale, siç rekomandohet në Deklaratën Botërore për Arsimim për të Gjithë (Jomtien);
- d) Të zvogëlojnë pabarazitë midis vendeve të zhvilluara dhe vendeve në zhvillim;
- e) Të inkurajojnë angazhimin e të rriturve dhe të familjes në mësimin për të nxitur arsimim të përgjithshëm për të gjithë njerëzit;
- f) Së bashku me të mësuarit shkrim lexim të promovojnë edhe aftësitë jetëgjate, njohuritë shkencore e teknologjike dhe punën për zgjerimin e përkufizimit të të mësuarit shkrim lexim duke marrë në konsiderim caqet dhe standardet e sotme;

Objektivi strategjik B.3.

Të përmirësohet qasja e grave në trajnimin profesional, shkencën e teknologjinë, dhe arsimimin e vazhdueshëm

Aksionet që duhen ndërmarrë

¹³ Rezolute e Asamblesë së Përgjithshme 2200 A(XXI), aneks.

82. Nga Qeveritë, në bashkëpunim me punëdhënësit, punëtorët dhe sindikatat e punës, organizatat ndërkombëtare dhe organizatat joqeveritare, përfshirë organizatat e grave dhe të rinisë dhe institucionet arsimore:

- a) Të zhvillojnë e të zbatojnë politikat e arsimimit, trajnimit dhe ritrajnimit për gratë, veçanërisht gratë e reja dhe gratë që hyjnë përsëri në tregun e punës, që t'u ofrojnë aftësi për t'i përmbushur nevojat e një konteksti të ndryshueshëm socio ekonomik për përmirësimin e mundësive të tyre të punësimit;
- b) Të sigurojnë njohjen e mundësive të arsimimit joformal për vajzat dhe gratë në sistemin arsimor;
- c) T'u ofrojnë informata grave dhe vajzave mbi përfitimet nga trajnimet profesionale, programet e trajnimit në shkencë e teknologji dhe të programeve të arsimimit të vazhdueshëm;
- d) Hartimi i programeve arsimore dhe të trajnimit për gratë e papuna me qëllim që t'u sigurohen atyre njohuri dhe aftësi të reja që do të rrisin dhe zgjerojnë më tej mundësitë e tyre për punësim, përfshirë vetëpunësimin, si dhe zhvillimin e aftësive të tyre në ndërmarrësi;
- e) Ofrimin e trajnimeve teknike e profesionale më të shumëllojshme dhe përmirësimi i qasjes për mbajtjen e vajzave dhe grave në arsimim dhe trajnim profesional në fusha të tilla si shkenca, matematika, inxhinieria, shkencat mjedisore dhe teknologjia, teknologjia informative dhe teknologjia e lartë, po ashtu edhe trajnime menaxhimi;
- f) Të promovojnë rolin qendror të grave në kërkimet bujqësore dhe ushqimore, dhe në programet arsimore dhe ato plotësuese;
- g) Të inkurajojnë adoptimin e programeve shkollore dhe materialeve mësimore, të inkurajojnë një mjedis përkrahës trajnimi dhe të marrin masa pozitive për promovimin e trajnimit për një varg të plotë zgjedhjesh për punësimin në karriera jo tradicionale për gratë dhe burrat, duke përfshirë zhvillimin e kurseve shumëdisiplinare për mësuesit e shkencës dhe matematikës për t'i ndërgjegjësuar ata për lidhjen e shkencës dhe teknologjisë me jetën e grave;
- h) Të zhvillojnë programe shkollore dhe materialet mësimore dhe të formulojnë dhe të marrin masa pozitive për t'u siguruar grave qasje dhe pjesëmarrje më të mirë në fushat teknike e shkencore, veçanërisht në fushat ku ato nuk janë të përfaqësuara ose janë të nënpërfaqësuara;

- i) Të zhvillojnë politika dhe programe për të inkurajuar gratë që të marrin pjesë në të gjitha programet që u mundësojnë që të mësojnë zanate;
- j) Të rrisin numrin e trajnimeve në fushat teknike, menaxheriale, ofrimin e ndihmës për bujqësi dhe marketingut për gratë në bujqësi, peshkatari, industri dhe afarizëm, art dhe zeje, për të rritur mundësitë që gjenerojnë të ardhura, pjesëmarrjen e grave në vendimmarrjen ekonomike, në veçanti përmes organizatave të grave në nivelin themelor, si dhe kontributin e tyre në prodhim, marketing, biznes, dhe shkencë e teknologji;
- k) Të sigurohet qasje në arsimim dhe trajnim cilësor në të gjitha nivelet përkatëse për gratë e rritura që kanë pak ose aspak arsim, për gratë me paaftësi dhe për gratë që janë të dokumentuara si emigrante, refugjate dhe të zhvendosura, për të përmirësuar mundësitë tyre të punësimit.

Objektivi Strategjik B.4.

Të zhvillohet arsimimi dhe trajnimi jodiskriminues

Aksionet që duhet ndër marrë

83. Nga Qeveritë, autoritetet e arsimit dhe institucionet e tjera arsimore dhe akademike:

- a) Të përpunojnë rekomandimet dhe të zhvillojnë programe shkollore, tekste mësimore dhe mjete ndihmëse mësimore të liruara nga stereotipet me bazë gjinore për të gjitha nivelet e arsimit, përfshirë trajnimin e mësuesve, në bashkëpunim me të gjithë të interesuarit - botuesit, mësuesit, autoritetet publike dhe shoqatat e prindërve;
- b) Të zhvillojnë programe dhe materiale trajnimi për mësuesit dhe edukatorët, të cilët rritin ndërgjegjësimin rreth statusit, rolit dhe kontributit të grave dhe burrave në familje, siç është përcaktuar në paragrafin 30, dhe në shoqëri; në këtë kontekst, të promovojnë barazinë, bashkëpunimin, respektin reciprok dhe ndarjen e përgjegjësisë midis vajzave dhe djemve nga niveli parashkollor e më tutje dhe të zhvillojnë në veçanti modulet arsimore që garantojnë se djemtë kanë aftësi të nevojshme për t'u kujdesur për nevojat e tyre shtëpiake dhe të ndajnë përgjegjësinë për ekonominë shtëpiake dhe për kujdesin ndaj atyre të cilët varen nga ta;
- c) Të zhvillojnë programe dhe materiale trajnimi për mësuesit dhe edukatorët, që ngritin nivelin e ndërgjegjësimin për vetë

rolin e tyre në procesin edukues, me qëllim t'u ofrojnë atyre strategji më efektive për të mësuarit e ndjeshëm nga këndvështrimi gjinor;

- d) Të ndërmarrin veprime për të siguruar se mësueset dhe profesoret femra kanë të njëjtat mundësi si dhe status të barabartë me mësuesit dhe profesorët meshkuj, duke marrë parasysh rëndësinë e të pasurit mësuese femra në të gjitha nivelet dhe me qëllim që të tërhiqen vajzat në shkollë dhe të mbahen ato në shkollë;
- e) Të prezantojnë dhe promovojnë trajnime për zgjidhjen paqësore të konflikteve;
- f) Të marrin masa pozitive për të rritur proporcionin e grave që fitojnë qasje në politikëbërje dhe vendimmarrje arsimore, veçanërisht të mësueseve, në të gjitha nivelet e arsimit dhe në disipinat akademike të cilat tradicionalisht janë të zotëruara nga meshkujt, të tilla si fushat shkencore dhe teknologjia;
- g) Të mbështesin dhe zhvillojnë studime dhe kërkime gjinore në të gjitha nivelet e arsimit, veçanërisht në nivelin pasuniversitar të institucioneve akademike, dhe t'i zbatojnë ato në zhvillimin e programeve shkollore, përfshirë programet universitare, tekstet mësimore dhe materialet ndihmëse për mësim, dhe në trajnimin e mësuesve;
- h) Të zhvillohen trajnime dhe mundësi udhëheqjeje për të gjitha gratë për t'i inkurajuar ato të marrin role udhëheqëse në shoqërinë civile edhe si studente edhe si të rritura;
- i) Të zhvillojnë programe të përshtatshme edukimi dhe informimi me respekt të duhur për shumëgjuhësinë, veçanërisht në lidhje me masmedian, që e bën publikun, sidomos prindërit, të ndërgjegjshëm për rëndësinë e arsimit jodiskriminues për fëmijët dhe për ndarjen e barabartë të përgjegjësiave familjare nga vajzat dhe djemtë;
- j) Të zhvillojnë programe për edukimi për të drejtat e njeriut, të cilat përfshijnë dimensionin gjinor në të gjitha nivelet e arsimit, në veçanti me inkurajimin e institucioneve të arsimit të lartë, posaçërisht në programet e tyre shkencore universitare dhe pasuniversitare juridike, sociale dhe politike, për të përfshirë studimin e të drejtave njerëzore të grave siç trajtohet në konventat e Kombeve të Bashkuara;
- k) Të largojnë pengesat ligjore dhe rregullatore dhe ato sociale, ku është e nevojshme, për edukimin shëndetësor seksual

dhe reprodutiv brenda edukimit formal, në lidhje me çështjet e shëndetit të grave;

- l) Të inkurajojnë, me udhëheqjen dhe mbështetjen e prindërve të tyre dhe në bashkëpunim me stafin dhe institucionet arsimore, përpunimin e programeve arsimore për vajzat dhe djemtë dhe krijimi i shërbimeve të integruara më qëllim të ngritjes së vetëdijes lidhur me përgjegjësitë e tyre, si dhe për t'i ndihmuar ata t'i marrin këto përgjegjësi, duke marrë parasysh rëndësinë e edukimit dhe shërbimeve të tilla për zhvillim personal dhe vetëbesim, po ashtu edhe si nevojë urgjente për t'iu shmangur shtatzënive të padëshirueshme, përhapjes së sëmundjeve seksualisht të transmetueshme, veçanërisht HIV/AIDS, si dhe dukurive siç janë dhuna dhe keqtrajtimi seksual;
- m) Të ofrohen hapësira sportive dhe për rekreacion ku ato mund të kenë qasje, dhe të vendosen e të fuqizohen programet e ndjeshme gjinore për vajzat dhe djemtë e të gjitha moshave në institucionet e komunitetit dhe të arsimit, si dhe të mbështetet përparimi i grave në të gjitha fushat e aktiviteteve atletike dhe fizike, duke përfshirë stërvitjen, trajnimin dhe administrimin, edhe si pjesëtarë në nivele kombëtare, rajonale dhe ndërkombëtare;
- n) Të njohin dhe të mbështesin të drejtat e grave dhe vajzave indigjene për arsimim; dhe të promovojnë një qasje shumëkulturore për arsimimin, që u përgjigjet nevojave, aspiratave dhe kulturave të grave indigjene, duke i përfshirë zhvillimin e programeve të përshtatshme të edukimit, programe shkollore e materiale ndihmëse, sa më shumë që është e mundur në gjuhët e popujve indigjenë dhe duke u mundësuar grave indigjene që të marrin pjesë në këto procese;
- o) Të njohin dhe respektojnë veprimtaritë artistike, shpirtërore dhe kulturore të grave indigjene.
- p) Të garantojnë që gjinia, barazia dhe diversiteti kulturor, fetar dhe të tjera, do të respektohen në institucionet arsimore;
- q) Të promovojnë arsimimin, trajnimin dhe programet relevante informative për gratë rurale dhe fermere përmes përdorimit të teknologjive të lira dhe të përshtatshme dhe në masmedia – për shembull, programe radioje, kaseta dhe njësi të lëvizshme;
- r) Të sigurojnë arsimim joformal, veçanërisht për gratë rurale, me qëllim që të realizojnë potencialin e tyre të plotë në lidhje

me shëndetësinë, mikro-ndërmarrje, bujqësi dhe të drejtat ligjore;

- s) Të largojnë të gjitha pengesat për qasje në edukimin formal për adoleshentët shtatzëna dhe nënat e reja dhe të përkrahin sigurimin e kujdesit për fëmijët dhe shërbimet tjera mbështetëse ku është e nevojshme.

Objektivi Strategjik B.5.

Ndarja e resurseve të mjaftueshme për monitorimin dhe zbatimin e reformave arsimore.

Aksionet që duhen ndërmarrë

84. Nga Qeveritë:

- a) Të sigurojnë resurset e nevojshme buxhetore për sektorin arsimor, me rishpërndarjen brenda sektorit arsimor për të garantuar shumë më të madhe të fondeve për arsimin themelor, sipas nevojës;
- b) Të themelojnë një një mekanizëm në nivelet e duhura për të monitoruar zbatimin e reformave dhe masave arsimore në ministritë përkatëse, si dhe të krijojnë programet e asistencës teknike, sipas nevojës, për të adresuar çështjet e ngritura në përpjekjet e monitorimit.

85. Nga Qeveritë dhe, kudo që është e nevojshme, nga institucionet private dhe publike, fondacionet, institutet kërkimore dhe organizatat joqeveritare:

- a) Kur është e nevojshme të mobilizojnë fonde shtesë nga institucionet private e publike, fondacionet, institutet kërkimore dhe organizatat joqeveritare, për t'u bërë të mundshme vajzave dhe grave, në masë të barabartë si djemve dhe burrave, të kryejnë shkollimin e tyre me një theks të veçantë tek popullsitë me mundësi të pakta;
- b) Të sigurojnë financim për programe speciale, siç janë programet në matematikë, shkencë dhe teknologji kompjuterike, për të rritur mundësitë për të gjitha vajzat dhe gratë.

86. Nga institucionet multilaterale të zhvillimit, përfshirë Bankën Botërore, bankat për zhvillim rajonal, donatorët bilateralë dhe fondacionet, që të marrin në konsiderim:

- (a) Rritjen e fondeve për nevojat e arsimit dhe trajnimit të vajzave dhe grave si një përparësi e programeve të asistencës për zhvillim;
- (b) Që duke punuar me Qeveritë përfituese të garantojnë që fondet për arsimimin e grave mbesin të njëjta ose rriten në përshtatjen strukturore dhe në programet e rimëkëmbjes ekonomike, duke përfshirë programet e huazimit dhe stabilizimit.

87. Nga organizatat ndërkombëtare dhe ato ndërqeveritare, veçanërisht Organizata e Kombeve të Bashkuara për Arsimin, Shkencën dhe Kulturën (UNESCO), në nivel global:

- a) Të kontribuojnë në vlerësimin e progresit të arritur, duke përdorur indikatorët arsimorë të nxjerra nga organizmat kombëtarë, rajonalë dhe ndërkombëtarë, dhe të shtyjë Qeveritë në zbatimin e masave për të zhdukur dallimet midis grave e burrave, vajzave dhe djemve në lidhje me mundësitë në arsimim dhe trajnim si dhe nivelet e arritura në të gjitha fushat, veçanërisht në programet e zhdukjes së analfabetizmit dhe ato të arsimit fillor;
- b) Të sigurojnë asistencë teknike sipas kërkesave të vendeve në zhvillim, për të ngritur kapacitetin për të monitoruar përparimin në largimin e dallimi midis grave dhe burrave në arsim, trajnim e hulumtim, si dhe në nivelet e arritjes në të gjitha fushat, sidomos arsimin bazë dhe zhdukjen e analfabetizmit;
- c) Të drejtojnë një fushatë ndërkombëtare për promovimin e së drejtës së grave dhe vajzave për arsimim;
- d) Të ndajnë një përqindje substanciale të resurseve të tyre për arsimin bazë për gratë dhe vajzat.

Objektivi Strategjik B.6.

Promovimi i arsimit dhe trajnimit jetëgjatë për vajzat dhe gratë

Aksionet që duhen ndërmarrë

88. Nga Qeveritë, institucionet arsimore dhe komunitetet:
- a) Të vënë në dispozicion një numër të madh programesh trajnimi dhe edukimi që çojnë në përvetësimin e vazhdueshëm nga gratë dhe vajzat të njohurive dhe aftësive të nevojshme për jetesë, kontribut në dhe përfitim nga komunitetet dhe kombet e tyre;
 - b) Të sigurojnë mbështetje për kujdes për fëmijët dhe shërbime të tjera që do t'iu bënte të mundur nënave të vazhdojnë shkollimin e tyre;
 - c) Të krijojnë programe fleksibile arsimit, trajnimit dhe ritrajnimit për mësimin jetëgjatë, që ndihmon tranzicionin midis veprimtarive të grave në të gjitha etapat e jetës së tyre.

C. GRATË DHE SHËNDETI

89. Gratë kanë të drejtën e gëzimit të standardit më të lartë të arritshëm të shëndetit fizik dhe mendor. Gëzimi i kësaj të drejte është qenësore për jetën e mirëqenien e tyre si dhe për aftësinë e tyre për të marrë pjesë në të gjitha fushat e jetës publike e private. Shëndeti është një gjendje e mirëqenies së plotë fizike, mendore dhe shoqërore dhe jo thjesht mungesa e sëmundjes ose dobësia. Shëndeti i grave përfshin mirëqenien e tyre emocionale, sociale dhe fizike dhe përcaktohet nga konteksti social, politik dhe ekonomik i jetës së tyre, si dhe nga biologjia. Megjithatë, shëndeti dhe mirëqenia nuk i përfshijnë shumicën e grave. Një pengesë e madhe për gratë në arritjen e standardit më të lartë të arritshëm të shëndetit është pabarazia midis burrave dhe grave si dhe ndërmjet grave në rajone të ndryshme gjeografike, klasave shoqërore dhe grupeve indigjene e etnike. Në forumet kombëtare dhe ndërkombëtare, gratë kanë theksuar se si parakushte të nevojshme për të arritur shëndetin optimal përgjatë ciklit të jetës, duhet të arrihen barazia, duke përfshirë ndarjen e përgjegjësive familjare, zhvillimi dhe paqja.

90. Gratë kanë qasje të ndryshme dhe të pabarabartë në shfrytëzimin e resurseve themelore shëndetësore, duke përfshirë shërbimet primare të kujdesit shëndetësor për parandalimin dhe trajtimin e sëmundjeve të fëmijërisë, mosushqyerjen, aneminë, sëmundjet diareike, sëmundjet e përhapura, malarien dhe sëmundje të tjera tropikale dhe tuberkulozin, midis të tjerash. Gratë gjithashtu kanë mundësi të ndryshme dhe të pabarabarta për mbrojtjen, promovimin dhe mirëmbajtjen e shëndetit të tyre. Në shumë vende në zhvillim, mungesa e shërbimeve emergjente obstetrike është gjithashtu një shqetësim i veçantë. Politikat dhe programet e shëndetit

shpesh i fuqizojnë stereotipet gjinore dhe nuk marrin në konsiderim pabarazitë socio-ekonomike dhe dallimet tjera midis grave, si dhe nuk marrin plotësisht në konsideratë mungesën e autonomisë së grave në lidhje me shëndetin e tyre. Shëndeti i grave gjithashtu ndikohet nga paragjykimet gjinore në sistemin shëndetësor dhe nga furnizimi i grave me shërbime mjekësore joadekuate dhe të papërshtatshme.

91. Në shumë vende, veçanërisht në vendet në zhvillim, sidomos në vendet më pak të zhvilluara, zvogëlimi i shpenzimeve në shëndetin publik dhe në disa raste përshtatja strukturore, kontribuojnë në përkeqësimin e sistemeve të shëndetit publik. Çka më shumë, privatizimi i sistemeve të kujdesit shëndetësor pa garancitë përkatëse të qasjes universale në kujdes të lirë shëndetësor, zvogëlon më tutje disponueshmërinë e kujdesit shëndetësor. Kjo gjendje jo vetëm që ndikon drejtpërdrejtë në shëndetin e grave dhe vajzave, por gjithashtu vendos përgjegjësi të shpërpjesëtuara mbi gratë, rolet e shumëfishta të të cilave, duke përfshirë rolet e tyre brenda familjes dhe komunitetit, shpesh nuk njihen; prandaj ato nuk marrin mbështetjen e nevojshme sociale, psikologjike dhe ekonomike.

92. Duhet të sigurohet e drejta e grave për të gëzuar standardin më të lartë të shëndetit në barazi me burrat përgjatë tërë ciklit të jetës së tyre. Gratë preken nga shumë prej të njëjtave kushte shëndetësore si burrat, por gratë i përjetojnë ato në mënyrë të ndryshme. Mbizotërimi i varfërisë dhe i varësisë ekonomike tek gratë, përvoja e tyre lidhur me dhunën, qëndrimet negative ndaj grave e vajzave, diskriminimi për shkak të racës ose format tjera të diskriminimit, fuqia e kufizuar që kanë shumë gra mbi jetën e tyre seksuale dhe riprodhuese, si dhe mungesa e ndikimit në vendimmarrje, janë realitete sociale, të cilat kanë një ndikim të dëmshëm në shëndetin e tyre. Mungesa e ushqimit dhe shpërndarja e pabarabartë e ushqimit për vajzat dhe gratë në ekonomitë shtëpiake, qasja e pamjaftueshme për ujë të pijshëm, në sanitari dhe lëndë djegëse, veçanërisht në zonat rurale dhe të varfëra urbane, kushtet e dobëta të banimit, të gjitha i tej rëndojnë gratë dhe familjet e tyre, si dhe kanë një efekt negativ në shëndetin e tyre. Shëndeti i mirë është thelbësor për të jetuar një jetë produktive dhe të kënaqshme, dhe e drejta e të gjitha grave për të kontrolluar të gjitha aspektet e shëndetit të tyre, në veçanti fertilitetin, është bazë për fuqizimin e tyre.

93. Diskriminimi i vajzave në qasjen në ushqim dhe shërbime të kujdesit shëndetësor, që shpesh rezulton nga preferenca për djemtë, rrezikon shëndetin dhe mirëqenien e tyre të tani dhe në të ardhshmen. Kushtet që detyrojnë vajzat për martesë të hershme,

shtatzëni dhe lindje fëmije, dhe që i nënshtrojnë praktikave të dëmshme, si gjymtimi gjenital femëror, paraqesin rreziqe të rënda shëndetësore. Vajzat adoleshente kanë nevojë për qasje në shërbimet të domosdoshme të shëndetit dhe të ushqimit derisa ato piqen, por shumë shpesh nuk i kanë. Këshillimi dhe qasja në informata dhe shërbime për shëndet seksual dhe riprodhues për adoleshentet, janë ende joadekuate ose mungojnë plotësisht, dhe e drejta e një gruaje të re për intimitet, besueshmëri, respekt dhe pëlqim të informuar shpesh nuk merren në konsiderim. Vajzat adoleshente janë edhe biologjikisht dhe psikologjikisht më të cenushme se djemtë ndaj abuzimit seksual, dhunës dhe prostitucionit, si dhe pasojat e marrëdhënieve seksuale të pambrojtura dhe të parakohshme. Trendët drejt përvojës së hershme seksuale, të kombinuara me një mungesë informatash dhe shërbimesh, rrit rrezikun e shtatzënisë së padëshiruar dhe shumë të hershme, infektimit me HIV dhe sëmundje të tjera seksualisht të transmetueshme, si dhe me abortime të pasigurta. Lindja e hershme vazhdon të jetë një pengesë në përmirësimin e statusit arsimor, ekonomik dhe shoqëror të grave në të gjitha anët e botës. Mbi të gjitha, për gratë e reja martesat dhe amësia e hershme mund të zvogëlojnë në mënyrë të ashpër mundësitë për arsimim dhe punësim dhe ka mundësi që të kenë ndikim afatgjatë, të dëmshëm në cilësinë e jetës së tyre dhe jetës së fëmijëve të tyre. Burrat e rinj shpesh nuk edukohen që të respektojnë vetëvendosjen e grave dhe ndarjen e përgjegjësive me gratë në çështjet e seksualitetit dhe riprodhimit.

94. Shëndeti riprodhues është një gjendje e mirëqenies së plotë fizike, mendore dhe sociale dhe jo thjesht mungesë e sëmundjeve ose dobësisë, në të gjitha çështjet që lidhen me sistemin riprodhues dhe funksionet e proceset e saja. Prandaj shëndeti riprodhues nënkupton që njerëzit të jenë të aftë të kenë një jetë të kënaqshme dhe të sigurtë seksuale dhe të kenë mundësinë të riprodhojnë dhe të kenë lirinë të vendosin kur dhe sa shpesh do të bëjnë atë. Me këtë kusht të fundit nënkuptohet pa dyshim e drejta e burrave dhe grave të informohen dhe të kenë qasje në metodat e sigurta, efektive, të volitshme dhe të pranueshme të planifikimit familjar sipas dëshirës së tyre, si dhe metodat e tjera sipas zgjedhjes së tyre të fertilitetit të cilat nuk janë në kundërshtim me ligjin, dhe e drejta për qasje në shërbimet e përshtatshme të kujdesit shëndetësor, që u bëjnë të mundur grave të kenë një shtatzëni dhe lindje të sigurt dhe t'u sigurojnë çifteve mundësinë më të mirë që të kenë një fëmijë të shëndoshë. Në lidhje me përcaktimin e mësipërm të shëndetit riprodhues, kujdesi për shëndetin riprodhues definohet si një konstelacion metodash, teknikash dhe shërbimesh, që kontribuojnë në shëndetin riprodhues dhe mirëqenie, duke parandaluar dhe duke zgjidhur problemet e shëndetit riprodhues. Ai gjithashtu përfshin shëndetin seksual, qëllimi i të cilit është përmbushja e jetës dhe marrëdhënieve

personale, dhe jo thjesht vetëm këshillimi dhe kujdesi që lidhet me riprodhimin dhe sëmundjet seksualisht të transmetueshme.

95. Duke marrë parasysh përcaktimin e mësipërm, e drejta riprodhuese përmbajnë disa të drejta të njeriut, që janë tashmë të njohura nga legjislacioni kombëtar, dokumentet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut dhe dokumentet tjera të konsensusit. Këto të drejta mbështeten mbi bazën e njohjes të së drejtës bazë të të gjitha çifteve dhe individëve për të vendosur lirisht dhe me përgjegjësi numrin, hapësirën dhe kohën e fëmijëve të tyre dhe për të pasur informacion dhe mjete për këtë, dhe që kjo e drejtë të arrijë standardin më të lartë të shëndetit seksual dhe riprodhues. Ajo gjithashtu përfshin të drejtën e tyre për të marrë vendime në lidhje me riprodhim pa kurrfarë diskriminimi, detyrimi apo dhune, siç shprehet në dokumentet për të drejtat e njeriut. Në ushtrimin e kësaj të drejte, ata duhet të marrin në konsiderim nevojat e jetesës së tyre dhe fëmijëve të tyre që kanë dhe që do të kenë dhe përgjegjësitë e tyre ndaj komunitetit. Promovimi i ushtrimit të përgjegjshëm të këtyre të drejtave për të gjithë njerëzit, do të jetë baza themelore për politikat dhe programet e mbështetura nga qeveria dhe komuniteti në fushën e shëndetit riprodhues, përfshirë planifikimin familjar. Si pjesë e zotimit të tyre, vëmendje e plotë i duhet kushtuar promovimit të marrëdhënieve reciproke dhe të barabarta gjinore dhe veçanërisht në përmbushjen e nevojave edukuese dhe të shërbimeve për adoleshentët për t'u mundësuar atyre të sillen në një mënyrë pozitive dhe të përgjegjshme në lidhje me seksualitetin e tyre. Shumë popuj të botës nuk vërejnë shëndetin riprodhues për shkak të faktorëve të tillë si: nivelit të pamjaftueshëm të njohurive rreth seksualitetit njerëzor dhe informatave dhe shërbimeve të papërshtatshme dhe të varfra për shëndetin riprodhues; përhapjes së sjelljeve seksuale të rrezikshmërisë së lartë; praktikave diskriminuese shoqërore; qëndrimeve negative për gratë dhe vajzat; dhe fuqisë së kufizuar që shumë gra e vajza kanë në jetën e tyre seksuale dhe riprodhuese. Adoleshentët janë veçanërisht të cenueshme për shkak të informacionit dhe qasjes në shërbimet relevante në shumicën e vendeve. Gratë dhe burrat më të vjetër kanë çështje të dallueshme të shëndetit riprodhues e seksual, të cilat janë shpesh të adresuara në mënyrë joadekuate.

96. Të drejtat njerëzore të grave përfshijnë të drejtën e tyre për të pasur kontroll mbi çështjet që lidhen me seksualitetin e tyre, si dhe për të vendosur lirisht dhe me përgjegjësi lidhur me ato çështje, duke përfshirë shëndetin seksual e riprodhues, të jenë të lira nga detyrimi, diskriminimi e dhuna. Marrëdhëniet e barabarta midis grave dhe burrave në çështjet e marrëdhënieve seksuale e të riprodhimit, që përfshijnë respektimin e plotë të integritetit të personit, kërkojnë

respekt, miratim dhe ndarje reciproke të përgjegjësive për sjelljen seksuale dhe pasojat e saj.

97. Për më tej, gratë u janë të nënshtruara rreziqeve të veçanta shëndetësore për shkak të reagimit joadekuat dhe mungesës së shërbimeve për të përmbushur nevojat shëndetësore që kanë të bëjnë me seksualitetin dhe riprodhimin. Komplikimet që kanë të bëjnë me shtatzëninë dhe lindjen e fëmijës janë ndër shkaqet kryesore që çojnë në vdekshmëri dhe morbiditet të grave të moshës riprodhuese në shumë pjesë të botës në zhvillim. Në një masë të caktuar probleme të njëjta ekzistojnë edhe në disa vende me ekonomi në tranzicion. Abortet e pasigurta kërcënojnë jetën e një numri të madh grash, duke paraqitur kështu një problem të rëndë të shëndetit publik pasi që në radhë të parë janë më të varfrit e më të rinjtë që bartin rrezikun më të lartë. Shumica e këtyre vdekjeve, problemeve shëndetësore dhe lëndimeve janë të parandalueshme përmes qasjes së përmirësuar në shërbime adekuate të kujdesit shëndetësor, përfshirë metodat e sigurta dhe efektive të planifikimit familjar dhe kujdesit emergjent obstetrik, duke njohur të drejtën e grave dhe burrave për të qenë të informuar dhe për të pasur qasje në metodat e sigurta, efektive, volitshme dhe të pranueshme të planifikimit familjar sipas zgjedhjes së tyre, si dhe metodave tjera sipas zgjedhjes për rregullimin e fertilitetit të cilat nuk janë kundër ligjit, dhe e drejta për qasje në shërbime të përshtatshme të kujdesit shëndetësor që do t'u bëjë të mundur grave të kalojnë të sigurta nëpër shtatzëni dhe lindje dhe t'u sigurojë çifteve mundësitë më të mira që të kenë një fëmijë të shëndoshë. Këto probleme dhe mjete, duhet te adresohen në bazë të raportit të Konferencës Ndërkombëtare mbi Popullsinë dhe Zhvillimin, me referencë të veçantë në paragrafët relevantë të Platformës për Veprim të kësaj Konference. Në shumicën e vendeve, moskujdesi ndaj të drejtave riprodhuese të grave, kufizon ashpërsisht mundësitë e tyre në jetën publike dhe private, duke përfshirë mundësitë për arsimim dhe fuqizim ekonomik dhe politik. Aftësia e grave për të kontrolluar fertilitetin e tyre krijon një bazë të rëndësishme për të gëzuar edhe të drejtat e tjera. Ndarja e përgjegjësive midis grave e burrave në çështjet që lidhen me sjelljen seksuale dhe riprodhuese është gjithashtu thelbësore për përmirësimin e shëndetit të grave.

98. HIV/AIDS dhe sëmundjet tjera seksualisht të transmetueshme, përcjellja e të cilave është shpesh konsekuencë e dhunës seksuale, janë duke pasur një efekt shkatërrues në jetën e grave, veçanërisht në shëndetin e vajzave adoleshente dhe grave të reja. Ato shpesh nuk kanë fuqi të këmbëngulin për praktika seksuale të sigurta e të përgjegjshme dhe kanë qasje të pakët në informata dhe shërbime për parandalim dhe trajtim. Gratë, të cilat përfaqësojnë gjysmën e të gjithë të rriturve të infektuar rishtazi me HIV/AIDS dhe sëmundje tjera seksualisht të transmetueshme, kanë theksuar se cenueshmëria e

tyre shoqërore dhe marrëdhëniet e pabarabarta të fuqisë midis grave dhe burrave janë pengesë për seks të sigurtë, si dhe në përpjekjet e tyre për kontrollin e përhapjes së sëmundjeve seksualisht të transmetueshme. Pasojat e HIV/AIDS kalojnë matanë shëndetit të grave, deri te roli i tyre si nëna dhe kujdestare dhe te kontributi i tyre në mbështetjen ekonomike të familjeve të tyre. Pasojat sociale, zhvillimore dhe shëndetësore të HIV/AIDS dhe sëmundjeve tjera seksualisht të transmetueshme duhen të shikohen nga një perspektivë gjinore.

99. Dhuna seksuale dhe ajo me bazë gjinore, duke përfshirë keqtrajtimin fizik dhe psikologjik, trafikimin e grave dhe vajzave, si dhe format tjera të keqtrajtimit dhe shfrytëzimit seksual, i vë gratë dhe vajzat në rrezik të madh të traumës fizike dhe mendore, të sëmundjeve dhe shtatzënisë së padëshiruara. Situata të tilla shpesh pengojnë gratë nga përdorimi i shërbimeve shëndetësore dhe shërbimeve të tjera.

100. Çrregullimet mendore të lidhura me marginalizimin, pafuqishmërinë dhe varfërinë, së bashku me ngarkesën e tepërt me punë dhe stresin, dhe rritja e rasteve të dhunës shtëpiake si dhe keqpërdorimi i substancave kimike, janë disa nga çështjet tjera shëndetësore në rritje për shqetësim lidhur me gratë. Gratë në tërë botën, veçanërisht gratë e reja, janë duke rritur shfrytëzimin e tyre të duhanit e që ka efekt serioz në shëndetin e tyre dhe të fëmijëve të tyre. Çështjet e shëndetit profesional gjithashtu po bëhen gjithnjë më të rëndësishme, pasi që një numër i madh grash punojnë në punë me pagë të ulët si në tregun formal dhe atë joformal të punës, në kushte të lodhshme e të pashëndetëshme, ndërsa numri i tyre po rritet. Kanceret e gjirit e të qafës së mitrës dhe kanceret tjera të sistemit riprodhues, si dhe jofertiliteti, ndikojnë në gjithnjë e më shumë gra dhe mund të parandalohen ose shërohen, nëse diktohen në fillimet e sëmundjes.

101. Me rritjen e jetëgjatësisë dhe rritjen e numrit të grave të moshuara, shqetësimet e tyre shëndetësore kërkojnë vëmendje të veçantë. Shëndeti afatgjatë i grave është i ndikuar nga ndryshimet në menopauzë, e cila, në kombinim me kushtet jetëgjata dhe faktorët e tjerë, siç janë ushqimi i varfër dhe mungesa e aktivitetit fizik, mund të rrisin rrezikun e sëmundjeve kardiovaskulare dhe të osteoporozës. Sëmundje të tjera të moshës dhe të marrëdhënieve të ndërsjellta të të moshuarit dhe paaftësisë tek gratë gjithashtu kërkojnë vëmendje të posaçme.

102. Gratë, si edhe burrat, veçanërisht në zonat rurale dhe të varfra urbane, janë ekspozuar gjithnjë më shumë rreziqeve shëndetësore mjedisore për shkak të katastrofave mjedisore dhe degradimit mjedisor. Gratë kane një ndryshim të ndryshme ndaj rreziqeve të shumëllojshme mjedisore, ndotësve dhe substancave kimike të ndryshme dhe ato vuajnë pasojat e ndryshme nga ekspozimi ndaj tyre.

103. Cilësia e kujdesit shëndetësor për gratë është shpesh e pamjaftueshme në mënyra të ndryshme, varësisht nga rrethanat lokale. Gratë shpesh nuk trajtohen me respekt, ose nuk u janë garantuar intimiteti dhe besueshmëria, ose ato nuk marrin gjithmonë informatat e plota rreth mundësive dhe shërbimeve në dispozicion. Për më tepër, në disa vende, dhënia e tepërt e medikamenteve për shkak ngjarjeve në jetën e tyre është e zakonshme, e kjo çon deri në ndërhyrje të panevojshme kirurgjikale dhe mjekime të papërshtatshme.

104. Të dhënat statistikore mbi shëndetin shpesh nuk janë sistematikisht të mbledhura, të ndara dhe të analizuar sipas moshës, gjinisë dhe statusit socio-ekonomik dhe sipas kritereve të vendosura demografike të përdorura në shërbim të interesave dhe zgjidhjes së problemeve të nëngrupeve, me theks të veçantë grupet e cenueshme dhe të marginalizuar dhe ndryshimet e tjera përkatëse. Të dhëna të fundit dhe të besueshme mbi vdekshmërinë dhe morbiditetin e grave, si dhe kushtet dhe sëmundjet që veçanërisht ndikojnë në gratë, nuk mund janë në dispozicion në shumë vende. Relativisht pak dihet se si faktorët ekonomikë e socialë ndikojnë në shëndetin e grave e vajzave të të gjitha moshave, rreth ofrimit të shërbimeve shëndetësore për vajzat dhe gratë dhe mënyrat e shfrytëzimit të shërbimeve të tilla, si dhe rreth vlerës së parandalimit të sëmundjeve e promovimin e programeve shëndetësore për gratë. Nuk janë hulumtuar sa duhet temat e rëndësishme për shëndetin e grave dhe shumë shpesh ka mungesë fondesh për kërkimet për shëndetin e grave. Kërkimet mjekësore, për shembull për sëmundjet e zemrës, dhe studimet epidemiologjike në shumë vende bazohen shpesh vetëm te burrat; ato nuk janë të hulumtuara nga këndvështrimi gjinor. Vërehet qartë mungesa e provave klinike që përfshijnë gratë për të vendosur informatat bazë rreth dozave, efekteve anësore dhe efektivitetit të barnave, duke përfshirë kontraceptivët, dhe këto prova nuk janë gjithmonë në përputhje me standardet etike për hulumtim dhe testim. Shumë protokolle të terapive mjekësore dhe trajtimeve të tjera mjekësore dhe ndërhyrjet e administruara për gratë, bazohen në

kërkimin mbi burrat pa investigim dhe përshtatje të ndryshimeve gjinore.

105. Në adresimin e pabarazive në statusin shëndetësor dhe qasjen e pabarabartë dhe shërbimet joadekuate të përkujdesit shëndetësor midis grave e burrave, Qeveritë dhe aktorët e tjerë duhet të promovojnë një politikë aktive dhe të dukshme të integritit të një perspektive gjinore në të gjitha politikat dhe programet, kështu që para se të merren vendimet, të bëhet një analizë mbi efektet e tyre mbi gratë dhe burrat, respektivisht.

Objektivi strategjik C.1.

Rritja e qasjes së grave gjatë ciklit të jetës së tyre në kujdes shëndetësor, informata dhe shërbime të përshtatshme, të volitshme dhe cilësore.

Aksionet që duhen ndërmarrë

106. Nga Qeveritë, në bashkëpunim me organizatat joqeveritare dhe organizatat e punëdhënësve e të punëtorëve, dhe me mbështetjen e institucioneve ndërkombëtare:

- (a) Të mbështeten dhe zbatohen zotimet e bëra në Programin për Veprim të Konferencës Ndërkombëtare mbi Popullsinë dhe Zhvillimin, siç është vendosur në raportin e kësaj Konference dhe Deklarata e Kopenhagës mbi Zhvillimin Social dhe Programi për Veprim i Samitit Botëror për Zhvillim Social¹⁴ dhe detyrimet e shteteve palë në Konventën për Eliminimin e Të Gjitha Formave Kundër Diskriminimit të Grave dhe marrëveshje të tjera përkatëse ndërkombëtare, që të përmbushin nevojat shëndetësore të vajzave e grave të të gjitha moshave;
- (b) Të ritheksohet e drejta për gëzimin e standardit më të lartë të arritshëm të shëndetit fizik e mendor, për të mbrojtur dhe promovuar arritjen e kësaj të drejte nga gratë dhe vajzat dhe për ta mishëruar atë në legjislacionin kombëtar, për shembull; rishikimi i legjislacionit ekzistues, përfshirja e legjislacionit për shëndetin, po ashtu edhe politikat shëndetësore, ku është e nevojshme, për të reflektuar një zotim për shëndetin e grave dhe për të siguruar se ato prekin do të jenë në përputhje ,e rolet dhe përgjegjësitë e ndryshuara të grave kudo që ato banojnë;

¹⁴ Raport i Samitit Botëror për Zhvillimin Social, Kopenhagë, 6-12 Mars 1995 (A/CONF.166/9), kapitulli I, rezoluta 1, anekset I dhe II.

- (c) Në bashkëpunim me organizatat e grave dhe të komunitetit të projektojnë dhe të zbatojnë programe shëndetësore të ndjeshme nga këndvështrimi gjinor, duke përfshirë shërbimet e decentralizuara shëndetësore, që adresojnë nevojat e grave gjatë tërë jetës së tyre dhe të marrin në konsideratë rolet dhe përgjegjësitë e tyre të shumta, kërkesat në kohën e tyre, nevojat e veçanta të grave rurale dhe grave me paaftësi, si dhe ndryshueshmërinë e nevojave të grave që dalin, ndërmjet të tjerave, nga mosha dhe dallimet socio-ekonomike dhe kulturore; të përfshijnë gratë, veçanërisht ato lokale dhe indigjene, në identifikimin dhe planifikimin e programeve të prioritetëve të kujdesit shëndetësor; dhe të heqin të gjitha pengesat për shërbimet shëndetësore për gratë dhe të sigurojnë një varg të gjerë shërbimesh të kujdesit shëndetësor;
- (d) Të lejohen gratë të kenë qasje në sistemet e sigurimit social në barazi me burrat gjatë gjithë ciklit të jetës;
- (e) Të sigurojnë më tepër shërbime të kujdesit shëndetësor primar të cilësisë së lartë, të pranueshme e të volitshme, duke përfshirë kujdesin shëndetësor seksual dhe riprodhues, i cili përfshin informata dhe shërbime për planifikimin familjar, dhe që i kushtojë vëmendje të veçantë kujdesit obstetrik të emergjencës dhe atij të maternitetit, siç është pranuar në Programin për Veprim të Konferencës Ndërkombëtare për Popullsinë dhe Zhvillimin;
- (f) Të rihartohen informacionet, shërbimet dhe trajnimet shëndetësore për punonjësit e shëndetit në mënyrë që ata të jenë të ndjeshëm nga këndvështrimi gjinor dhe ta reflektojnë këtë perspektivë te shfrytëzuesit në lidhje me aftësitë ndërnjerëzore dhe ato komunikuese dhe të drejtën e shfrytëzuesit për intimitet dhe besueshmëri. Këto shërbime, informata dhe trajnime, duhet të kenë një qasjeje gjithëpërfshirëse;
- (g) Të sigurojnë që të gjitha shërbimet shëndetësore dhe punonjësit shëndetësorë të jenë në përputhje me të drejtat e njeriut dhe sipas standardeve etike, profesionale dhe gjinore në ofrimin e shërbimeve shëndetësore për gratë, që synojnë sigurimin e miratimit të përgjegjshëm, vullnetar dhe të informuar. Të inkurajojnë zhvillimin, zbatimin dhe përhapjen e kodeve të etikës të drejtuara nga kodet ekzistuese ndërkombëtare të etikës mjekësore, si dhe nga parimet etike, që qeverisin profesionistët e tjerë të shëndetit;
- (h) Të marrin të gjitha masat e nevojshme për të zhdukur intervenimet mjekësore të dëmshme, të panevojshme ose të detyruara, po ashtu edhe mjekimin e papërshtatshëm dhe tej

mjekimin e grave. Të gjitha gratë duhet të jenë plotësisht të informuara për zgjedhjet që kanë, duke përfshirë përfitimet e mundshme dhe efektet potenciale anësore, nga personeli i trajnuar siç duhet;

- (i) Të fuqizojnë dhe riorientojnë shërbimet shëndetësore, veçanërisht kujdesi shëndetësor primar, me qëllim që të sigurojnë qasje universale në shërbimet shëndetësore cilësore për gratë dhe vajzat, të zvogëlohet numri i shëndetit të dobët dhe morbiditetit të nënave, dhe deri në vitin 2000 të arrihet objektivi i miratuar në mbarë botën për zvogëlimin e vdekshmërisë së nënave për së paku 50% nga niveli i vitit 1990 dhe të zvogëlohet për edhe gjysmë deri në vitin 2015; të sigurohet që shërbimet e nevojshme janë në dispozicion në secilin nivel të sistemit shëndetësor, dhe të ofrojë qasje vlefshme, përmes sistemit të kujdesit shëndetësor parësor, për të gjithë individët e moshave të përshtatshme sa më shpejt të jetë e mundur dhe jo më vonë se viti 2015;
- (j) Të njohin dhe të punojnë lidhur me ndikimin shëndetësor të abortit të pasigurt si një shqetësim i madh publik shëndetësor, siç janë pajtuar në paragrafin 8.25 të Programit për Veprim të Konferencës Ndërkombëtare për Popullsinë dhe Zhvillimin;¹⁵
- (k) Paragrafi 8.25 i Programit për Veprim i Konferencës Ndërkombëtare për Popullsinë dhe Zhvillimin deklaron: “Në asnjë rast nuk duhet të promovohet aborti si një metodë e planifikimit familjar. Të gjitha Qeveritë dhe organizatat e rëndësishme ndërqeveritare dhe joqeveritare inkurajohen që të fuqizojnë zotimin e tyre për shëndetin të grave, të merren me ndikimin e abortit të pasigurt në shëndet ¹⁶ si një shqetësim i madh publik shëndetësor dhe të zvogëlojnë ndihmat për abort përmes shërbimeve të zgjeruara dhe të përmirësuara të planifikimit familjar. Parandalimit të shtatzënive të padëshiruara duhet t’i jepet gjithmonë prioriteti i shkallës më të lartë dhe duhet të bëhen të gjitha përpjekjet për të eliminuar nevojën për abort. Gratë që kanë shtatzëni të padëshiruara, duhet të kenë qasje të menjëhershme në informata të besueshme dhe këshillim të dhembshur. Çfarëdo mase ose ndryshimi lidhur me abortin brenda sistemit shëndetësor mund të përcaktohet vetëm në nivelin kombëtar apo lokal, varësisht nga procesi legjislativ

¹⁵ Raport i Konferencës Ndërkombëtare për Popullsinë dhe Zhvillimin, Kajro, 5-13 Shtator 1994 (United Nations Publication, Sales, No. E. 95. XIII. 18), ka. I, rezoluta 1, aneks.

¹⁶ Aborti i pasigurt është përcaktuar si një procedurë për përfundimin e shtatzënisë së padëshiruar nga persona që nuk kanë aftësitë e nevojshme për ta bërë atë, ose në një mjedis ku mungojë standardet minimale mjekësore, ose të dyja (bazuar në Organizatën Botërore të Shëndetit, Parandalimi dhe Menaxhimi i Abortit të Pasigurt, Raport i Grupit Teknik të Punës, Gjenevë, Prill 1992 (WHO/MSM/9.25)).

kombëtar. Në rrethanat kur aborti nuk është i kundërligjshëm, një abort i tillë duhet të jetë i sigurt. Në të gjitha rastet, gratë duhet të kenë qasje në shërbimet cilësore shëndetësore për menaxhimin e ndërlkimeve që mund të rrjedhin nga aborti. Këshillimi, edukimi dhe shërbimet e planifikimit familjar të pas abortit duhet të ofrohen menjëherë, që të ndihmojnë për të ndaluar aborte të përsëritura.” Të marrin në konsiderim rishikimin e ligjeve që përmbajnë masa ndëshkuese kundër grave që u janë nënshtruar aborteve të paligjshme;

- (l) T’u kushtohet vëmendje e veçantë nevojave të vajzave, veçanërisht promovimi i sjelljes së shëndoshë, duke përfshirë aktivitetet fizike; të merren masa specifike për zvogëlimin e hendekut gjinor në morbiditet dhe vdekshmëri ku vajzat janë të pafavorizuara, në të njëjtën kohë duke arritur përbushjen e objektivave të miratuara ndërkombëtarisht për zvogëlimin e vdekshmërisë së foshnjave dhe fëmijëve – në masë më specifike, deri në 2000 të arrihet zvogëlimi i shkallës së vdekshmërisë së foshnjave dhe fëmijëve nën pesë vjeç me një të tretën e nivelit të vitit 1990, ose 50 deri 70 për 1000 lindje, por jo më pak; deri në vitin 2015 shkalla e vdekshmërisë së foshnjave të bjerë në 35 për 1000 lindje dhe vdekshmëria nën 5 vjeç të bjerë nën 45 për 1000;
- (m) Të sigurojnë që vajzat të kenë qasje të vazhdueshme në informata dhe shërbime të nevojshme lidhur me shëndetin dhe ushqimin deri sa janë duke u pjekur, për të ndihmuar tranzicionin e shëndetshëm nga fëmijëria në moshën e rritur;
- (n) Të zhvillohen informata, programe dhe shërbime për të ndihmuar gratë për të kuptuar dhe përshtatur ndryshimeve që kanë të bëjnë me plakjen dhe për të adresuar dhe trajtuar nevojat shëndetësore të grave të moshuara, duke i kushtuar vëmendje të veçantë atyre që janë të varura fizikisht ose psikologikisht;
- (o) Të sigurohet që vajzat dhe gratë e të gjitha moshave që kanë çfarëdo forme të paaftësie të marrin shërbime mbështetëse;
- (p) Të formulojnë politika speciale, të hartojnë programe dhe të fusin në fuqi legjislacionin e nevojshëm për të zvogëluar dhe eliminuar rreziqet shëndetësore mjedisore dhe profesionale që janë të lidhura me punën në shtëpi, në vendin e punës apo kudo tjetër me vëmendjen për gratë shtatzëne dhe me fëmijë në gji;
- (q) Të integrohen shërbimet e shëndetit mendor në sistemet e kujdesit shëndetësor primar ose nivele të tjera të përshtatshme, të zhvillohen programe përkrahëse dhe të

trajnohen punonjësit e shëndetit primar për të njohur dhe për t'u kujdesur për vajzat dhe gratë e të gjitha moshave që kanë përjetuar përvoja të ndonjë forme dhune, veçanërisht dhunë familjare, keqtrajtim seksual ose keqtrajtme tjera që janë si pasojë e konflikteve të armatosura e të paarmatosura;

- (r) Të promovojnë informimin publik mbi përfitimet e ushqyerjes me gji; të shqyrtojnë mënyrat dhe mjetet e zbatimit të plotë të Kodit Ndërkombëtar të OBSH/UNICEF për Reklamimin e Zëvendësuesve të Qumështit të gjirit, dhe t'u bëhet e mundur nënave të ushqejnë me gji foshnjat e tyre duke iu siguruar atyre mbështetje ligjore, ekonomike, praktike dhe emocionale;
- (s) Të krijojnë mekanizma për të përkrahur dhe përfshirë organizatat joqeveritare, veçanërisht organizatat e grave, grupet profesionale dhe organizmat tjerë që punojnë për përmirësimin e shëndetit të vajzave e grave, në politikëbërjen qeveritare, hartimin e programeve, kuqo që është e mundshme, dhe zbatimin e tyre në të gjitha nivelet brenda sektorit shëndetësor dhe sektorëve të ndërlidhur;
- (t) Të përkrahin organizatat joqeveritare që punojnë për shëndetin e grave dhe të ndihmojnë në zhvillimin e rrjeteve që synojnë përmirësimin e koordinimit dhe bashkëpunimit midis të gjithë sektorëve që ndikojnë në shëndet;
- (u) Të racionalizohet prokurimi i ilaçeve dhe të sigurohet furnizimi i vazhdueshëm dhe i besueshëm i materialeve farmaceutike, kontraceptive të cilësisë së lartë dhe furnizime dhe pajisje tjera, duke përdorur Listën e Modelit të OBSH-së të Barnave Thelbësore si një udhëzues, dhe të garantojnë sigurinë e barnave dhe pajisjeve përmes proceseve rregullatore kombëtare për miratimin e barnave;
- (v) Të sigurojnë qasje të përmirësuar në shërbime të përshtatshme të trajtimit dhe rehabilitimit për gratë që keqpërdorin lëndë kimike dhe për familjet e tyre;
- (w) Të promovojnë dhe garantojnë siguri të ekonomive shtëpiake dhe siguri ushqimore kombëtare, sipas nevojës, dhe të zbatojnë programet që synojnë përmirësimin e statusit ushqimor të të gjitha vajzave dhe grave me zbatimin e zotimeve të bëra në Planin e Veprimit mbi Ushqimin në Konferencën Ndërkombëtare për Ushqimin,¹⁷ duke përfshirë një ulje në mbarë botën, deri në vitin 2000, të mosushqyerjes së ashpër dhe të asaj të moderuar midis fëmijëve nën

¹⁷ Raporti Përfundimtar i Konferencës Botërore për Ushqimin, Rome, 5-11 Dhjetor 1992 (Romë, Organizata Botërore e Ushqimit e Kombeve të Bashkuara, 1993), Pjesa II.

moshën pesë vjeçe në gjysmën e niveleve të vitit 1990, duke i kushtuar vëmendje të veçantë dallimeve gjinore në ushqyerje, dhe një zvogëlim deri në vitin 2000 të anemisë nga mungesa e hekurit tek vajza dhe gratë deri në një të tretën e niveleve të vitit 1990;

- (x) Të sigurojnë disponueshmëri dhe qasje universale në ujë të pijshëm të sigurt dhe sanitari dhe të krijojnë sa më shpejtë mundshëm sisteme publike efektive të shpërndarjes;
- (y) Të sigurojnë qasje të plotë dhe të barabartë në infrastrukturën dhe shërbimet e kujdesit shëndetësor për gratë indigjene.

Objektivi Strategjik C.2.

Të fuqizohen programet parandaluese që promovojnë shëndetin e grave

Aksionet që duhet ndërmarrë

107. Nga Qeveritë, në bashkëpunim me organizatat joqeveritare, masmediat, sektorin privat dhe organizatat relevante ndërkombëtare, përfshirë organizmat e Kombeve të Bashkuara, sipas nevojës:

- a) T'i japin përparësi programeve arsimore formale dhe joformale të cilat i përkrahin gratë dhe u bëjnë të mundur që të zhvillojnë vetëbesimin, të fitojnë njohuri, të marrin vendime dhe përgjegjësi për shëndetin e tyre, të arrijnë respektin reciprok në çështjet që kanë të bëjnë me seksualitetin dhe fertilitetin dhe t'i edukojnë burrat lidhur me rëndësinë e shëndetit dhe mirëqenies së grave, duke vendosur fokus special në programet për të dy palët, burrat dhe gratë, të cilat theksojnë eliminimin e qëndrimeve dhe praktikave të dëmshme, përfshirë gjymtimin gjenital femëror, preferencën për fëmijë të gjinisë mashkullore (që rezulton me vrasjen e foshnjave të gjinisë femërore dhe në seleksionimin para lindjes të fëmijëve), martesat e hershme, përfshirë martesën e fëmijëve, dhunën kundër grave, shfrytëzimin seksual, keqtrajtimin seksual, i cili nganjëherë si pasojë ka infektimin me HIV/AIDS dhe sëmundje të tjera seksualisht të transmetueshme, keqpërdorimi i drogave, diskriminimin i grave dhe vajzave në shpërndarjen e ushqimit dhe qëndrime e praktika të tjera të dëmshme në lidhje me jetën, shëndetin dhe mirëqenien e grave dhe, duke njohur se disa prej këtyre praktikave mund të jenë shkelje të të drejtave të njeriut dhe të parimeve etike mjekësore;

- (b) Të ndjekin politika sociale dhe njerëzore të zhvillimit, arsimimit dhe punësimit për të zhdukur varfërinë e grave me qëllim që të zvogëlojnë ndjeshmërinë e tyre ndaj shëndetit të ligë dhe për të përmirësuar shëndetin e tyre;
- (c) Të inkurajojnë burrat për të ndarë në masë të barabartë kujdesin për fëmijët dhe punët e shtëpisë, si dhe për të ofruar pjesën e tyre të përkrahjes financiare për familjet e tyre, madje edhe nëse ata nuk jetojnë me to;
- (d) Të fuqizojnë ligjet, reformojnë institucionet dhe promovojnë normat dhe praktikat të cilat eliminojnë diskriminimin e grave dhe inkurajojnë që të dy palët, burrat dhe gratë, të marrin përgjegjësi për sjelljet e tyre seksuale dhe riprodhuese, të sigurojnë respektimin e plotë të integritetit të personit, të ndër marrin veprime për të garantuar kushtet e nevojshme për gratë që të ushtrojnë të drejtën e tyre riprodhuese dhe për të zhdukur ligjet dhe praktikat detyruese;
- (e) Të përgatitin dhe shpërndajnë informatat përmes fushatave publike shëndetësore, mediave, këshillimit të besueshëm dhe sistemit të edukimit, që janë të hartuara që të sigurojnë se gratë dhe burrat, veçanërisht të rinjtë, mund të përfitojnë njohuri rreth shëndetit të tyre, sidomos informata për seksualitetin dhe riprodhimin, duke marrë parasysh të drejtat e fëmijëve për qasje në informata, intimitet, besueshmëri, respekt dhe pëlqimin e informuar, si dhe për përgjegjësitë, të drejtat dhe detyrat e prindërve, si dhe mbikëqyrësve ligjorë që, në mënyrë që është në pajtim me nivelin e kapaciteteve në zhvillim të fëmijës, të garantojnë drejtimin dhe mbikëqyrjen e përshtatshme që ata fëmijë të ushtrojnë të drejtat e njohura në Konventën për të Drejtat e Fëmijës, dhe në përputhje me Konventën për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit të Grave. Në të gjitha veprimet që kanë të bëjnë me fëmijët, si konsideratë primare do të jetë interesi më i lartë i fëmijës;
- (f) Të krijojnë programe dhe ti përkrahin programet në sistemin arsimor, në vendin e punës dhe në komunitet, për të krijuar mundësi për pjesëmarrje në sport, në aktivitetet fizike dhe rekreacion që të jenë në dispozicion për vajzat dhe gratë e të gjitha moshave mbi të njëjtën bazë e cila u është bërë e mundur burrave dhe djemve;
- (g) Të njohin dhe të specifikojnë nevojat e adoleshentëve dhe të zbatojnë programe të përshtatshme specifike, si janë edukimi dhe informimi mbi çështjet e shëndetit seksual e riprodhues dhe mbi sëmundjet seksualisht të transmetueshme, përfshirë HIV/AIDS, duke marrë parasysh të drejtat e

fëmijës, dhe përgjegjësitë, të drejtat dhe detyrat e prindërve siç janë të shprehura në paragrafin 108 (e);

- (h) Të zhvillojnë politika që zvogëlojnë ngarkesën e shpërpjesëtuar dhe gjithnjë më të madhe mbi gratë të cilat kanë role të shumëfishta brenda familjes dhe komunitetit, duke u ofruar atyre përkrahje dhe programe adekuate nga shërbimet sociale dhe shëndetësore;
- (i) Të miratojnë rregullore për të siguruar që kushtet e punës, përfshirë pagesën për punën e kryer paguar dhe promovimin e grave në të gjitha nivelet e sistemit shëndetësor, nuk janë diskriminuese dhe që janë në pajtim me standardet e drejta dhe profesionale për t'u mundësuar atyre të punojnë në mënyrë efektive;
- (j) Të sigurojnë që informatat dhe trajnimet mbi shëndetin dhe ushqimin janë pjesë përbërëse e të gjitha programeve për mësim të shkrim leximit për të rritur dhe programeve shkollore të nivelit fillor;
- (k) Të zhvillohen dhe të ndërmerren fushata mediale dhe programe informimi e edukimi që informojnë gratë dhe vajzat për rreziqet për shëndetin dhe rreziqet tjera të lidhura me keqpërdorimin e lëndëve kimike dhe varshmërinë në to si dhe të zhvillojnë më tutje programe e strategji të cilat shkurajojnë keqpërdorimin e lëndëve kimike dhe varshmërinë në to dhe të promovojnë rehabilitimin dhe shërimin;
- (l) Të sajojnë dhe të zbatojnë programe të gjithëpërfshirëse dhe koherente për parandalimin, diagnostikimin dhe trajtimin e osteoporozës, një sëmundje që ndikon kryesisht në gratë;
- (m) Të krijojnë dhe/apo të fuqizojnë programe dhe shërbime, duke përfshirë fushatat mediale, që adresojnë parandalimin, zbulimin e hershëm dhe trajtimin e kancerëve të gjirit, të qafës së mitrës dhe lloje të tjera të sistemit riprodhues;
- (n) Të zvogëlojnë rreziqet mjedisore të cilat paraqesin një kërcënim të madh për shëndetin, veçanërisht në rajonet dhe komunitetet e varfra; të zbatojnë një qasje përkujdesi paraprak, siç është rënë dakord në Deklaratën e Rios për Mjedisin dhe Zhvillimin, të miratuar nga Konferenca e Kombeve të Bashkuara për Mjedisin dhe Zhvillimin,¹⁸ dhe të përfshijnë raportimin për rreziqet shëndetësore për gratë që

¹⁸ Raport i Konferencës së Kombeve të Bashkuara mbi Mjedisin dhe Zhvillimin, Rio de Janeiro, 3-14 Qershor, 1992, vol. I, Rezolutë e miratuar nga Konferenca, Rezoluta 1, aneksi I.

rrjedhin nga mjedisi në monitorimin dhe zbatimin e agjendës 21;¹⁹

- (o) Të ngritin vetëdijen midis grave, profesionistëve të shëndetit, politikëbërësve dhe publikut të gjerë rreth rreziqeve shëndetësore serioze, por të parandalueshme, që burojnë nga pirja e duhanit dhe nevojën për masa rregulluese e edukuese për të ulur pirjen e duhanit si një masë e rëndësishme për promovimin e shëndetit dhe aktiviteteve për parandalimin e sëmundjeve;
- (p) Të sigurojnë që programet shkollore mjekësore dhe trajnimet tjera për kujdesin shëndetësor të përfshijnë kurse për shëndetin e grave që janë të ndjeshme nga këndvështrimi gjinor, gjithëpërfshirëse dhe të detyrueshme;
- (q) Të miratojnë masa specifike parandaluese për të mbrojtur gratë, të rinjtë dhe fëmijët nga çfarëdo lloj keqpërdorimi – si shembull, nga keqpërdorimi seksual, shfrytëzimi, trafikimi dhe dhuna – duke përfshirë formulimin dhe zbatimin e ligjeve dhe sigurimin e mbrojtjes ligjore dhe mjekësore dhe llojet tjera të asistencës.

Objektivi strategjik C.3.

Të ndërmerren nisma të ndjeshme gjinore, të cilat adresojnë çështjet e sëmundjeve seksualisht të transmetueshme, HIV/AIDS dhe çështjeve të shëndetit riprodhues dhe seksual.

Aksionet që duhet ndërmarrë

108. Nga Qeveritë, organizmat ndërkombëtare, përfshirë organizatat e Kombeve të Bashkuara, donatorët bilateralë dhe multilateralë dhe organizatat joqeveritare:

- (a) Të garantojnë përfshirjen e grave, veçanërisht atyre të infektuara me HIV/AIDS ose sëmundje të tjera seksualisht të transmetueshme ose të prekura nga epidemia HIV/AIDS, në të gjithë vendimmarrjen e ndërlidhur me zhvillimin, zbatimin, monitorimin dhe vlerësimin e politikave dhe programeve për HIV/AIDS dhe sëmundje të tjera seksualisht të transmetueshme;
- (b) Të rishikojnë dhe të përmirësojnë ligjet dhe, ku është e mundur, të luftojnë praktikën që mund të kontribuojnë në

¹⁹ Ibid., Rezoluta 1, aneksi II.

prekshmerinë e grave nga infeksioni HIV dhe sëmundje të tjera seksualisht të transmetueshme, përfshirë dekretimin e legjislacionit kundër këtyre praktikave socio-kulturore që kontribuojnë në atë, si dhe të zbatojnë legjislacionin, politikat dhe praktikën për mbrojtjen e grave, adoleshenteve dhe vajzave të reja nga diskriminimi që lidhet me HIV/AIDS;

- (c) Të inkurajojnë të gjithë sektorët e shoqërisë, përfshirë sektorin publik, si dhe organizatat ndërkombëtare, që të zhvillojnë politika dhe praktika lidhur me HIV/AIDS të cilat janë të ndjeshme dhe përkrahëse, dhe jodiskriminuese, që mbrojnë të drejtat e individëve të infektuar;
- (d) Të pranojnë nivelin e përhapjes së epidemisë së HIV/AIDS në vendet e tyre, duke marrë veçanërisht në konsiderim ndikimin e tij të gratë, me qëllim të garantojë që gratë e infektuara të mos vuajnë nga stigmatizimi dhe diskriminimi qoftë edhe kur udhëtojnë;
- (e) Të zhvillojnë programe dhe strategji të ndjeshme gjinore shumësektoriale për të përfunduar nënshkrimin shoqëror të grave dhe vajzave dhe për të garantuar fuqizimin e tyre social e ekonomik dhe barazinë; dhe për të lehtësuar promovimin e programeve për të edukuar dhe bërë të mundur që burrat të marrin mbi vete përgjegjësitë e tyre për parandalimin e HIV/AIDS dhe sëmundjet tjera seksualisht të transmetueshme;
- (f) Të ndihmojnë zhvillimin e strategjive të komunitetit që do të mbrojnë gratë e të gjitha moshave nga HIV dhe sëmundjet tjera seksualisht të transmetueshme, të sigurojnë kujdes dhe mbështetje për vajzat e gratë e infektuara dhe familjet e tyre, si dhe të mobilizojë të gjitha pjesët e komunitetit në përgjigje kundër përhapjes së epidemisë së HIV/AIDS dhe për të ushtruar presion mbi të gjitha autoritetet përgjegjëse që të përgjigjen në kohë, në mënyrë efektive, të qëndrueshme dhe të ndjeshme nga këndvështrimi gjinor;
- (g) Të përkrahin dhe fuqizojnë kapacitetin kombëtar për të krijuar dhe përmirësuar politikat dhe programe të ndjeshme gjinore për HIV/AIDS dhe sëmundjet tjera seksualisht të transmetueshme, përfshirë ofrimin e resurseve dhe paisjeve për gratë që janë dhënëset kryesore të kujdesit ose mbështetje ekonomike për të infektuarit me HIV/AIDS ose ata të cilët janë të prekur nga epidemia, dhe të mbijetuarit, veçanërisht fëmijët dhe personat e moshuar;
- (h) Të ofrojnë punëtori dhe edukim dhe trajnim të specializuar për prindërit, vendim marrësit dhe udhëheqësit e opinionit në të gjitha nivelet e komunitetit, përfshirë autoritetet fetare

dhe tradicionale, lidhur me parandalimin e HIV/AIDS dhe sëmundjeve të tjera seksualisht të transmetueshme, dhe pasojat e tyre mbi gratë dhe burrat e të gjitha moshave;

- (i) T'u jepen të gjitha grave dhe punonjësve të shëndetit të tëra informatat dhe edukimi përkatës rreth sëmundjeve seksualisht të transmetueshme, përfshirë HIV/AIDS dhe shtatzëninë dhe implikimet që kjo ka për foshnjat, përfshirë ushqimin me qumësht gjiri;
- (j) Të ndihmojnë gratë dhe organizatat formale dhe joformale për të krijuar dhe zgjeruar edukimin efektiv të moshatarëve dhe programe të shtrirjes së gjerë, si dhe të marrin pjesë në hartimin, zbatimin dhe monitorimin e këtyre programeve;
- (k) T'i kushtojnë vëmendje të plotë promovimit të marrëdhënieve të barabarta gjinore të respektit reciprok dhe, veçanërisht përmes shërbimit të nevojave për shërbime dhe edukim të adoleshentëve për t'u bërë të mundur atyre të merren në një mënyrë pozitive dhe të përgjegjshme me seksualitetin e tyre;
- (l) Të hartojnë programe specifike për burrat e të gjitha moshave dhe djemtë adoleshentë, për të njohur rolet prindërore që referohen në paragrafin 108 (e), që kanë për qëllim që të sigurojnë një informatë të plotë dhe të saktë për sjelljet e sigurta dhe të përgjegjshme seksuale dhe riprodhuese, duke përfshirë metodat vullnetare, të përshtatshme dhe efektive mashkullore për parandalimin e HIV/AIDS dhe sëmundjeve tjera seksualisht të transmetueshme përmes, me fjalë të tjera, abstinencës dhe përdorimit të kondomit;
- (m) Përmes sistemit primar të kujdesit shëndetësor të sigurojnë qasje universale të çifteve dhe individëve në shërbime të përshtatshme dhe të volitshme parandaluese në lidhje me sëmundjet seksualisht të transmetueshme, përfshirë HIV/AIDS, dhe zgjerojnë shtrirjen e ofrimit të shërbimeve të këshillimit dhe të diagnostikimit dhe trajtimit vullnetar e të besueshëm për gratë; të sigurojnë që kudo që është e mundur, që qendrat shëndetësore të furnizohen me kondome të cilësisë së lartë, dhe barna për trajtimin e sëmundjeve seksualisht të transmetueshme të cilat do tu distribuoheshin;
- (n) Të mbështesin programe që japin njohuri se rreziku më i lartë që gratë të fitojnë HIV lidhet me sjellje të rrezikut të lartë, si përdorimi i lëndëve intravenoze dhe sjelljet e papërgjegjshme seksuale të ndikuara nga substanca kimike dhe të pambrojtura, dhe të marrin masat e duhura parandaluese;

- (o) Të mbështesin dhe të ndihmojnë kërkimet për veprim të orientuar me metoda të volitshme, të kontrolluara nga gratë, për të parandaluar HIV dhe sëmundjet tjera seksualisht të transmetueshme, mbi strategjitë për fuqizimin e grave për të mbrojtur veten nga sëmundjet seksualisht të transmetueshme, përfshirë HIV/AIDS, dhe për metodat e kujdesit, mbështetjes dhe trajtimit të grave, sigurimit të përfshirjes së tyre në të gjitha aspektet e një kërkimi të tillë;
- (p) Të mbështetin dhe të iniciojnë kërkime që adresojnë nevojat dhe gjendjet e grave, përfshirë kërkime për infeksionin HIV dhe sëmundjet tjera seksualisht të transmetueshme për gratë, mbi metodat e mbrojtjes të kontrolluara nga gratë, të tilla si janë mikrobicidet jo-spermicide, dhe për qëndrime e praktikat mashkullore e femërore për marrjen e rrezikut.

Objektivi strategjik C.4.

Të promovohen kërkimet dhe shpërndahen informatat për shëndetin e grave.

Aksionet që duhet ndërmarrë

109. Nga Qeveritë, sistemi i Kombeve të Bashkuara, profesionistët e shëndetit, institucionet kërkimore, organizatat joqeveritare, donatorët, industrinë farmaceutike dhe masmedia, sipas nevojës:

- (a) Të trajnojnë hulumtuesit dhe të prezantojnë sisteme që lejojnë përdorimin e të dhënave të mbledhura, të analizuar dhe të ndara, midis faktorëve tjerë, sipas seksit dhe moshës, kritereve tjera të vendosura demografike dhe variabëlve socio-ekonomikë, në politikëbërje, si dhe ku është e nevojshme edhe në planifikim, monitorim dhe vlerësim;
- (b) Të promovohen kërkimet, trajtimi dhe teknologjia shëndetësore me ndjeshmëri gjinore dhe të përqendruara në gratë, dhe të lidhen njohuritë tradicionale dhe indigjene me mjekësinë moderne, duke ofruar informatat e vlefshme për gratë për t'i aftësuar ato të marrin vendime të informuara dhe të përgjegjshme;
- (c) Të rritet numri i grave në pozita udhëheqëse në profesionet shëndetësore, përfshirë studiuesit e shkencëtarët, për të arritur barazinë në afatin më të hershëm të mundshëm;
- (d) Të rrisin mbështetjen financiare nga të gjitha burimet për kërkime parandaluese, dhe shërbime të përshtatshme biomjeksore, të sjelljes, epidemiologjike dhe të shërbimit shëndetësor për çështjet e grave dhe për kërkime mbi

shkaktarët social, ekonomik dhe politik të problemeve të shëndetit të grave, si dhe pasojat e tyre, duke përfshirë ndikimin e pabarazive gjinore dhe moshore, veçanërisht në lidhje me sëmundjet kronike dhe jo infektive, veçanërisht sëmundjeve dhe problemeve kardiovaskulare, kancereve, infeksioneve dhe dëmtimet të traktit riprodhues, HIV/AIDS dhe sëmundjet tjera seksualisht të transmetueshme, dhunën shtëpiake, shëndetin profesional, paaftësitë, problemet e shëndetit në lidhje me mjedisin, sëmundjet tropikale dhe aspekteve shëndetësore të plakjes;

- (e) Të informojnë gratë rreth faktorëve që rritin rrezikun e zhvillimit të kancereve dhe infeksioneve të traktit riprodhues, në mënyrë që ato të mund të marrin vendime të informuara rreth shëndetit të tyre;
- (f) Të mbështesin dhe financojnë kërkimet sociale, ekonomike, politike dhe kulturore për të parë se si ndikojnë pabarazitë me bazë gjinore në shëndetin e grave, përfshirë etiologjinë, epidemiologjinë, ofrimin dhe shfrytëzimin e shërbimeve dhe rezultatet përfundimtare të trajtimit;
- (g) Të mbështesin sistemet e shërbimeve shëndetësore dhe hulumtimet lidhur me veprimet për të fuqizuar qasjen dhe për të përmirësuar cilësinë e dhënies së shërbimeve, për të siguruar mbështetjen e duhur për gratë si ofruese të kujdesit shëndetësor dhe për të shqyrtuar modelet që lidhen me ofrimin e shërbimeve shëndetësore për gratë dhe shfrytëzimi i shërbimeve të tilla nga gratë;
- (h) Të ofrojnë mbështetje financiare dhe institucionale për kërkimet mbi metodat dhe teknologjitë e sigurta, efektive, të volitshme dhe të pranueshme për shëndetin riprodhues dhe seksual të grave dhe burrave, duke përfshirë edhe më shumë metoda të sigurta, efektive, të volitshme dhe të pranueshme për rregullimin e fertilitetit, përfshirë planifikimin natyral të familjes për të dy gjinitë, metodat për mbrojtjen nga HIV/AIDS dhe sëmundjet tjera seksualisht të transmetueshme dhe, midis tjerash, metoda të thjeshta dhe të lira të diagnostikimit të sëmundjeve të tilla. Ky kërkim në të gjitha shkallët duhet të udhëhiqet nga përdoruesit dhe nga perspektiva gjinore, veçanërisht nga perspektiva e grave, dhe duhet të kryhet në përputhje të plotë me standardet ndërkombëtarisht të pranuar etike, mjekësore, shkencore dhe ligjore për kërkime biomjekësore;
- (i) Pasi që aborti i pasigurt 15/ është një kërcënim i madh për jetën dhe shëndetin e grave, duhet të promovohet kërkimi për të kuptuar dhe adresuar më mirë përcaktuesit dhe pasojat e abortit të nxitur, duke përfshirë efektet e tij në

fertilitetin e mëtejshëm, në shëndetin riprodhues dhe mendor dhe praktikën kontrceptive, si dhe kërkimet për trajtimin e ndërlikimeve të abortit dhe të kujdesit pas abortit;

- (j) Të njohin dhe inkurajojnë kujdesin përfitues shëndetësor tradicional, veçanërisht atë që praktikohet nga gratë indigjene, me qëllim të ruajtjes dhe mishërimit të vlerës së kujdesit tradicional shëndetësor në ofrimin e shërbimeve shëndetësore, si dhe të mbështesin kërkimin që shkon në drejtim të arritjes së këtij qëllimi;
- (k) Të zhvillojnë mekanizma për të vlerësuar dhe për të shpërndarë të dhënat në dispozicion dhe gjetjet nga kërkimet midis tjerash edhe hulumtuesve, politikëbërësve, profesionistëve të shëndetit dhe grupeve te grave;
- (l) Të monitorojnë gjenomin njerëzore dhe kërkimet gjenetike nga këndvështrimi i shëndetit të grave dhe të përhapin informatat dhe rezultatet e studimeve të kryera në përputhje me standardet etike të pranuar.

Objektivi strategjik C.5.

Rritja e resurseve dhe monitorimi i rezultateve të shëndetit të grave

Aksionet që duhet ndërmarë

110. Nga Qeveritë në te gjitha nivelet, dhe ku është e nevojshme, në bashkëpunim me organizatat joqeveritare, veçanërisht organizatat e grave dhe ato rinore:

- (a) Të alokojnë mjeteve më të larta buxhetore për shërbimet e kujdesit shëndetësor primar dhe atij social, me mbështetje adekuate për nivelet sekondare dhe terciare, duke i dhënë një vëmendje të posaçme shëndetit riprodhues dhe seksual të vajzave dhe grave; përparësi u duhet dhënë programeve shëndetësore në zonat rurale dhe atyre të varfra urbane;
- (b) Të zhvillojnë qasje novatore për financimin e shërbimeve shëndetësore përmes promovimit të pjesëmarrjes së komunitetit dhe të financimit lokal; ku është e nevojshme, të rritet alokimi buxhetor për qendrat shëndetësore të komunitetit dhe programet e shërbimet e bazuara në komunitet të cilat adresojnë nevojat specifike shëndetësore të grave;
- (c) Të zhvillojnë shërbimet lokale shëndetësore, duke promovuar bashkimin e pjesëmarrjes së komunitetit me vetëdije të

ngritur gjinore dhe vetë-kujdesin si dhe programet shëndetësore të hartuara në mënyrë të veçantë që synojnë parandalimin e sëmundjeve;

- (d) Ku është e mundur, të zhvillojnë objektivat dhe afatet kohore për përmirësimin e shëndetit të grave dhe për programet e planifikimit, zbatimit, monitorimit dhe vlerësimit, të bazuara në vlerësimet me ndikim gjinor, duke përdorur të dhëna cilësore dhe sasiore, të ndara në bazë të gjinisë, moshës, kritereve tjera të vendosura demografike dhe treguesve socio-ekonomikë;
- (e) Sipas nevojës, të themelojnë mekanizma ministrorë dhe ndërministrorë për monitorimin e zbatimit të reformave të programeve dhe politikave të shëndetit të grave, dhe sipas nevojës të krijojnë pika kontakti në nivelet më të larta në autoritetet kombëtare të planifikimit, që janë përgjegjëse për monitorim, për të garantuar që interesat e shëndetit të grave janë integruar në të gjitha agjencitë dhe programet qeveritare relevante.

111. Nga Qeveritë, Kombet e Bashkuara dhe agjencitë e saja të specializuara, institucionet financiare ndërkombëtare, donatorët bilateralë dhe sektori privat, varësisht:

- a) Të formulojnë politika që janë favorizuese për investime në shëndetin e grave dhe ku është e nevojshme të rritet alokimi për investime të tilla;
- b) Të sigurojnë asistencë të përshtatshme materiale, financiare dhe logjistike për organizatat rinore joqeveritare me qëllim që t'i forcojnë ato për të adresuar shqetësimet rinore në fushën e shëndetit, duke përfshirë shëndetin seksual dhe riprodhues;
- c) T'i japin përparësi më të lartë shëndetit të grave dhe të zhvillojnë mekanizma për koordinimin dhe zbatimin e objektivave shëndetësore të Platformës për Veprim dhe marrëveshjeve relevante ndërkombëtare për të siguruar përparimin.

D. DHUNA KUNDËR GRAVE

112. Dhuna kundër grave është pengesë në arritjen e objektivave të barazisë, zhvillimit e paqes. Dhuna kundër grave shkel dhe dëmton

apo shfuqizon gratë që të gëzojnë të drejtat e tyre të njeriut dhe liritë themelore. Dështimi në afatgjatë për të mbrojtur dhe promovuar këto të drejta dhe liri në rastet e dhunës kundër grave është një problem shqetësues për të gjitha shtetet ndaj dhe duhet të adresohet. Njohuritë rreth shkaqeve dhe pasojave të saja, si dhe shkalla e paraqitjes dhe masat për ta luftuar atë, janë zgjeruar më tutje që nga Konferenca e Najrobit. Në të gjitha shoqëritë, në një shkallë më të lartë apo më të ulët, gratë dhe vajzat u janë nënshtruar keqtrajtimit fizik, seksual dhe psikologjik, pavarësisht nga të ardhurat, nga klasat apo kulturat. Statusi i ulët social dhe ekonomik i grave mund të jetë edhe shkak edhe pasojë e dhunës kundër grave.

113. Termi “dhunë kundër grave” do të thotë çfarëdo veprimi i dhunës me bazë gjinore, që rezulton, apo mund të rezultojë, me lëndime ose vuajtje fizike, seksuale ose psikologjike të grave, duke përfshirë kërcënimet për një veprim i tillë, detyrimin apo mohimit arbitrar të lirisë, pa marrë parasysh nëse ndodh në jetën publike apo private. Rrjedhimisht, dhuna kundër grave përfshin por nuk kufizohet me:

- a) Dhunën fizike, seksuale dhe psikologjike që ndodh në familje, duke përfshirë rrahjen, keqtrajtimin seksual të vajzave në ekonominë shtëpiake, dhunën që lidhet me prikën, përdhunimin martesor, gjymtimin gjenital femëror dhe praktikat e tjera tradicionale të dëmshme për gratë, dhuna jo-martesorë dhe dhuna e lidhur me shfrytëzimin;
- b) Dhunën fizike, seksuale dhe psikologjike, që ndodh brenda komunitetit, duke përfshirë përdhunimin, keqtrajtimin seksual, ngacmimin seksual dhe frikësimin në vendin e punës, në institucionet arsimore dhe gjetiu, trafikimin e grave dhe prostitucionin e detyruar;
- c) Dhunën fizike, seksuale dhe psikologjike kryhet ose të pranuar nga shteti kudo që ndodh.

114. Akte të tjera të dhunës kundër grave gjithashtu përfshijnë dhunimin e të drejtave njerëzore të grave në situatat në konflikt të armatosur, në veçanti vdekjen, përdhunimin sistematik, skllavërinë seksuale dhe shtatzëninë e detyruar.

115. Aktet e dhunës kundër grave gjithashtu përfshijnë sterilizimin e detyruar dhe abortin e detyruar, përdorimin e detyruar/me forcë të

kontraktivëve, përzgjedhjen e seksit para lindjes dhe vrasjen e fëmijëve femra.

116. Disa grupe grash, si gratë që u përkasin grupeve minoritare, gratë indigjene, gratë refugjate, gratë emigrante, duke përfshirë edhe punëtorët emigrante, gratë që jetojnë në varfëri në zonat rurale dhe komunitete të largëta, gratë nevojtare, gratë në institucione ose nën arrest, vajzat, gratë me paaftësi, gratë e moshuara, gratë e zhvendosura, gratë e riatdhesuara, gratë që jetojnë në varfëri dhe gratë në situatat të konfliktit të armatosur, pushtimit të huaj, në luftëra agresioni, në luftëra civile, në terrorizëm, përfshirë marrjen peng, janë gjithashtu veçanërisht të cenushme kundrejt dhunës.

117. Aktet e dhunës ose kërcënimet, pa marrë parasysh nëse shfaqen brenda shtëpisë ose në komunitet, që kryhen ose pranohen nga Shteti, u shtie në mend grave frikën dhe pasigurinë për jetën dhe bëhen pengesë për arritjen e barazisë, zhvillimit dhe paqes. Frika nga dhuna, përfshirë ngacmimin, është një detyrim i përhershëm në lëvizjen e grave dhe kufizon qasjen e tyre në resurset dhe veprimtaritë themelore. Kostot e larta sociale, shëndetësore dhe ekonomike të individëve dhe shoqërisë, janë shoqëruar me dhunën kundër grave. Dhuna kundër grave është një prej mekanizmave socialë kryesorë prej të cilit gratë detyrohen të kenë një pozicion të nënshtruar krahasuar me burrat. Në shumë raste, dhuna kundër grave dhe vajzave, shfaqet në familje ose brenda shtëpisë, ku dhuna shpesh tolerohet. Moskujdesi, keqtrajtimi fizik e seksual dhe përdhunimi i vajzave dhe grave nga anëtarët e familjes dhe anëtarëve të tjerë të ekonomisë shtëpiake, po ashtu edhe rastet e keqtrajtimit bashkëshortor ose jobashkëshortor, shpesh kalojnë pa u raportuar dhe si të tilla janë të vështira për t'u zbuluar. Madje edhe kur një dhunë e tillë raportohet, shumë shpesh nuk bëhet asgjë për të mbrojtur viktimat apo dënuar fajtorët.

118. Dhuna kundër grave është një shfaqje e marrëdhënieve historikisht të pabarabarta të pushtetit midis burrave dhe grave, që ka çuar deri te mbizotërimi dhe diskriminimi i grave nga burrat, si dhe ndalimin e përparimit të plotë të grave. Dhuna kundër grave gjatë ciklit të jetës, në thelb rrjedh nga modelet kulturore, veçanërisht nga efektet e dëmshme të disa praktikave zakonore apo tradicionale dhe të gjitha aktet e ekstremizmit të lidhura me racën, gjininë, gjuhën ose fenë, që i zgjasin jetën statusit të ulët i cili u është përcaktuar grave në familje, në vendin e punës, në komunitet dhe në shoqëri. Dhuna kundër grave acarohet nga presionet sociale, prej të cilave është turpi nga denoncimi i disa akteve të dhunës të kryera kundër grave;

mungesa e qasjes së grave në informata, ndihmë ose mbrojtje ligjore; mungesa e ligjeve që në mënyrë efektive ndalojnë dhunën kundër grave; dështimi për të reformuar ligjet ekzistuese; përpjekjet joadekuate nga ana e autoriteteve publike për të promovuar ndërgjegjësimin e ligjeve ekzistuese dhe për të vënë në zbatim ligjet ekzistuese; dhe mungesa e mjeteve edukuese, si dhe mjeteve tjera, për të adresuar shkaqet dhe pasojat e dhunës. Imazhet e dhunës kundër grave në media, në veçanti ato që shfaqin përdhunim ose robërinë seksuale, si dhe shfrytëzimi i grave dhe vajzave si objekte seksi, përfshirë pornografinë, janë faktorë që ndihmojnë në nivelin shumë të lartë dhe të vazhdueshme të përhapjes së dhunës, ndikojnë negativisht në komunitetin në përgjithësi, veçanërisht fëmijët dhe të rinjtë.

119. Zhvillimi i një qasjeje gjithëpërfshirëse dhe shumë-disiplinore ndaj kërkesës sfiduese të promovimit të familjes, komuniteteve dhe Shteteve që janë të lira nga dhuna kundër grave, është i nevojshëm dhe i arritshëm. Barazia, partneriteti midis grave dhe burrave, dhe respekti për dinjitetin njerëzor, duhet të përshkojnë të gjitha nivelet e procesit të shoqërizimit. Sistemet e edukimit duhet të promovojnë vetë-respektin, respektin reciprok dhe bashkëpunimin midis burrave dhe grave.

120. Mungesa e të dhënave adekuate, të ndara sipas gjinisë, mbi rastet e dhunës e bëjnë të vështirë përpunimin e programeve dhe monitorimin e ndryshimeve. Mungesa e dokumentacionit ose dokumentacioni joadekuat dhe kërkimet mbi dhunën familjare, ngacmimin seksual dhe dhunën kundër grave dhe vajzave në jetën private dhe publike, duke përfshirë dhunën në vendin e punës, pengojnë përpjekjet për të hartuar strategji specifike për intervenim. Përvoja nga një numër i vendeve tregon se gratë dhe burrat mund të mobilizohen për të tejkaluar dhunën në të gjitha format e saj dhe që mund të merren masa efektive publike për të adresuar si shkaqet ashtu edhe pasojat e dhunës. Mobilizimi i grupeve të burrave kundër dhunës gjinore janë aleatë të nevojshëm për ndryshim.

121. Gratë mund të jenë të cenueshme ndaj dhunës së kryer nga persona në pozita pushteti si në situata në konflikt ashtu edhe situata kur nuk ka konflikt. Trajnimi i të gjithë zyrtarëve për të drejtën humanitare dhe atë të të drejtave të njeriut, si dhe dënimi i fajtorëve të akteve të dhunës kundër grave, do të ndihmonin për të siguruar që një dhunë e tillë të mos kryhet nga zyrtarët publik në të cilët gratë duhet të mund të kishin besim, përfshi zyrtarët e policisë, të burgjeve dhe të forcave të sigurisë.

122. Ndalja efektive e trafikimit të grave dhe vajzave për tregun e seksit, është një çështje e shqetësimit urgjent ndërkombëtar. Duhet të rishikohen dhe të fuqizohet zbatimi i Konventës së vitit 1949 për Shtypjen e Trafikut të Personave dhe të Shfrytëzimit të Prostitutimit të Tjerëve,²⁰ si dhe të instrumenteve të tjera relevante. Shfrytëzimi i grave për prostitucion ndërkombëtar dhe nga rrjetet e trafikimit, janë kthyer në një fokus madhor të krimit të organizuar ndërkombëtar. Raportuesi i Veçantë i Komisionit të Drejtave të Njeriut për dhunën kundër grave, i cili ka hulumtuar këto akte si një shkaktar shtesë i shkeljes së të drejtave të njeriut e lirive themelore të grave e vajzave, ftohet që brenda mandatit të vet dhe si çështje urgjente të adresojë çështjen e trafikimit ndërkombëtar për qëllimin e tregtisë me seks, si dhe çështjet e prostitucionit të detyruar, të përdhunimit, keqtrajtimit seksual dhe turizmit të seksit. Gratë dhe vajzat që janë viktimat e kësaj tregtie ndërkombëtare, janë në një rrezik të rritur nga dhuna e mëtejshme, si dhe nga shtatzënitë të padëshiruara dhe infeksionet seksualisht të transmetueshme, përfshirë infeksionin me HIV/AIDS.

123. Në adresimin e dhunës kundër grave, Qeveritë dhe aktorët e tjerë duhet të promovojnë një politikë aktive dhe të dukshme të integritit të perspektivës gjinore në të gjitha politikat dhe programet, në mënyrë që para se të merren vendimet, të bëhet një analizë e efekteve të tyre mbi gratë dhe burrat, respektivisht.

Objektivi strategjik D.1.

Të merren masa integruese për parandalimin dhe zhdukjen e dhunës kundër grave.

Aksionet që duhen ndërmarrë

124. Nga Qeveritë:

- (a) Të dënojnë dhunën kundër grave dhe të përmbahen nga vënia në jetë e ndonjë zakoni, tradite ose konsiderate fetare për të ju shmangur obligimeve të tyre në lidhje me zhdukjen e kësaj dhune, siç shtrohet në Deklaratën për Eliminimin e Dhunës kundër Grave;
- (b) Të përmbahen që mos të kryejnë dhunë kundër grave dhe t'i ushtrojnë kujdesin e duhur për parandalimin, hetimin dhe,

²⁰ Rezolutë e Asamblesë së Përgjithshme 317 (IV), aneks.

në përputhje me legjislacionin kombëtar, dënimin e akteve të dhunës kundër grave, pa marrë parasysh nëse këto akte janë kryer nga shteti ose nga persona privatë;

- (c) Të dekretojnë dhe/ose të përforcojnë sanksionet penale, civile, të punës dhe ato administrative në legjislacionin vendor, për të dënuar dhe rregulluar gabimet e bëra kundër grave dhe vajzave, të cilat i janë nënshtruar çfarëdo forme dhune, qoftë ajo në shtëpi, në vendin e punës, në komunitet apo shoqëri;
- (d) Të miratojnë dhe/ose zbatojnë, dhe periodikisht të rishikojnë dhe të analizojnë legjislacionin për të garantuar efektivitetin e saj në eliminimin e dhunës kundër grave, duke theksuar parandalimin e dhunës dhe ndjekjen e fajtorëve; të marrin masa për të siguruar mbrojtjen e grave të cilat i janë nënshtruar çfarëdo forme të dhunës, qasje në mjete të drejta dhe efektive juridike, përfshirë kompensimin, dëmshpërblimin dhe shërimin e viktimave, dhe rehabilitimin e fajtorëve;
- (e) Të punojnë në mënyrë aktive për të dekretuar dhe/ose zbatuar normat dhe instrumentet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, pasi që ato kanë të bëjnë me dhunën kundër grave, përfshirë ato që janë pjesë e Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut,²¹ Marrëveshjes Ndërkombëtare mbi të Drejtat Civile dhe Politike, Marrëveshjes Ndërkombëtare mbi të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore, dhe Konventës kundër Torturës dhe formave tjera të Trajtimit dhe Ndëshkimit Mizor, Jonjerëzore apo Degradues;²²
- (f) Të zbatojnë Konventën për Eliminimin e Të Gjitha Formave të Diskriminimit kundër Grave, duke pasur arrë parasysh rekomandimin 19 të miratuar nga Komiteti për Eliminimin e Diskriminimit kundër Grave, në sesionin e tij të njëmbëdhjetë;²³
- (g) Të promovojnë një politikë aktive dhe të dukshme të integritit të perspektivës gjinore në të gjitha politikat dhe programet, që kanë të bëjnë me dhunën kundër grave dhe të inkurajojnë, mbështesin dhe zbatojnë aktivisht masa dhe programe që synojnë rritjen e njohurive dhe të kuptuarit e shkaqeve, pasojave dhe mekanizmave të dhunës kundër grave nga ata që janë përgjegjës për zbatimin e këtyre politikave, të tillë si zyrtarët që punojnë në zbatimin e ligjit,

²¹ Rezolutë e Asamblesë së Përgjithshme 217 A (III),

²² Rezolutë e Asamblesë së Përgjithshme 39/46, aneks.

²³ Regjistrimet Zyrtare të Asamblesë së Përgjithshme, Sesioni i 47-të, Shtesa No. 38(A/47/38), kap.I

personeli policor dhe punonjësit juridik, mjekësor dhe socialë, si dhe ata që merren me çështjet e pakicave, emigrimit dhe të refugjatëve, dhe të zhvillojnë strategji për të siguruar që riviktimizimi i grave që kanë qenë viktime të dhunës nuk do të ndodhë për shkak se nuk janë ligje të ndjeshme gjinore ose apo për shkak të praktikave juridike ose të zbatimit të tyre;

- (h) Të sigurojnë grave të cilat kanë qenë subjekte të dhunës, qasje në mekanizmat e drejtësisë dhe, në pajtim me legjislacionin kombëtarë, në mjete ligjore të drejta dhe efektive për dëmin që ato kanë pësuar dhe të informojnë gratë për të drejtat e tyre për të kërkuar dëmshpërblimin përmes këtyre mekanizmave;
- (i) Të dekretojnë dhe të zbatojnë legjislacionin kundër fajtorëve të praktikave dhe akteve të dhunës kundër grave, siç janë gjymtimi gjenital femëror, përzgjedhja e seksit para lindjes, vrasja e fëmijëve femra dhe dhuna e lidhur me prikën, si dhe t'u jepet përkrahje shumë e fuqishme përpjekjeve të organizatave joqeveritare dhe organizatave të komunitetit për të eliminuar praktika të tilla;
- (j) Të formulojnë dhe zbatojnë, në të gjitha nivelet e duhura, planet e veprimit për të zhdukur dhunën kundër grave;
- (k) Të adoptojnë dhe miratojnë të gjitha masat e duhura, veçanërisht në fushën e arsimit, për të modifikuar modelet sociale dhe kulturore të sjelljes së burrave dhe grave, dhe eliminimit të praktikave paragjykuese zakonore, si dhe të gjitha praktikave të tjera të bazuara në idenë e inferioritetit ose të superioritetit të njërit prej gjinive dhe mbi rolet stereotipe për gratë dhe burrat;
- (l) Të krijojnë ose të fuqizojnë mekanizmat institucionalë në mënyrë që gratë dhe vajzat të mund të raportojnë aktet e dhunës kundër tyre në një mjedis të sigurt dhe të besueshëm, të lira nga frika e dënimit ose hakmarrjes dhe të ngritin padi;
- (m) Të garantojnë që gratë me paaftësi kanë qasje në informata dhe shërbime në fushën e dhunës kundër grave;
- (n) Të krijojnë, përmirësojnë ose zhvillojnë, sipas nevojës, si dhe të financojnë programe trajnimi për personelin gjyqësor, ligjor, mjekësor, social, arsimor, policor dhe të emigracionit, me qëllim të ndalimit të keqpërdorimit të fuqisë që çon drejt dhunës kundër grave dhe ndërgjegjësimi i personelit të tillë për natyrën e akteve dhe kërcënimeve të dhunës me bazë

gjinore, në mënyrë që të mund të sigurohet trajtimi i drejtë i viktimave femërore;

- (o) Të miratohen ligje, ku është e nevojshme, si dhe të përforcohen ligjet ekzistuese të cilat dënojnë forcat e policisë, të sigurisë ose ndonjë agjenti tjetër të Shtetit, që kryejnë aktet e dhunës kundër grave në gjatë kryerjes së detyrës së tyre, të rishikohet legjislacioni ekzistues dhe të merren masa efektive kundër fajtorëve të një dhune të tillë;
- (p) Të ndajjnë resurset adekuate përbrenda buxhetit qeveritar dhe të mobilizojnë resurset e komunitetit për veprimtaritë të cilat lidhen me eliminimin e dhunës kundër grave, përfshirë burimet për zbatimin e planeve të veprimit në të gjitha nivelet e duhura;
- (q) Bazuar në dispozitat t instrumenteve të Kombeve të Bashkuara për të drejtat e njeriut, të përfshijnë në raportet e dorëzuara informata të cilat kanë të bëjnë me dhunën kundër grave dhe masat që janë marrë për të zbatuar Deklaratën për Eliminimin e Dhunës kundër Grave;
- (r) Të bashkëpunojnë me Raportuesin Special i Komisionit të të Drejtave të Njeriut për dhunën kundër grave dhe të asistojnë atë në ushtrimin e mandatit të saj dhe të pajisin atë me të gjitha informatat e kërkuara; të bashkëpunojnë gjithashtu me mekanizmat e tjera kompetentë, të tilla si Raportuesi Special i Komisionit të të Drejtave të Njeriut për torturën dhe Raportuesi Special i Komisionit të të Drejtave të Njeriut për ekzekutimet joligjore, jashtë gjyqimit dhe arbitrare, në lidhje me dhunën kundër grave;
- (s) Të rekomandojnë që Komisioni për të Drejtat e Njeriut të rishikojë mandatin e Raportuesit Special për dhunën kundër grave pasi të përfundojë mandati i sajë më 1997 dhe, nëse autorizohet, ta zgjasë dhe fuqizojë atë mandat.

125. Nga qeveritë, përfshirë qeveritë lokale dhe organizatat e komunitetit, organizatat joqeveritare, institucionet arsimore, sektorët publik e privat, veçanërisht ndërmarrjet dhe masmediat, sipas nevojës:

- a) Të sigurojnë strehim të mirë financiar dhe ndihma përkrahëse për vajzat dhe gratë të cilat kanë qenë të nënshtruara dhunës, po ashtu edhe shërbime këshillëdhënëse mjekësore, psikologjike dhe të tjera, si dhe ndihmë ligjore pa pagesë ose me kosto të ulët ku është e

nevojshme, si dhe asistencën e duhur për t'u mundësuar atyre të gjejnë mjete për të krijuar jetesë;

- b) Të krijojnë shërbime gjuhësore dhe kulturore ku gratë dhe vajzat emigrante do të kishin qasje, përfshirë këtu gratë punëtore emigrante, e që janë viktimat të dhunës me bazë gjinore;
- c) Të njohin cenueshmërinë ndaj dhunës dhe formave tjera të keqtrajtimit të grave emigrante, përfshirë gratë emigrante punëtore, statusi ligjor i të cilave në shtetin pranues varet nga punëdhënësit që mund ta shfrytëzojnë gjendjen e tyre;
- d) Të mbështesin nismat e organizatave të grave dhe organizatave joqeveritare në mbarë botën për të ngritur ndërgjegjësimin lidhur me çështjen e dhunës kundër grave dhe të kontribuojnë për eliminimin e saj;
- e) Të organizojnë, mbështesin dhe financojnë edukimin me bazë në komunitet dhe fushata trajnimi për të rritur ndërgjegjësimin rreth dhunës kundër grave si një shkelje që nuk u lejon grave të gëzojnë të drejtat e tyre të njeriut, si dhe të mobilizojnë komunitet lokale për të përdorur metoda të përshtatshme tradicionale dhe novatore, të ndjeshme nga këndvështrimi gjinor, për zgjidhjen e konfliktit;
- f) Të njohin, mbështesin dhe të promovojnë rolin themelor të institucioneve të ndërmjetësimit, të tilla si qendrat e kujdesit shëndetësor primar, qendrat e planifikimit familjar, shërbimet ekzistuese shëndetësore në shkollë, shërbimet për mbrojtjen e nënës dhe foshnjës, qendrat për familjet emigrante dhe të tjera, në fushën e informimit e të edukimit në lidhje me keqtrajtimin;
- g) Të organizojnë dhe financojnë fushata informimi dhe programe edukimi e trajnimi, me qëllim që të ndërgjegjësojnë vajzat dhe djemtë, si dhe gratë dhe burrat, për efektet e dëmshme sociale të dhunës në familje, komunitet dhe në shoqëri; t'i mësojë këta se si të komunikojnë pa dhunë; të promovojnë trajnimin për viktimat dhe viktimat e mundshme në mënyrë që ato të mbrojnë veten dhe të tjerët ndaj një dhune të tillë;
- h) Të shpërndajnë informatat mbi asistencën ekzistuese për gratë dhe familjet që janë viktimat të dhunës;
- i) Të sigurojnë, financojnë dhe të inkurajojnë programe këshillimi dhe rehabilitimi për kryesit veprave të dhunës, si dhe të promovohen kërkime që do të çonin më tutje

përpjekjet lidhur me këshillimin dhe rehabilitimin i cili do të parandalonte rishfaqjen e kësaj dhune;

- j) Të rrisin ndërgjegjësimin lidhur me përgjegjësinë e mediave në promovimin e imazheve jostereotipe të grave dhe burrave, po ashtu dhe për zhdukjen e modeleve të paraqitjes në media të cilat gjenerojnë dhunë, si dhe të inkurajojnë peronat përgjegjës për përmbajtjen e mediave që të krijojnë udhëzues profesionalë dhe kode të mirësjelljes të cilat janë në pajtim me lirinë e shprehjes; gjithashtu të rrisin ndërgjegjësimin për rolin e rëndësishëm të mediave në informimin dhe edukimin e popullatës rreth shkaqeve dhe efekteve të dhunës kundër grave dhe në nxitjen e debatit publik për këtë çështje.

126. Nga Qeveritë, punëdhënësit, sindikatat, organizatat rinore dhe ato të komunitetit dhe organizatat joqeveritare, sipas nevojës:

- (a) Të zhvillojnë programe dhe procedura për eliminimin e ngacimit seksual dhe formave të tjera të dhunës kundër grave në të gjitha institucionet arsimore, vendet e punës dhe kudo;
- (b) Të zhvillojnë programe dhe procedura për të edukuar dhe rritur ndërgjegjësimin lidhur me aktet e dhunës kundër grave të cilat përbëjnë një krim dhe shkelje të të drejtave njerëzore të grave;
- (c) Të zhvillojnë programe këshillimi, mjekimi dhe mbështetjeje për vajzat, adoleshentët dhe gratë e reja që kanë qenë ose janë të përfshira në marrëdhënie keqtrajtimi, veçanërisht ato që jetojnë në shtëpi ose në institucione ku ndodh abuzimi;
- (d) Të marrin masa të posaçme për të zhdukur dhunën kundër grave, veçanërisht të atyre që ndodhen në situata të cenueshme, të tilla si gratë e reja, refugjate, gratë e shpërngulura dhe të zhvendosura, gratë me paaftësi dhe gratë punëtore emigrante, duke përfshirë zbatimin e ndonjë legjislacioni ekzistues dhe, sipas nevojës, zhvillimin e legjislacionit të ri për gratë punëtore emigrante si në shtetin e origjinës ashtu edhe në atë pranues.

127. Nga Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara:

T'i sigurojë Raportuesit Special të Komisionit të të Drejtave të Njeriut për dhunën kundër grave tërë asistencën e nevojshme, veçanërisht stafin dhe resurset e nevojshme për të kryer të gjitha funksionet të përcaktuara me mandat, veçanërisht në zbatimin dhe

përcjelljen e misionëve të ndërmarrë, qoftë vetëm ose në bashkëpunim me raportuesit tjerë specialë dhe grupet e punës, si dhe asistencën adekuate për konsultime periodike me Komitetin për Eliminimin e Diskriminimit Kundër Grave dhe të gjitha organet e traktatit.

128. Nga Qeveritë, organizatat ndërkombëtare dhe organizatat joqeveritare:

Të inkurajojnë përhapjen dhe zbatimin e Udhëzimeve të UNHCR mbi Mbrojtjen e Grave Refugjate dhe Udhëzimet e UNHCR për Parandalimin dhe Reagimin ndaj Dhunës Seksuale kundër Refugjatëve.

Objektivi Strategjik D.2.

Të studiohen shkaqet dhe pasojat e dhunës kundër grave dhe efektiviteti i masave parandaluese

Aksionet që duhen ndërmarrë

129. Nga Qeveritë, organizatat rajonale, Kombet e Bashkuara, organizatat e tjera ndërkombëtare, institucionet kërkimore, organizatat rinore e të grave dhe organizatat joqeveritare, sipas nevojës:

- a) Të promovojnë kërkimet, të mbledhin të dhëna dhe të hartojnë statistika, veçanërisht për dhunën shtëpiake të lidhur me përhapjen e lartë të formave të ndryshme të dhunës kundër grave dhe të inkurajojnë kërkimet në lidhje me shkaqet, natyrën, seriozitetin dhe pasojat e dhunës kundër grave, si dhe efektivitetin e masave të zbatuara për të parandaluar dhe marrë masa kundër dhunës ndaj grave;
- b) Të përhapin gjerë gjetjet e kërkimeve dhe studimeve;
- c) Të mbështesin dhe iniciojnë kërkime për ndikimin e dhunës, siç është përdhunimi, mbi gratë dhe vajzat e mitura, dhe informatat dhe statistikat e nxjerra t'i vendosin në dispozicion të publikut të gjerë;
- d) Të inkurajojnë mediat për të shqyrtuar ndikimin e roleve stereotipe gjinore, përfshirë ato të cilat përforcohen nga reklamata komerciale e të cilat përkrahin dhunën me bazë gjinore dhe pabarazitë, si dhe të shqyrtojnë se si transmetohen ato gjatë ciklit të jetës dhe të marrin masa për

të eliminuar këto imazhe negative me qëllim të promovimit të një shoqërie pa dhunë.

Objektivi Strategjik D.3.

Të eliminohet trafikimi i grave dhe të asistohen viktimat e dhunës së prostitucionit dhe trafikimit

Aksionet që duhen ndërmarrë

130. Nga Qeveritë e shteteve të origjinës, atyre të transitit dhe të destinacionit, organizatat rajonale dhe ndërkombëtare, sipas nevojës:

- a) Të marrin në konsiderim ratifikimin dhe zbatimin e konventave ndërkombëtare mbi trafikimin e personave dhe robërinë;
- b) Të marrin masat e duhura për të adresuar faktorët rrënjësorë, përfshirë faktorët e jashtëm, të cilët inkurajojnë trafikimin e grave dhe vajzave për prostitucion dhe forma të tjera të tregtisë të seksit, martesat e detyruara dhe punën e detyruar me qëllim të eliminimit të trafikimit të grave, duke përfshirë fuqizimin e legjislacionit ekzistues me qëllim të ofrimit të mbrojtjes më të mirë të të drejtave të grave dhe vajzave dhe dënimit e fajtorëve, edhe përmes masave penale edhe atyre civile;
- c) Të ngrihet niveli i bashkëpunimit dhe veprimit të bashkërenduar i të gjitha autoriteteve dhe institucioneve relevante në fushën e zbatimit të ligjit që kanë për qëllim çmontimin e rrjeteve kombëtare, rajonale dhe ndërkombëtare të trafikimit;
- d) Të ndajnë resurse për të siguruar programe të gjithanshme të projektuara për të shëruar dhe rehabilituar prapa në shoqëri viktimat e trafikimit, duke përfshirë përmes trajnimeve për punë, asistencës ligjore dhe kujdesin shëndetësor të besueshëm, si dhe të ndërmarrin masa për të bashkëpunuar me organizatat joqeveritare për të siguruar kujdes social, mjekësor dhe psikologjik për viktimat e trafikimit;
- e) Të zhvillojnë programe dhe politika edukimi e trajnimi, si dhe të marrin në konsiderim dekretimin e legjislacionit i cili synon parandalimin e turizmit të seksit dhe trafikimit, duke i dhënë theks të veçantë mbrojtjes së grave të reja dhe fëmijëve.

E. GRATË DHE KONFLIKTI I ARMATOSUR

131. Një mjedis i cili ruan paqen botërore dhe promovon dhe mbron të drejtat e njeriut, demokracinë dhe zgjedhjen paqësore të mosmarrëveshjeve, në përputhje me parimet e moskërcënimit ose mospërdorimit të forcës kundër integritetit territorial ose pavarësisë politike dhe respektimit të sovranitetit, siç është parashtruar në Kartën e Kombeve të Bashkuara, është një faktor i rëndësishëm për përparimin e grave. Paqja është e lidhur në mënyrë të pandashme me barazinë midis grave dhe burrave dhe zhvillimin. Konfliktet e armatosura dhe llojet tjera të konfliktit si dhe terrorizmi dhe pengmarrja, vazhdojnë ende në shumë pjesë të botës. Agresioni, pushtimi i huaj, konfliktet etnike dhe llojet tjera të konfliktit, janë realitete që vijnë në ndikojnë mbi gratë dhe burrat gati në çdo rajon. Shkelje të mëdha e sistematike dhe situata që përbëjnë pengesa serioze për gëzimin e plotë të të drejtave të njeriut, vazhdojnë të shfaqen në pjesë të ndryshme të botës. Këto shkelje dhe pengesa përfshijnë po ashtu edhe torturën dhe sjelljen mizore, trajtim ose ndëshkimin jonjerëzor dhe degradues, ekzekutimet jashtëligjore dhe arbitrare, zhdukjet, arrestimet arbitrare, të gjitha format e racizmit dhe të diskriminimi racor, pushtimi i huaj dhe mbizotërimi i huaj, ksenofobia, varfëria, uria, si dhe mohime të tjera të të drejtave ekonomike, sociale e kulturore, jotoleranca fetare, terrorizmi, diskriminimi kundër grave dhe mungesa e fuqisë së ligjit. E drejta ndërkombëtare humanitare, që ndalon sulmet mbi popullsitë civile, si i tillë, nganjëherë po shpërfillet sistematikisht dhe të drejtat e njeriut shpesh shkelen në situatat e konfliktit të armatosur, duke ndikuar popullsinë civile, veçanërisht gratë dhe fëmijët, të moshuarit dhe të paaftët. Shkeljet e të drejtave njerëzore të grave në situatat e konfliktit të armatosur, janë shkelje të parimeve themelore të të drejtave ndërkombëtare të njeriut dhe të drejtës ndërkombëtare humanitare. Shkeljet masive të të drejtave të njeriut, veçanërisht në formën e gjenocidit, “spastrimit etnik” si një strategji e luftës dhe pasojave të saj, përdhunimit, përfshirë përdhunimin sistematik të grave në situata lufte, që krijojnë eksode masive refugjatësh dhe personash të zhvendosur, janë praktika neveritëse, të cilat janë dënuar fuqimisht dhe duhet të ndalohen menjëherë, ndërsa fajtorët e krimeve të tilla të ndëshkohen. Disa prej këtyre situatave të konfliktit të armatosur e kanë origjinën e tyre në pushtimin ose kolonizimin e një vendi nga një Shtet tjetër dhe të vazhdimin të atij kolonizimi përmes represionit shtetëror dhe ushtarak.

132. Konventa e Gjenevës lidhur me Mbrojtjen e Personave Civilë në Kohë Luftë, e vitit 1949, dhe Protokollet Shtesë të vitit 1977²⁴ garanton se gratë duhet të jenë sidomos të mbrojtura nga ndonjë sulm i nderit të tyre, në mënyrë të veçantë nga trajtimi degradues dhe përbuzës, përdhunimit, prostitucionit të detyruar ose ndonjë formë tjetër sulmi të pahijshëm. Deklarata e Vjenës dhe Programi për Veprim i miratuar në Konferencën Botërore për të Drejtat e Njeriut, deklaroi se “Shkeljet e të drejtave njerëzore të grave në situatat e konfliktit të armatosur janë shkelje të parimeve themelore të të drejtave ndërkombëtare të njeriut dhe të drejtës ndërkombëtare humanitare.”²⁵ Të gjitha shkeljet e këtij lloji, përfshirë veçanërisht vrasjen, përdhunimin, përfshirë përdhunimin sistematik, skllavërinë seksuale dhe shtatzëninë e detyruar, kërkojnë një përgjigje veçanërisht efektive. Shkeljet dhe situatat e tilla masive dhe sistematike që përbëjnë pengesa serioze për gëzimin e plotë të të drejtave të njeriut, vazhdojnë të shfaqen në pjesë të ndryshme të botës. Shkeljet dhe pengesat e tilla përfshijnë po ashtu edhe torturën dhe trajtimin mizor, jonjerëzor dhe degradues ose arrestimet jashtëligjore dhe arbitrare, të gjitha format e racizmit, diskriminimit racor, ksenofobinë, mohimin e të drejtave ekonomike, sociale, kulturore dhe jotolerancën fetare.

133. Shkeljet e të drejtave të njeriut në situatat me konflikt të armatosur dhe pushtimi ushtarak, janë shkelje të parimeve themelore të të drejtave ndërkombëtare të njeriut dhe të drejtës ndërkombëtare humanitare, të mishëruara në instrumentet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut dhe në Konventën e Gjenevës të 1949 dhe Protokollet Shtesë të tij. Shkeljet masive të të drejtave të njeriut dhe politikave pastrimit etnik në vendet e shkatërruara nga lufta dhe zonat e pushtuara, vazhdojnë të ndodhin. Këto praktika kanë krijuar, me fjalë të tjera, një rrjedhje masive refugjatësh dhe personash të tjerë të zhvendosur që kanë nevojë të mbrojtjes ndërkombëtare dhe persona të zhvendosur brenda vendit, shumica e të cilëve janë gra, vajza adoleshente dhe fëmijë. Viktimat civile, shumica gra e fëmijë, shpesh tejkalojnë numrin e viktimave të luftëtarëve. Përveç kësaj, gratë shpesh bëhen ato që ofrojnë kujdesin luftëtarëve të plagosur dhe si rezultat i konfliktit, e gjejnë veten papritur si udhëheqëse të vetme të ekonomive shtëpiake, prind të vetëm dhe kujdestar të të afërmeve të moshuar.

134. Në një botë të jostabilitetit dhe të dhunës së vazhdueshme, zbatimi i qasjeve bashkëpunuese drejt paqes dhe sigurisë, është një nevojë urgjente. Qasja e barabartë dhe pjesëmarrja e plotë e grave në

²⁴ Seria e Marrëveshjeve të Kombeve të Bashkuara, Vol. 75, No. 973, f. 287

²⁵ Raport i Konferencës për të Drejtat e Njeriut, kap. III, sekt. II, parag.38

strukturat e pushtetit, si dhe përfshirja tërësore e tyre në të gjitha përpjekjet për parandalimin dhe zgjidhjen e konflikteve, janë thelbësore për mirëmbajtjen dhe promovimin e paqes dhe të sigurisë. Sado që gratë kanë filluar të luajnë një rol të rëndësishëm në zgjidhjen e konflikteve, në paqe-ruajtjen e në mbrojtjen dhe mekanizmat e punëve të jashtme, ato janë ende të nënpërfaqësuar në pozita vendimmarrëse. Që gratë të luajnë një rol të barabartë në sigurinë dhe mbajtjen e paqes, ato duhet të fuqizohen politikisht dhe ekonomikisht, si dhe të përfaqësohen në masë adekuate në të gjitha nivelet e vendimmarrjes.

135. Përderisa komunitete të tëra vuajnë pasojat e konflikteve të armatosura dhe të terrorizmit, gratë dhe vajzat janë veçanërisht të ndikuar për shkak të statusit në shoqëri dhe gjinisë së tyre. Palët në konflikt shumë shpesh përdhunojnë gratë pa frikë nga ndëshkimi, shpesh duke përdorur përdhunimin sistematik si një taktikë të luftës dhe të terrorizmit. Ndikimi i dhunës kundër grave dhe shkelja e të drejtave të njeriut të grave në situata të tilla përjetohet nga gratë e të gjitha moshave, që vuajnë shpërnguljen, humbjen e vendbanimit dhe pronës, humbjen ose zhdukjen e pavullnetshme të të afërmeve, varfërinë, ndarjen e familjes dhe shpërbërjen, dhe janë viktimat e akteve të vrasjes, terrorizmit, torturës, zhdukjes së pavullnetshme, skllavërisë seksuale, përdhunimit, keqtrajtimit seksual dhe shtatzënisë së detyruar në situatat e konfliktit të armatosur, veçanërisht si rezultat i politikave të spastrimit etnik dhe formave të tjera të reja të dhunës që janë duke u shfaqur. Kësaj i bashkëngjiten edhe pasojat traumatike afatgjata sociale, ekonomike e psikologjike të konfliktit të armatosur, të pushtimit të huaj dhe mbizotërimit të huaj.

136. Gratë dhe fëmijët përbëjnë rreth 80% të miliona refugjatëve dhe të personave të tjerë të shpërngulur në tërë botën, përfshirë personat e shpërngulur brenda vendit. Ata kërcënohen me heqje të drejtës mbi pronë, të mira materiale dhe shërbime, dhe heqjen e së drejtës së tyre për t'u kthyer në shtëpitë e tyre të origjinës. Po ashtu kërcënohen edhe nga dhuna e pasiguria. Vëmendje e posaçme duhet t'i kushtohet dhunës seksuale kundër grave dhe vajzave të çrrënjosura të shfrytëzuara si një metodë e persekutimit në fushatat sistematike të terrorit dhe të frikësimit, si dhe detyrimit të anëtarëve të një grupi të veçantë etnik, kulturor ose fetar, të largohen nga shtëpitë e tyre. Gratë gjithashtu mund të detyrohen të largohen si rezultat i frikës së persekutimit për arsye të emëtuara në Konventën e vitit 1951 në lidhje me Statusin e Refugjatëve dhe të Protokollit të 1967-ës, që përfshin persekutimin përmes dhunës seksuale ose persekutimit tjetër me bazë gjinore. Dhe ato vazhdojnë të jenë të cenueshme ndaj dhunës dhe shfrytëzimit gjersa janë në arrati, si në vendet e azilit dhe rivendosjes në koloni ashtu edhe gjatë dhe pas riatdhesimit. Gratë

shpesh përjetojnë vështirësi të njohjes së statusit të refugjatit në disa vende të azilit kur si bazë për atë kërkesë është një persekutim i tillë.

137. Gratë refugjate, të zhvendosura dhe emigrante, në shumicën e rasteve shfaqin fuqi, qëndresë dhe mendjemprehtësi dhe mund të kontribuojnë pozitivisht në vendet e ribanimit ose në vendet e tyre të origjinës pas kthimit në to. Ato kanë nevojë të përfshihen në mënyrë të përshtatshme në vendimet që ndikojnë mbi to.

138. Shumë organizata joqeveritare të grave kanë bërë thirrje për ulje të shpenzimeve ushtarake në mbarë botën, si dhe në tregtimin dhe trafikimin ndërkombëtar të armëve dhe proliferimin e tyre. Popujt që jetojnë në varfëri janë më të ndikuarit negativisht nga konflikti dhe shpenzimi i tepërt ushtarak. Ata janë të privuar për shkak të mungesës së investimeve në shërbimet themelore. Gratë që jetojnë në varfëri, veçanërisht gratë rurale, vuajnë për shkak të përdorimit të armëve që janë shkaktojnë lëndime të mëdha ose kanë efekt në të gjithë pa dallim. Ka më se 100 milion mina tokësore kundër këmbësorie të shpërndara në 64 vende të globit. Ndikimi negativ në zhvillim i shpenzimeve të tepërta ushtarake, tregtia e armëve dhe investimet për prodhimin dhe blerjen e armëve, duhet të adresohet. Në të njëjtën kohë, mirëmbajtja e sigurisë dhe paqes kombëtare është thelbësore për rritjen dhe zhvillimin ekonomik dhe fuqizimin e grave.

139. Gjatë kohës së konfliktit të armatosur dhe kolapsit të komuniteteve, roli i grave është qenësor. Ato shpesh punojnë për të ruajtur rendin shoqëror në mes të konflikteve të armatosura dhe llojeve tjera të konfliktit. Gratë japin një kontribut të rëndësishëm, por i cili shpesh nuk ju njihet, si edukatore të paqes edhe në familje edhe në shoqëritë e tyre.

140. Edukimi për të zhvilluar një kulturë të paqes që mbështet drejtësinë dhe tolerancën për të gjithë kombet dhe popujt është qenësor për të arritur paqen e qëndrueshme dhe duhet të fillojë në moshë të hershme. Ai duhet të përfshijë elementët e zgjidhjes së konfliktit, ndërmjetësimit, zvogëlimit të paragjyqimeve dhe respektin për diversitetin.

141. Në adresimin e konflikteve të armatosura apo llojeve tjera të konfliktit, duhet të promovohen politika aktive dhe të dukshme të integritit të perspektivës gjinore në të gjitha politikat dhe programet,

në mënyrë që para se të merren vendimet të bëhet një analizë lidhur me efektet që ato do të kenë mbi gratë dhe burrat, respektivisht.

Objektivi strategjik E.1.

Të rritet pjesëmarrja e grave në zgjidhjen e konfliktit në nivelet e vendimmarrjes dhe të mbrohen gratë që jetojnë në situatat e konflikteve të armatosura dhe konflikteve të tjera ose nën pushtimin e huaj.

Aksionet që duhen ndërmarrë

142. Nga qeveritë, institucionet ndërkombëtare dhe rajonale ndërqeveritare:

- (a) Të marrin veprime për promovimin e pjesëmarrjes së barabartë të grave dhe mundësitë e barabarta për gratë për të marrë pjesë në të gjitha forumet dhe veprimtaritë e paqes në të gjitha nivelet, veçanërisht në nivel vendimmarrës, përfshirë në Sekretariatit e Kombeve të Bashkuara në lidhje me shpërndarjen e barabartë gjeografike në pajtim me Nenin 101 të Kartës së Kombeve të Bashkuara;
- (b) Të fuqizojnë rolin e grave dhe të sigurojnë përfaqësimin e barabartë të grave në të gjitha nivelet e vendimmarrjes në institucione kombëtare e ndërkombëtare, që mund të bëjnë ose të ndikojnë në politika në lidhje me çështjet e ruajtjes së paqes, diplomacisë parandaluese dhe veprimtarive përkatëse si dhe në të gjitha etapat e ndërmjetësimit dhe negociatave për paqe, duke marrë parasysh rekomandimet specifike të Sekretarit të Përgjithshëm në planin e tij strategjik të veprimit për përmirësimin e statusit të grave në Sekretariat (1995-2000) (A/49/587, seksioni IV).;
- (c) Të integrojnë perspektivën gjinore në zgjidhjen e konflikteve të armatosura apo konflikteve të tjera dhe pushtimit të huaj dhe të synojnë balancën gjinore kur emërohen ose promovohen kandidatët për pozita juridike apo pozita të tjera në të gjitha organet relevante ndërkombëtare, siç janë Gjykata Ndërkombëtare të Kombeve të Bashkuara për ish Jugosllavinë dhe ajo për Ruandën dhe Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë, si dhe si në organet e tjera që kanë të bëjnë me zgjidhjet paqësore të mosmarrëveshjeve;

- (d) Të garantojnë që këto organe janë të afta për të adresuar çështjet gjinore siç duhet duke ofruar trajnime të duhura për prokurorët e gjyqtarët dhe zyrtarët e tjerë të cilët merren me raste që përfshijnë përdhunimin, shtatzëninë e padëshiruar në situatat e konflikteve të armatosura, sulmin e pahijshëm dhe format tjera të dhunës kundër grave në konfliktet e armatosura, përfshirë terrorizmin, si dhe të integrohet një perspektivë gjinore në punën e tyre;
- (e) Të fuqizojnë pjesëmarrjen e grave në proceset e pajtimit dhe rindërtimit kombëtar pas të gjitha formave të konfliktit.

Objektivi Strategjik E.2.

Zvogëlimi i shpenzimeve të tepërta ushtarake dhe kontrolli i shkallës së disponueshmërisë së armatimeve

Aksionet që duhen ndërmarrë

143. Nga Qeveritë:

- (a) Të rrisin dhe përshpejtojnë, sipas nevojës, varësisht prej nevojave për sigurinë kombëtare, shndërrimin e resurseve ushtarake dhe industrive të ndërlidhura me to për qëllime të zhvillimit dhe ato paqësore;
- (b) Të ndërmarrin veprime për të zbuluar mënyra të reja të gjenerimit të resurseve financiare publike dhe private, në mes tjerash, përmes zvogëlimit të duhur të shpenzimeve të tepërta ushtarake, përfshirë shpenzimet ushtarake globale, tregtinë me armë dhe investimet në prodhimin dhe blerjen e armëve, duke marrë në konsiderim kërkesat e sigurisë kombëtare, në mënyrë që të lejohet shpërndarja e mundshme e fondeve shtesë për zhvillim social e ekonomik, në mënyrë të veçantë për përparimin e grave;
- (c) Të ndërmarrin veprime për të hetuar dhe dënuar anëtarët e forcave policore, të sigurisë dhe të forcave të armatosura dhe të tjerët të cilët kanë kryer akte të dhunës ndaj grave, shkelje të drejtës humanitare ndërkombëtare dhe shkelje të të drejtave njerëzore të grave në situata të konfliktit të armatosur;
- (d) Përderisa pranojnë nevojat legjitime për mbrojtjen kombëtare, të njohin dhe të adresojnë rreziqet e konflikteve të armatosura për shoqërinë dhe efektin negativ të shpenzimeve të tepërta ushtarake, tregtisë me armë, sidomos

ato armë që shkaktojnë shumë lëndime apo që kanë efekte pa dallim, dhe investimi i tepërt në prodhimin dhe blerjen e armëve; ngjashëm, të njohin nevojat për të luftuar trafikimin e paligjshëm të armëve, dhunën, krimin, prodhimin dhe shfrytëzimin dhe trafikimin e drogave të paligjshme, dhe trafikimin e grave dhe fëmijëve;

- (e) Të njohin që gratë dhe fëmijët janë veçanërisht të ndikuar nga përdorimi pa dallim i minave tokësore kundërnjerëzore:
- i. Të punojnë aktivisht për ratifikimin, nëse nuk është bërë ende deri tani, të Konventës së vitit 1981 për Ndalimin apo Kufizimin e Përdorimit të Disa Armëve Konvencionale të Cilat Mund Jenë Tepër Dëmtuese ose Kanë Efekte Pa Dallim, veçanërisht Protokolli mbi Ndalimin ose Kufizimin e Përdorimit të Minave, Minave të Befasisë dhe Mjeteve Tjera (Protokolli II),²⁶ me qëllim të ratifikimit universal deri në vitin 2000;
 - ii. Të ndërmarrin fuqishëm në konsideratë fuqizimin e Konventës për të promovuar një ulje të vdekjeve dhe vajtjen e rëndë të shkaktuar popullsisë civile nga përdorimi pa dallim i minave tokësore;
 - iii. Të ndërmarrin promovimin e asistencës për pastrimin nga minat, duke lehtësuar dukshëm, për sa i takon mjeteve minapastruese, shkëmbimin e informatave, transferimit të teknologjisë dhe promovimit të kërkimit shkencor;
 - iv. Brenda kontekstit të Kombeve të Bashkuara, të mbështesin përpjekjet për të koordinuar një program për reagim të përbashkët të asistencës për çminim pa diskriminim e panevojshëm;
 - v. Të miratojnë në datën më të hershme të mundshme, nëse ende nuk është bërë, një moratorium mbi eksportin e minave tokësore kundërnjerëzore, përfshirë entitetet joqeveritare, duke shënuar me kënaqësi se shumë shtete tashmë kanë deklaruar moratoriumet mbi eksportin, transferimin ose shitjen e minave të tilla;
 - vi. Të ndërmarrin dhe inkurajojnë përpjekje të mëtejshme ndërkombëtare për të kërkuar zgjidhjet për problemet e shkaktuara nga minat tokësore kundërnjerëzore, me qëllim të zhdukjes së tyre eventuale, duke njohur se Shtetet mund të lëvizin në mënyrë më efektive drejt këtij objekti derisa zhvillohen alternativat e qëndrueshme dhe të njerëzishme;

²⁶ Vjetari i Kombeve të Bashkuara për çarmatimin, Vol.5: 1980 (UN publication, sales No. E.81.IX.4) app VII.

- (f) Duke njohur rolin udhëheqës që kanë luajtur gratë në lëvizjen për paqe:
- i. Të punojnë aktivisht për çarmatimin e përgjithshëm dhe të plotë nën kontrollin e rreptë dhe efektiv ndërkombëtar;
 - ii. Të mbështesin negociatat mbi përfundimin, pa vonesë, të një traktati gjithëpërfshirës për kontrollin e armëve bërthamore që do të ishte i verifikueshëm në mënyrë multilaterale dhe universale, që do të kontribuonte në çarmatimin bërthamor dhe parandalimin e përhapjes së armëve bërthamore në të gjitha aspektet e saja;
 - iii. Deri sa të hyjë në fuqi traktati i përgjithshëm për ndalimin e provave të armëve bërthamore, të ushtrohet përmbajtje e nivelit më të lartë në lidhje me provat bërthamore.

Objektivi Strategjik E.3.

Të promovohen format jo të dhunshme për zgjidhjen e konflikteve dhe të zvogëlohen rastet e keqtrajtimit të të drejtave të njeriut në situatat e konfliktit

Aksionet që duhen ndërmarrë

144. Nga Qeveritë:

- a) Të marrin nën konsiderim ratifikimin e instrumenteve ndërkombëtare ose bashkëngjitjen në ato instrumente ndërkombëtare që përmbajnë klauzola në lidhje me mbrojtjen e grave dhe fëmijëve në konfliktet e armatosura, përfshirë Konventën e Gjenevës lidhur me Mbrojtjen e Personave Civilë në Kohë Lufte, e vitit 1949, dhe Protokollet Shtesë të Konventës së Gjenevës të vitit 1949, lidhur me Mbrojtjen e Viktimave të Konflikteve të Armatosura Ndërkombëtare (Protokolli I) dhe për Mbrojtjen e Viktimave të Konflikteve të Armatosura Jo Ndërkombëtare (Protokolli II);
- b) Të respektojnë plotësisht normat e të drejtës ndërkombëtare humanitare në konfliktet e armatosura dhe të marrin të gjitha masat e nevojshme për mbrojtjen e grave dhe fëmijëve, veçanërisht kundër përdhunimit, prostitucionit të detyruar dhe çfarëdo forme tjetër të sulmit të pahijshëm.

145. Nga Qeveritë dhe organizatat ndërkombëtare dhe rajonale:

- a) Të ripohojnë të drejtën për vetëvendosje të të gjithë popujve, veçanërisht të popujve nën dominimin kolonial ose formave tjera të mbizotërimit të huaj apo pushtimit të huaj, dhe rëndësia e realizimit efektiv të kësaj të drejte, siç shprehet, midis tjerash, në Deklaratën e Vjenës dhe Programin për Veprim, miratuar nga Konferenca Botërore për të Drejtat e Njeriut;
- b) Të inkurajojnë diplomacinë, negociatat dhe zgjidhjen paqësore të mosmarrëveshjeve në përputhje me Kartën e Kombeve të Bashkuara, në veçanti Nenin 2, paragrafët 3 dhe 4 të kësaj karte;
- c) Të kërkojnë me ngulm identifikimin dhe dënimin e praktikave sistematike të përdhunimit dhe formave të tjera të trajtimit jonjerëzor dhe degradues të grave si një instrument i qëllimshëm i luftës dhe spastrimit etnik, dhe të marrin masa për t'u siguruar viktimave të një keqtrajtimi të tillë asistencë të plotë për rehabilitimin e tyre fizik dhe mendor;
- d) Të riafirmojnë se përdhunimi gjatë konfliktit të armatosur përbën krim lufte dhe nën disa rrethana të caktuara ai përbën një krim kundër njerëzimit dhe një akt gjenocidi, siç është e definuar në Konventën për Parandalimin dhe Dënimin e Krimeve të Gjenocidit²⁷; të marrin të gjitha masat e nevojshme për mbrojtjen e grave dhe fëmijëve nga akte të tilla dhe të fuqizojnë mekanizmat për të hetuar dhe dënuar të gjithë ata që janë përgjegjës dhe ti sjellin fajtorët para drejtësisë;
- e) Të përkrahin dhe të fuqizojnë standardet e definuara në të drejtën ndërkombëtare humanitare dhe instrumentet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut për të parandaluar të gjitha aktet e dhunës kundër grave në situatat e konfliktit të armatosur dhe akteve të tjera të konfliktit; të ndërmarrin një hetim të plotë të të gjitha akteve të dhunës kundër grave të kryera gjatë luftës, përfshirë përdhunimin, veçanërisht përdhunimin sistematik, prostitucionin e detyruar dhe format tjera të sulmit të padenjë dhe skllavërisë seksuale, të ndjekin të gjithë kriminelët përgjegjës për krime lufte kundër grave dhe t'u sigurohet dëmshpërblim i plotë i grave viktimave;

²⁷ Rezolutë e Asamblesë së Përgjithshme 260 A (III) anex

- f) T'i bëjnë thirrje komunitetit ndërkombëtar për të dënuar dhe vepruar kundër të gjitha formave dhe manifestimeve të terrorizmit;
- g) Të marrin në konsideratë interesat e ndjeshme gjinore në zhvillimin e programeve të trajnimit për të gjithë personelin relevant lidhur me të drejtën ndërkombëtare humanitare dhe ndërgjegjësimin për të drejtat e njeriut dhe të rekomandohen trajnime të tilla për ata që përfshihen në misionet paqeruajtëse dhe të ndihmës humanitare të OKB-së, me qëllim të parandalimit të dhunës, në veçanti asaj kundër grave;
- h) Të shkurajojnë miratimin e ndonjë mase të njëanshme dhe të përmbahen nga çfarëdo mase e tillë që nuk është në përputhje me të drejtën ndërkombëtare dhe Kartën e Kombeve të Bashkuara, që ndalon arritjen e plotë të zhvillimit ekonomik dhe social nga popullsia e vendeve të ndikuara, në mënyrë të veçantë grave dhe fëmijëve, që pengon mirëqenien e tyre dhe krijon pengesa për gëzimin e plotë të të drejtave të njeriut nga ata, përfshirë të drejtën e secilit për një standard jetese të mjaftueshëm për shëndetin dhe mirëqenien e tyre, si dhe të drejtën për ushqim, kujdes mjekësor dhe shërbime të nevojshme sociale. Kjo Konferencë ripohon që ushqimi dhe mjekimi duhet të mos përdoren si një mjet i presionit politik;
- i) Të marrin masat sipas të drejtës ndërkombëtare me qëllim të zbutjes së ndikimit negativ të sanksioneve ekonomike në gratë dhe fëmijët.

Objektivi *strategjik E.4.*

Të nxitet kontributi për zhvillimin e një kulture të paqes

Aksionet që duhen ndërmarrë

146. Nga Qeveritë, institucionet ndërqeveritare ndërkombëtare dhe rajonale dhe he organizatat joqeveritare.

- a) Të promovojnë zgjidhjen paqësore të konfliktit dhe paqen, pajtimin dhe tolerancën përmes arsimimit, trajnimit, veprimeve të komunitetit dhe programeve rinore të shkëmbimit, veçanërisht për gratë e reja;
- b) Të rishqyrtojnë zbatimin e planit të veprimit për Dhjetëvjeçarin e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e

Njeriut për Arsimim (1995-2004), të marrin nën konsideratë rezultatet e Konferencës së Katërt Botërore për Gratë: Aksioni për Barazi, Zhvillim e Paqe;

- c) Të inkurajojnë zhvillimin e mëtejshëm të kërkimeve për paqe, duke përfshirë pjesëmarrjen e grave, për të shqyrtuar ndikimin e konfliktit të armatosur në gratë dhe fëmijët dhe natyrën dhe kontributin e pjesëmarrjes së grave në lëvizjet paqësore kombëtare, rajonale dhe ndërkombëtare; të angazhohen në kërkime dhe të identifikojnë mekanizma novatorë për kufizimin e dhunës dhe për zgjidhjen e konflikteve për përhapjen publike dhe për përdorimin nga gratë dhe burrat;
- d) Të zhvillojnë dhe të shpërndajnë kërkimet për efektet fizike, psikologjike, ekonomike dhe sociale të konflikteve të armatosura në gratë, sidomos gratë e reja dhe vajzat, me qëllim të zhvillimit të politikave dhe programeve për të adresuar pasojat e konflikteve;
- e) Të marrin parasysh krijimin e programeve edukuese për vajzat dhe djemtë për të zhvilluar një kulturë të paqes, duke u fokusuar në zgjidhjen e konflikteve me mjete jo të dhunshme dhe promovimin e tolerancës.

Objektivi strategjik E.5.

Të sigurohet mbrojtja, asistenca dhe trajnimi i grave refugjate, dhe grave të tjera të zhvendosura që kanë nevojë për mbrojtje ndërkombëtare dhe grave të zhvendosura brenda vendit.

Aksionet që duhen ndërmarrë

147. Nga Qeveritë, organizatat ndërqeveritare e joqeveritare dhe institucionet e tjera të përfshira në sigurimin e mbrojtjes, asistencës dhe trajnimit të grave refugjate, të grave të zhvendosura në nevojë të mbrojtjes ndërkombëtare dhe të grave të zhvendosura brenda vendit, përfshirë Zyrën e Komisionarit të Lartë të Kombeve të Bashkuara për Refugjatë dhe Programit Botëror të Ushqimit, sipas nevojës:

- (a) Të marrin masa për të siguruar që gratë të jenë plotësisht të përfshira në planifikimin, hartimin, zbatimin, monitorimin dhe vlerësimin e të gjitha projekteve e programeve afatshkurtra dhe afatgjata që ofrojnë asistencë për gratë refugjate, gratë e zhvendosura që kanë nevojë për mbrojtje ndërkombëtare dhe të gratë e zhvendosura brenda vendit, duke përfshirë menaxhimin e kampeve dhe resurseve për refugjatët; për të garantuar që refugjatët dhe gratë e vajzat e

zhvendosura të kenë qasje të drejtpërdrejtë në shërbimet e ofruara;

- (b) Të ofrojnë mbrojtje dhe asistencë adekuate për gratë dhe fëmijët e zhvendosur brenda vendit të vet dhe të gjejnë zgjidhje për shkaqet rrënjësore të zhvendosjes së tyre me qëllim të parandalimit të kësaj dukurie, dhe kudo që është e mundur të ndihmohet kthimi i tyre ose rivendosja;
- (c) Të marrin masa për të mbrojtur sigurinë dhe integritetin fizik të grave refugjate, grave tjera të zhvendosura që kanë nevojë për mbrojtje ndërkombëtare dhe të grave të zhvendosura brenda vendit, si gjatë zhvendosjes së tyre ashtu edhe gjatë rikthimit të tyre në komunitetet e origjinës, përfshirë programet e rehabilitimit; të marrin masa efektive për të mbrojtur nga dhuna gratë që janë refugjate ose të zhvendosura, të kryejnë një hetim i paanshëm dhe të thukët për çfarëdo shkelje të tillë dhe përgjegjësit të sillen para drejtësisë;
- (d) Duke respektuar plotësisht dhe duke ju përmbajtur rreptësisht parimeve të moskthimit të refugjatëve, të ndërmarrin të gjitha masat e nevojshme për të garantuar të drejtën e grave refugjate dhe të zhvendosura për tu kthyer vullnetarisht në vendin e tyre të origjinës në siguri dhe me dinjitet, si dhe të drejtën e tyre për mbrojtje pas kthimit;
- (e) Të marrin masat, në nivel kombëtar me bashkëpunimin ndërkombëtar, sipas nevojës, në përputhje me Kartën e Kombeve të Bashkuara, për të gjetur zgjidhje të qëndrueshme të çështjeve që lidhen me gratë e zhvendosura brenda vendit, përfshirë të drejtën e tyre për t'u kthyer vullnetarisht e të sigurta në shtëpinë e tyre të origjinës;
- (f) Të garantojnë që komuniteti ndërkombëtar dhe organizatat e saja ndërkombëtare të resurse financiare dhe resurse të tjera për lehtësimin emergjent dhe asistencën tjetër afatgjatë, e cila merr parasysh nevojat specifike, resurset dhe mundësitë e grave refugjate, të grave të zhvendosura që kanë nevojë për mbrojtje ndërkombëtare dhe të grave të zhvendosura brenda vendit. Në ofrimin e mbrojtjes dhe ndihmës, të ndërmarrin të gjitha masat e duhura për të eliminuar diskriminimin kundër grave e vajzave me qëllim që t'u sigurohet qasje e barabartë për ushqim, ujë dhe strehim, arsimim dhe shërbime sociale e shëndetësore të përshtatshme dhe adekuate, duke përfshirë kujdesin për shëndetin riprodhues dhe kujdesin dhe shërbimet për nënat për të luftuar sëmundjet tropikale;

- (g) Të ndihmojnë në disponueshmërisë e materialeve arsimore në gjuhën e duhur – gjithashtu edhe në situatat e emergjencës – me qëllim për të minimizuar ndaljet në shkollim të fëmijëve refugjatë dhe atyre të zhvendosur;
- (h) Të zbatojnë normat ndërkombëtare për të garantuar qasje të barabartë dhe trajtim të barabartë të grave dhe burrave në procedurat e përcaktimit të refugjatëve dhe dhënies së azilit, përfshirë respektimin e plotë dhe duke ju përmbajtur rreptësisht parimit të moskthimit, midis tjerash, përmes vendosjes së rregullave kombëtare të emigracionit në përputhje me instrumentet përkatëse ndërkombëtare, dhe të marrin nën konsiderim njohjen e statusit të refugjatit atyre grave që pretendojnë se statusi i refugjatit bazohet në frikën reale nga persekutimi për arsytet e emëtuara në Konventën e vitit 1951,²⁸ në lidhje me Statusin e Refugjatëve dhe Protokollin e vitit 1967,²⁹ duke përfshirë persekutimin përmes dhunës seksuale ose persekutimit tjetër në baza gjinore, si dhe të sigurojnë qasje në zyrtarë me trajnim specifik, përfshirë zyrtaret femra, për të intervistuar gratë në lidhje me përvojat e ndjeshme apo të dhimbshme, të tilla si sulmet seksuale;
- (i) Të mbështesin dhe të promovojnë përpjekjet e Shteteve për zhvillimin e kriterëve dhe udhëzimeve për reagim ndaj persekutimit që në mënyrë specifike është drejtuar kundër grave, duke ndarë informatat mbi nismat e Shteteve për zhvillimin e kriterëve dhe udhëzimeve të tilla dhe për monitorimin e tyre për të garantuar zbatimin e drejtë dhe të qëndrueshëm të tyre;
- (j) Të promovojnë kapacitetet për vetë-mbështetje të grave refugjate, të grave të tjera të zhvendosura që kanë nevojë për mbrojtje ndërkombëtare dhe të grave të zhvendosura brenda vendit, si dhe të sigurojnë programe për gratë, veçanërisht gratë e reja, në fushat e udhëheqjes dhe vendimmarrjes brenda komuniteteve të refugjatëve dhe të të kthyerve;
- (k) Të sigurojnë që do të mbrohen të drejtat njerëzore të grave refugjate dhe të zhvendosura dhe që gratë refugjate dhe të zhvendosura janë të vetëdijesuar për këto të drejta; të sigurojnë që të njihet rëndësia jetësore e ribashkimit familjar;
- (l) T'u sigurojnë, sipas nevojës, grave që janë përcaktuar si refugjate, qasje në programe trajnimi profesional dhe punësimi, duke përfshirë trajnime të gjuhës, trajnim, për zhvillim të ndërmarrjeve të vogla dhe planifikim e këshillim

²⁸ *Kombet e Bashkuara, Seria e Marrëveshjeve, vol. 189. No.2545.*

²⁹ *Ibid., vol.606, no.8791.*

për të gjitha format e dhunës kundër grave, që duhet përfshirë programe rehabilitimi për viktimat e torturës dhe për trauma; Qeveritë dhe donatorët tjerë duhen të kontribuojnë në masë adekuatë në programet e asistencës për gratë refugjate, për gratë tjera të zhvendosura që kanë nevojë për mbrojtjes ndërkombëtare dhe të grave të zhvendosura brenda vendit, veçanërisht duke marrë parasysh efektet që kanë në vendet pritëse rritja e kërkesave të popullsisë të mëdha refugjate dhe nevojës për të zgjeruar bazën e donatorëve për të arritur ndarje më të mirë të ngarkesës;

- (m) Të ngritin nivelin e ndërgjegjësimit publik lidhur me kontributin e bërë nga gratë refugjate në vendet e ku janë rivendosur, për të promovuar të kuptuarit e të drejtave të tyre të njeriut dhe të nevojave e aftësive të tyre, dhe të inkurajohet të kuptuarit dhe pranimi i ndërsjellë përmes programeve edukuese që promovojnë harmoninë midis kulturave dhe ndërmjet racave;
- (n) T'u sigurojnë shërbimet themelore dhe ato mbështetëse grave që janë zhvendosur nga vendi i tyre i origjinës si rezultat i terrorizmit, dhunës, trafikimit të drogës dhe arsyeve tjera që lidhen me situata të dhunës;
- (o) Të zhvillojnë ndërgjegjësimin për të drejtat njerëzore të grave dhe të sigurojnë, sipas nevojës, edukim dhe trajnim për të drejtat e njeriut personelit ushtarak dhe policor i cili vepron në zonat e konfliktit të armatosur dhe zonat ku ka refugjatë.

148. Nga Qeveritë:

- a) Të përhapin dhe zbatojnë Udhëzimet e UNHCR mbi Mbrojtjen e Grave Refugjate dhe Udhëzimet e UNHCR për Vlerësimin dhe Kujdesin për Viktimat e Traumës dhe Dhunës, ose të sigurojnë udhëzime të ngjashme, në bashkëpunim të ngushtë me gratë refugjate në të gjithë sektorët e programeve të refugjatëve;
- b) Të mbrojnë gratë dhe fëmijët që emigrojnë si anëtarë familjeje nga keqtrajtimi ose mohimi i të drejtave të tyre të njeriut prej dorëzanësve dhe të marrin parasysh zgjatjen e qëndrimit të tyre, në rast se ka mundësi që marrëdhënia familjare të shpërbëhet, përbrenda kufijve të legjislacionit vendës.

Të sigurohet asistencë për gratë e kolonive dhe të territoreve jovetëqeverisëse.

Aksionet që duhen ndërmarrë

149. Nga Qeveritë, organizatat ndërqeveritare dhe joqeveritare:

- a) Të mbështesin dhe promovojnë zbatimin e së drejtës për vetëvendosje të të gjithë popujve, siç shprehet, midis tjerash, në Deklaratën e Vjenës dhe Programin për Veprim, duke siguruar programe të veçanta për udhëheqje dhe trajnime për vendimmarrje;
- b) Të mbështesin dhe promovojnë zbatimin e së drejtës për vetëvendosje të të gjithë popujve, siç shprehet, midis tjerash, në Deklaratën e Vjenës dhe Programin për Veprim, duke siguruar programe të veçanta për udhëheqje dhe trajnime për vendimmarrje.

F. GRATË DHE EKONOMIA

150. Ka dallime të konsiderueshme midis grave dhe të burrave në qasjen për të ushtruar fuqi në strukturat ekonomike dhe mundësitë për të ushtruar atë fuqi në shoqëritë e tyre. Në shumicën e pjesëve të botës, gratë gati plotësisht mungojnë në vendimmarrjen ekonomike apo ose janë shumë dobët të përfaqësuara, përfshirë edhe në formulimin e politikave financiare, monetare, tregtare dhe politikave të tjera ekonomike, po ashtu edhe të sistemeve të tatimit dhe rregullimit të pagesave. Pasi që shpesh përbrenda kornizës së politikave të tilla, individët gra dhe burra marrin vendimet e tyre, midis tjerash, edhe lidhur me atë se si do të ndajnë kohën e tyre midis punës së paguar dhe asaj të papaguar, vetë zhvillimi i këtyre strukturave ekonomike dhe politikave ka ndikim të drejtpërdrejtë në qasjen e grave dhe burrave në resurset ekonomike, fuqinë e tyre ekonomike dhe rrjedhimisht, në masën e barazisë midis tyre në nivelet individuale dhe familjare, si dhe në shoqërinë si tërësi.

151. Në shumë rajone, pjesëmarrja e grave në punën e paguar në tregun formal dhe joformal të punës është rritur në masë të dukshme dhe ka ndryshuar gjatë dhjetëvjeçarit të fundit. Përderisa gratë vazhdojnë të punojnë në bujqësi dhe peshkatarë, ato gjithashtu janë përfshirë gjithnjë më shumë edhe në ndërmarrjet e mikro, të vogla dhe të mesme, dhe në disa raste janë bërë më dominante në zgjerimin e

sektorit joformal. Për shkak të situatave të vështira ekonomike dhe mungesës së një fuqie për të bërë pazar, që rezulton nga pabarazia gjinore, shumë gra janë detyruar të pranojnë pagesë të ulët dhe kushte të varfra pune e kështu shpesh janë kthyer në punëtorë të preferuar. Nga ana tjetër, gratë ju kanë bashkangjitur gjithnjë e më shumë fuqisë punëtore me dëshirën e tyre pasi që janë të ndërgjegjësuar për të drejtat e tyre dhe kanë filluar t'i kërkojnë ato. Disa kanë korrur sukses në hyrjen dhe përparimin në vendin e punës dhe përmirësimin e pagesën dhe kushteve të punës. Megjithatë, gratë kanë qenë veçanërisht të ndikuara nga situata ekonomike dhe proceset e ristrukturimit, të cilat kanë ndryshuar natyrën e punësimit dhe, në shumë raste, kanë çuar në humbjen e vendit të punës, madje edhe nga gratë profesioniste e të kualifikuara. Përveç kësaj, shumë gra kanë hyrë në sektorin joformal për shkak të mungesës së mundësive të tjera. Pjesëmarrja e grave dhe shqetësimet gjinore ende mungojnë në masë të madhe nga proceset e formulimit të politikave të institucioneve multilaterale dhe duhet të ngrohen në këtë proces i cili definon kushtet dhe, në bashkëpunim me Qeveritë, përcakton objektivat e programeve të përshtatjes strukturore, huave dhe granteve.

152. Diskriminimi në arsim e trajnim, punësimi dhe pagesa, promovimi dhe praktikat e lëvizshmërisë horizontale, si dhe kushtet jofleksibile të punës, mungesa e qasjes në resurse prodhuese dhe ndarja joadekuate e përgjegjësive familjare, e kombinuar me një mungesë shërbimesh ose shërbime të pamjaftueshme, të tilla si ato për kujdes të fëmijëve, vazhdojnë të kufizojnë punësimin, mundësitë ekonomike, profesionale dhe mundësitë tjera, si dhe lëvizshmërinë për gratë dhe e bën përfshirjen e tyre të mundimshme. Për më tepër, pengesat nga qëndrimet kufizojnë pjesëmarrjen e grave në zhvillimin e politikave ekonomike, e në disa rajone kufizojnë qasjen e grave dhe vajzave në arsimim dhe trajnim për menaxhim ekonomik.

153. Përqindja e grave në fuqinë e punës vazhdon të rritet dhe pothuajse kudo gratë po punojnë më shumë jashtë ekonomisë shtëpiake, sado që nuk ka një lehtësim paralel të përgjegjësisë për punën e papaguar në shtëpi e në komunitet. Të ardhurat e grave po bëhen gjithnjë e më të nevojshme për ekonomitë familjare të të gjitha llojeve. Në disa rajone ka rritje të grave në aktivitetet ndërmarrëse dhe aktivitetet tjera të vetë-përkrahjes, veçanërisht në sektorin joformal. Në shumë vende, gratë përbëjnë shumicën e punëtorëve në punët jostandarde, të tilla si punësimi i përkohshëm, punë e rastit, disa punë me gjysmë orari, punësim me kontratë të punësim të bazuar në shtëpi.

154. Gratë punëtore emigrante, përfshirë edhe punëtorët e shtëpive, kontribuojnë në ekonomitë e vendeve dërguese përmes të **remitancave** nga diaspora, si dhe kontribuojnë në ekonomitë e vendeve marrëse përmes pjesëmarrjes së tyre në fuqinë e punës. Megjithatë, në

shumicën prej vendeve pritëse gratë emigrante përjetojnë nivele më të larta të papunësisë krahasuar edhe me punëtorët jo-emigrantë edhe me punëtorët emigrantë meshkuj.

155. Vëmendja e pamjaftueshme ndaj analizës gjinore ka nënkuptuar se kontributet dhe shqetësimet e grave mbeten shpesh të shpërfillura në strukturat ekonomike, të tilla si tregjet dhe institucionet financiare, tregjet e punës, ekonominë si disiplinë akademike, infrastrukturën ekonomike e sociale, tatimet dhe sistemet sociale të sigurimeve, si dhe në familje dhe ekonomi shtëpiake. Si rezultat, shumë politika dhe programe, mund të vazhdojnë të kontribuojnë në pabarazitë midis grave dhe burrave. Atje ku është arritur përparim në integrimin e perspektivës gjinore, është rritur edhe efektiviteti i programeve dhe politikave.

156. Sado që shumë gra kanë përparuar në strukturat ekonomike, për shumicën e grave, veçanërisht ato që përballen me pengesa shtesë, pengesa këto që nuk kanë lejuar gratë të shprehin aftësitë e tyre për të arritur autonominë ekonomike dhe për të siguruar jetesën e qëndrueshme për vete dhe vartësit e tyre. Gratë janë aktive në një larmi fushash ekonomike, të cilat ato shpesh i kombinojnë, që shtrihen nga puna me pagë dhe bujqësia dhe peshkataria ekzistenciale e deri te sektori joformal. Megjithatë pengesat ligjore dhe zakonore mbi pronësinë apo qasjes për tokën, resurset natyrore, kapitali, kredia, teknologjitë dhe mjetet e tjera të prodhimit, po ashtu edhe diferencimet e pagës, kontribuojnë për të penguar progresin ekonomik të grave. Gratë kontribuojnë në zhvillim jo vetëm përmes punës së paguar, por gjithashtu në një shkallë të madhe edhe përmes punës së papaguar. Nga njëra anë, gratë marrin pjesë në prodhimin e mallrave dhe shërbimeve për treg dhe konsum shtëpiak, në bujqësi, prodhimin e ushqimit në ndërmarrjet familjare. Edhe pse e përfshirë në Llogaritë Kombëtare të Sistemit të Kombeve të Bashkuara dhe në standardet ndërkombëtare për statistikën e punës, kjo punë e papaguar – posaçërisht ajo që lidhet me bujqësinë – është shpesh e nënvlerësuar dhe e regjistruar në masë të vogël. Nga ana tjetër, gratë ende kryejnë shumicën e punëve të papaguara shtëpiake dhe në komunitet, të tilla si kujdesi për fëmijët dhe të moshuarit, përgatitja e ushqimit për tërë familjen, mbrojtjen e mjedisit dhe ofrimin e asistencës vullnetare për individët ose grupet e cënueshme e të disfavorizuara. Kjo punë shpesh nuk matet në terma sasiorë dhe nuk vlerësohet në llogaritë kombëtare. Kontributi i grave në zhvillim është seriozisht i nënvlerësuar prandaj edhe pranimi shoqëror i tij është i kufizuar. Dukshmëria e plotë e llojit, shtrirjes dhe shpërndarjes së kësaj pune të papaguar do të kontribuojë gjithashtu për një ndarje më të mirë të përgjegjësisë.

157. Sado që janë krijuar disa mundësi të reja punësimi për gratë, si rezultat i globalizimit të ekonomisë, ka ende trende të cilat përkeqësojnë pabarazitë midis grave dhe burrave. Në të njëjtën kohë,

globalizimi, përfshirë edhe integrimin ekonomik, mund të krijojë presion mbi situatën e punësimit të grave për të përshtatur atë rrethanave të reja dhe për të gjetur resurse të reja për punësim pasi që modelet e tregut po ndryshojnë. Duhet bërë më shumë analiza mbi ndikimin e globalizimit në statusin ekonomik të grave.

158. Këto trende janë karakterizuar me pagat e ulëta, mbrojtja të vogël apo mungesë të mbrojtjes së standardeve të punës, kushtet e dobëta të punës, veçanërisht në lidhje me sigurinë dhe shëndetin profesional të grave, nivelet e ulëta të aftësive, dhe mungesa e sigurisë në punë dhe e sigurimeve shoqërore, si në sektorin formal ashtu edhe në atë joformal. Papunësia e grave është një problem serioz dhe gjithnjë më i madh në shumë vende dhe sektorë. Punëtorët e rinj në sektorët joformalë dhe ruralë dhe gratë punëtore emigrante, mbeten më së paku të mbrojtura nga ligjet e punës dhe të emigracionit. Gratë, veçanërisht ato që janë kryefamiljare dhe kanë fëmijë të vegjël, janë të kufizuara në mundësitë e tyre për punësim për arsye që përfshijnë kushtet jofleksibile të punës dhe ndarjen joadekuate të përgjegjësisë familjare, nga burrat dhe nga shoqëria .

159. Në vendet, që po përjetojnë transformime rrënjësore politike, ekonomike dhe sociale, aftësitë e grave, nëse përdoren më mirë, mund të përbëjnë një kontribut të madh në jetën ekonomike të vendeve të tyre. Rendimenti i tyre duhet të vazhdojë të zhvillohet dhe të përkrahët dhe potenciali i tyre të realizohet më tutje.

160. Mungesa e punësimit në sektorin privat dhe reduktimet në shërbimet publike dhe në punët në shërbime publike, kanë ndikuar në mënyrë të shpërpjesëtuar në gratë. Në disa vende, gratë kryejnë më tepër punë të papaguar, të tillë si kujdesi për fëmijët dhe për ata që kanë të sëmurë ose të moshuar, duke kompensuar kështu humbjen e të ardhurave të ekonomisë shtëpiake, veçanërisht kur shërbimet publike nuk janë në dispozicion. Në shumë raste, strategjitë për krijim të punësimit nuk i kanë kushtuar vëmendje të mjaftueshme profesioneve dhe sektorëve ku mbizotërojnë gratë; e as nuk kanë promovuar mjaft qasjen e grave në ato profesione dhe sektorë që janë tradicionalisht mashkullorë.

161. Shumë nga gratë në punë të paguar ballafaqohen me pengesa që i ndalojnë ato në realizimin e potencialit të tyre. Përderisa një numër ende gjenden në nivelet e ulëta të menaxhimit, qëndrimet diskriminuese shpesh i privojnë ato nga ngritja e mëtejshme në detyrë. Përvoja e ngacmimit seksual është një fyerje e dinjitetit të një punonjësi dhe ndalon gratë nga dhënia e kontributit që do të shprehte aftësitë e tyre të plota. Mungesa e një mjedisi pune që është i përshtatshëm për persona familjar, duke përfshirë mungesën e kujdesit për fëmijë të përshtatshëm e të volitshëm, dhe orari jofleksibil i punës, pengojnë edhe më shumë gratë nga arritja e potencialit të tyre të plotë.

162. Në sektorin privat, përfshirë ndërmarrjet transnacionale dhe ato kombëtare, gratë mungojnë në shkallë të lartë nga menaxhimi dhe nivelet e politikave, që paraqesin politika dhe praktika diskriminuese të punësimit dhe përparimit në detyrë. Mjedisi jo i favorshëm i punës, si dhe numri i kufizuar i mundësive të punësimit në dispozicion, kanë detyruar shumë gra të kërkojnë alternativa. Gratë janë bërë gjithnjë e më shumë të vetë-punësuar dhe pronare e menaxhere të ndërmarrjeve mikro, të vogla e të mesme. Në shumë vende zgjerimi i sektorit joformal dhe ndërmarrjeve të vetë-organizuara dhe të pavarura, është bërë duke iu falënderuar grave, të cilat me praktikën e dhe iniciativat e tyre bashkëpunuese, vetë-ndihmuese dhe tradicionale në prodhim dhe tregti paraqesin një resurs jetësor ekonomik. Kur ato fitojnë qasje dhe kontroll ndaj kapitalit, kredisë dhe resurseve tjera, teknologjisë dhe trajnimit, gratë mund të rritin prodhimin, marketingun dhe të ardhurat për zhvillim të qëndrueshëm.

163. Duke marrë parasysh faktin që pabarazitë e vazhdueshme dhe përparimi i vërejtshim bashkëjetojnë, është e nevojshme të rimendohen politikat e punësimit me qëllim të integritit të perspektivës gjinore dhe të tërheqjes së vëmendjes në një numër të madh të mundësive, si dhe për të adresuar çfarëdo implikime negative gjinore të modeleve aktuale të punës dhe të punësimit. Për të realizuar plotësisht barazinë midis grave dhe burrave në kontributin e tyre në ekonomi, nevojiten përpjekje aktive për njohjen dhe vlerësimin e barabartë të ndikimit të punës dhe përvojës, njohurive dhe vlerave, që kanë të dy palët, gratë dhe burrat, në shoqëri.

164. Për adresimin e potencialit ekonomik dhe të pavarësisë së grave, Qeveritë dhe aktorët e tjerë duhet të promovojnë një politikë të dukshme dhe aktive të integritit gjinor në të gjitha politikat dhe programet, në mënyrë që para se të merren vendimet, të bëhet një analizë mbi efektet që kanë ato mbi gratë dhe burrat, respektivisht.

Objektivi Strategjik F.1

Të promovojnë të drejtat ekonomike dhe pavarësinë e grave, duke përfshirë qasjen për punësim e kushte e përshtatshme të punës dhe kontrollin mbi resurset ekonomike

Aksionet që duhen ndërmarrë

165. Nga Qeveritë:

- a) Të dekretojnë dhe të fusin në fuqi një legjislacion i cili garanton të drejtat e grave dhe burrave për pagesë të barabartë për punë të njëjtë ose punë me vlerë të njëjtë;
- b) Të miratojnë dhe zbatojnë ligje kundër diskriminimit në baza gjinore në tregun e punës, duke marrë nën konsiderim të veçantë gratë e moshuara si punëtore, punësimin dhe promovimin, sigurimin e përfitimeve të punësimit dhe sigurimeve shoqërore, si dhe të kushteve të punës;
- c) Të eliminojnë praktikën diskriminuese të punëdhënësve dhe të marrin masa të përshtatshme në lidhje me rolin dhe funksionet riprodhuese të grave, të tilla si mohimi i punësimit apo largimi për shkak të shtatzënisë ose ushqyerjes së fëmijës me gji, ose kërkimi i provave për përdorimin e kontraktivëve, dhe marrja e masave efektive që sigurojnë se nuk do të ketë diskriminim të grave shtatzëna, grave në pushimin e lindjes ose grave që rihyjnë në tregun e punës pas lindjes së fëmijës;
- d) Të krijojnë mekanizma dhe të ndërmarrin veprime pozitive që bëjnë të mundur që gratë të fitojnë qasje për pjesëmarrje të plotë dhe të barabartë në formulimin e politikave dhe përcaktimin e strukturave përmes organeve të tilla si ministritë e financës dhe tregtisë, komisionet ekonomike kombëtare, institutet kërkimore ekonomike dhe agjencitë tjera kyçe, si dhe përmes pjesëmarrjes së tyre në organet e përshtatshme ndërkombëtare;
- e) Të ndërmarrin reforma legjislative dhe administrative për t'u dhënë grave të drejta të barabarta me burrat në resurset ekonomike, duke përfshirë qasjen në pronësi dhe kontroll të tokës dhe pasurive të tjera, kredi, trashëgimi, resurse natyrore dhe teknologji të reja;
- f) Të kryejnë shqyrtime të të ardhurave kombëtare dhe tatimit në trashëgimi, dhe të sistemeve të sigurimeve sociale, për të zhdukur çfarëdo paragjykimi ekzistues kundër grave;
- g) Të zhvillojnë më tepër njohuri të gjithanshme të punës dhe të punësimit, midis tjerash, edhe përmes përpjekjeve për të matur dhe kuptuar më mirë llojin, shtrirjen dhe shpërndarjen e punës së papaguar, veçanërisht të punës për përkujdes për pjesëtarët e familjes dhe punën e papaguar të kryer në fermat ose bizneset familjare, dhe të inkurajojë ndarjen dhe përhapjen e informatave mbi studimet dhe përvojat në këtë fushë, përfshirë zhvillimin e metodave për vlerësimin e tyre në termet sasiore, për një reflektim të mundshëm në llogaritë që mund të zhvillohen të ndara nga llogaritë kombëtare, por në pajtim me thelbin e tyre;

- h) Të shqyrtojnë dhe të amandamentojnë ligjet të cilat qeverisin veprimin e institucioneve financiare për të siguruar që ato ofrojnë shërbime për gratë dhe burrat mbi një bazë të barabartë;
- i) Të ndihmojnë, në nivelet e duhura, proceset buxhetore më të hapura dhe më transparente;
- j) Të rishikojnë dhe zbatojnë politikat kombëtare që mbështesin mekanizmat tradicional të kursimeve, kredisë dhe të huasë për gratë;
- k) Të mundohen të sigurojnë që politikat kombëtare lidhur me marrëveshjet tregtare ndërkombëtare dhe rajonale nuk ndikojnë negativisht në aktivitetet e reja dhe tradicionale ekonomike të grave;
- l) Të sigurojnë që gjithë korporatat, duke përfshirë korporatat transnacionale, u binden ligjeve dhe kodeve kombëtare, rregulloreve të sigurimeve shoqërore, marrëveshjeve, instrumenteve dhe konventave të aplikueshme ndërkombëtare, duke përfshirë ato që kanë të bëjnë me mjedisin dhe ligjet e tjera relevante;
- m) Të rregullojnë politikat e punësimit në mënyrë që të ndihmojnë në ristrukturimin e modeleve të punës me qëllim të promovimit të ndarjes së përgjegjësive familjare;
- n) Të krijojnë mekanizma dhe forume tjera që të mundësojnë gratë ndërmarrëse dhe gratë punëtore që të kontribuojnë në formulimin e politikave dhe programeve që janë duke u zhvilluar nga ministritë e ekonomisë dhe institucionet financiare;
- o) Të dekretojnë dhe të fusin në fuqi ligjet për mundësi të barabarta, të marrin veprime pozitive dhe të sigurojnë pajtueshmërinë e sektorëve publikë e privatë përmes mjeteve të ndryshme;
- p) Të përdorin analiza që kanë ndikim gjinor për zhvillimin e politikave mikro e makro ekonomike dhe sociale me qëllim të monitorimit të ndikimit të tillë dhe të ristrukturimit të politikave në rast kur ka ndikim të dëmshëm;
- q) Të promovojnë politikat e ndjeshme gjinore dhe masat për fuqizimin e grave si partnere të barabarta me burrat në fushat teknike, menaxheriale dhe të ndërmarrësisë;
- r) Të reformojnë ligjet ose të dekretojnë politikat kombëtare të cilat mbështesin krijimin e ligjeve të punës për të siguruar mbrojtjen e të gjitha punëtoreve, duke përfshirë praktikatat e

sigurisë në punë, të drejtën për t'u organizuar dhe qasjen në drejtësi.

Objektivi Strategjik F.2.

Të ndihmohet qasja e barabartë e grave në resurse, punësimin, tregje dhe tregti

Aksionet që duhen ndërmarrë

166. Nga Qeveritë:

- a) Të promovojnë dhe mbështesin vetëpunësimin e grave dhe zhvillimin e ndërmarrjeve të vogla, të fuqizojnë qasjen e grave në kredi dhe kapital në kushte të përshtatshme dhe të barabarta me ato të burrave, përmes rritjes së numrit të institucioneve të dedikuara për promovimin e ndërmarrësisë së grave, duke përfshirë, ku është mundur, skemat jotradicionale dhe reciproke të kredisë, si dhe krijimin e lidhjeve novatore me institucionet financiare;
- b) Të fuqizojnë rolin nxitës të Shtetit si punëdhënës për të zhvilluar një politikë të mundësive të barabarta për gratë dhe burrat;
- c) Të zgjerojnë, në nivele kombëtare dhe lokale, potencialin e gjenerimit të të ardhurave të grave rurale duke ndihmuar përmes lehtësimit të qasjes së barabartë dhe kontrollit të barabartë mbi resurset e prodhimit, tokës, kredisë, kapitalit, të drejtës së pronësisë, programeve zhvillimore dhe strukturave të bashkëpunimit;
- d) Të promovojnë dhe të fuqizojnë mikro-ndërmarrjet, bizneset e reja të vogla, ndërmarrjet bashkëvepruese, tregjet e zgjeruara dhe mundësitë e tjera të punësimit dhe, ku është e mundur, ndihmojnë në tranzicionin nga sektori joformal në atë formal, veçanërisht në zonat rurale;
- e) Të krijojnë dhe të modifikojnë programet dhe politikat që njohin dhe fuqizojnë rolin jetësor të grave në sigurimin e ushqimit dhe t'u sigurojnë grave prodhuese të cilat punojnë me apo pa pagesë, veçanërisht ato të përfshira në prodhimin e ushqimit, si ferma bujqësore, peshkatari dhe akuakulturë, si dhe ndërmarrjet urbane, qasje të barabartë në teknologjitë e përshtatshme, transport, shërbime plotësuese, marketing dhe mundësi të kredive në nivele lokale dhe të komunitetit;

- f) Të krijojnë mekanizma të përshtatshëm dhe të inkurajojnë institucionet ndërsektoriale të cilat u mundësojnë kooperativave të grave që të përmirësojnë qasjen në shërbimet e nevojshme;
- g) Të rrisin raportin e numrit të grave punëtore dhe personelit tjetër qeveritar që sigurojnë asistencën teknike ose që administrojnë programet ekonomike;
- h) Të rishikojnë, riformulojnë, dhe, nëse është e nevojshme, të zbatojnë politika, duke përfshirë ligjet dhe rregulloret qeveritare lidhur me afarizëm, ligjet komerciale dhe ligjet e kontratave, për t'u siguruar që ato nuk i diskriminojnë ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme pronare të cilave janë gratë në zonat rurale e urbane;
- i) Të analizojnë, këshillojnë, koordinojnë dhe zbatojnë politikat të cilat integrojnë nevojat dhe interesat e të punësuarve, të vetë-punësuarve dhe grave ndërmarrëse në politikat, programet dhe buxhetet sektoriale dhe ndërministrorë;
- j) Të sigurojnë qasje të barabartë për gratë në trajnimet efektive për punë, ritrajnime, shërbime këshilluese dhe të punësimit, të cilat nuk janë të kufizuara në fushat tradicionale të punësimit;
- k) Të heqin pengesat e politikave dhe ato rregullative, me të cilat përballen gratë në programet sociale dhe të zhvillimit, e të cilat i shkurajojnë nismat private dhe individuale;
- l) Të mbrojnë dhe promovojnë respektimin e të drejtave themelore të punëtorëve, duke përfshirë ndalimin e punës së detyruar dhe të punës së fëmijëve, lirinë e bashkëshoqërimit dhe të drejtës për t'u organizuar dhe për të arritur marrëveshje kolektive, pagesën e barabartë për burrat dhe gratë për punën e të njëjtës vlerë dhe mosdiskriminim në punësim, duke i zbatuar plotësisht konventat e Organizatës Ndërkombëtare të Punës, në rastet kur shtetet janë palë të këtyre konventave, si dhe duke marrë në konsiderim parimet e mishëruara në ato raste kur ato shtete nuk janë palë në këto konventa, me qëllim që të arrihet rritja e qëndrueshme ekonomike dhe zhvillimi i qëndrueshëm.

167. Nga Qeveritë, bankat qendrore dhe bankat kombëtare të zhvillimit, si dhe institucionet private bankare, sipas nevojës:

- a) Të rrisin pjesëmarrjen e grave, duke përfshirë gratë ndërmarrëse, në bordet këshilluese dhe format tjera, për t'u

mundësuar grave ndërmarrëse nga të gjithë sektorët dhe organizatat e tyre që të kontribuojnë në formulimin dhe rishikimin e politikave dhe të programeve që janë duke u zhvilluar nga ministritë e ekonomisë dhe institucionet bankare;

- b) Të mobilizojnë sektorin bankar për të rritur huadhënien dhe financimin përmes nxitjes dhe zhvillimit të ndërmjetësve që u shërbejnë nevojave të grave ndërmarrëse dhe prodhuese si zonat rurale ashtu edhe në ato urbane, si dhe të përfshijë gratë në udhëheqje, planifikim dhe vendimmarrje;
- c) Të strukturojnë shërbimet ashtu që të arrijnë gratë rurale dhe ato urbane të përfshira në ndërmarrjet mikro, të vogla e të mesme, me vëmendje të veçantë në gratë e reja, gratë me të ardhura të ulëta, ato që u përkasin pakicave racore dhe etnike, dhe grave indigjene që kanë mungesë qasjeje në kapital dhe pronë; të zgjerojnë mundësitë e qasjes së grave në tregjet financiare përmes identifikimit dhe inkurajimit të mbikëqyrjes financiare dhe të reformave rregullatore, të cilat mbështesin përpjekjet e drejtpërdrejta ose të tërthorta të institucioneve financiare për të përmbushur më mirë nevojat për kredi dhe nevojat tjera financiare të ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme të grave;
- d) Të sigurojnë që prioritetet e grave janë të përfshira në programet për investime publike për infrastrukturë ekonomike, të tilla si ato për ujë dhe higjienë, elektrifikim dhe ruajtje të energjisë, transport dhe ndërtim rrugësh. Të promovojnë përfshirjen më të madhe të grave përfituese në planifikimin e projekteve dhe në etapat e zbatimit të tyre për të siguruar qasje në punë dhe kontrata.

168. Nga Qeveritë dhe organizatat joqeveritare:

- (a) T'i kushtojnë vëmendje të veçantë nevojave të grave kur shpërndahen informata për tregun, tregtinë dhe resurset dhe të sigurojnë trajnim të duhur në këto fusha;
- (b) Të inkurajojnë strategjitë për zhvillimin ekonomik të komunitetit, që ndërtohen në partneritet midis Qeverive, si dhe të inkurajojnë anëtarët e shoqërisë civile që të krijojnë vende pune dhe të adresojnë rrethanat shoqërore të individëve, familjeve dhe komuniteteve;

169. Nga donatorët multilateralë dhe bankat rajonale të zhvillimit, si dhe nga agjencitë donatore bilaterale dhe private, në nivel ndërkombëtar, rajonal dhe subrajonal:

- (a) Të rishikojnë, dhe ku është e nevojshme të riformulojnë, dhe të zbatojnë politika, programe dhe projekte, për të siguruar që një përqindje më e lartë e resurseve do të arrijë tek gratë në zonat rurale dhe të largëta;
- (b) Të zhvillojnë marrëveshje fleksibile të donacioneve për të financuar institucionet ndërmjetëse që kanë si cak aktivitetet ekonomike të grave, dhe të promovojnë vetëmjaftueshmërinë dhe kapacitetin e rritur të ndërmarrjeve ekonomike të grave dhe përfitimin e rritur të tyre;
- (c) Të zhvillojnë strategjitë për të konsoliduar dhe fuqizuar asistencën e tyre për sektorin e ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme, me qëllim që të zgjerojnë mundësitë e grave për të marrë pjesë plotësisht dhe barabartë, si dhe për të punuar së bashku për të koordinuar dhe rritur efektivitetin e këtij sektori, duke shfrytëzuar ekspertizën dhe resurset financiare brenda këtyre organizatave, si dhe nga agjencitë bilaterale, Qeveritë dhe organizatat joqeveritare.

170. Nga organizatat ndërkombëtare multilaterale dhe bilaterale për zhvillim dhe bashkëpunim:

Përmes ofrimit të kapitalit dhe/ose resurseve, institucioneve financiare që u shërbejnë atyre me të ardhura të ulëta, të mbështesin ndërmarrjet mikro dhe të vogla të grave ndërmarrëse dhe prodhuese si në sektorin formal ashtu dhe atë joformal.

171. Nga Qeveritë dhe/ose institucionet donatore multilaterale:

Të rishikojnë rregullat dhe procedurat e institucioneve formale financiare kombëtare dhe ndërkombëtare që pengojnë shumëfishimin e prototipit të Bankës Grameen, që siguron mundësi krediti për gratë rurale.

172. Nga organizatat ndërkombëtare:

Të sigurojnë mbështetje adekuate për programet dhe projektet e hartuara për të promovuar veprimtaritë e qëndrueshme dhe produktive ndërmarrëse midis grave, veçanërisht atyre të disfavorizuara.

Objektivi strategjik F.3.

Të ofrojnë shërbime biznesi, trajnime dhe qasje në tregje, informata dhe teknologji, veçanërisht për gratë me të ardhura të ulëta

Aksionet që duhen ndërmarrë

173. Nga Qeveritë në bashkëpunim me organizatat joqeveritare dhe sektorin privat:

- a) Të ofrojnë infrastrukturën publike për të siguruar qasje të barabartë të tregut për gratë dhe burrat ndërmarrës;
- b) Të zhvillojnë programe që ofrojnë trajnime dhe ritrajnime, veçanërisht për teknologjitë e reja dhe shërbimet e volitshme për gratë në menaxhimin e biznesit, zhvillimin e prodhimit, financa, prodhimin dhe kontrollin e cilësisë, marketingun dhe aspektet ligjore të biznesit;
- c) Të sigurojë programe të shtrirjes së gjerë për të informuar gratë me të ardhura të ulëta dhe të varfra, veçanërisht ato që jetojnë në zonat rurale dhe të largëta, lidhur me mundësitë për qasje në treg dhe teknologji, dhe të ofrojë asistencë në shfrytëzimin e këtyre mundësive;
- d) Të krijojnë shërbime mbështetëse jodiskriminuese, duke përfshirë fondet për investim për bizneset e grave dhe ti kenë si cak gratë, veçanërisht ato me të ardhura të ulëta, në programet e promovimit të tregtisë;
- e) Të përhapin informatat rreth grave ndërmarrëse të suksesshme si në aktivitetet ekonomike tradicionale ashtu edhe në ato jotradicionale, si dhe aftësitë e nevojshme për të arritur sukses; të ndihmojnë rrjetëzimin dhe shkëmbimin e informatave;
- f) Të marrin masa për të garantuar qasje të barabartë të grave në trajnimet që janë duke u mbajtur vendin e punës, duke i përfshirë gratë e papuna, prindërit e vetëm, gratë që rihyjnë në tregun e punës pas një daljeje të përkohshme të gjatë nga punësimi për shkak të përgjegjësive familjare dhe shkaqeve tjera, si dhe gratë e shpërngulura nga format e reja të prodhimit ose formave tjera të kufizimeve, dhe të nxisin në nivel më të madh ndërmarrjet për të zgjeruar numrin e qendrave të trajnimit profesional që u sigurojnë trajnim grave në fushat jotradicionale;
- g) Të ofrojnë shërbimet të volitshme mbështetëse, të tilla si shërbime të kujdesit për fëmijët të cilësisë së lartë, fleksibile dhe të volitshme, që do të marrin parasysh nevojat e burrave dhe grave që punojnë.

174. Nga organizatat kombëtare, rajonale dhe ndërkombëtare të biznesit dhe organizatat joqeveritare, që lidhen me problemet e grave:

Të mbrojnë në të gjitha nivelet nxitjen dhe mbështetjen e bizneseve dhe ndërmarrjeve të grave, duke përfshirë ato në sektorin joformal, si dhe qasjen e barabartë të grave ndaj burimeve të prodhimit.

Objektivi strategjik F.4.

Të fuqizohet kapaciteti ekonomik i grave dhe rrjetet komerciale

Aksionet që duhen ndërmarrë

175. Nga Qeveritë:

- a) Të adoptojnë politika që mbështesin organizatat afariste, organizatat joqeveritare, kooperativat, fondet rrotulluese të huave, sindikatat e kredive, organizatat e themelore, grupet vetë-ndihmuese të grave dhe grupe të tjera me qëllim të sigurimit të shërbimeve grave ndërmarrëse në zonat rurale dhe urbane;
- b) Të integrojnë perspektivën gjinore në të gjitha politikat të ristrukturimit ekonomik dhe të rregullimit strukturor, si dhe të hartojnë programe për gratë që janë prekur nga ristrukturimi ekonomik, përfshirë programet e përshtatjes strukturore, dhe për gratë që punojnë në sektorin joformal;
- c) Të miratojnë politika që krijojnë në mjedis të përshtatshëm për grupet e grave vetë-ndihmuese, organizatat dhe kooperativat e punëtorëve, përmes formave jokonvencionale të mbështetjes dhe duke njohur të drejtën e anëtarësimit dhe të drejtën për t'u organizuar;
- d) Të mbështesin programe që përforcojnë vetëbesimin e grupeve të veçanta të grave, siç janë gratë e reja, gratë me paaftësi, gratë e moshuara dhe gratë që u përkasin minoriteteve racore dhe etnike;
- e) Të promovojnë barazinë gjinore përmes promovimit të studimeve për gratë dhe përmes përdorimit të rezultateve të studimeve dhe kërkimeve gjinore në të gjitha fushat, ndër të tjera, në fushat ekonomike, shkencore dhe teknologjike;

- f) Të mbështesin veprimtaritë ekonomike të grave indigjene, duke marrë parasysh njohuritë e tyre tradicionale, me qëllim të përmirësimit të situatës së tyre dhe zhvillimit të tyre;
- g) Të adoptojnë politika që plotësojnë ose mirëmbajnë mbrojtjen e ligjeve të punës dhe dispozitave të sigurimit shoqëror për ata që bëjnë punë të paguar në shtëpi;
- h) Të njohin dhe të inkurajojnë kontributin e kërkimeve nga gratë shkencëtare dhe teknologe;
- i) Të garantojnë që politikat dhe rregulloret nuk diskriminojnë ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme të udhëhequra nga gratë.

176. Nga ndërmjetësit financiarë, institutet kombëtare të trajnimit, sindikatat e kredive, organizatat joqeveritare, shoqatat e grave, organizatat profesionale dhe sektori privat, sipas nevojës:

- a) Të sigurojnë, në nivele kombëtare, rajonale dhe ndërkombëtare, trajnimin në një llojllojshmëri të aftësive që kanë të bëjnë me bizneset dhe menaxhimin financiar dhe aftësitë teknike për t'u bërë të mundur grave, veçanërisht grave të reja, të marrin pjesë në politikëbërje të këtyre niveleve;
- b) Të sigurojnë shërbime afariste, përfshirë marketingun dhe informata për tregun, dizejnimin e prodhimeve dhe novacionet, transferimin dhe cilësinë e teknologjisë, të ndërmarrjeve afariste të grave, duke përfshirë ato që janë në sektorët e eksportit të ekonomisë;
- c) Të promovojnë lidhjet teknike dhe tregtare dhe të krijojnë ndërmarrje të përbashkëta të grave ndërmarrëse në nivel kombëtar, rajonal dhe ndërkombëtar për të mbështetur nismat e bazuara në komunitet;
- d) Të fuqizojnë pjesëmarrjen e grave në kooperativat e prodhimit dhe të marketingut duke ofruar mbështetje të marketingut dhe mbështetje financiare, veçanërisht në zonat rurale dhe të largëta, duke përfshirë gratë e marginalizuara;
- e) Të promovojnë dhe të fuqizojnë mikro-ndërmarrjet e grave, bizneset e reja të vogla, ndërmarrjet kooperative, tregjet e zgjeruara dhe mundësitë tjera të punësimit dhe, ku është e mundur, të ndihmojnë tranzicionin nga sektori joformal në sektorin formal, në zonat rurale dhe urbane;

- f) Të investojnë kapital dhe të zhvillojnë portofolio investimi për të financuar ndërmarrjet afariste të grave;
- g) T'i kushtojnë vëmendje të mjaftueshme sigurimit të asistencës teknike, shërbimeve këshilluese, trajnimit dhe ritrajnimit për gratë që duan të hyjnë në ekonominë e tregut;
- h) Të mbështesin rrjetet e kredive dhe ndërmarrjet novatore, përfshirë skemat tradicionale të sigurimeve;
- i) Të sigurojnë marrëveshje të rrjetëzimit për gratë ndërmarrëse, duke përfshirë mundësitë ku gratë që kanë përvojë do të mbikëqyreshin dhe udhëzoheshin nga gratë me më shumë përvojë;
- j) Të inkurajojnë organizatat e komunitetit dhe autoritetet publike për të vendosur një fond huash për gratë ndërmarrëse, duke u bazuar në modelet e suksesshme të kooperativave të vogla.

177. Nga sektori privat, duke përfshirë korporatat transnacionale dhe ato kombëtare:

- a) Të adoptojnë politika dhe krijojnë mekanizma që do të dhuronin kontratat mbi një bazë jodiskriminuese;
- b) Të rekrutojnë gratë për udhëheqje, vendimmarrje dhe menaxhim dhe t'u ofrojnë atyre programe trajnimi, të gjitha në një bazë të barabartë me burrat;
- c) Të respektojnë ligjet kombëtare të punës, të mjedisit, të konsumit, të shëndetit dhe të sigurisë, veçanërisht ato që prekin gratë.

Objektivi strategjik F.5.

Të zhduket ndarja profesionale dhe të gjitha format e diskriminimit në punësim

Aksionet që duhen ndërmarrë

178. Nga Qeveritë, punëdhënësit, punëmarrësit, sindikatat e punës dhe organizatat e grave:

- a) Të zbatojnë dhe jetësojnë ligjet dhe rregulloret dhe të inkurajojnë kodet vullnetare të mirësjelljes që garantojnë se standardet ndërkombëtare të punës, të tilla si Konventa e Organizatës Ndërkombëtare të Punës nr. 100 për pagë të barabartë dhe të drejta të barabarta të punëtorëve, të zbatohet njëjloj për punëtorët meshkuj dhe femra;
- b) Të dekretojnë dhe fusin në fuqi ligjet si dhe të paraqesin masat zbatuese, përfshirë edhe mjetet për dëmshpërblim dhe qasje në drejtësi në rastet kur nuk përfilllet ligji, dhe të ndalohet diskriminimi i drejtpërdrejtë apo i tërthortë në bazë të gjinisë, sa i përket statusit martesor ose familjar në lidhje me qasjen në punësim, kushtet e punësimit, përfshirjen e trajnimit, promovimin në detyrë, shëndetin dhe sigurinë, po ashtu edhe përfundimin e marrëdhënies së punës dhe sigurimet sociale të punëtorëve, përfshirë mbrojtjen ligjore kundër ngacmimit seksual dhe racor;
- c) Të dekretojnë dhe fusin në fuqi ligjet dhe të zhvillojnë politikat në vendin e punës kundër diskriminimit gjinor në tregun e punës, veçanërisht duke pasur parasysh punëtorët e moshuara, në punësimin dhe promovimin e tyre në detyrë, si dhe përfshirjen e beneficioneve të punësimit dhe sigurimit social, si dhe në lidhje me kushtet diskriminuese të punës dhe ngacmimit seksual; duhet të zhvillohen mekanizma për rishikimin dhe monitorimin e rregullt të ligjeve të tilla;
- d) Të eliminojnë praktikat diskriminuese nga punëdhënësit të bëra mbi bazën e roleve dhe funksioneve riprodhuese të grave, duke përfshirë refuzimin e punësimit dhe pushimin e grave nga puna për shkak të shtatzënisë dhe përgjegjësive të ushqyerjes me gjë;
- e) Të zhvillojnë dhe promovojnë programe punësimi dhe shërbimesh për gratë që hyjnë dhe/ose rihyjnë në tregun e punës, sidomos gratë e varfëra urbane, gratë rurale dhe ato të reja, gratë e vetëpunësuarat dhe ato që janë prekura negativisht nga përshtatja strukturore;
- f) Të zbatojnë dhe monitorojnë punësimin pozitiv në sektorin publik dhe atë privat, programet e barazisë dhe të veprimeve pozitive, për të adresuar diskriminimin sistematik kundër grave në forcën e punës, veçanërisht gratë me paaftësi dhe gratë që u përkasin grupeve tjera të disfavorizuara, në lidhje me punësimin, mbajtjen dhe promovimin në detyrë, dhe trajnimin profesional të grave në të gjithë sektorët;
- g) Të eliminojnë ndarja profesionale, veçanërisht përmes promovimit të pjesëmarrjes së barabartë të grave në punët që kërkojnë nivel të lartë të aftësive dhe në pozitat e larta

menaxheriale, dhe përmes masave të tjera, të tilla si këshillimi dhe vendosja, që stimulojnë zhvillimin e karrierës së tyre në vendin e punës dhe lëvizshmërinë në rritje në tregun e punës, dhe me stimulimin e diversifikimit të zgjedhjeve profesionale nga gratë dhe burrat. Të inkurajohen gratë për t'u marrë me punë jotradicionale, veçanërisht në shkencë e teknologji, dhe të inkurajohen burrat të kërkojnë punësim në sektorin social;

- h) Të njohin marrëveshjen kolektive si e drejtë dhe si një mekanizëm i rëndësishëm për eliminimin e pabarazisë në pagë për gratë dhe për përmirësimin e kushteve të punës;
- i) Të promovojnë zgjedhjen e grave si zyrtare të sindikatave dhe të sigurojnë që zyrtarëve të sindikatave që janë zgjedhur që të përfaqësojnë gratë t'u jepet mbrojtje në punë dhe sigurim fizik në lidhje me shkarkimin nga funksionet e tyre;
- j) Të sigurojnë qasje dhe zhvillojnë programe speciale për t'u mundësuar grave me paaftësi të punësohen dhe të mbajnë punësimin, si dhe të sigurojnë qasje në arsimim dhe trajnim në të gjitha nivelet e duhura, në pajtim me Rregullat Standarde mbi Barazinë e Mundësive për Njerëzit me Paaftësi;³⁰ të rregullojnë sa më shumë që është e mundshme, kushtet e punës me qëllim që t'i përshtaten nevojave të grave me paaftësi, të cilave do të duhej t'u sigurohet mbrojtje ligjore kundër humbjes së pabazë të punës për shkak të paaftësive të tyre;
- k) Të rrisin përpjekjet për zvogëluar dallimet midis nivelit të pagës së grave dhe burrave, të ndërmarrin masa për zbatimin e parimeve të pagesës së barabartë për punë të njëjtë të vlerës së njëjtë përmes fuqizimit të legjislacionit, përfshirë pajtimin me ligjet dhe standardet ndërkombëtare të punës, dhe të inkurajojnë skemat e vlerësimit të punës me kriter neutral gjinor;
- l) Të krijojnë dhe/ose fuqizojnë mekanizmat për të gjykuar çështjet që kanë të bëjnë me diskriminim në pagë;
- m) Si cak, të vendosin datat specifike për eliminimin e të gjitha formave të punës së fëmijëve që janë në kundërshtim me standardet e pranuar ndërkombëtare dhe të sigurojnë zbatimin e plotë të ligjeve përkatëse ekzistuese dhe, ku është e nevojshme, të dekretohet legjislacioni i nevojshëm për zbatimin e Konventës për të Drejtat e Fëmijës dhe standardeve të Organizatës Ndërkombëtare të Punës, që sigurojnë mbrojtjen e fëmijëve që punojnë, veçanërisht

³⁰ Rezoluta 48/96 e Asamblesë së Përgjithshme, aneks.

fëmijëve të rrugës, përmes dispozitave për shërbime të përshtatshme shëndetësore, arsimore, dhe shërbimeve tjera sociale;

- n) Të sigurojnë që strategjitë për eliminimin e punës së fëmijëve gjithashtu do të adresojnë çështjen e kërkesave të tepërta që u bëhen disa vajzave për punë të papaguar në ekonomitë e tyre shtëpiake dhe në ekonomitë e tjera shtëpiake, ku kjo praktikohet;
- o) Të rishikojnë, analizojnë dhe, ku është e nevojshme, të riformulojnë strukturat e pagave për profesionet ku dominojnë femrat, të tilla si mësimdhënia, infermiera dhe kujdesi për fëmijët, me qëllim të rritjes së statusit dhe përfitimit të tyre të ulët;
- p) Të ndihmohet punësimi produktiv i grave të dokumentuara emigrante (përfshirë gratë që janë përcaktuar si refugjate sipas Konventës së vitit 1951 në lidhje me Statusin e Refugjatit) përmes njohjes më të gjerë të arsimimit dhe kredencialeve nga një vend i huaj, si dhe me adoptimin e një qasjeje të integruar në trajnimet e tregut të punës, që përfshin edhe trajnime gjuhësore.

Objektivi Strategjik F.6.

Të nxitet harmonizimi i përgjegjësive të punës dhe të familjes për gratë dhe burrat

Aksionet që duhen ndërmarrë

179. Nga Qeveritë:

- (a) Të miratojnë politika për të siguruar mbrojtjen e duhur të ligjeve të punës dhe sigurimit social, përfitimet për punëtorët me gjysmë orari, me punë të përkohshme, sezonale dhe që punojnë në shtëpi; të promovojnë zhvillimin e karrierës bazuar në kushtet e punës të cilat harmonizojnë përgjegjësitë në punë dhe ato në familje;
- (b) Të sigurojnë që puna me orar të plotë dhe ajo me gjysmë orari mund të zgjidhet lirisht nga gratë dhe burrat mbi baza ta barabarta, dhe duke marrë parasysh mbrojtjen e duhur për punëtorët atipikë sa i përket qasjes në punësim, kushtet e punës, dhe sigurimet sociale;

- (c) Përmes legjislacionit të sigurojnë nxitjen dhe/ose inkurajimin, dhe mundësitë për gratë dhe burrat për të marrë leje prindërore të mbrojtur nga puna dhe të kenë përfitime prindërore. Të promovohet ndarja e barabartë e përgjegjësive për familjen prej burrave dhe grave, duke përfshirë përmes legjislacionit të përshtatshëm, nxitjes dhe inkurajimit, si dhe gjithashtu për të nxitur lehtësimin e nënave punëtore që ushqejnë fëmijët me qumësht gjiri;
- (d) Të zhvillojnë politika, midis tjerash edhe në arsim, për të ndryshuar qëndrimet të cilat sforcojnë ndarjen e punës bazuar në gjini me qëllim që të promovojnë konceptin e ndarjes së përgjegjësive familjare për punën në shtëpi, veçanërisht në lidhje me kujdesin për fëmijët dhe të moshuarit;
- (e) Të përmirësojnë zhvillimin dhe qasjen në teknologjitë që lehtësojnë punën profesionale aq sa dhe atë shtëpiake, të inkurajohet vetëmbështetja, gjenerimi i të ardhurave, transformimi i roleve të përshtatshme brenda procesit prodhues dhe të mundësojnë gratë të largohen nga punët me pagë të ulët;
- (f) Të shqyrtojnë një numër politikash dhe programesh, përfshirë legjislacionin për sigurimet shoqërore dhe sistemin e tatimit, në pajtim me prioritetet dhe politikat kombëtare, për të përcaktuar si të promovojnë barazinë gjinore dhe fleksibilitetin në mënyrën se si **njerëzit ndajnë kohën e** tyre midis arsimimit e trajnimit, punës së paguar, përgjegjësive familjare, veprimtarive vullnetare dhe formave të tjera shoqërisht të dobishme të punës, pushimit dhe argëtimit, dhe si nxjerrin përfitimet nga to.

180. Nga Qeveritë, sektori privat dhe organizatat joqeveritare, sindikatat e punës dhe Kombet e Bashkuara, sipas nevojës:

- (a) Të miratojnë masat e duhura që përfshijnë organet relevante qeveritare dhe shoqatat e punëdhënësve dhe të të punësuarve, në mënyrë që gratë dhe burrat të jenë të aftë të marrin leje të përkohshme nga puna, të kenë punësim të transferueshëm dhe beneficionet e pensionimit, si dhe të bëjnë marrëveshje për të ndryshuar orët e punës pa sakrifikuar projektet e tyre për zhvillim dhe përparim në punë dhe në karrierë;
- (b) Të hartojnë dhe të ofrojnë programe arsimore përmes fushatave novatore në media dhe programe arsimore në komunitet dhe në shkollë për të ngritur vetëdijen për

barazinë gjinore dhe rolet jostereotipe gjinore të grave dhe burrave brenda familjes; të sigurojnë shërbime dhe projekte mbështetëse, si janë kujdesi për fëmijët në vendin e punës dhe marrëveshjet fleksibile për punë;

- (c) Të dekretojnë dhe zbatojnë ligjet kundër ngacmimit seksual dhe formave të tjera të ngacmimit në të gjitha vendet e punës.

G. GRATË NË PUSHTET DHE VENDIMMARRJE

181. Deklarata Universale Për të Drejtat e Njeriut thotë se çdo njeri ka të drejtë të marrë pjesë në Qeverinë e vendit të tij/saj. Fuqizimi dhe autonomia e grave dhe përmirësimi i statusit social, ekonomik dhe politik të grave është thelbësor për arritjen e një qeverie dhe administrate transparente dhe të përgjegjshme, si dhe të një zhvillimi të qëndrueshëm në të gjitha fushat e jetës. Marrëdhëniet e fuqisë që pengojnë arritjen e një jetese të kënaqshme të grave, veprojnë në shumë nivele të shoqërisë, nga më personalja deri te ajo më publike. Arritja e objektivit të pjesëmarrjes së barabartë të grave dhe burrave në vendimmarrje do të sigurojë një balancë që reflekton më saktë përbërjen e shoqërisë dhe nevojitet me qëllim që të forcimit të demokracisë dhe promovimit të funksionimit të duhur të sajë. Barazia në vendimmarrjen politike kryen një funksion balancimi pa të cilin është gati e pamundshme që të kishte një integrim real të dimensionit të barazisë në politikëbërjen e qeverisë. Në lidhje me këtë, pjesëmarrja e barabartë e grave në jetën politike, luan një rol qendror në procesin e përgjithshëm të përparimit të grave. Pjesëmarrja e barabartë e grave në vendimmarrje nuk është vetëm një kërkesë për drejtësi ose demokraci të thjeshtë, por duhet parë gjithashtu si një kusht i nevojshëm që të merren parasysh interesat e grave. Pa pjesëmarrjen aktive të grave dhe përfshirjen e perspektivës së grave në të gjitha nivelet e vendimmarrjes, synimi i barazisë, i zhvillimit dhe i paqes, nuk mund të arrihet.

182. Pavarësisht nga përhapja e gjerë e lëvizjes drejt demokratizimit në shumë vende, gratë janë ende të nën-përfaqësuara në një shkallë të madhe në të gjitha nivelet e qeverisë, veçanërisht në atë ministror dhe organet e tjera ekzekutive, dhe kanë bërë fare pak përparim në arritjen e pushtetit politik në trupat legjislativë ose në arritjen e caktuar të miratuar nga Këshilli Ekonomik dhe Social për të pasur 30% gra në pozita në nivelet vendimmarrëse deri në vitin 1995. Përgjithësisht, vetëm 10% e anëtarëve të trupave legjislativë dhe një përqindje më e ulët e pozitave ministrore mbahen tani nga gratë. Në të vërtetë, disa vende, përfshirë ato të cilat janë duke kaluar nëpër ndryshime themelore politike, ekonomike dhe sociale, kanë pësuar një rënie të

dukshme në numrin e grave të përfaqësuara në trupat legjislativë. Sado që gratë përbëjnë së paku gjysmën e elektoratit në pothuajse të gjitha vendet dhe kanë fituar të drejtën për të votuar dhe për të mbajtur pozita zyrtare në pothuajse të gjitha shtetet anëtare të Kombeve të Bashkuara, gratë vazhdojnë të jenë seriozisht të nën-përfaqësuara si kandidatë për zyrat publike. Modelet tradicionale të punës së shumë partive politike dhe strukturave qeveritare vazhdojnë të jenë barrierë për pjesëmarrjen e grave në jetën publike. Gratë mund të shkurajohen nga kërkimi i pozitave politike për shkak të qëndrimeve dhe praktikave diskriminuese, përgjegjësive ndaj familjes dhe fëmijëve, dhe kostos së lartë të kërkuarit dhe mbajtjes së pozitave zyrtare. Gratë në politikë dhe në pozitat vendimmarrëse në Qeveritë dhe në organet legjislativë, kontribuojnë për ridefinimin e prioritetëve politike duke vendosur pikë të reja në agjendën politike të cilat reflektojnë dhe adresojnë interesat, vlerat dhe përvojat specifike gjinore të grave, si dhe duke ofruar perspektiva të reja në çështjet kryesore politike.

183. Gratë kanë shfaqur rol të konsiderueshëm udhëheqës në komunitet dhe në organizatat joformale, po ashtu edhe në zyrat publike. Megjithatë, shoqërimi dhe stereotipizimi negativ i grave dhe burrave, duke përfshirë stereotipizimin përmes mediave, përforcon tendencën që vendimmarrja politike të mbetet domen i burrave. Ngjashëm, nën-përfaqësimi i grave në pozitat vendimmarrëse në fushat e artit, kulturës, sportit, mediave, arsimit, fesë dhe ligjit, kanë parandaluar gratë që të kenë një ndikim të dukshëm në shumë institucione kyçe.

184. Për shkak të qasjes së tyre të kufizuar në fushat tradicionale të pushtetit, të tilla si organet vendimmarrëse të partive politike, organizatat e punëdhënësve dhe sindikatat, gratë kanë fituar qasje në pushtet përmes strukturave alternative, veçanërisht në spektrin e organizatave joqeveritare. Përmes organizatave joqeveritare dhe organizatave bazë, gratë kanë arritur që të artikulojnë interesat dhe shqetësimet e tyre dhe i kanë vendosur çështjet e grave në agjendat kombëtare, rajonale dhe ndërkombëtare.

185. Pabarazia në arenën publike shpesh mund të fillojë me qëndrime dhe praktika diskriminuese dhe marrëdhënie të pabarabarta të fuqisë midis burrave dhe grave brenda familjes, siç përshkruhet në paragrafin 30. Ndarja e pabarabartë e punës dhe përgjegjësive brenda ekonomisë familjare, të bazuara në raportet e pabarabarta të pushtetit, gjithashtu kufizon potencialin e grave për të gjetur kohë dhe për të zhvilluar aftësitë e kërkua për pjesëmarrje në vendimmarrje në forumet më të gjera publike. Një ndarje më e barabartë e këtyre përgjegjësive midis grave dhe burrave siguron jo vetëm një cilësi më të mirë të jetës për gratë dhe të bijat e tyre, por gjithashtu zgjeron mundësitë e tyre për të formuar dhe për të hartuar politikat publike, praktikat dhe shpenzimet në mënyrë që interesat e

tyre të mund të njihen dhe të adresohen. Rrjetet dhe modelet joformale të vendimmarrjes në nivel të komunitetit lokal, të cilat pasqyrojnë etosin mbizotërues mashkullor, kufizojnë aftësinë e grave për të marrë pjesë barabartë në jetën politike, ekonomike dhe sociale.

186. Raporti i ulët i grave midis vendimmarrësve ekonomikë dhe politikë në nivel lokal, kombëtar, rajonal dhe ndërkombëtar, pasqyron pengesat strukturore dhe të qëndrimeve që kanë nevojë të adresohen përmes masave pozitive. Qeveritë, korporatat transnacionale dhe kombëtare, masmediat, bankat, institucionet akademike dhe shkencore, si dhe organizatat rajonale dhe ndërkombëtare, përfshirë ato në sistemin e Kombeve të Bashkuara, nuk përdorin plotësisht talentet e grave si menaxhere, politikëbërëse, diplomate dhe ndërmjetës të nivelit më të lartë.

187. Shpërndarja e barabartë e fuqisë dhe vendimmarrjes në të gjitha nivelet varet nga Qeveritë dhe aktorët e tjerë që merren me analiza statistikore gjinore dhe integrim të një perspektive gjinore në zhvillimin e politikave dhe zbatimin e programeve. Barazia në vendimmarrje është thelbësore për fuqizimin e grave. Në disa vende diskriminimi pozitiv ka çuar përfaqësimin e grave në qeverisje lokale dhe kombëtare në 33.3 për qind ose edhe më lartë.

188. Institucionet statistikore kombëtare, rajonale dhe ndërkombëtare, kanë ende njohuri të pamjaftueshme se si të prezantojnë çështjet që lidhen me trajtimin e barabartë të grave dhe burrave në sferat ekonomike dhe sociale. Në veçanti, ka një përdorim të pamjaftueshëm të të bazave ekzistuese të shënimeve dhe metodologjive ekzistuese në sferën e rëndësishme të vendimmarrjes.

189. Me qëllim të adresimit të pabarazive midis burrave dhe grave në ndarjen e pushtetit dhe vendimmarrjes në të gjitha nivelet, Qeveritë dhe aktorët e tjerë duhet të promovojnë një politikë aktive dhe të dukshme të integritit të perspektivës gjinore në të gjitha politikat dhe programet, ashtu që para se të merren vendimet, të bëhet një analizë e efekteve të tyre mbi gratë dhe burrat, respektivisht.

Objektivi Strategjik G.1.

Të merren masat për të siguruar qasje të barabartë dhe pjesëmarrje të plotë të grave në strukturat e pushtetit dhe të vendimmarrjes

Aksionet që duhen ndërmarrë

190. Nga Qeveritë:

- a) Të zotohen për vendosjen e objektivit të balancës gjinore në organet dhe komitetet e qeverisë, po ashtu në njësitë e administratës publike, dhe në gjyqësi, duke përfshirë, midis tjerash, vendosjen e caqeve specifike dhe masave zbatuese për ngritjen substanciale të numrit të grave, me qëllim të arritjes së përfaqësimit të barabartë të grave dhe burrave, nëse është e nevojshme edhe përmes diskriminimit pozitiv, në të gjitha pozitat qeveritare dhe të administratës publike;
- b) Të marrin masa, kudo që është e mundshme, në sistemet elektorale që inkurajojnë partitë politike të integrojnë gratë në pozitat publike të zgjedhura dhe jo të zgjedhura, në proporcion dhe nivel të njëjtë me burrat;
- c) Të mbrojnë dhe të promovojnë të drejtat e barabarta të grave dhe burrave për t'u angazhuar në veprimtaritë politike dhe për lirinë e anëtarësimit, duke përfshirë anëtarësinë në partitë politike dhe sindikatat e punës;
- d) Të rishikojnë ndikimin e ndryshëm të sistemeve elektorale në përfaqësimin politik të grave në organet e zgjedhura dhe të merret në konsiderim, ku është e mundshme, rregullimi ose reformimi i këtyre sistemeve;
- e) Të monitorojnë dhe vlerësojnë përparimin në përfaqësimin e grave përmes mbledhjes, analizës dhe përhapjen së rregullt të dhënave sasiore e cilësore për gratë dhe burrat në të gjitha nivelet dhe në pozita të ndryshme vendimmarrëse në sektorët publikë dhe privatë, si dhe të përhapen në baza vjetore të dhëna mbi numrin e grave dhe burrave të punësuar në nivele të ndryshme në Qeveri; të sigurojnë që gratë dhe burrat të kenë qasje të barabartë në të gjitha emërimet publike dhe të vendosin mekanizmat brenda strukturave qeveritare për monitorimin e progresit në këtë fushë;
- f) Të mbështesin organizatat joqeveritare dhe institutet kërkimore që kryejnë studime në lidhje me pjesëmarrjen e grave dhe ndikimin në vendimmarrje dhe në mjedisin vendimmarrës;
- g) Të inkurajojnë përfshirjen më të madhe të grave indigjene në vendimmarrje në të gjitha nivelet;
- h) Të inkurajojnë dhe, ku është e mundshme, të garantojnë që organizatat e financuara nga qeveria të miratojnë politika dhe praktika jodiskriminuese me qëllim që të rrisin numrin e grave në organizatat e tyre dhe t'i ngrenë në pozita më të larta;

- i) Të njohin se ndarja e punës dhe përgjegjësiive prindërore midis grave dhe burrave promovon pjesëmarrjen më të lartë të grave në jetën publike, si dhe të marrin masa të duhura për të arritur këtë, duke përfshirë masa për të pajtuar jetën familjare dhe profesionale;
- j) Të synojnë një balancë gjinore në listat e kandidatëve kombëtarë të emëruar për zgjedhje ose emërim në organet e Kombeve të Bashkuara, agjencitë e specializuara dhe organizatat tjera autonome të sistemit të Kombeve të Bashkuara, veçanërisht për poste në nivele më të larta.

191. Nga partitë politike:

- (a) Të marrin në konsiderim ekzaminimin e strukturave dhe procedurave të partisë për të hequr të gjitha pengesat që diskriminojnë, drejtpërdrejt ose tërthorazi, pjesëmarrjen e grave;
- (b) Të marrin në konsiderim zhvillimin e iniciativave që i lejojnë gratë të marrin pjesë plotësisht në të gjitha strukturat e brendshme politikëbërëse dhe në proceset e emërimit dhe nominimit zgjedhor;
- (c) Të marrin në konsiderim përfshirjen e çështjeve gjinore në agjendat e tyre politike duke marrë masa që të sigurojnë se gratë mund të marrin pjesë në udhëheqësinë e partive politike në baza të barabarta me burrat.

192. Nga qeveritë, organet kombëtare, sektori privat, partitë politike, sindikatat e punës, organizatat e punëdhënësve, institucionet kërkimore dhe akademike, trupat rajonale dhe nënrajonale, dhe organizatat joqeveritare dhe ndërkombëtare:

- a) Të marrin veprime pozitive për të krijuar një masë kritike të grave udhëheqëse, ekzekutive dhe menaxhuese në pozitë strategjike të vendimmarrjes;
- b) Të krijojnë ose të fuqizojnë, sipas nevojës, mekanizmat për monitorimin e qasjes së grave në nivelet e larta të vendimmarrjes;
- c) Të rishikojnë kriteret për rekrutim dhe emërim në trupat këshilluese dhe vendimmarrëse dhe promovimi në pozitë në pozita të larta për të siguruar që kriteret e tilla janë të rëndësishme dhe nuk diskriminojnë gratë;

- d) Të inkurajojnë përpjekjet e organizatave joqeveritare, sindikatave të punës dhe sektorit privat për të arritur barazinë midis grave e burrave në radhët e tyre, duke përfshirë pjesëmarrjen e barabartë në organet vendimmarrëse dhe në negociatat në të gjitha fushat dhe në të gjitha nivelet;
- e) Të zhvillojnë strategjitë e komunikimit për të promovuar debatin publik për rolet e reja të grave e burrave në shoqëri dhe në familje (siç është e definuar në paragrafin 30);
- f) Të ristrukturojnë rekrutimin dhe programet e zhvillimit të karrierës për të siguruar që të gjitha gratë, veçanërisht gratë e reja, të kenë qasje të barabartë në trajnim menaxherial, ndërmarrësor, teknik dhe të udhëheqjes, duke përfshirë edhe trajnimet në vendin e punës;
- g) Të zhvillojnë programet e përparimit të karrierës për gratë e të gjitha moshave që përfshin planifikimin e karrierës, gjurmimin, këshillimin, udhëheqjen, trajnimin dhe ritrajnimin;
- h) Të inkurajojnë dhe mbështesin pjesëmarrjen e organizatave joqeveritare të grave në konferencat e Kombeve të Bashkuara dhe në proceset përgatitore të tyre;
- i) Të synojnë mbështetjen e balancës gjinore në përbërjen e delegacioneve të Kombeve të Bashkuara dhe të forumeve të tjera ndërkombëtare.

193. Nga Kombet e Bashkuara:

- a) Të zbatojnë politikat dhe masat ekzistuese të punësimit dhe të miratojnë politika dhe masa të reja punësimi me qëllim që të arrihet barazia e përgjithshme gjinore, veçanërisht në nivelin profesional dhe më tej deri në vitin 2000, duke i kushtuar vëmendje rëndësisë së rekrutimit të stafit në një bazë sa më të gjerë gjeografike që është e mundur, në pajtim me Nenin 101, paragrafin 3 të Kartës së Kombeve të Bashkuara;
- b) Të zhvillojnë mekanizma për nominimin e grave kandidate për emërim në pozita të larta në Kombet e Bashkuara, agjencitë e specializuara dhe organizatat e trupat e tjerë të sistemit të Kombeve të Bashkuara;
- c) Të vazhdojnë të mbledhin dhe të shpërndajnë të dhëna sasiore e cilësore për gratë dhe burrat në vendimmarrje dhe të analizojnë ndikimin e tyre të ndryshëm në vendimmarrje,

si dhe të monitorojnë progresin drejt arritjes së synimit të vënë nga Sekretarit i Përgjithshëm për të pasur 50 për qind gra në pozita menaxheriale dhe të vendimmarrjes deri në vitin 2000.

194. Nga organizatat e grave, organizatat joqeveritare, sindikatat e punës, partnerët socialë, prodhuesit dhe organizatat industriale e profesionale:

- a) Të ndërtojnë dhe fuqizojnë solidaritetin ndërmjet grave përmes aktiviteteve të informimit, arsimit dhe sensibilizimit;
- b) Të avokojnë në të gjitha nivelet për të bërë të mundur që gratë të ndikojnë në vendimet, proceset dhe sistemet politike, ekonomike dhe sociale, si dhe të punojnë drejt kërkimit të llogaridhënies nga përfaqësuesit e zgjedhur në lidhje me angazhimet e tyre për shqetësimet gjinore;
- c) Në pajtim me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave, të vendosin baza të shënimeve për gratë dhe kualifikimet e tyre për përdorim në emërimin e grave në pozita të larta vendimmarrjeje dhe pozita këshilltarësh, për t'i shpërndarë Qeverive, organizatave rajonale dhe ndërkombëtare dhe ndërmarrjeve private, partive politike dhe organeve të tjera relevante.

Objektivi Strategjik G.2.

Të rritet kapaciteti i grave për të marrë pjesë në vendimmarrje dhe udhëheqje

Aksionet që duhen ndërmarrë

195. Nga Qeveritë, organizmat kombëtarë, sektori privat, partitë politike, sindikatat e punës, organizatat e punëdhënësve, organet rajonale dhe nën-rajonale, organizatat joqeveritare dhe ndërkombëtare dhe institucionet arsimore:

- a) Të sigurojnë trajnime për udhëheqësi dhe vetëbesim për të asistuar gratë dhe vajzat, veçanërisht ato me nevoja të posaçme, gratë me paaftësi dhe gratë që u takojnë pakicave racore dhe etnike, për të fuqizuar vetëbesimin e tyre dhe për t'i inkurajuar ato për të marrë pozita vendimmarrëse;

- b) Të kenë kritere transparente për pozitat vendimmarrëse dhe për të siguruar që organet përzgjedhëse të kenë përbërje të balancuar gjinore;
- c) Të krijojnë një sistem të këshillimit për gratë papërvojë dhe, në veçanti, t'u ofrojnë trajnime, përfshirë trajnimet për udhëheqësi dhe vendimmarrje, për t'iu drejtuar publikut dhe për të qenë vetë-pohuese, po ashtu edhe për pjesëmarrje në fushata politike;
- d) Të sigurojnë trajnime të ndjeshme gjinore për gratë dhe burrat për të promovuar marrëdhëniet jodiskriminuese të punës dhe respektimin e llojllojshmërisë në stilet e punës dhe menaxhimit;
- e) Të zhvillojnë mekanizma dhe trajnime për të inkurajuar gratë që të marrin pjesë në procesin zgjedhor, në veprimtaritë politike dhe fushat tjera të udhëheqjes.

H. MEKANIZMAT INSTITUTIONALË PËR PËRPARIMIN E GRAVE

196. Makineritë Kombëtare për përparimin e grave janë krijuar pothuajse në çdo Shtet Anëtar të OKB-së që, midis tjerash, të hartojnë, promovojnë dhe zbatojnë, ekzekutojnë, monitorojnë, vlerësojnë, avokojnë dhe mobilizojnë mbështetje për politikën që promovojnë përparimin e grave. Makineritë kombëtare janë të ndryshme në formë dhe në efektivitetin e tyre, dhe në disa raste kanë rënë. Shpesh të marginalizuar në strukturat qeveritare kombëtare, këta mekanizma shpesh pengohen nga mandatet e paqarta, mungesa e stafit, trajnimeve dhe të dhënave adekuate, dhe resurseve të pamjaftueshme, si dhe nga mbështetja e pamjaftueshme nga udhëheqësia politike kombëtare

197. Në nivelet rajonale dhe ndërkombëtare, mekanizmat dhe institucionet që promovojnë përparimin e grave si një pjesë integrale e zhvillimeve themelore politike, ekonomike, sociale e kulturore, si dhe të nismat për zhvillimin dhe të drejtat e njeriut, ballafaqohen me probleme të njëjta që burojnë nga mungesa e zotimit të niveleve më të larta.

198. Konferencat e njëpasnjëshme ndërkombëtare kanë nënvizuar nevojën për të marrë në konsideratë faktorët gjinorë në planifikimin e

politikave dhe programeve. Megjithatë, në shumë raste kjo nuk është bërë.

199. Organet rajonale që kanë të bëjnë me përparimin e grave janë fuqizuar, së bashku me makinerinë ndërkombëtare, si janë Komisioni për Statusin e Grave dhe Komiteti për Eliminimin e Diskriminimit kundër Grave,

200. Në shumë organizata janë zhvilluar metodologjitë për kryerjen e analizave me bazë gjinore në politika dhe programe dhe për t'u marrë me efektet e ndryshme të politikave mbi gratë dhe burrat, dhe ato janë në dispozicion për zbatim, por shpesh nuk zbatohen ose nuk zbatohen në vazhdimësi.

201. Një makineri kombëtare për përparimin e grave është njësia qendrore për bashkërendim të politikave përbrenda qeverisë. Detyra kryesore e kësaj njësie është të mbështesë integrimin e gjerë të perspektivës së barazisë gjinore në të gjitha fushat e politikave përgjatë tërë qeverisë. Kushtet e nevojshme për funksionimin efektiv të makinerive të tilla kombëtare përfshijnë:

- a) Vendosjen në nivelin më të lartë të mundshëm në qeveri, duke rënë në përgjegjësinë e ndonjë ministri nga Këshilli i Ministrave;
- b) Mekanizmat ose proceset institucionale që ndihmojnë, sipas nevojës, planifikimin e decentralizuar, zbatimin dhe monitorimin me qëllim të përfshirjes së organizatave joqeveritare dhe organizatave të komunitetit nga ato themeloret e më tutje;
- c) Resurse të mjaftueshme sa i përket buxhetit dhe aftësive profesionale;
- d) Mundësi për të ndikuar në zhvillimin e të gjitha politikave të Qeverisë.

202. Në adresimin e çështjes së mekanizmave për promovimin e përparimit të grave, Qeveritë dhe aktorët e tjerë, duhet të promovojnë një politikë aktive dhe të dukshme të integritit të një perspektive gjinore në të gjitha politikat dhe programet, ashtu që para se të merren vendimet, të bëhet një analizë mbi efektet e tyre mbi gratë dhe burrat, përkatësisht.

Objektivi Strategjik H.1.

Të krijohen ose fuqizohen makineritë kombëtare dhe organet tjera qeveritare

Aksionet që duhen ndërmarrë

203. Nga Qeveritë:

- a) Të sigurojnë që përgjegjësia për përparimin e grave është e garantuar plotësisht nga nivelet më të larta të mundshme të qeverisë; në shumë raste kjo mund të jetë në nivel të ministrit nga Këshilli i Ministrave;
- b) Bazuar në një zotim të fuqishëm politik, të krijojnë një makineri kombëtare, atje ku ajo nuk ekziston, dhe të fuqizohen, sipas nevojës, makineritë ekzistuese kombëtare, për përparimin e grave në nivelin më të lartë të mundshëm të qeverisë; ai duhet të ketë mandat dhe autoritet të përcaktuar qartë; si elemente kritike do të ishin resurset adekuate dhe aftësia dhe kompetenca për të ndikuar në politikat dhe për të formuluar dhe rishikuar legjislacionin. Midis tjerash, ajo duhet të kryejë analizat politike, të ndërmarrë avokimin, komunikim, bashkërendim dhe monitorimin e zbatimit;
- c) Të sigurojnë trajnimin e stafit për hartimin dhe analizimin e të dhënave nga perspektiva gjinore;
- d) Të krijojnë procedura për të lejuar makinerinë të mbledhë informata mbi çështjet e politikave të nivelit të qeverisë në një etapë të hershme dhe ta përdorë atë vazhdimisht në procesin e zhvillimit dhe rishikimit të politikave përbrenda Qeverisë;
- e) T'u raportojë rregullisht trupave legjislative lidhur me progresin e përpjekjeve, sipas nevojës, për të integruar shqetësimet gjinore, duke marrë parasysh zbatimin e Platformës për Veprim;
- f) Të inkurajojnë dhe promovojnë përfshirjen aktive të një numri të madh dhe të llojllojshëm të aktorëve institucionalë në sektorët publikë, privatë dhe vullnetarë, për të punuar për barazinë gjinore midis grave e burrave.

Objektivi Strategjik H.2.

Të integrohet perspektiva gjinore në legjislacion, politikat publike, programet dhe projektet

Aksionet që duhen ndërmarrë

204. Nga Qeveritë:

- a) Të kërkojnë të sigurojnë që para se të merren vendimet politike, të bëhet një analizë për ndikimin e tyre mbi gratë dhe burrat, respektivisht;
- b) Të rishikojnë rregullisht politikat, programet dhe projektet kombëtare, si dhe zbatimin e tyre, duke vlerësuar ndikimin e politikave të punësimit dhe të ardhurave me qëllim që të garantojnë që gratë janë përfituese të drejtpërdrejta të zhvillimit dhe që kontributi i tyre i plotë për zhvillimin, si në punën e paguar ashtu dhe në atë të papaguar, të merren në konsiderim në politikat ekonomike dhe planifikimin ekonomik;
- c) Të promovojnë strategjitë dhe synimet kombëtare për barazinë midis grave dhe burrave me qëllim të eliminimit të pengesave për ushtrimin e të drejtave të grave dhe për të çrrënjësuar të gjitha format e diskriminimit kundër grave;
- d) Të punojnë me anëtarët e trupave legislative, sipas nevojës, për të nxitur një perspektivë gjinore në të gjithë legjislacionin dhe në të gjitha politikat;
- e) T'u japin të gjitha ministrive mandatin për të rishikuar politikat dhe programet nga një perspektivë gjinore dhe nga pikëvështrimi i Platformës për Veprim. Të vendosin përgjegjësinë për zbatimin e këtij mandati në nivelin më të lartë të mundshëm. Të krijojnë dhe/ose fuqizojnë një strukturë koordinuese ndërministrorë për të zbatuar këtë mandat dhe për të monitoruar progresin dhe të rrjetëzohen me makineritë përkatëse.

205. Nga makineritë kombëtare:

- a) Të ndihmohet formulimi dhe zbatimi i politikave qeveritare për barazinë midis grave dhe burrave, të zhvillojnë strategjitë dhe metodologjitë e duhura, si dhe të promovohet bashkërendimi dhe bashkëpunimi brenda qeverisë qendrore me qëllim që të sigurohet integrimi i një perspektive gjinore në të gjitha proceset e politikëbërjes;
- b) Të promovojnë dhe krijojnë marrëdhënie bashkëpunimi me degët përkatëse të qeverisë, qendrat për studime për gratë dhe institucionet akademike, edukuese, sektorin privat, mediat, organizatat joqeveritare, veçanërisht organizatat dhe të gjithë aktorët e tjerë të shoqërisë civile;

- c) Të ndërmarrin aktivitete që, midis tjerash, fokusohen në reformën ligjore në lidhje me familjen, kushtet e punësimit, sigurimin shoqëror, tatimin në të ardhura, mundësitë e barabarta në arsimim, masat pozitive për promovimin e përparimit të grave, si dhe një perceptim të qëndrimeve dhe një kulturë të favorshme për barazinë, po ashtu edhe promovimin e një perspektive gjinore në politikat ligjore dhe reformat e programimit;
- d) Të promovojnë pjesëmarrjen e rritur të grave si agjente aktive dhe si përfituese të procesit të zhvillimit, që do të rezultonte me një përmirësim të cilësisë së jetës për të gjithë;
- e) Të vendosin lidhje të drejtpërdrejta me organet kombëtare, rajonale dhe ndërkombëtare të cilat merren me përparimin e grave;
- f) Të sigurojnë trajnim dhe asistencë këshilluese për agjencitë e qeverisë me qëllim të integritimit të një perspektive gjinore në politikat dhe programet e tyre.

Objektivi Strategjik H.3.

Të prodhohen dhe shpërndahen të dhëna dhe informata të ndara sipas gjinisë për planifikimin dhe vlerësimin

Aksionet që duhen ndërmarrë

206. Nga shërbimet statistikore kombëtare, rajonale dhe ndërkombëtare dhe agjencive relevante qeveritare dhe të Kombeve të Bashkuara, në bashkëpunim me organizatat kërkimore dhe të dokumentimit, në fushat e tyre përkatëse të përgjegjësive:

- (a) Të sigurojnë që statistikën lidhur me individët të mbledhen, hartohen, analizohen dhe prezantohen sipas gjinisë dhe moshës, si dhe të pasqyrojnë problemet, çështjet dhe pyetjet të cilat kanë të bëjnë me gratë dhe burrat në shoqëri;
- (b) Rregullisht të mbledhin, hartojnë, analizojnë dhe prezantojnë të dhëna të ndara sipas moshës, gjinisë, treguesve socio-ekonomikë dhe treguesve të tjerë relevantë, përfshirë numrin e vartësve, për përdorim në planifikimin dhe zbatimin e politikave dhe programeve, si dhe të pasqyrojnë problemet dhe pyetjet që kanë të bëjnë me gratë dhe burrat në shoqëri;

- (c) Të përfshijnë qendrat për studime për gratë dhe organizatat kërkimore në zhvillimin dhe testimin e treguesve dhe metodologjive kërkimore të përshtatshme për të fuqizuar analizat gjinore, si dhe në monitorimin dhe vlerësimin e zbatimit të objektivave të Platformës për Veprim;
- (d) Të caktojnë apo emërojnë stafin për të fuqizuar programet e statistikave gjinore dhe për të siguruar bashkërendimin, monitorimin dhe lidhjen me të gjitha fushat e punës statistikore, dhe për të përgatitur rezultatet që integrojnë statistikën nga fushat e ndryshme tematike;
- (e) Të përmirësojnë mbledhjen e të dhënave lidhur me kontributin e plotë të grave dhe burrave në ekonomi, duke përfshirë pjesëmarrjen e tyre në sektorin joformal;
- (f) Të zhvillojnë një njohje më gjithëpërfshirëse të të gjitha formave të punës dhe punësimit, duke:
- i. Përmirësuar mbledhjen e të dhënave për punën e papaguar e cila tashmë është përfshirë në Llogarinë Kombëtare të Sistemit të Kombeve të Bashkuara, siç janë bujqësia, veçanërisht bujqësia për mbijetesë, dhe llojet e tjera të veprimtarive prodhuese jo për treg;
 - ii. Përmirësuar matjet që aktualisht nënvlerësojnë papunësinë dhe nën-punësimin e grave në tregun e punës;
 - iii. Zhvilluar metodat, në forumet e përshtatshme, për matjen e vlerës në terma sasiorë, të punës së papaguar që mbetet jashtë llogarive kombëtare, si janë kujdesi për fëmijët ose të moshuarit dhe përgatitja e ushqimit, për pasqyrim të mundshëm në llogaritë satelitore ose llogaritë tjera zyrtare që do të mund të nxirreshin ndaras mirëpo të cilat janë në pajtim me llogaritë kombëtare, me qëllim të njohjes së kontributit ekonomik të grave dhe për ta bërë të dukshme shpërndarjen e pabarabartë të punës së paguar dhe të punës së papaguar midis grave dhe burrave;
- (g) Të zhvillojnë klasifikimin ndërkombëtar të veprimtarive për statistikën lidhur me shfrytëzimin kohor që janë të ndjeshme ndaj dallimeve midis grave e burrave në punën e paguar dhe të papaguar dhe mbledhja e të dhënave, të ndara sipas gjinisë. Në nivel kombëtar, bazuar në kufizimet e mundshme kombëtare:
- i. Drejtojnë studimeve të rregullta me përdorim kohor për të matur, në terma sasiorë, punën e papaguar,

duke përfshirë regjistrimin e këtyre veprimtarive, që janë kryer në të njëjtën kohë me veprimtaritë tjera të paguara ose të papaguara;

- ii. Të masin, në terma sasiorë, punën e papaguar që është jashtë llogarive kombëtare për të përmirësuar metodat ashtu që të reflektojnë saktësisht vlerën e saj në llogaritë satelitore apo llogaritë tjera zyrtare që janë të ndara nga llogaritë thelbësore kombëtare por që janë në pajtim me to;
- (h) Të përmirësojnë konceptet dhe metodat e mbledhjes së të dhënave për varfërinë midis grave e burrave, përfshirë edhe qasjen e tyre ndaj resurseve;
- (i) Të fuqizojnë sistemin qenësor statistikor dhe të inkuadrojnë analizat gjinore në botimet dhe kërkimet; t'i japin përparësi dallimeve gjinore në hartimin e kërkimeve dhe mbledhjen dhe analizën e të dhënave me qëllim të përmirësimit të të dhënave mbi morbiditetin; përmirësimit të mbledhjes së të dhënave për qasjen ndaj shërbimeve shëndetësore, përfshirë qasjen ndaj shërbimeve shëndetësore seksuale dhe riprodhuese, kujdes për nënat dhe planifikim familjar, me përparësi të veçantë për nënat adoleshente dhe kujdesit për të moshuarit;
- (j) Të zhvillojnë të dhëna të përmirësuara të ndara sipas gjinisë dhe moshës mbi viktimat dhe fajtorët e të gjitha formave të dhunës kundër grave, të tilla si dhuna familjare, ngacmimi seksual, përdhunimi, incesti dhe keqtrajtimi seksual, dhe trafikimi i grave dhe vajzave, po ashtu edhe mbi dhunën e kryer nga agjentët e shtetit;
- (k) Të përmirësojnë konceptet dhe metodat e mbledhjes së të dhënave për pjesëmarrjen e grave dhe burrave me paaftësi, duke përfshirë qasjen e tyre në resurse.

207. Nga Qeveritë:

- (a) Të sigurojnë nxjerrjen e rregullt të një botimi statistikor për gjininë, që paraqet dhe interpreton të dhëna tematike mbi gratë dhe burrat në një formë të përshtatshme për një masë të gjerë shfrytëzuesish jo-teknikë;
- (b) Të sigurojnë që prodhuesit dhe përdoruesit e statistikave në çdo vend të rishikojnë rregullisht se sa adekuate janë sistemet statistikore zyrtare dhe sa mbulojnë çështjet gjinore, si dhe të përgatisin një plan për përmirësimet e duhura, ku është e nevojshme;

- (c) Të zhvillojnë dhe të inkurajojnë zhvillimin e studimeve sasiore dhe cilësore nga organizatat kërkimore, sindikatat e punës, punëdhënësit, sektori privat dhe organizatat joqeveritare mbi ndarjen e fuqisë dhe ndikimin në shoqëri, duke përfshirë numrin e grave dhe burrave në pozita të larta të vendimmarrjes në të dy sektorët, publikë dhe privatë;
- (d) Të përdorin më tepër të dhëna të ndjeshme gjinore në formulimin e politikave dhe zbatimin e programeve dhe projekteve.

208. Nga Kombet e Bashkuara:

- (a) Të promovojnë zhvillimin e metodave për të gjetur mënyra më të mira për të mbledhur, krahasuar dhe analizuar të dhënat që mund të lidhen me të drejtat njerëzore të grave, duke përfshirë dhunën kundër grave, për t'u përdorur nga të gjitha organet relevante të Kombeve të Bashkuara;
- (b) Të promovojnë zhvillimin e mëtejshëm të metodave statistikore për të përmirësuar të dhënat që kanë të bëjnë me gratë në zhvillimin ekonomik, social, kulturor dhe politik;
- (c) Të përgatisin një botim të "Grave të Botës" në një interval të rregullt pesëvjeçar dhe ta shpërndajnë gjerësisht;
- (d) Sipas kërkesës, të asistojnë vendet në zhvillimin e politikave dhe programeve gjinore;
- (e) Të sigurojnë që raportet, të dhënat dhe botimet relevante të Sektorit të Statistikave të Sekretariatit të Kombeve të Bashkuara dhe të INSTRAW për përparimin në nivelet kombëtare dhe ndërkombëtare, të i jenë transmetuar Komisionit për Statusin e Grave në baza të rregullta dhe në një formë të koordinuar.

209. Nga institucionet multilaterale të zhvillimit dhe donatorët bilateralë:

Të inkurajojnë përkrahjen e zhvillimit të kapacitetit kombëtar në vendet në zhvillim dhe në vendet me ekonomi në tranzicion, duke u ofruar resurse dhe asistencë teknike në mënyrë që ato vende të mund të masin plotësisht punën e bërë nga gratë dhe burrat, duke përfshirë punën e paguar dhe të papaguar, dhe ku është e përshtatshme, të përdoren llogaritë satelite ose llogaritë tjera zyrtare për punën e papaguar.

I. TË DREJTAT NJERËZORE TË GRAVE

210. Të drejtat e njeriut dhe liritë themelore janë e drejtë e lindur e të gjitha qenieve njerëzore, mbrojtja dhe promovimi i këtyre të drejtave është përgjegjësia e parë e Qeverive.

211. Konferenca Botërore për të Drejtat e Njeriut e riafirmoi zotimin solemn të të gjitha Shteteve për të përmbushur detyrimin e tyre për të promovuar respektin universal, dhe mbikëqyrjen dhe mbrojtjen e të gjitha të drejtave të njeriut dhe lirive themelore për të gjithë, në përputhje me Kartën e Kombeve të Bashkuara, instrumentet e tjera që lidhen me të drejtat e njeriut, dhe të drejtën ndërkombëtare. Natyra universale e këtyre të drejtave dhe lirive themelore është jashtë çdo dyshimi.

212. Promovimi dhe mbrojtja e të gjitha të drejtave të njeriut dhe lirive themelore duhet të konsiderohet si një objektivë prioritare e Kombeve të Bashkuara, në përputhje me qëllimet dhe parimet e saja, në veçanti me qëllimin e bashkëpunimit ndërkombëtar. Në kuadrin e këtyre qëllimeve dhe parimeve, promovimi edhe mbrojtja e të gjitha të drejtave të njeriut është një shqetësim i drejtë i bashkësisë ndërkombëtare. Bashkësia ndërkombëtare duhet t'i trajtojë të drejtat e njeriut në mënyrë globale, në një mënyrë të drejtë e të barabartë, me të njëjtën bazë dhe me të njëjtin theks. Platforma për Veprim ripohon rëndësinë e sigurimit të universalitetit, objektivitetit dhe mospërzgjedhjes kur merren në konsideratë çështjet e të drejtave të njeriut.

213. Platforma për Veprim ripohon se të gjitha të drejtat e njeriut – civile, kulturore, ekonomike, politike dhe sociale, duke përfshirë të drejtën për zhvillim – janë universale, të pandashme, të ndërvarura dhe të ndërlidhura, siç janë të shprehura në Deklaratën e Vjenës dhe Programin për Veprim të miratuara nga Konferenca Botërore për të Drejtat e Njeriut. Konferenca ripohoi se të drejtat njerëzore të grave dhe të vajzave të mitura janë pjesë të patjetërsueshme, përbërëse dhe të pandashme të të drejtave universale të njeriut. Gëzimi i plotë dhe i barabartë i të gjitha të drejtave të njeriut dhe lirive themelore nga gratë dhe vajzat është një prioritet për Qeveritë dhe Kombet e Bashkuara dhe është thelbësore për përparimin e grave.

214. Të drejtat e barabarta të grave dhe burrave janë përmendur qartësisht në Preambulën e Kartës së Kombeve të Bashkuara. Të gjitha instrumentet kryesore ndërkombëtare të të drejtave të njeriut përfshijnë gjininë si një bazë për të cilën shtetet nuk mund të diskriminojnë.

215. Qeveritë duhet jo vetëm të përmbahen nga shkelja e të drejtave njerëzore të grave, por duhet të punojnë aktivisht për t'i promovuar

dhe mbrojtur këto të drejta. Njohja e rëndësisë së të drejtave njerëzore të grave pasqyrohet në faktin që tre të katërtat e Shteteve Anëtare të Kombeve të Bashkuara kanë miratuar Konventën për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit kundër Grave.

216. Konferenca Botërore për të Drejtat e Njeriut ripohoi qartë se të drejtat njerëzore të grave gjatë tërë ciklit të jetës së tyre, janë një pjesë e patjetërsueshme, integrale dhe e pandashme e të drejtave universale të njeriut. Konferenca Ndërkombëtare për Popullsinë dhe Zhvillimin ripohoi të drejtat riprodhuese të grave dhe të drejtën për zhvillim. Të dyja këto, Deklarata e të Drejtave të Fëmijës³¹ dhe Konventa për të Drejtat e Fëmijës¹¹ garantojnë të drejtat e fëmijës dhe përkrahin parimin e mos-diskriminimit mbi baza gjinore.

217. Hendeku midis ekzistencës së të drejtave dhe gëzimit efektiv të tyre është si rezultat i mungesës së angazhimit të Qeverive për promovimin dhe mbrojtjen e këtyre të drejtave dhe dështimi i Qeverive për të informuar gratë dhe burrat rreth tyre. Mungesa e mekanizmave të përshtatshëm për kompensim në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar dhe resurset joadekuate në që të dy nivelet, e ndërlikojnë problemin. Në shumicën e vendeve janë ndërmarrë masa për të pasqyruar të drejtat e garantuara në Konventën për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit kundër Grave në ligjin kombëtar. Një numër vendesh kanë themeluar mekanizma për të fuqizuar aftësitë e grave për të ushtruar të drejtat e tyre.

218. Me qëllim të mbrojtjes së të drejtave e njeriut të grave, është e nevojshme që sa më shumë që është e mundur t'u shmangemi përdorimit të rezervimeve dhe të sigurojmë që nuk do të ketë rezervime ë cilat nuk janë në pajtim me objektivat dhe qëllimet e Konventës apo që nuk janë në pajtim me të drejtën ndërkombëtare të traktateve. Derisa të drejtat njerëzore të grave, siç përcaktohet nga instrumentet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, të njihen plotësisht dhe të mbrohen, aplikohen dhe zbatohen në mënyrë efektive, dhe të zbatohen në ligjin kombëtar, po ashtu edhe në praktikën kombëtare në kodin familjar, dhe atë civil, penal, të punës e të tregtisë si dhe rregullat dhe rregulloret administrative, ato do të ekzistojnë vetëm si emër.

219. Në ato vende, të cilat ende nuk janë bërë palë në Konventën për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit kundër Grave dhe në instrumentet tjera ndërkombëtarë të të drejtave të njeriut, ose ku janë futur rezervimet që nuk janë në pajtim me objektivin dhe qëllimin e Konventës, ose ku ligjet kombëtare nuk janë rishikuar ende për të zbatuar normat dhe standardet ndërkombëtare, atëherë barazia de jure e grave ende nuk është siguruar. Gëzimi i plotë i të drejtave të barabarta prej grave është minuar nga mospërputhjet midis legjislacionit vendës dhe të drejtës ndërkombëtare, si dhe

³¹ Rezoluta e Asamblesë së Përgjithshme 1386 (XIV).

instrumenteve ndërkombëtare mbi të drejtat e njeriut. Procedurat administrative tepër komplekse, mungesa e ndërgjegjësimit përbrenda procesit juridik dhe monitorimi joadekuat i shkeljes së të drejtave njerëzore të grave, të cilit i shtohet edhe nën-përfaqësimi i grave në sistemet juridike, informatat e pamjaftueshme për të drejtat ekzistuese dhe qëndrimet e praktikat këmbëngulëse, përjetësojnë pabarazinë de facto të grave. Pabarazia de facto gjithashtu përjetësohet, midis tjerash, edhe nga mungesa e zbatimit të ligjeve dhe kodeve të familjes, atij civil, penal, të punës, tregtisë, ose rregullat dhe rregulloret administrative që synojnë të sigurojnë gëzimin e plotë të të drejtave të njeriut dhe lirive themelore të grave.

220. Çdo person duhet të ketë të drejtë të marrë pjesë, të kontribuojë dhe të gëzojë zhvillimin kulturor, ekonomik, politik dhe social. Në shumë raste gratë dhe vajzat vuajnë diskriminimin në shpërndarjen e burimeve ekonomike dhe sociale. Kjo shkel drejtpërdrejt të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore.

221. Të drejtat e njeriut të të gjitha grave dhe vajzave të mitura duhet të jenë pjesë përbërëse e të gjitha veprimtarive për të drejtat e njeriut të Kombeve të Bashkuara. Nevojiten përpjekje të intensifikuara për të integruar statusin e barabartë dhe të drejtat e njeriut të të gjitha grave dhe vajzave në aktivitetet kryesore në tërë sistemin e Kombeve të Bashkuara, dhe për të adresuar këto çështje rregullisht dhe sistematikisht përmes mekanizmave dhe organeve relevante. Kjo, midis tjerash, kërkon bashkëpunim dhe bashkërendim të përmirësuar midis Komisionit për Statusin e Grave, Komisionarit të Lartë Për të Drejtat e Njeriut të Kombeve të Bashkuara, Komisionit për të Drejtat e Njeriut, përfshirë raportorët e tij specialë dhe tematikë, ekspertët e pavarur, grupet e punës dhe Nënkomisionin e tij për Parandalimin e Diskriminimit dhe Mbrojtjen e Minoriteteve, Komisionin për Zhvillim të Qëndrueshëm, Komisionin për Zhvillimin Social, Komisionin mbi Parandalimin e Krimit dhe Drejtësinë Kriminale dhe Komitetin për Eliminimin e Diskriminimit kundër Grave dhe organizma të tjera të traktatit të të drejtave të njeriut, dhe të gjitha entitetet relevante të sistemit të Kombeve të Bashkuara, duke përfshirë agjencitë e specializuara. Bashkëpunimi është gjithashtu i nevojshëm për të fuqizuar, racionalizuar dhe për të futur në rrjedhë sistemin e të drejtave të njeriut të Kombeve të Bashkuara dhe për të promovuar efektivitetin dhe efikasitetin e tij duke marrë parasysh nevojën për t'iu shmangur dyfishimit të panevojshëm dhe mbivendosjen e mandateve dhe detyrave.

222. për tu arritur objektivi i realizimit të plotë të të drejtave të njeriut për të gjithë, atëherë duhet të aplikohen instrumentet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut në atë mënyrë që të merret parasysh më qartë natyra sistematike dhe sistemike e diskriminimit kundër grave, të cilat janë të treguar qartë nga analizat gjinore.

223. Duke mbajtur në mend Programin për Veprim të Konferencës Ndërkombëtare për Popullsi dhe Zhvillim dhe Deklaratën e Vjenës dhe Programin për Veprim të miratuara nga Konferenca Botërore për të Drejtat e Njeriut, siç është e shprehur në raportet përkatëse, Konferenca e Katërt Botërore për Gratë ripohon se të drejtat riprodhese mbeten në njohjen e së drejtës bazë të të gjithë çifteve dhe individëve për të vendosur lirisht dhe përgjegjësisht numrin, hapësirën dhe kohën e fëmijëve të tyre, si dhe për të pasur informatat dhe mjete për të bërë këtë, si dhe të drejtën për ta arritur standardin më të lartë të shëndetit seksual dhe riprodhues. Kjo gjithashtu përfshin të drejtën e tyre për të marrë vendime lidhur me riprodhimin e lirë nga diskriminimi, detyrimi dhe dhuna, siç shprehet në dokumentet për të drejtat e njeriut.

224. Dhuna kundër grave edhe shkel edhe dëmton ose shfuqizon mundësinë e gëzimit të të drejtave të njeriut dhe lirive themelore nga gratë. Duke marrë parasysh Deklaratën mbi Eliminimin e Dhunës kundër Grave dhe punën e Raportuesve Specialë, dhuna me bazë gjinore, e tillë si rrahja dhe dhuna tjetër shtëpiake, keqtrajtimi seksual, robëria seksuale dhe shfrytëzimi, si dhe trafikimi ndërkombëtarë i grave dhe fëmijëve, prostitucioni i detyruar dhe ngacmimi seksual, si dhe dhuna ndaj grave që rezulton nga paragjykimimi kulturor, racizmi dhe diskriminimi racor, ksenofobia, pornografia, spastrimi etnik, konflikti i armatosur, pushtimi i huaj, ekstremizmi fetar e antifetar dhe terrorizmi, janë të papajtueshëm me dinjitetin dhe vlerën e personit njerëzor dhe duhet të luftohen dhe të eliminohen. Çfarëdo aspekti i dëmshëm i disa praktikave tradicionale, zakonore ose moderne, që shkelin të drejtat e grave, duhen të ndalohen dhe eliminohen. Qeveritë duhet të ndërmarrin veprim urgjent për të luftuar dhe eliminuar të gjitha format e dhunës kundër grave në jetën private dhe publike, të kryera apo toleruara nga Shteti ose personat privatë.

225. Shumë gra ballafaqohen me barriera shtesë kundër gëzimit të tyre të të drejtave të njeriut për shkak të faktorëve të tillë si raca, gjuha, etnia, kultura, feja, paaftësia ose klasa shoqërore ekonomike, ose për shkak se janë popull indigjen, emigrantë, përfshirë gratë punëtore emigrante, gratë e zhvendosura ose refugjate. Ato mund të jenë gjithashtu të pafavorizuara dhe të marginalizuara nga një mungesë e përgjithshme e njohurive dhe njohjes së të drejtave të tyre të njeriut, si dhe nga pengesat që ato ndeshin për të fituar qasje në informata dhe mekanizma kompensimi në rastet kur shkelen të drejtat e tyre.

226. Faktorët që shkaktojnë ikjen e grave refugjate, të grave të tjera të shpërngulura në nevojë të mbrojtjes ndërkombëtare dhe grave të zhvendosura brenda vendit, mund të jenë ndryshe nga ato që ndikojnë në burrat. Këto gra vazhdojnë të jenë të cenueshme ndaj abuzimeve të të drejtave të njeriut gjatë dhe pas ikjes së tyre.

227. Përderisa gratë janë duke përdorur gjithnjë më shumë sistemin ligjor për të ushtruar të drejtat e tyre, në shumë vende mungesa e ndërjegjësisimit lidhur me ekzistencën e këtyre të drejtave është një pengesë që ndalon gratë nga gëzimi i plotë i të drejtave të tyre njerëzore dhe arritja e barazisë. Përvoja në shumë vende ka treguar se gratë mund të fuqizohen dhe të motivohen për të mbrojtur të drejtat e tyre, pavarësisht nga niveli i tyre i arsimimit ose statusi i tyre socio-ekonomik. Programet për edukimin ligjor dhe strategjitë mediale kanë qenë efektive në ndihmën ndaj grave për të kuptuar lidhjen midis të drejtave të tyre dhe aspekteve të tjera të jetës të tyre, si dhe në demonstrimin se mund të ndërmerren nisma kosto efektive për të ndihmuar gratë që t'i fitojnë këto të drejta. Ofrimi i edukimit për të drejtat e njeriut është thelbësore për promovimin dhe të kuptuarit të të drejtave të njeriut, përfshirë njohuritë e mekanizmave të kompensimit për të rregulluar çështjen e shkeljes së të drejtave të tyre. Është e nevojshme për të gjithë individët, veçanërisht gratë në rrethana të cenueshme, të kenë njohuri të plotë të të drejtave të tyre dhe qasje në kompensim ligjor kundër shkeljeve të të drejtave të tyre.

228. Gratë që janë të angazhuara në mbrojtjen e të drejtave të njeriut duhet të mbrohen. Qeveritë kanë për detyrë që të garantojnë gëzimin e plotë të gjitha të drejtave të cekura në Deklaratën Universale për të Drejtat e Njeriut, Marrëveshjen Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike dhe Marrëveshjen Ndërkombëtare mbi të Drejtat Ekonomike, Shoqërore dhe Kulturore të grave që punojnë paqësisht me kapacitet personal ose organizativ për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Organizatat joqeveritare, organizatat e grave dhe grupet feministe, kanë luajtur një rol katalistik në promovimin e të drejtave njerëzore të grave përmes veprimtarive themelore shoqërore, rrjetëzimit dhe avokimit dhe kanë nevojë për inkurajim, mbështetje dhe qasje në informata nga Qeveria me qëllim që të kryejnë këto veprimtari.

229. Për të adresuar gëzimin e të drejtave të njeriut, Qeveritë dhe aktorët e tjerë duhet të promovojnë një politikë aktive dhe të dukshme të integritit të perspektivës gjinore në të gjitha politikat dhe programet në mënyrë që, para se të merren vendimet, të bëhet një analizë për efektet që kanë ato mbi gratë dhe burrat.

Objektivi strategjik I.1

Të promovohen dhe të mbrohen të drejtat njerëzore të grave, përmes zbatimit të plotë të të gjitha instrumenteve të drejtave të njeriut, veçanërisht Konventës për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit kundër Grave

Aksionet që duhen ndërmarrë

230. Nga Qeveritë:

- (a) Të punojnë aktivisht për ratifikimin ose pranimin dhe zbatimin e marrëveshjeve ndërkombëtare dhe rajonale për të drejtat e njeriut;
- (b) Të ratifikojnë dhe të pranojnë, si dhe të sigurojnë zbatimin e Konventës për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit kundër Grave në mënyrë që ratifikimi universal i Konventës të mund të arrihet deri në vitin 2000;
- (c) Të kufizojnë çfarëdo rezervimesh kundër Konventës për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit kundër Grave; të formulojnë ndonjë rezervim të tillë në mënyrë sa më të saktë dhe të ngushtë që të jetë e mundur; të sigurojnë që asnjë rezervim nuk është i papajtueshëm me qëllimin dhe objektin e Konventës ose i papajtueshëm me të drejtën ndërkombëtare të traktateve, si dhe t'i rishikon rregullisht ato me qëllim të tërheqjes së tyre; dhe tërheqja e rezervimeve që janë kundër objektivit dhe qëllimit të Konventës për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit kundër Grave ose të cilat janë përndryshe të papajtueshme me marrëveshjen të drejtën ndërkombëtare të traktateve;
- (d) Të marrin në konsideratë hartimin e planeve kombëtare të veprimit të cilat identifikojnë hapat që duhet ndërmarrë për të përmirësuar promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut, duke përfshirë të drejtat njerëzore të grave, siç rekomandohen nga Konferenca Botërore për të Drejtat e Njeriut;
- (e) Të krijojnë ose fuqizojnë institucionet e pavarura kombëtare për mbrojtjen dhe promovimin e këtyre të drejtave, përfshirë të drejtat njerëzore të grave, siç rekomandohet nga Konferenca Botërore për të Drejtat e Njeriut;
- (f) Të zhvillojnë një program gjithëpërfshirës edukimi për të drejtat e njeriut për të rritur ndërgjegjësimin midis grave për të drejtat e tyre të njeriut dhe midis të tjerash për të drejtat njerëzore të grave;
- (g) Nëse ato janë palë Shtetërore, të zbatojnë Konventën duke rishikuar të gjitha ligjet, politikat, praktikat dhe procedurat kombëtare për të garantuar se ato përmbushin detyrimet e parapara në Konventë; të gjitha shtetet duhet të ndërmarrin një rishikim të të gjitha ligjeve, politikave praktikave dhe procedurave kombëtare për të siguruar se ato përmbushin detyrimet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut në këtë fushë;

- (h) Të përfshijnë aspektet gjinore në raportimin në të gjitha konventat e tjera për të drejtat e njeriut, përfshirë konventat e ONP, për të siguruar analiza dhe rishikime të të drejtave njerëzore të grave;
- (i) Të raportojnë në afat në Komitetin për Eliminimin e Diskriminimit kundër Grave në lidhje me zbatimin e Konventës, duke ndjekur plotësisht udhëzimet e përcaktuara nga Komiteti dhe përfshirjen e organizatave joqeveritare, ku është e mundshme, ose marrjen parasysh të kontributeve të tyre në përgatitjen e raportit;
- (j) T'i mundësojnë Komitetit për Eliminimin e Diskriminimit kundër Grave që të kryejë mandatin e tij në plotësi duke u lejuar një kohë adekuate për të kryer takimet përmes ratifikimit të gjerë të rishikimit të adoptuar nga Shtetet palë të Konventës për Eliminimin e të Gjitha Formave Diskriminimit kundër Grave në 22 Maj 1995 në pajtim me nenin 20, paragrafin 1,³² dhe për promovimin e metodave efikase të punës;
- (k) Të mbështesin procesin e iniciuar nga Komisioni për Statusin e Grave me qëllim të përpunimit të një drafti të një protokollit fakultativ të Konventës për Eliminimin e të Gjitha Formave Diskriminimit kundër Grave, që mund të hyjë në fuqi sa më parë të jetë e mundur përmes procedurës për të drejtën e peticionit, duke marrë parasysh raportin e Sekretarit të Përgjithshëm mbi protokollin fakultativ, përfshirë ato qëllime që lidhen me realizueshmërinë e tij;
- (l) Të marrin masa urgjente për të arritur ratifikimin universal të Konventës për të Drejtat e Fëmijës para fundit të vitit 1995 dhe të sigurojnë zbatimin e plotë të Konventës për të garantuar të drejta të barabarta për vajzat dhe djemtë, si dhe për të inkurajuar ato shtete që ende nuk janë bërë palë të kësaj Konvente që të bëhen palë me qëllim që të realizohet zbatimi universal i Konventës për të Drejtat e Fëmijës deri në vitin 2000;
- (m) Të adresojnë problemet akute të fëmijëve, midis tjerash, përmes mbështetjes së përpjekjeve në kontekstin e sistemit të Kombeve të Bashkuara, që synon adoptimin e masave efikase ndërkombëtare për parandalimin dhe zhdukjen e vrasjeve të fëmijëve vajza, punën e dëmshme të fëmijëve, shitjen e fëmijëve dhe organeve të tyre, prostitucionin e fëmijëve, pornografinë e fëmijëve dhe format e tjera të abuzimit seksual dhe të marrin në konsiderim dhënien e

³² Shih Konventën për Eliminimin e të Gjitha Formave Diskriminimit kundër Grave CEDAW/SP/1995/2

kontributit për hartimin e një protokolli fakultativ për Konventën për të Drejtat e Fëmijës;

- (n) Duke përfshirë përmes bashkëpunimit ndërkombëtar, të fuqizojnë zbatimin e të gjitha instrumenteve përkatëse të të drejtave të njeriut me qëllim të luftimit dhe eliminimit të formave të organizuara dhe formave të tjera të trafikimit të grave dhe fëmijëve, përfshirë me qëllim shfrytëzimin seksual, pornografisë, prostitucionit dhe turizmit seksual, si dhe për t'u siguruar shërbime ligjore dhe sociale viktimave. Kjo duhet të përmbajë dispozita për bashkëpunimin ndërkombëtar për të ndjekur dhe dënuar ata që janë përgjegjës për shfrytëzimin e organizuar të grave dhe fëmijëve;
- (o) Duke marrë parasysh nevojën për të garantuar respektimin e plotë të të drejtave njerëzore të grave indigjene, të marrin në konsiderim hartimin e një deklaratë mbi të drejtat e popujve indigjenë për t'u miratuar nga Asambleja e Përgjithshme brenda Dhjetëvjeçarit Ndërkombëtar të Popujve Indigjenë të Botës, duke inkurajuar pjesëmarrjen e grave indigjene në grupet e punës për përpunimin e projekt deklaratës, në përputhje me dispozitat për pjesëmarrjen e organizatave të popujve indigjenë.

231. Nga organet, organizmat dhe agjencitë relevante të sistemit të Kombeve të Bashkuara, të gjitha organizmat e të drejtave të njeriut të sistemit të Kombeve të Bashkuara, si dhe Komisionari i Lartë për të Drejtat e Njeriut i Kombeve të Bashkuara dhe Komisionari i Lartë për Refugjatë të Kombeve të Bashkuara, që përderisa promovojnë një efikasitet dhe efektivitet më të madh përmes koordinimit më të mirë të organizmave, mekanizmave dhe procedurave të ndryshme, duke marrë parasysh nevojën e ndalimit të dyfishimit të panevojshëm dhe mbivendosjes së panevojshme të mandateve dhe detyrave të tyre:

- (a) T'u japin vëmendje të plotë dhe të qëndrueshme të drejtave njerëzore të grave në ushtrimin e mandateve të tyre përkatëse për të promovuar respektimin universal të të gjitha të drejtave të njeriut - civile, kulturore, ekonomike, politike dhe shoqërore - përfshirë të drejtën për zhvillim;
- (b) Të sigurojnë zbatimin e rekomandimeve të Konferencës Botërore për të Drejtat e Njeriut për integrimin e plotë dhe përfshirjen e të drejtave njerëzore të grave në të gjitha zhvillimet;
- (c) Të zhvillojnë një program gjithëpërfshirës politikash për integrimin e të drejtave njerëzore të grave përgjatë tërë

sistemit të Kombeve të Bashkuara, duke përfshirë veprimtaritë në lidhje me shërbimet e këshillimit, asistencën teknike, metodologjinë e raportimit, vlerësimin e ndikimit gjinor, koordinimin, informimin publik dhe edukimin për të drejtat e njeriut, si dhe të luajnë një rol aktiv në zbatimin e programit;

- (d) Të sigurojnë integrimin dhe pjesëmarrjen e plotë të grave edhe si agjente edhe si përfituese në procesin e zhvillimit dhe të ripërsëritin objektivat e vendosura për veprimin global për gratë drejt zhvillimit të qëndrueshëm dhe të barabartë të parashtruar në Deklaratën e Rios për Mjedisin dhe Zhvillimin;
- (e) Të përfshijnë informimin mbi shkeljet me baza gjinore të të drejtave të njeriut në veprimtaritë e tyre dhe të integrojnë gjetjet në të gjitha programet dhe aktivitetet e tyre;
- (f) Të sigurojnë se do të ketë bashkëpunim dhe koordinim të punës të të gjithë organizmave dhe mekanizmave për të drejtat e njeriut dhe të sigurojnë se janë duke u respektuar të drejtat njerëzore të grave;
- (g) Të fuqizojnë bashkëpunimin dhe koordinimin midis Komisionit për Statusin e Grave, Komisionit të të Drejtave të Njeriut, Komisionit për Zhvillimin Social, Komisionit për Zhvillimin e Qëndrueshëm, Komisionit për Parandalimin e Krimin dhe Drejtësinë Kriminale, organizmave të Kombeve të Bashkuara për monitorimin e marrëveshjeve të të drejtave të njeriut, përfshirë Komitetin për Eliminimin e Diskriminimit kundër Grave, dhe UNIFEM, INSTRAW, UNDP, UNICEF dhe organizatave të tjera të sistemit të Kombeve të Bashkuara, që me mandatet e tyre veprojnë në promovimi e të drejtave njerëzore të grave, dhe të përmirësojnë bashkëpunimin midis Divizionit Për Përparimin e Grave dhe Qendrës për të Drejtat e Njeriut;
- (h) Të vendosin bashkëpunim efektiv midis Komisionarit të Lartë për të Drejtat e Njeriut të Kombeve të Bashkuara dhe Komisionarit të Lartë për Refugjatë të Kombeve të Bashkuara dhe organizmave të tjera relevante, brenda mandateve të tyre përkatëse, duke marrë në konsiderim lidhjen e ngushtë midis shkeljeve masive të të drejtave të njeriut, veçanërisht në formën e gjenocidit, spastrimit etnik, përdhunimit sistematik të grave në situata lufte dhe rrjedhjes së refugjatëve dhe të zhvendosurve të tjerë, si dhe faktit që gratë refugjate, si dhe ato të zhvendosura dhe të rikthyera mund t'i nënshtrohen keqtrajtimit të veçantë të të drejtave të njeriut;

- (i) Të inkurajojnë përfshirjen e një perspektive gjinore në programet kombëtare të veprimit dhe në institucionet për të drejtat e njeriut dhe në institucionet kombëtare, përbrenda kontekstit të programeve të shërbimeve këshillëdhënëse për të drejtat e njeriut;
- (j) Të ofrojnë trajnim për të drejtat njerëzore të grave për të gjithë personelin dhe zyrtarët e Kombeve të Bashkuara, veçanërisht ata që janë të kyçur në veprimtaritë për të drejtat e njeriut dhe ato për ndihmë humanitare, si dhe të promovojnë të kuptuarit e të drejtave njerëzore të grave në mënyrë që të njohin dhe të merren me shkeljet e të drejtave njerëzore të grave dhe të mund të marrin plotësisht në konsideratë aspektin gjinor në punën e tyre.

Objektivi strategjik I.2.

Të sigurohet barazia dhe mos-diskriminimi sipas ligjit dhe në praktikë

Aksionet që duhen ndërmarrë

232. Nga Qeveritë:

- (a) T'i japin përparësi promovimit dhe mbrojtjes së gëzimit të plotë dhe të barabartë të të gjitha të drejtave të njeriut dhe lirive themelore nga gratë dhe burrat pa kurrfarë dallimi sa i përket racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, fesë, opinionëve politike ose tjera, origjinës kombëtare ose shoqërore, statusit të pronës, lindjes ose ndonjë statusi tjetër;
- (b) Të sigurojnë garanci kushtetuese dhe/ose të dekretojnë legjislacionin përkatës për të ndaluar diskriminimin me bazë të gjinisë për të gjitha gratë dhe vajzat e të gjitha moshave dhe t'u sigurojë grave të të gjitha moshave të drejta të barabarta dhe gëzimin e plotë të atyre të drejtave;
- (c) Të mishërojnë parimin e barazisë së burrave dhe grave në legjislacionin e tyre dhe të sigurojnë, përmes ligjit dhe mjeteve të tjera të përshtatshme, realizimi praktik të këtij parimi;
- (d) Të rishikojnë ligjet kombëtare, duke përfshirë ligjet zakonore dhe praktikat ligjore në fushat e ligjit familjar, civil, penal, të punës dhe atij komercial me qëllim që të sigurojë zbatimin e parimeve dhe të procedurave të të gjitha instrumenteve relevante ndërkombëtare të të drejtave të njeriut me anën e legjislacionit kombëtar, si dhe të revokojë ndonjë ligj të

mbetur që diskriminon me bazë gjinie dhe të heqë paragjykimet gjinore në administrimin e drejtësisë;

- (e) Të fuqizojnë dhe të inkurajojnë zhvillimin e programeve për të mbrojtur të drejtat njerëzore të grave në institucionet kombëtare për të drejtat e njeriut të cilat zbatojnë programet e tilla, siç janë komisionet e të drejtave të njeriut ose avokatët e popullit, duke u dhënë atyre status, burime dhe qasje të përshtatshme në Qeveri për të asistuar individët, në veçanti gratë, dhe të sigurojnë se këto institucione do t'u kushtojnë vëmendje adekuate problemeve që përfshijnë shkeljen e të drejtave njerëzore të grave;
- (f) Të marrin veprime për të siguruar që të drejtat njerëzore të grave, përfshirë të drejtat të cilave u referohen paragrafët 96 dhe 97 në seksionin IV. C, janë plotësisht të respektuara dhe të mbrojtura;
- (g) Të ndërmarrin veprim të menjëhershëm për të luftuar dhe eliminuar dhunën kundër grave, e cila është një shkelje e të drejtave të njeriut, që rrjedh nga praktikatat e dëmshme tradicionale apo zakonore, paragjykimet kulturore dhe ekstremizmi;
- (h) Të ndalojnë gjymtimin gjeneral femëror kudo që ai ekziston dhe t'u japin mbështetje të fuqishme përpjekjeve të organizatave joqeveritare, komunitetit dhe institucioneve fetare për të zhdukur praktikatat e tilla;
- (i) Të ofrojnë edukim dhe trajnime të ndjeshme gjinore për të drejtat e njeriut për zyrtarët publikë, përfshirë, midis tjerash, personelin e policisë dhe atë ushtarak, zyrtarët e enteve korrigjuese, personelin shëndetësor dhe atë mjekësor, punonjësit socialë, përfshirë njerëzit që merren me çështjet e emigracionit dhe të refugjatëve, dhe mësuesit e të gjitha niveleve të sistemit të arsimit, si dhe ta vënë në dispozicion një edukim dhe trajnim të tillë edhe për juristët dhe anëtarët e parlamentit me qëllim që t'u mundësojnë atyre të ushtrojnë më të mirë përgjegjësitë e tyre publike;
- (j) Të promovojnë të drejtat e barabarta të grave për t'u bërë anëtarë të sindikatave dhe organizatave të tjera profesionale dhe shoqërore;
- (k) Të krijojnë mekanizma efektive për hetimin e shkeljeve të të drejtave njerëzore të grave të kryera nga cilido zyrtar publik dhe të marrin masat e nevojshme ligjore ndëshkimore në përputhje me ligjet kombëtare;

- (l) Të rishikojnë dhe amendamentojnë ligjet dhe procedurat kriminale, sipas nevojës, për të zhdukur çdo diskriminim kundër grave me qëllim që të sigurojnë se ligji dhe procedurat kriminale u garantojnë grave mbrojtje efektive kundër krimeve drejtuar atyre ose që në masë jo-proporcionale prekin gratë dhe persekutimit të tyre, pavarësisht prej marrëdhënieve kryesit të veprës kriminale dhe viktimës, si dhe për të siguruar që gratë e akuzuara, viktima dhe/ose dëshmitare nuk janë riviktimizuar ose diskriminuar gjatë hetimit dhe persekutimit të krimeve;
- (m) Të sigurojnë që gratë kanë të njëjtat të drejta me burrat për të qenë gjykatëse, avokate ose zyrtare të tjera të gjykatave, si dhe, midis tjerash, police dhe zyrtare burgu dhe paraburgimi;
- (n) Të fuqizojnë mekanizmat ekzistues ose të krijojnë mekanizmat e ri alternativë administrativë që do të jenë në dispozicion dhe pa pagesë ose të volitshme si dhe programe të ndihmës ligjore për të asistuar gratë e disfavorizuara që kërkojnë dëmshpërblim për shkeljet e të drejtave të tyre;
- (o) Të sigurojnë që të gjitha organizatat e grave dhe ato joqeveritare dhe anëtarët e tyre që punojnë në fushën e mbrojtjes dhe promovimit të të gjitha të drejtave të njeriut – civile, kulturore, ekonomike, politike dhe sociale, përfshirë të drejtën për zhvillim – të gëzojnë plotësisht të gjitha të drejtat dhe liritë e njeriut në përputhje me Deklaratën Universale për të Drejtat e Njeriut dhe të gjitha instrumentet tjera të të drejtave të njeriut dhe mbrojtjen e ligjeve kombëtare;
- (p) Të fuqizojnë dhe të inkurajojnë zbatimin e rekomandimeve që janë pjesë e Rregullave Standarde mbi Barazimin e Mundësive për Personat me Paaftësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë për të siguruar mosdiskriminimin dhe gëzimin e barabartë të të gjitha të drejtave të njeriut dhe lirive themelore nga gratë e vajzat me paaftësi, përfshirë qasjen e tyre në informata dhe shërbime në fushën e dhunës kundër grave, po ashtu edhe pjesëmarrjen e tyre aktive dhe kontributin ekonomik në të gjitha aspektet e shoqërisë;
- (q) Të inkurajojnë zhvillimin e programeve të ndjeshme gjinore për të drejtat e njeriut.

Objektivi strategjik I.3.

Të arrihen edukimi ligjor

Aksionet që duhen ndërmarra

233. Nga Qeveritë dhe organizatat joqeveritare, Kombet e Bashkuara dhe organizatat e tjera ndërkombëtare, sipas nevojës:

- (a) Të përkthejnë, kudo që është e mundur, në gjuhët lokale e indigjene dhe në formate alternative të përshtatshme për persona me paaftësi dhe persona me nivel të ulët arsimimi, të botojnë dhe shpërndajnë ligje dhe informata në lidhje me statusin e barabartë dhe të drejtat njerëzore të grave, përfshirë Deklaratën Universale për të Drejtat e Njeriut, Marrëveshjen Ndërkombëtare mbi të Drejtat Civile dhe Politike, Marrëveshjen Ndërkombëtare mbi të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore, Konventën për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit kundër Grave, Konventën Ndërkombëtare për Eliminimin e të Gjitha Formave Diskriminimit Racor,³³ Konventën për të Drejtat e Fëmijës, Konventën kundër Torturës dhe Trajtimit apo Ndëshkimit Tjetër Mizor, Jonjerëzor apo Degradues, Deklarata mbi të Drejtat për Zhvillim³⁴ dhe Deklarata mbi Eliminimin e Dhunës Kundër Grave, po ashtu edhe rezultatet e konferencave dhe samiteve relevante të Kombeve të Bashkuara dhe raportet kombëtare të Komitetit për Eliminimin e Diskriminimit kundër Grave;
- (b) Të botojnë dhe të shpërndajnë informatat e tilla në formate lehtë të kuptueshme dhe formate alternative të përshtatshme për personat me paaftësi dhe personat me nivel të ulët arsimor;
- (c) Të shpërndajnë informatat mbi legjislacionin kombëtar dhe ndikimin e tij në gratë, duke përfshirë udhëzimet tek të cilat ka qasje të lehtë lidhur me shpjegimet se si mund të shfrytëzohet një sistem juridik për të ushtruar të drejtat e personit;
- (d) Të përfshijnë informatat rreth instrumenteve dhe standardeve ndërkombëtare e rajonale në informatat e tyre publik, si dhe në veprimtaritë e tyre për edukimin me të drejtat e njeriut dhe arsimin për të rritur dhe programe trajnimi, sidomos për grupe të tilla si ushtarakët, policia dhe personeli tjetër për zbatimin e ligjit, gjyqësia, profesionistët ligjorë dhe shëndetësorë, për të siguruar që të drejtat e njeriut mbrohen në mënyrë efektive;
- (e) Të vënë në dispozicion të gjerë dhe të botojnë plotësisht informatat mbi ekzistencën e mekanizmave kombëtarë, rajonalë dhe ndërkombëtarë që ofrojnë ndihmë kur shkelen të drejtat njerëzore të grave;

³³ Rezoluta e Asamblesë së Përgjithshme 2106 A (XX), aneks.

³⁴ Rezoluta e Asamblesë së Përgjithshme 41/128, aneks.

- (f) Të inkurajojnë, koordinojnë dhe bashkëpunojnë me grupet lokale dhe rajonale të grave, organizatat relevante joqeveritare, edukatorët dhe mediat, në zbatimin e programeve në edukimin për të drejtat e njeriut për t'i vetëdijesuar gratë për të drejtat e tyre të njeriut;
- (g) Të promovojnë edukimin për të drejtat e njeriut dhe të drejtat ligjore të grave në programin shkollor në të gjitha nivelet e arsimit dhe të ndërmarrin fushata publike, duke përfshirë në gjuhët të vendit që përdoren më gjerësisht, mbi barazinë e grave dhe burrave në jetën publike dhe private, përfshirë të drejtat e tyre brenda familjes, si dhe instrumentet relevante për të drejtat e njeriut nën ligjin kombëtar dhe ndërkombëtar;
- (h) Të promovojnë edukimin në të gjitha vendet për të drejtat e njeriut dhe të drejtën ndërkombëtare humanitare për anëtarët e sigurisë kombëtare dhe të forcave të armatosura, duke përfshirë ata që janë caktuar në operacionet paqeruajtëse të Kombeve të Bashkuara, në bazë rutinore dhe të vazhdueshme, duke i rikujtuar dhe duke i ndërgjegjësuar ata për faktin se ata duhet të respektojnë të drejtat e grave në të gjitha kohët, si në detyrë ashtu edhe jashtë detyrës, duke i përkushtuar vëmendje të veçantë rregullave për mbrojtjen e grave dhe fëmijëve, dhe mbrojtjes së të drejtave të njeriut në situatat e konfliktit të armatosur;
- (i) Të marrin masa të nevojshme për të siguruar që gratë refugjate dhe ato të zhvendosura, gratë emigrante dhe gratë punëtore emigrante, të vetëdijesohen për të drejtat e tyre të njeriut dhe për mekanizmat për ndihmë juridike në dispozicionin e tyre.

J. GRATË DHE MEDIAT

234. Gjatë dhjetëvjeçarit të shkuar, përparimet në teknologji kanë ndihmuar rrjetin global të komunikimit që tejkalon kufijtë kombëtarë dhe ka një ndikim në politikat publike, qëndrimet dhe sjelljen private, veçanërisht te fëmijët dhe të rinjtë. Kudo ekziston mundësia për mediat që të japin një kontribut shumë më të madh për përparimin e grave.

235. Më shumë gra janë përfshirë në karrierë në sektorin e komunikimit, por fare pak kanë arritur pozita në nivel vendimmarrjeje ose të shërbejnë në bordet dhe organet qeverisëse që ndikojnë politikat e mediave. Mungesa e ndjeshmërisë gjinore në media del në pah nga pamundësia për të eliminuar stereotipizimin me bazë gjinore, që

mund të gjenden në organizatat e medias publike dhe private, lokale, kombëtare dhe ndërkombëtare.

236. Projektimi i vazhdueshëm i imazheve negative dhe degraduese të grave në komunikimet mediale – elektronike, të shkruar, vizuale dhe audio – duhet të ndryshohet. Media e shkruar dhe elektronike në shumicën e vendeve nuk siguron një pikturë të balancuar të jetës dhe kontributeve të ndryshme të grave në shoqëri në një botën në ndryshim. Çka më shumë, produktet mediale të dhunshme dhe degraduese apo pornografike gjithashtu ndikojnë negativisht në gratë dhe pjesëmarrjen e tyre në shoqëri. Programimi që përforcon rolet tradicionale të grave mund të jetë njëjtë kufizues. Prirja mbarëbotërore ndaj konsumerizmit ka krijuar një klimë në të cilën reklammat dhe mesazhet komerciale shpesh portretizojnë gratë para së gjithash si konsumatore dhe si cak i kanë vajzat dhe gratë e të gjitha moshave, pa dallim.

237. Gratë duhet të fuqizohen duke zgjeruar aftësitë e tyre, njohuritë dhe qasjen në teknologjitë informative. Kjo do të fuqizojë aftësinë e tyre për të luftuar portretizimet negative të grave ndërkombëtarisht dhe të sfidojnë instancat e keqtrajtimit të fuqisë së një industrie gjithnjë e më të rëndësishme. Mekanizmat vetërregulluese për mediat duhet të krijohen e fuqizohen dhe të zhvillohen qasje për të eliminuar programimin me paragjykime gjinore. Shumica e grave, veçanërisht në vendet në zhvillim, nuk kanë mundësi të kenë qasje efektive në magjistralen gjithnjë e më të madhe të informatave elektronike dhe prandaj nuk mund të krijojnë rrjete që i sigurojnë ato me burime alternative të informatave. Prandaj gratë kanë nevojë të përfshihen në vendimmarrje lidhur me zhvillimin e teknologjive të reja që të mund të marrin pjesë plotësisht në rritjen dhe ndikimin e tyre.

238. Në adresimin e çështjes së mobilizimit të mediave, Qeveritë dhe aktorët e tjerë duhet të promovojnë një politikë aktive dhe të dukshme të integritimit të perspektivës gjinore në politikat dhe programet.

Objektivi strategjikt J.1.

Të rritet pjesëmarrja dhe qasja e grave ndaj shprehjes dhe vendimmarrjes në media dhe përmes mediave dhe në teknologjitë e reja të komunikimit.

Aksionet që duhen ndërmarrë

239. Nga Qeveritë:

- (a) Të mbështetin arsimimin, trajnimin dhe punësimin e grave për të promovuar dhe siguruar qasje të barabartë në të gjitha fushat dhe nivelet e mediave;

- (b) Të mbështetin kërkimet në të gjitha aspektet e grave dhe mediave në mënyrë që të definojnë fushat që kërkojnë vëmendje dhe veprim, si dhe të rishikojnë politikat ekzistuese për mediat me qëllim të integritetit të perspektivës gjinore;
- (c) Të promovojnë pjesëmarrjen e plotë dhe të barabartë të grave në media, duke përfshirë menaxhimin, programimin, arsimimin, trajnimin dhe kërkimin;
- (d) Të synojnë balancën gjinore në emërimin e grave dhe burrave në të gjitha organizmat këshilluese, menaxhuese, rregullatore apo monitoruese, përfshirë ato të cilat janë të lidhura me mediat private dhe Shtetërore ose mediat publike;
- (e) Deri në përmasat të cilat janë në pajtim me lirinë e shprehjes, të inkurajojnë këto organe për të rritur numrin e programeve për gratë dhe nga gratë për të parë nëse nevojat dhe shqetësimet e grave janë të adresuara si duhet;
- (f) Të inkurajojnë dhe njohin rrjetet e mediave të grave, përfshirë rrjetet e mediave elektronike dhe teknologjitë e tjera të reja të komunikimit, si një mjet për përhapjen e informatave dhe shkëmbimit të pikëpamjeve, duke përfshirë në nivel ndërkombëtar, dhe mbështetjen e grupeve të grave që janë aktive në arritjen e atij qëllimi në të gjithë punën e mediave dhe sistemet e komunikimit;
- (g) Të inkurajojnë dhe sigurojnë mjete ose nxitje për shfrytëzim kreativ të programeve në mediat kombëtare për shpërndarjen e informatave në forma të ndryshme kulturore të popujve indigjenë dhe zhvillimit e çështjeve sociale dhe arsimore lidhur me të përbrenda kornizave të ligjit kombëtar;
- (h) Të garantojnë lirinë e mediave dhe pastaj edhe mbrojtjen e tyre përbrenda kornizës së ligjit kombëtar dhe të inkurajojnë, në pajtim me lirinë e shprehjes, përfshirjen pozitive të mediave në çështjet shoqërore dhe të zhvillimit.

240. Nga sistemet kombëtare dhe ndërkombëtare të mediave:

Të zhvillojnë, në përputhje me lirinë e shprehjes, mekanizma rregullatorë, duke përfshirë ato vullnetare, të cilat promovojnë portretizime të balancuara dhe të larmishme të grave nga mediat dhe nga sistemet ndërkombëtare të komunikimit dhe që promovojnë pjesëmarrjen e rritur të grave dhe burrave në produksion dhe vendimmarrje.

241. Nga Qeveritë, sipas nevojës, ose makinerisë kombëtare për përparimin e grave:

- (a) Të inkurajojnë zhvillimin e programeve të edukimit dhe të trajnimit për gratë me qëllim të prodhimit të informatave për masmediat, duke përfshirë financimin e përpjekjeve eksperimentale, dhe përdorimin e teknologjive të reja të komunikimit, hapësirës kibernetike dhe satelitore, qoftë publike apo private;
- (b) Të inkurajojnë përdorimin e sistemeve të komunikimit, duke përfshirë teknologjitë e reja, si mjete për fuqizimin e pjesëmarrjes së grave në proceset demokratike;
- (c) Të ndihmojnë përpilimin e një liste të ekspertëve gra të mediave;
- (d) Të inkurajojnë pjesëmarrjen e grave në zhvillimin e udhëzuesve dhe kodeve profesionale të mirësjelljes ose mekanizmave të tjerë të përshtatshëm vetërregullues për promovimin e portretizimit të balancuar dhe jo stereotip të grave nga mediat.

242. Nga organizatat joqeveritare dhe shoqatat profesionale të mediave:

- (a) Të inkurajojnë themelimin e grupeve mediale të kontrollit të cilat mund monitorojnë mediat dhe të konsultohet me mediat për të siguruar që nevojat dhe brengat e grave janë pasqyruara në mënyrën e duhur;
- (b) Të trajnojnë gratë për të përdorur më tepër teknologjinë informative për komunikim dhe për media, përfshirë edhe në nivel ndërkombëtar;
- (c) Të krijojnë rrjete midis organizatave joqeveritare, organizatave të grave dhe organizatave profesionale të mediave, dhe të zhvillojnë programe informimi për to, me qëllim që të njohin nevojat specifike të grave në media, dhe të lehtësojnë pjesëmarrjen gjithnjë më të madhe të grave në komunikim, veçanërisht në nivel ndërkombëtar, në mbështetjen e dialogut Jug-Jug dhe Veri-Jug ndërmjet dhe midis këtyre organizatave, ndër të tjerat, për të promovuar të drejtat njerëzore të grave dhe barazinë midis burrave dhe grave;

- (d) Të inkurajojnë industrinë mediale dhe institucionet e edukimit dhe trajnimit të mediave që, në gjuhët e përshtatshme, për grupet tradicionale, indigjene dhe grupe të tjera etnike, të zhvillojnë forma të mediave, si janë tregimi, drama, poezia dhe kënga, të cilat pasqyrojnë kulturën e tyre, dhe që përdorin këto forma të komunikimit për të shpërndarë informatat për çështjet shoqërore dhe ato të zhvillimit.

Objektivi Strategjik J.2.

Të promovojnë portretizimin e balancuar dhe jostereotipik të grave në media

Aksionet që duhen ndërmarrë

243. Nga Qeveritë dhe organizatat ndërkombëtare, deri në atë masë që është në përputhje me lirinë e shprehjes:

- (a) Të promovojnë hulumtimin dhe zbatimin e strategjisë së informimit, edukimit dhe të komunikimit, që synon nxitjen e portretizimit të balancuar të grave e vajzave dhe rolet e tyre të shumëfishta;
- (b) Të inkurajojnë mediat dhe agjencitë e reklamave për të zhvilluar programe specifike për të rritur ndërgjegjësimin për Platformën për Veprim;
- (c) Të inkurajojnë trajnim të ndjeshëm nga këndvështrimi gjinor për profesionistët e mediave, përfshirë pronarët dhe menaxherët e mediave, për të inkurajuar krijimin dhe përdorimin e imazheve jostereotipike, të balancuara dhe të larmishme të grave në media;
- (d) Të inkurajojnë mediat që të përmbahen nga paraqitja e grave si qenie inferiore dhe shfrytëzimi i tyre si objekte dhe mallra seksi, por më tepër të prezantohen si qenie njerëzore kreative, si aktore dhe kontribuuese kyçe të procesit të zhvillimit dhe si përfituese të atij procesi;
- (e) Të promovojnë konceptin se stereotipet seksiste të shfaqura në media kanë diskriminime gjinore, dhe të natyrës degraduese e të pahijshme;
- (f) Të marrin masa efektive ose të fillojnë masa të tilla, përfshirë legjislacionin e duhur kundër pornografisë dhe projeksionit të dhunës kundër grave dhe fëmijëve në media.

244. Nga organizatat e masmediave dhe organizatave të reklamimit:

- (a) Të zhvillojnë, në përputhje me lirinë e shprehjes, udhëzues dhe kode profesionale të mirësjelljes dhe forma të tjera të vetërregullimit për të promovuar prezantimin e imazheve jostereotipe të grave;
- (b) Të krijojnë, në përputhje me lirinë e shprehjes, udhëzues dhe kode profesionale të mirësjelljes, që adresojnë materialet e dhunës, degradimit ose pornografisë lidhur me gratë në media, përfshirë reklamat;
- (c) Të zhvillojnë një perspektivë gjinore për të gjitha çështjet e shqetësimeve të komunitetit, të konsumatorëve dhe të shoqërisë civile;
- (d) Të rrisin pjesëmarrjen e grave në vendimmarrje në të gjitha nivelet në media.

245. Nga mediat, organizatat joqeveritare dhe sektori privat, në bashkëpunim, sipas nevojës, me makinerinë kombëtare për përparimin e grave:

- (a) Të promovojnë ndarjen e barabartë të përgjegjësive familjare përmes fushatave mediale, që theksojnë barazinë dhe rolet jostereotipe të grave dhe burrave brenda familjes dhe që shpërndajnë informatat që kanë si synim zhdukjen e keqtrajtimit bashkëshortor dhe të fëmijës, si dhe të gjitha format e dhunës kundër grave, përfshirë dhunën familjare;
- (b) Të prodhojnë dhe/ose përhapin materiale mediale për gratë udhëheqëse, midis tjerash si udhëheqëse që në pozitë të tyre udhëheqëse sjellin shumë përvoja të ndryshme jetësore, duke përfshirë, por duke mos u kufizuar në përvojat e tyre në balancimin e përgjegjësive të punës dhe familjes si nëna dhe si profesioniste, si menaxhere dhe si ndërmarrëse, për të ofruar modele shembullore, veçanërisht për gratë e reja;
- (c) Të promovojnë fushata të gjëra, të shfrytëzojnë programet edukuese private dhe publike, për të shpërndarë informatat rreth rritjes së ndërgjegjësimit lidhur me të drejtat njerëzore të grave;
- (d) Të mbështesin zhvillimin dhe financimin, sipas nevojës, të mediave alternative dhe shfrytëzimit të të gjitha mjeteve të komunikimit për përhapjen e informatave për gratë dhe interesat e tyre;

- (e) Të zhvillojnë qasje të ndryshme dhe të trajnojnë ekspertë për të zbatuar analizat gjinore në lidhje me programet e mediave.

K. GRATË DHE MJEDISI

246. Varfëria dhe degradimi mjedisor janë të ndërlidhura ngushtë. Përderisa varfëria rezulton me disa lloje të stresit mjedisor, një shkak madhor i përkeqësimit të vazhdueshëm të mjedisit global është modeli i paqëndrueshëm i konsumit dhe i prodhimit, veçanërisht në vendet e industrializuara, që është një çështje serioze për shqetësim dhe i cila rëndon më tutje varfërinë dhe pabarazitë. Rritja e nivelit të detit si rezultat i ngrohjes globale shkakton një kërcënim serioz dhe të menjëhershëm për popujt që jetojnë në shtetet ishuj dhe në zonat bregdetare. Përdorimi i substancave që varfërojnë ozonin, të tilla si kloroflorkarbonet, halonet dhe bromidet metile (nga të cilat bëhen shkumat dhe plastika), janë duke e prekur gjerësisht atmosferën, duke lejuar kështu që nivele tepër të larta të rrezeve të dëmshme ultraviolete të arrijnë në sipërfaqen e tokës dhe të kenë efekte serioze në shëndetin e njerëzve, si janë shkalla e lartë e kancerit të lëkurës, dëmtimet të syve dhe dobësimi i sistemeve të imunitetit. Ato gjithashtu kanë efekte të rënda mbi mjedisin, përfshirë dëme në prodhimet bujqësore dhe në jetën në oqeanë.

247. Të gjitha Shtetet dhe të gjithë popujt do të bashkëpunojnë për detyrën thelbësore të çrrënjësjes së varfërisë si një domosdoshmëri për zhvillim të qëndrueshëm, me qëllim të uljes së e pabarazive në standardet e jetesës dhe për të përmbushur më mirë nevojat e shumicës së popullsisë së botës. Uraganet, tajfunet dhe katastrofat tjera natyrore, si dhe shkatërrimi i resurseve, dhuna, zhvendosjet dhe efektet tjera që kanë të bëjnë me luftën, konfliktet e armatosura dhe konfliktet tjera, përdorimi dhe testimi i armëve bërthamore, dhe pushtimi i huaj, gjithashtu mund të kontribuojë në degradimin mjedisor. Përkeqësimi i resurseve natyrore zhvendos komunitetet, sidomos gratë, nga veprimtaritë prodhuese duke shtuar ashtu më tutje në punën e papaguar. Si në zonat urbane ashtu edhe në ato rurale, degradimi mjedisor rezulton me efekte negative në shëndet, mirëqenie dhe cilësinë e jetës së popullsisë në përgjithësi, e veçanërisht të grave e vajzave të të gjitha moshave. Vëmendje dhe njohje e posaçme duhet t'u jepet rolit dhe situatës së veçantë të grave që jetojnë në zonat rurale dhe atyre që punojnë në sektorin bujqësor, ku qasja në trajnime, tokë, resurse natyrore dhe prodhuese, kredi, programe të zhvillimit dhe struktura kooperative, mund t'u ndihmojnë që të rritin pjesëmarrjen e tyre në zhvillimin e qëndrueshëm. Rreziqet mjedisore në shtëpi dhe në vendin e punës mund të kenë një ndikim të shpërpjesëtuar mbi shëndetin e grave për shkak të ndjeshmërive të ndryshme të tyre ndaj efekteve toksike të kemikateve të ndryshme. Këto rreziqe për shëndetin e grave, janë veçanërisht të larta në zonat

urbane, si dhe në zonat me të ardhura të ulëta ku ka një përqendrim të lartë të objekteve të ndotësve industrial.

248. Përmes menaxhimit dhe shfrytëzimit përdorimit të burimeve natyrore, gratë mund të sigurojnë jetesën për familjet dhe komunitetet e veta. Si konsumatore dhe prodhuese, kujdestare të familjeve të tyre dhe edukatore, gratë luajnë një rol të rëndësishëm në promovimin e zhvillimit të qëndrueshëm përmes brengës që tregojnë për cilësinë dhe qëndrueshmërinë e jetës për brezat e sotëm dhe brezat e ardhshëm. Qeveritë kanë shprehur zotimin e tyre për krijimin e një paradigme të re zhvillimore e cila integron qëndrueshmërinë mjedisore me barazinë dhe drejtësinë gjinore brenda dhe midis brazave si përshkruhet në kapitullin 24 të Agjendës 21.

249. Gratë, në një masë të madhe mungojnë në të gjitha nivelet e formulimit të politikave dhe vendimmarrjes në menaxhimin e resurseve natyrore dhe menaxhimin, ruajtjen, mbrojtjen dhe rehabilitimin mjedisor dhe përvoja dhe aftësitë e tyre në avokimin dhe monitorimin e menaxhimit të përshtatshëm të burimeve natyrore; tepër shpesh mbeten të marginalizuara në nivelin menaxhial të organizmave politikëbërës dhe vendimmarrës, si dhe në institucionet arsimore dhe agjencitë mjedisore. Gratë rrallë janë trajnuar si menaxhere profesioniste të resurseve natyrore me kapacitete politikëbërjeje, të tilla si planifikim të shfrytëzimit të tokës, agrikulturaliste, eksperte të pyjeve, shkencëtare të detit dhe juriste mjedisore. Madje edhe në rastet kur gratë janë trajnuar si menaxhere profesioniste të resurseve natyrore, shpesh janë të nën-përfaqësuara në institucionet formale me kapacitetet politikëbërëse në nivele kombëtare, rajonale dhe ndërkombëtare. Shpesh gratë nuk janë pjesëmarrëse të barabarta në menaxhimin e institucioneve financiare dhe menaxhimin e korporatave, vendimmarrja e të cilëve ndikon në masë të madhe në cilësinë mjedisore. Për më tepër, ka dobësi institucionale në koordinimin midis organizatave joqeveritare të grave dhe institucioneve kombëtare që merren me çështjet e mjedisit, pavarësisht nga rritja e shpejtë dhe dukshmëria e organizatave joqeveritare të grave kohëve të fundit në këto çështje në të gjitha nivelet.

250. Gratë kanë luajtur shpesh rol udhëheqës ose kanë qenë prijëse në promovimin e një etike mjedisore, zvogëlimin e shfrytëzimit të resurseve, si dhe ripërdorimin dhe riciklimin e resurseve për të minimizuar konsumin e tepërt dhe të kotë. Gratë mund të kenë një rol veçanërisht të fuqishëm për të ndikuar në vendimet për konsumin e qëndrueshëm. Çka më shumë, kontributet e grave në menaxhimin mjedisor, përfshirë përmes fushatave themelore dhe fushatave të rinisë për mbrojtjen e mjedisit, kanë ndodhur shpesh në nivel lokal, ku veprimi i decentralizuar për çështjet e mjedisit është më i nevojshëm dhe vendimtar. Gratë, sidomos gratë indigjene, kanë njohuri të posaçme të lidhjeve ekologjike dhe të menaxhimit të

ekosistemit të brishtë. Gratë në shumë komunitete ofrojnë forcën kryesore punuese për prodhimin themelor për jetesë, përfshirë prodhimin e ushqimeve të detit; që këtë rol i tyre është qenësor për furnizimin me ushqim dhe ushqyerje, në zgjerimin e mjeteve të jetesës dhe të sektorëve joformalë dhe në ruajtjen e mjedisit. Në disa rajone gratë janë përgjithësisht anëtarët më të qëndrueshme të komunitetit, pasi që burrat ndjekin punën në vende të largëta, duke lënë gratë të mbrojnë mjedisin natyror dhe të sigurojnë shpërndarjen adekuate dhe të qëndrueshme të resurseve përbrenda ekonomisë shtëpiake dhe komunitetit.

251. Aksionet strategjike të nevojshme për menaxhimin e shëndoshë mjedisor kërkojnë një qasje gjithëpërfshirëse, multidisiplinare dhe ndërsektoriale. Pjesëmarrja dhe udhëheqja e grave janë thelbësore për çdo aspekt të kësaj qasjeje. Konferencat e fundit të Kombeve të Bashkuara për zhvillimin, po ashtu edhe konferencat rajonale përgatitore për Konferencën e Katërt Botërore për Gratë, kanë bërë të njohur se politikat e zhvillimit të qëndrueshëm të cilat nuk përfshijnë gratë dhe burrat njëlloj, nuk do të kenë sukses në afat të gjatë. Ato kanë bërë thirrje për pjesëmarrje efektive të grave në prodhimin e njohurive dhe edukimin mjedisor në vendimmarrje dhe menaxhim në të gjitha nivelet. Prandaj, përvojat dhe kontributet e grave për një mjedis të shëndoshë ekologjikisht duhet të jenë qendrore në agjendën për shekullin e njëzet e një. Zhvillimi i qëndrueshëm do të jetë një objektivi i pakapshëm nëse nuk njihet dhe nuk mbështetet kontributi i grave në menaxhimin mjedisor.

252. Për adresimin e mungesës së njohjes të mbështetjes adekuate të kontributit të grave në ruajtjen dhe menaxhimin e resurseve natyrore dhe mbrojtjen e mjedisit, Qeveritë dhe aktorët e tjerë duhet të promovojnë një politikë aktive dhe të dukshme të integritit të perspektivës gjinore në të gjitha politikat dhe programet, duke përfshirë, sipas nevojës, një analizë të efekteve mbi gratë dhe burrat, përkatësisht, para se të merren vendimet.

Objektivi strategjik K.1.

Përfshirja aktive e grave në vendimmarrjen mjedisore në të gjitha nivelet

Aksionet që duhen ndërmarrë

253. Nga Qeveritë, në të gjitha nivelet, përfshirë autoritetet komunale, sipas nevojës:

- (a) Të sigurojnë mundësitë për gratë, përfshirë gratë indigjene, që të marrin pjesë në vendimmarrjen mjedisore në të gjitha nivelet, përfshirë si menaxhere, projektuese e planifikuese, dhe si zbatuese e vlerësuese të projekteve mjedisore;
- (b) Të ndihmojnë dhe rrisin qasjen e grave në informim e edukim, përfshirë në fushat e shkencës, teknologjisë dhe ekonomisë, duke zgjeruar kështu njohuritë, aftësitë dhe mundësitë e tyre për pjesëmarrje në vendimet mjedisore;
- (c) Bazuar në legjislacionin kombëtar dhe në përputhje me Konventën për Diversitetin Biologjik³⁵ të inkurajojnë mbrojtjen efektive dhe përdorimin e njohurive, novacioneve dhe praktikave të grave të komuniteteve indigjene dhe vendore, përfshirë praktikën që lidhen me traditën mjekësore, biodiversitetin dhe teknologjitë indigjene, dhe të përpjekjen që të sigurojnë që ato do të respektohen, mirëmbahen, promovohen dhe ruhen në një mënyrë të qëndrueshme ekologjike dhe për të promovuar aplikimin më të gjerë të tyre me miratimin dhe përfshirjen e bartësve të njohurive të tilla. Përveç kësaj, të ruhet e drejta ekzistuese e pronës intelektuale e këtyre grave, siç mbrohet sipas ligjit kombëtar dhe ndërkombëtar. Të punojnë aktivisht, ku është e nevojshme, për të gjetur mënyra dhe mjete të tjera për mbrojtjen efektive dhe përdorimin e këtyre njohurive, novacioneve dhe praktikave, varësisht nga legjislacioni kombëtar dhe në pajtim me Konventën për Diversitetin Biologjik dhe të drejtën ndërkombëtare relevante, të inkurajojnë ndarjen e drejtë dhe të barabartë të përfitimeve që dalin nga shfrytëzimi i këtyre njohurive, novacioneve e praktikave;
- (d) Të marrin masa të duhura për të ulur rreziqet për gratë nga rreziqet e identifikuar mjedisore në shtëpi, në punë dhe në mjedise të tjera, përfshirë zbatimin e duhur të teknologjive të pastra, duke marrë parasysh qasjen parandaluese të rënë dakord në Deklaratën e Rios për Mjedisin dhe Zhvillimin;
- (e) Të marrin masa për të integruar një perspektivë gjinore në projektimin dhe zbatimin, midis tjerash, të mekanizmave të menaxhimit të resurseve, teknikave të prodhimit dhe zhvillimit të infrastrukturës në zonat rurale dhe urbane, që janë të shëndosha dhe të qëndrueshme;
- (f) Të marrin masa për të fuqizuar gratë si prodhuese dhe konsumatore në mënyrë që të ndër marrin veprime efektive

³⁵ Programi i Mjedisit i Kombeve të Bashkuara, Konventa mbi Diversitetin Biologjik (Ligji Mjedisor dhe Qendra e Institucioneve për Programim Aktivitetesh),

mjedisore, bashkë me burrat, në shtëpitë e tyre, në komunitete dhe në vendin e punës;

- (g) Të promovojnë pjesëmarrjen e komuniteteve vendore, veçanërisht grave, në identifikimin e nevojave të shërbimeve publike, planifikimit hapësinor, si dhe ofrimi dhe projektimi i infrastrukturës urbane.

254. Nga Qeveritë dhe organizatat ndërkombëtare dhe institucionet e sektorit privat, sipas nevojës:

- (a) Të marrin parasysh ndikimi gjinor në punën e Komisionit për Zhvillim të Qëndrueshëm dhe organet e tjera përkatëse të Kombeve të Bashkuara dhe në veprimtaritë e institucioneve financiare ndërkombëtare;
- (b) Të promovojnë përfshirjen e grave dhe përfshirjen e perspektivës gjinore në hartimin, miratimin dhe ekzekutimin e projekteve të financuara nga Projekti i Mjedisit Global (GEF – Global Environment Facility) dhe organizatat tjera përkatëse të Kombeve të Bashkuara;
- (c) Të inkurajojnë hartimin e projekteve në zonat e interesit për Projektin e Mjedisit Global që të mund të përfitojnë gratë dhe projektet e menaxhuara nga gratë;
- (d) Të krijojnë strategjitë dhe mekanizmat për të rritur përqindjen e grave, veçanërisht në nivelet bazike, të përfshira si vendimmarrëse, planifikuese, menaxhere, shkencëtare dhe këshilltare teknike dhe si përfituese në hartimin, zhvillimin dhe zbatimin e politikave dhe programeve për menaxhimin e resurseve natyrore dhe mbrojtjen e ruajtjen mjedisore;
- (e) Të inkurajojnë institucionet shoqërore, ekonomike, politike dhe shkencore për të adresuar degradimin mjedisor dhe ndikimin që ka si pasojë mbi gratë.

255. Nga organizatat joqeveritare dhe sektori privat:

- (a) Të fillojnë me avokimin e çështjeve të menaxhimit të resurseve natyrore dhe mjedisore lidhur me gratë dhe të sigurojnë informata për të kontribuar drejt mobilizimit të resurseve për mbrojtjen dhe ruajtjen mjedisore;
- (b) Të ndihmojnë qasjen e grave që merren me bujqësi, peshkatori dhe blegtori në njohuri, aftësi, shërbime të

marketingut dhe teknologji të shëndosha mjedisore për të mbështetur dhe fuqizuar rolet e tyre qenësore dhe ekspertizën e tyre në menaxhimin e resurseve dhe ruajtjen e diversitetit biologjik.

Objektivi strategjik K.2.

Të integrohen shqetësimet dhe perspektivat gjinore në politikat dhe programet për zhvillim të qëndrueshëm

Aksionet që duhen ndërmarrë

256. Nga Qeveritë:

- (a) Të integrojnë gratë, përfshirë gratë indigjene, perspektivat dhe njohuritë e tyre, në bazë të barabartë me burrat, në vendimmarrje lidhur me menaxhimin e qëndrueshëm të resurseve dhe zhvillimin e politikave dhe programeve për zhvillim të qëndrueshëm, përfshirë në veçanti ato të hartuara për të adresuar dhe për të parandaluar degradimin mjedisor të tokës;
- (b) Të vlerësojnë politikat dhe programet në relacion me termat e ndikimit mjedisor dhe qasjes së barabartë të grave për përdorimin e resurseve natyrore;
- (c) Të sigurojnë një hulumtim adekuat për të vlerësuar se si dhe në çfarë përmasa gratë janë veçanërisht të ndjeshme ose të ekspozuara ndaj degradimit mjedisor dhe rreziqeve mjedisore, duke përfshirë, sipas nevojës, kërkimet dhe mbledhjen e të dhënave për grupe specifike të grave, sidomos grave me të ardhura të ulëta, grave indigjene dhe grave që u përkasin pakicave;
- (d) Të integrojnë njohuritë dhe praktikat tradicionale të grave rurale në përdorimin dhe menaxhimin e resurseve të qëndrueshme në zhvillimin e menaxhimit mjedisor dhe programeve plotësuese;
- (e) Të integrojnë rezultatet e kërkimeve të ndjeshme gjinore në integrimin e politikave me qëllim të zhvillimit të vendbanimeve njerëzore të qëndrueshme;
- (f) Të promovojnë njohuritë dhe të sponsorizohen kërkimet mbi rolin e grave, veçanërisht grave rurale dhe indigjene, në mbledhjen dhe prodhimin e ushqimit, konservimin e tokës, ujitjen, menaxhimin e drenazheve, kanalizimet, menaxhimin e zonës bregdetare dhe resurseve detare, menaxhimin e integruar të dëmtimit nga insektet, planifikimin e

shfrytëzimit të tokës, konservimin e pyllit dhe pylltaria e komunitetit, peshkatarinë, parandalimin e katastrofave natyrore, dhe resurset e reja dhe të energjisë së ripërtërishme, duke u fokusuar në veçanti në njohuritë dhe përvojën e grave indigjene;

- (g) Të zhvillojnë një strategji për ndryshim për të zhdukur të gjitha pengesat për pjesëmarrjen e plotë dhe të barabartë të grave në zhvillimin e qëndrueshëm dhe qasjen e barabartë dhe kontrollin ndaj resurseve;
- (h) Të promovojnë arsimimin e vajzave dhe grave të të gjitha moshave në shkencë, teknologji, ekonomi dhe disiplina të tjera që kanë të bëjnë me mjedisin natyror në mënyrë që ato të mund të bëjnë zgjedhje të informuar dhe të ofrojnë kontributin e informuar në përcaktimin e prioriteteve lokale ekonomike, mjedisore dhe shkencore për menaxhimin dhe shfrytëzimin e duhur të resurseve dhe ekosistemeve natyrore dhe lokale;
- (i) Të zhvillojnë programe për të përfshirë femrat profesioniste dhe shkencëtare, si dhe punonjëset teknike, administrative dhe sekretariale, në menaxhimin e mjedisit, për të zhvilluar programe trajnimi për gra dhe vajza në këto fusha, të zgjerojnë mundësitë për punësimin dhe promovimin e grave në këto fusha, si dhe zbatimin e masave speciale për të avancuar ekspertizën dhe pjesëmarrjen e grave në këto veprimtari;
- (j) Të identifikojnë dhe promovojnë teknologjitë e shëndosha ambientale që janë projektuar, zhvilluar dhe përmirësuar në konsultim me gratë dhe që janë të përshtatshme si për gratë ashtu edhe për burrat;
- (k) Të mbështesin zhvillimin e qasjes së barabartë të grave në infrastrukturën e banimit, ujin e sigurtë, teknologjitë energjie të qëndrueshme dhe të volitshme, të tilla si era, energjia solare, biomasa dhe burimet tjera të ripërtërishme, përmes vlerësimit të nevojave përmes pjesëmarrjes, planifikimit të energjisë dhe formulimit të politikave në nivele lokale dhe kombëtare;
- (l) Të sigurojnë që do të ketë ujë të pastër dhe të gjithë të kenë qasje në ujë të pastër deri në vitin 2000 dhe që planet për mbrojtjen dhe ruajtjen mjedisore janë hartuar dhe zbatuar për të përtërirë sistemet e ndotura të ujit dhe rindërtuar kanalet e shkatërruara ujitëse.

257. Nga organizatat ndërkombëtare, organizatat joqeveritare dhe institucionet e sektorit privat:

- (a) Të përfshijnë gratë në industrinë e komunikimit për ngritjen e vetëdijes lidhur me çështjet mjedisore, veçanërisht për ndikimin shëndetësor dhe mjedisor të prodhimeve, teknologjive dhe proceseve të industrisë;
- (b) Të inkurajojnë konsumatorët për të përdorur fuqinë e tyre blerëse për të promovuar prodhimin e produkteve të sigurta ambientalisht dhe të inkurajojnë investime në veprimtari dhe teknologji ambientalisht të shëndosha, si dhe teknologji dhe aktivitete produktive bujqësore, të peshkatarisë, komerciale dhe industriale;
- (c) Të mbështesin nismat e grave konsumatore për promovimin dhe marketingun e ushqimeve organike dhe objekteve për riciklim, informatat për prodhimet dhe prodhime të etiketuara, duke përfshirë etiketimin e kemikateve toksike dhe mbajtësve të pesticideve, me fjalë dhe simbole të kuptueshme për konsumatorin, pavarësisht nga mosha dhe niveli i arsimimit.

Objektivi Strategjik K.3.

Të fuqizohen ose të krijohen mekanizma në nivelet kombëtare, rajonale dhe ndërkombëtare për të vlerësuar ndikimin e zhvillimit dhe politikave mjedisore në gratë.

Aksionet që duhen ndërmarrë

258. Nga Qeveritë, organizatat rajonale dhe ndërkombëtare dhe organizatat joqeveritare, përkatësisht:

- (a) T'u ofrojnë asistencë teknike grave, veçanërisht në vendet në zhvillim, në sektorët e bujqësisë, peshkatarisë, ndërmarrjeve të vogla, tregtisë dhe industrisë për të siguruar promovimin e vazhdueshëm të zhvillimit të resurseve njerëzore dhe të zhvillimit të teknologjive të shëndosha ambientalisht dhe të ndërmarrësisë së grave;
- (b) Të zhvillojnë baza të dhënave të ndjeshme nga këndvështrimi gjinor, sisteme të informimit dhe të monitorimit dhe kërkime për veprim të orientuar pjesëmarrës, metodologji dhe analiza politikash, me bashkëpunimin e institucioneve akademike dhe grave lokale hulumtuese, lidhur me:

- i. Njohurinë dhe përvojën nga ana e grave lidhur me menaxhimin dhe konservimin e resurseve natyrore për përfshirjen në bazat e të dhënave dhe sistemet e informimit për zhvillimin e qëndrueshëm;
 - ii. Ndikimin që ka në gratë degjenerimi mjedisor dhe i resurseve natyrore, që rrjedhin, midis tjerash, edhe nga modelet e paqëndrueshme të prodhimit dhe konsumit, thatësitrat, uji i cilësisë së varfër, ngrohja globale, rritja e hapësirës së shkretëtirës, rritja e nivelit të detit, mbeturinat e rrezikshme, katastrofat natyrore, kemikatet toksike dhe mbeturinat pesticide, mbeturinat radioaktive, konfliktet e armatosura dhe pasojat e tyre;
 - iii. Analizën e lidhjeve strukturore midis marrëdhënieve gjinore, mjedisit dhe zhvillimit, me theks të veçantë në sektorë të posaçëm, si bujqësia, industria, peshkataria, pylltaria, shëndeti mjedisor, diversiteti biologjik, klima, resurset ujore dhe higjiena;
 - iv. Masat për të zhvilluar dhe përfshirë analiza mjedisore ekonomike, kulturore, shoqërore dhe me ndjeshmëri gjinore si një hap thelbësor në zhvillimin dhe monitorimin e programeve dhe politikave;
 - v. Programet për të krijuar qendra rurale dhe urbane trajnimi, kërkimi dhe qendra të resurseve, që do të përhapin teknologjitë e shëndosha ambientalisht për gratë;
- (c) Të sigurojnë pajtueshmërinë e plotë me detyrimet relevante ndërkombëtare, përfshirë ku është e nevojshme edhe, Konventën e Bazelit dhe konventat tjera në lidhje me lëvizjen ndërkufitare të mbeturinave të rrezikshme (që përfshijnë mbeturina toksike) dhe IAEA Kodi i Praktikës në lidhje me lëvizjen e mbeturinave radioaktive; të dekretohen dhe të hyjnë në fuqi rregulloret për menaxhimin e shëndoshtë mjedisor në lidhje me deponimin dhe lëvizjen e sigurtë; të marrin nën konsiderim veprimin drejt ndalimit të këtyre lëvizjeve që janë të pasigurta dhe të paruajtura, si dhe të sigurojnë kontrollin dhe menaxhimin e rreptë të mbeturinave të rrezikshme dhe radioaktive, në përputhje me detyrimet relevante ndërkombëtare e rajonale dhe të eliminojnë eksportimin e mbeturinave të tilla në vendet të cilat, individualisht ose përmes marrëveshjeve ndërkombëtare, e ndalojnë importimin e tyre;
- (d) Të promovojnë bashkëpunimin brenda dhe ndërmjet institucioneve për zbatimin e Platformës për Veprim, kapitullit 24 të Agjendës 21, ndër të tjera, duke i kërkuar

Komisionit për Zhvillim të Qëndrueshëm, përmes Këshillit Ekonomiko Social, të kërkojë kontribut nga Komisioni për Statusin e Grave kur të rishikojnë zbatimin e Agjendës 21 në lidhje me gratë dhe zhvillimin.

L. VAJZAT E MITURA

259. Konventa mbi të Drejtat e Fëmijës njeh se “Shtetet palë duhet të respektojnë dhe të garantojnë të drejtat e paraqitura në Konventën e tanishme për çdo fëmijë brenda juridiksionit të tyre pa diskriminim të ndonjë lloji, pa marrë parasysh racën, ngjyrën, gjininë, gjuhën, fenë, opinionin politik ose tjetër, origjinën kombëtare, etnike ose shoqërore, pronën, paaftësinë, statusin e lindjes së fëmijës ose prindit të tij/saj ose të mbikëqyrësit ligjor” (Neni 2, paragrafi 1) Megjithatë, në shumë vende, treguesit në dispozicion dëshmojnë se vajzat e mitura diskriminohen që në stadet e hershme të jetës, nëpër fëmijërinë e tyre dhe në moshën madhore. Në disa zona të botës, burrat janë më shumë në numër se sa gratë në proporcionin prej 5 në çdo 100. Arsye për këtë dallim përfshijnë ndërmjet të tjerash, qëndrimet dhe praktikatat e dëmshme, si janë gjymtimi gjenital femëror, preferenca për djem – që rezulton në vrasjen e foshnjave vajza, dhe përzgjedhja e gjinisë para lindjes – martesë e hershme, përfshi martesën e fëmijëve, dhuna kundër grave, shfrytëzimi seksual, keqtrajtimi seksual, diskriminimi kundër vajzave në shpërndarjen e ushqimit dhe praktika të tjera lidhur me shëndetin dhe mirëqenien. Si rezultat, më pak vajza se djem mbijetojnë të arrijnë moshën madhore.

260. Vajzat shpesh trajtohen si inferiore dhe mësohen nga shoqëria që te vënë veten të fundit, duke dëmtuar kështu vetëvlerësimin e tyre. Diskriminimi dhe neglizhenca në fëmijëri mund të nisin një spirale tatëpjete të privimit dhe të përjashtimit nga integrimi shoqëror. Duhet të ndërmerren nisma për të përgatitur vajzat që të marrin pjesë aktivisht, efektivisht dhe barabartë më djemtë në të gjitha nivelet e udhëheqjes shoqërore, ekonomike, politike dhe kulturore.

261. Proceset edukuese me paragjykime gjinore, përfshirë programet shkollore, materialet dhe praktikatat arsimore, qëndrimet e mësuesve dhe ndërveprimi në klasë, përforcojnë pabarazitë ekzistuese gjinore.

262. Vajzat dhe adoleshentët mund të marrin një larmi porosish konfliktuoze dhe hutuese lidhur me rolet e tyre gjinore nga prindërit e tyre, nga mësuesit, moshatarët dhe mediat. Gratë dhe burrat duhet të punojnë së bashku me fëmijët dhe të rinjtë për të thyer stereotipet e rrënjosura gjinore, duke marrë parasysh të drejtat e fëmijës dhe përgjegjësitë, të drejtat dhe detyrat e prindërve, siç përshkruhen në paragrafin 267.

263. Sadoqë numri i fëmijëve të arsimuar në disa vende është rritur në 20 vjetët e fundit, djemtë kanë ecur përpara shumë më tepër se vajzat. Në vitin 1990, 130 milion fëmijë nuk kishin qasje për shkollën fillore; prej tyre 81 milion ishin vajza. Kjo mund t'u atribuohet faktorëve të tillë si qëndrimeve zakonore, punës së fëmijëve, martesave të hershme, mungesës së fondeve dhe mungesës së objekteve adekuate të shkollimit, shtatzënisë në moshën adoleshente dhe pabarazive gjinore në shoqëri si tërësi si dhe në familje, siç përshkruhet në paragrafin 30. Në disa vende mungesa e mësuesve gra mund të ndalojë regjistrimin e vajzave në shkollë. Në shumë raste, vajzat fillojnë të kryejnë punët e rënda të shtëpisë në moshë shumë të hershme dhe pritet t'i menaxhojnë të dyja përgjegjësitë, ato arsimore dhe ato shtëpiake, gjë që shpesh rezulton me rezultat të dobët shkollor dhe braktisje të hershme të shkollës.

264. Përqindja e vajzave të regjistruara në shkollën e mesme mbetet dukshëm e ulët në shumë vende. Vajzat shpesh nuk inkurajohen ose nuk u jepet mundësia për të ndjekur trajnimin dhe arsimimin shkencor dhe teknik, gjë që kufizon njohuritë që ato kërkojnë për jetën e tyre të përditshme, si dhe mundësitë e punësimit të tyre.

265. Vajzat janë më pak të inkurajuara se djemtë të marrin pjesë dhe të mësojnë rreth funksionimit shoqëror, ekonomik dhe politik të shoqërisë, si rrjedhim nuk u ofrohen të njëjtat mundësi si djemve për të marrë pjesë në proceset vendimmarrëse.

266. Diskriminimi ekzistues kundër vajzave të mitura për qasjen e tyre ndaj ushqimit dhe shërbimeve shëndetësore fizike dhe mendore, rrezikon të sotmen dhe të ardhmen e tyre shëndetësore. Është vlerësuar se 450 milion grave të rritura në vendet në zhvillim iu është penguar rritja si rezultat i mungesës së proteinave energjike në ushqim në fëmijëri.

267. Konferenca Ndërkombëtare për Popullsinë dhe Zhvillimin, në paragrafin 7.3 të Programit për Veprim, njohu se “vëmendje e plotë duhet t'i jepet promovimit të marrëdhënieve gjinore të barabarta reciprokisht të respektueshme dhe veçanërisht në përmbushjen e nevojave për arsim dhe për shërbime të adoleshentëve për t'u mundësuar atyre të merren në një mënyrë të përgjegjshme dhe pozitive me seksualitetin e tyre”, duke marrë në konsiderim të drejtat e fëmijëve për qasje në informata, intimitetin, besueshmërisë, respekt dhe pëlqimit të informuar, po ashtu edhe përgjegjësitë, të drejtat dhe detyrat e prindërve dhe kujdestarëve ligjorë për të siguruar, në një mënyrë që është në pajtim me kapacitetet në zhvillim të fëmijës, drejtimin dhe kujdesin e duhur në ushtrimin nga fëmija të të drejtave të njohura në Konventën për të Drejtat e Fëmijës, dhe në përputhje me Konventën për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit kundër Grave. Në të gjitha veprimet në lidhje me fëmijët, interesi për të mirën e fëmijës do të jetë konsiderata primare. Mbështetje do t'i jepet edukimit integral seksual për të rinjtë me përkrahjen dhe

udhëzimin e prindërve, që thekson përgjegjësinë e meshkujve për seksualitetin dhe fertilitetin e tyre dhe që u ndihmon që të ushtrojnë përgjegjësitë e tyre.

268. Më shumë se 15 milion vajza të moshës 15 deri 19 vjeç lindin fëmijë çdo vit. Mëmësia në moshë tepër të hershme nënkupton ndërlikime gjatë shtatzënisë dhe lindjes dhe një rrezik për vdekjen e ëmës që është shumë më i lartë se zakonisht. Fëmijët e nënave të reja kanë nivel më të lartë të morbiditetit dhe vdekshmërisë. Lindja e fëmijëve në moshë të hershme vazhdon të jetë një pengesë në përmirësimin e statusit arsimor, ekonomik dhe shoqëror të grave në të gjitha pjesët e botës. Mbi të gjitha, martesat e hershme dhe mëmësia e hershme, mund të pengojnë tepër mundësitë për arsimim e punësim dhe kanë një ndikim negativ afatgjatë në cilësinë e jetës së tyre dhe të fëmijëve të tyre.

269. Dhuna seksuale dhe sëmundjet seksualisht të transmetueshme, përfshirë HIV/AIDS, kanë një efekt shkatërrues në shëndetin e fëmijëve, dhe vajzat janë më të cenueshme se djemtë ndaj pasojave të marrëdhënieve të pambrojtura dhe të parakohshme seksuale. Vajzat shpesh ballafaqohen me presione për të filluar me aktivitet seksual. Për shkak të faktorëve të tillë si mosha e tyre rinore, presionet shoqërore, mungesa e ligjeve mbrojtëse, ose dështimi në zbatimin e ligjit, vajzat janë më të cenueshme ndaj të gjitha llojeve të dhunës, veçanërisht dhunës seksuale, përfshirë përdhunimin, keqtrajtimin seksual, shfrytëzimin seksual, trafikimin, ndoshta edhe shitjen e organeve dhe të indeve të tyre, si dhe punës së detyruar.

270. Vajzat e mitura me paaftësi ballafaqohen me pengesa shtesë dhe duhet t'u sigurohet gëzimi i barabartë dhe jodiskriminues i të gjitha të drejtave të njeriut dhe lirive themelore në përputhje me Rregullat Standarde të Kombeve të Bashkuara për Barazimin e Mundësive për Personat me Paaftësi.

271. Disa fëmijë janë veçanërisht të cenueshëm, posaçërisht ata të cilët janë të braktisur, pa shtëpi dhe të zhvendosur, fëmijët e rrugës, fëmijët në zonat në konflikt, dhe fëmijët që diskriminohen për shkak se i përkasin një grupi minoritar etnik ose racor.

272. Për këtë arsye, të gjitha barrierat duhet të eliminohen për t'u mundësuar vajzave pa përjashtim që të zhvillojnë potencialin dhe aftësitë e tyre të plota përmes qasjes së barabartë në arsimim dhe trajnim, ushqim, kujdes shëndetësor fizik e mendor dhe informata të ndërlidhura.

273. Në adresimin e çështjeve që lidhen me fëmijët dhe të rinjtë, Qeveritë duhet të promovojnë një politikë aktive dhe të dukshme të integritit të perspektivës gjinore në të gjitha politikat dhe programet, në mënyrë që para se të merren vendimet, të bëhet një analizë për efektet e tyre mbi vajzat dhe djemtë përkatësisht.

Objektivi strategjik L.1.

Të eliminohen të gjitha format e diskriminimit kundër vajzave të mitura

Aksionet që duhen ndërmarrë

274. Nga Qeveritë:

- a) Shtetet që nuk kanë nënshkruar ose ratifikuar Konventën për të Drejtat e Fëmijës, duhet të marrin masa urgjente për nënshkrimin dhe ratifikimin e Konventës, duke mbajtur në mend thirrjen e fuqishme të bërë në Konferencën Botërore për Të Drejtat e Njeriut për ta nënshkruar atë para fundit të vitit 1995, dhe Shtetet që e kanë nënshkruar dhe ratifikuar Konventën, të sigurojnë zbatimin e plotë të saj përmes adoptimit të të gjitha masave të nevojshme legislative, administrative dhe masave tjera dhe krijimi i një mjedisi favorizues që inkurajon respektimin e plotë të të drejtave të fëmijëve;
- b) Në pajtim me nenin 7 të Konventës për të Drejtat e Fëmijës, të marrin masa për të garantuar se një fëmijë regjistrohet menjëherë pas lindjes dhe ka të drejta nga lindja për t'u emëruar, të drejtën të përfitojë një kombësi, dhe sa më shumë të jetë e mundur, të drejtën për t'i njohur prindërit dhe për të pasur kujdesin e prindërve të tij/saj;
- c) Të marrin masa për të garantuar që fëmijët do të pranojnë mbështetjen e duhur financiare nga prindërit e tyre, ndërmjet masave të tjera, përmes zbatimit të ligjeve për përkrahjen e fëmijëve;
- d) Të eliminojnë padrejtësitë dhe pengesat në lidhje me trashëgiminë me të cilat ballafaqohen vajzat e mitura, ashtu që të gjithë fëmijët të mund të gëzojnë të drejtat e tyre pa diskriminim, ndër të tjera, duke dekretuar, sipas nevojës, zbatuar legjislacionin që garanton të drejta të barabarta të ndarjes së trashëgimisë dhe të drejta të barabarta për të trashëguar, pavarësisht nga gjinia e fëmijës;
- e) Të dekretojnë dhe zbatojnë rreptësisht ligjet që sigurojnë se martesë është e vlefshme vetëm me pëlqimin e lirë dhe të plotë të bashkëshortëve që synojnë të martohen. Përveç kësaj, të dekretojnë dhe zbatojnë rreptësisht ligjet që lidhen me minimumin e moshës ligjore për të dhënë pëlqimin dhe minimumin e moshës për martesë dhe, ku është e nevojshme, të ngrihet mosha minimale e martesës;

- f) Të zhvillojnë dhe zbatojnë politika, plane të veprimit dhe programe gjithëpërfshirëse për mbijetesën, mbrojtjen, zhvillimin dhe përparimin e vajzave të mitura për të promovuar dhe mbrojtur gëzimin e plotë të të drejtave të saja të njeriut dhe të garantojnë mundësi të barabarta për vajzat; këto plane dhen të jenë pjesë përbërëse të gjithë procesit të plotë të zhvillimit;
- g) Të sigurojnë ndarjen sipas gjinisë dhe moshës të të gjitha të dhënave në lidhje me fëmijët në sektorin e shëndetit, arsimit dhe sektorëve të tjerë me qëllim që të përfshirjes së një perspektive gjinore në planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e programeve të tilla.

275. Nga Qeveritë dhe organizatat ndërkombëtare dhe joqeveritare:

- (a) Të ndajnë informatat dhe të dhënat për fëmijët sipas gjinisë dhe moshës, të ndër marrin hulumtime mbi gjendjen e vajzave dhe të integrojnë, ku është e mundur, këto rezultate në formulimin e politikave, programeve dhe në vendimmarrje për përparimin e vajzave të mitura;
- (b) Të gjenerojnë përkrahje shoqërore për zbatimin e ligjeve lidhur me moshën minimale ligjore për martesë, në veçanti duke siguruar mundësi arsimimi për vajzat.

Objektivi Strategjik L.2.

Të eliminohen qëndrimet dhe praktikat negative kulturore kundër vajzave

Aksionet që duhen ndërmarrë

276. Nga Qeveritë:

- (a) Të inkurajojnë dhe të përkrahin, sipas nevojës, organizatat joqeveritare dhe organizatat e komunitetit, në përpjekjet e tyre për të promovuar ndryshimet e qëndrimeve dhe praktikave negative ndaj vajzave;
- (b) Të përgatisin programe edukimi dhe të zhvillojnë materiale mësimi dhe tekste shkollore që do të ndërgjegjësojnë dhe do të informojnë të rriturit rreth efekteve të dëmshme të disa praktikave tradicionale dhe zakonore për vajzat e mitura;
- (c) Të zhvillojnë dhe të adoptojnë programe shkollore, materiale dhe tekste mësimore për të përmirësuar vetë-imazhin, jetën

dhe mundësitë për punë të vajzave, veçanërisht në fushat ku gratë kanë qenë tradicionalisht të nën-përfaqësuar, të tilla si matematika, shkenca, teknologjia;

- (d) Të marrin masa në mënyrë që tradita, feja dhe ushtrimi i tyre të mos jenë bazë për diskriminimin kundër vajzave.

277. Nga Qeveritë dhe, sipas nevojës, organizatat ndërkombëtare dhe joqeveritare:

- (a) Të promovojnë një mjedis edukues që eliminon të gjitha barrierat që pengojnë shkollimin e vajzave të martuara dhe/ose shtatzëna dhe nënave të reja, dhe kudo që është e mundshme, duke përfshirë objekte të volitshme dhe fizikisht të arritshme të kujdesit për fëmijë dhe edukimit prindëror, për të inkurajuar ata që kanë përgjegjësi kujdesin e fëmijëve dhe vëllezërve/motrave të tyre gjatë viteve shkollore për tu kthyer në shkollim, ose për ta vazhduar deri në përfundimin e saj;
- (b) Të inkurajojnë institucionet arsimore dhe mediat që të adoptojnë dhe projektojnë imazhe të balancuara dhe jostereotipe të vajzave dhe djemve, për të eliminuar pornografinë dhe portretizimet degraduese dhe të dhunshme të vajzave të mitura;
- (c) Të eliminojnë të gjitha format e diskriminimit kundër vajzave të mitura dhe shkaqet rrënjësore për parapëlqimin për djemtë, që përfundon me praktika të dëmshme joetike si janë përzgjedhja para lindjes e gjinisë së fëmijës dhe vrasja e fëmijëve femra; kjo shpesh komplikohet me shfrytëzimin e teknologjive për të përcaktuar gjininë e fetusit, që përfundon me abort të fetuseve femërore;
- (d) Të zhvillojnë politika dhe programe që u japin përparësi programeve të edukimit formal dhe joformal, që mbështesin vajzat dhe i aftësojnë ato për të përfutur njohuri, për të zhvilluar vetëbesimin dhe për të marrë përgjegjësinë për jetën e tyre; dhe të vendosin fokus të veçantë në programet për të edukuar gratë dhe burrat, veçanërisht prindërit, për rëndësinë e shëndetit dhe mirëqenies fizike dhe mendore të vajzave, përfshirë eliminimin e diskriminimit kundër vajzave në shpërndarjen e ushqimit, martesën e hershme, dhunën kundër vajzave, gjymtimin gjeneral femëror, prostitucionin e fëmijëve, keqtrajtimit seksual, përdhunimin dhe incestin.

Objektivi Strategjik L.3.

Të promovohen dhe të mbrohen të drejtat e vajzave të mitura dhe të rritet vetëdijesimi lidhur me nevojat dhe potencialin e tyre.

Aksionet që duhen ndërmarrë

278. Nga Qeveritë dhe organizatat ndërkombëtare dhe joqeveritare:

- (a) Të gjenerojnë vetëdijesimin për situatat e pafavorshme të vajzave midis politikëbërësve, planifikuesve, administratorëve dhe zbatuesve në të gjitha nivelet, si dhe brenda ekonomive shtëpiake dhe komuniteteve;
- (b) Të vetëdijësojnë vajzat e mitura, veçanërisht vajzat e mitura në situata të rënda, për potencialin e tyre, të edukohen rreth të drejtave të cilat i janë garantuar sipas të gjitha instrumenteve ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, përfshirë Konventën për të Drejtat e Fëmijës, legjislacionin e dekretuar për te dhe masat e ndryshme të ndërmarra si nga organizatat qeveritare ashtu edhe nga ato joqeveritare, që punojnë për të përmirësuar statusin e sajë;
- (c) Të arsimojnë gratë, burrat, vajzat dhe djemtë për të promovuar statusin e vajzave dhe për t'i inkurajuar ato që të punojnë për respektin reciprok dhe partneritetin e barabartë midis vajzave dhe djemve;
- (d) Të ndihmojë me furnizimin e njëjtë të shërbimeve dhe mjeteve të duhura vajzave me paaftësi dhe t'u ofrohen familjeve të tyre, sipas nevojës, shërbimet përkatëse përkrahëse.

Objektivi Strategjik L.4.

Të eliminohet diskriminimi kundër vajzave në arsim, zhvillim të aftësive dhe trajnim

Aksionet që duhen ndërmarrë

279. Nga Qeveritë:

- a) Të sigurojnë qasje universale dhe të barabartë në arsimimin fillor dhe përfundimin e shkollimit fillor për të gjithë fëmijët, dhe të eliminojnë hendekun ekzistues midis djemve e vajzave, siç është e përcaktuar sipas nenin 28 të Konventës për të Drejtat e Fëmijës; njëjloj, të sigurojnë qasje të barabartë për arsimin e mesëm nëntëvjeçar deri në vitin 2005 dhe qasje të barabartë në arsimin e lartë, përfshirë

arsimimin profesional dhe teknik për të gjitha vajzat dhe të gjithë djemtë, duke përfshirë të disfavorizuarit dhe të talentuarit;

- b) Të marrin masa për të integruar programet funksionale të shkrim leximit dhe numërimit, veçanërisht për vajzat që nuk ndjekin shkollën në programet për zhvillim;
- c) Të promovojnë edukimin për të drejtat e njeriut në programet edukuese dhe të përfshijnë në edukimin për të drejtat e njeriut faktin se të drejtat njerëzore të grave dhe vajzave të mitura janë një pjesë e patjetërsueshme, integrale dhe e pandashme e të drejtave universale të njeriut;
- d) Të rrisin shkallën e regjistrimit dhe të përmirësojnë përqindjet e vajzave që vazhdojnë shkollimin duke ndarë resurse të duhura buxhetore dhe duke kyçur përkrahjen e komunitetit dhe prindërve përmes fushatave dhe orareve fleksibile shkollore, nxitjes, bursave, qasjes në programet për vajzat që kanë lënë shkollën dhe masa të tjera;
- e) Të zhvillojnë programe trajnimi dhe materiale për mësuesit dhe edukatorët, duke ngritur kështu vetëdijen lidhur me rolin e tyre vetanak në procesin e arsimit, me qëllim për t'u siguruar strategji efektive për mësimdhënie të ndjeshme nga aspekti gjinor;
- f) Të ndërmarrin veprime për të siguruar që mësueset dhe profesoret të kenë të njëjtat mundësi dhe të njëjtin status si mësuesit dhe profesorët meshkuj.

280. Nga Qeveritë dhe organizatat ndërkombëtare dhe joqeveritare:

- (a) Të sigurojnë arsimim dhe trajnimi aftësimi për të rritur mundësitë e vajzave për punësim dhe qasje në proceset vendimmarrëse;
- (b) Të sigurojnë arsimim për të rritur njohuritë dhe aftësitë e vajzave lidhur me funksionimin e sistemeve ekonomike, financiare dhe politike;
- (c) Të sigurojnë qasje në arsimimin dhe trajnime aftësimi të përshtatshme për vajzat e mitura me paaftësi për pjesëmarrjen e tyre të plotë në jetë;
- (d) Të promovojnë pjesëmarrjen e plotë dhe të barabartë të vajzave në veprimtaritë jashtë programit shkollor, të tilla si sportet, drama dhe veprimtaritë kulturore.

Objektivi Strategjik: L.5.

Të eliminohet diskriminimi kundër vajzave në shëndet dhe ushqyerje

Aksionet që duhen ndërmarrë

281. Nga Qeveritë dhe organizatat ndërkombëtare dhe joqeveritare:

- a) Të sigurojnë informim publik mbi heqjen e praktikave diskriminuese kundër vajzave në shpërndarjen e ushqimit, në ushqyerje dhe qasjen në shërbimet shëndetësore;
- b) Të sensibilizojnë vajzat e mitura, prindërit, mësuesit dhe shoqërinë në lidhje me shëndetin dhe ushqyerjen e mirë të përgjithshme, si dhe të ngritin vetëdijen për rreziqet shëndetësore dhe problemet e tjera që lidhen me shtatzënitë e hershme;
- c) Të fuqizojnë dhe të riorientojnë edukimin shëndetësor dhe shërbimet shëndetësore, veçanërisht programet e kujdesit shëndetësor primar, përfshirë shëndetin seksual dhe riprodhues dhe hartimin e programeve cilësore shëndetësore për të përmbushur nevojat fizike e mendore të vajzave, si dhe të përkujdesen për nevojat e të rinjve, të grave shtatzëna dhe me fëmijë në gji;
- d) Të krijojnë programe edukimi për bashkëmoshatarë me qëllim të fuqizimit të veprimit individual dhe kolektiv për të zvogëluar cenueshmërinë e vajzave ndaj HIV/AIDS dhe sëmundjeve tjera seksualisht të transmetueshme, si është rënë dakord në Programin për Veprim të Konferencës Ndërkombëtare mbi Popullsinë dhe Zhvillimin dhe siç është vendosur në raportin e kësaj Konference, duke njohur rolet prindërore të cilave u referohet në paragrafin 267 të kësaj Platforme për Veprim;
- e) Të sigurojnë edukimin dhe shpërndarjen e informatave vajzave, sidomos vajzave adoleshente, lidhur me fiziologjinë e riprodhimit, shëndetit seksual dhe riprodhues, siç është rënë në dakord në Programin për Veprim të Konferencës Ndërkombëtare për Popullsinë dhe Zhvillimin dhe si është vendosur në raportin e kësaj Konference, praktika të përgjegjshme të planifikimit familjar, të jetës familjare, shëndetit riprodhues, sëmundjeve seksualisht të transmetueshme, infeksionit HIV dhe parandalimit të AIDS/SIDA, duke njohur rolet prindërore të cilave u referohet në paragrafin 267;

- f) Të përfshijnë trajnim lidhur me shëndetin dhe ushqyerjen si një pjesë përbërëse e programeve të mësimit dhe programit shkollor që fillon në nivelin fillor, për përfitimin e vajzave të mitura;
- g) Të theksojnë rolin dhe përgjegjësinë e adoleshentëve për shëndetin dhe sjelljen seksuale dhe riprodhuese përmes sigurimit të shërbimeve dhe këshillimeve të përshtatshme, siç janë diskutuar në paragrafin 267;
- h) Të zhvillojnë programe informimi dhe trajnimi për planifikuesit dhe zbatuesit e programeve shëndetësore në lidhje me nevojat speciale shëndetësore të vajzave të mitura;
- i) Të marrin të gjitha masat e duhura me qëllim të ndaljes së praktikave tradicionale që paragjykojnë lidhur me shëndetin e fëmijëve, siç është e paraparë në nenin 24 të Konventës për të Drejtat e Fëmijës.

Objetivi Strategjik L.6.

Të eliminohet shfrytëzimi ekonomik i punës së fëmijëve dhe mbrojtja e vajzave të reja në punë

Aksionet që duhen ndërmarrë

282. Nga Qeveritë:

- a) Në përputhje me nenin 32 të Konventës për të Drejtat e Fëmijës, të mbrojnë fëmijët nga shfrytëzimi ekonomik dhe nga kryerja e çfarëdo pune që mund të jetë e rrezikshme për ta ose që do të mund të ndërhyjë në arsimimin e tyre, ose të jetë e dëmshme për shëndetin e fëmijës ose zhvillimin fizik, mendor, shpirtëror, moral ose shoqëror të fëmijës;
- b) Të përcaktojnë me legjislacionin kombëtar moshën minimale për lejimin e një fëmije për punësim, në përputhje me standardet ekzistuese ndërkombëtare të punës dhe Konventën për të Drejtat e Fëmijës, duke përfshirë vajzat në të gjithë sektorët e veprimtarisë;
- c) Të mbrojnë vajzat e reja në punë, ndër të tjera, përmes:
 - i. Moshës pse moshat minimale për lejimin e punësimit;
 - ii. Monitorimit të rreptë të kushteve të punës (respektimin e kohës së punës, ndalimin e punës për

- fëmijët të cilëve nuk ua lejon legjislacioni kombëtar, dhe monitorimi i higjienës dhe i kushteve shëndetësore në punë);
- iii. Zbatimit të mbulimit nga sigurimet sociale;
 - iv. Themelimit të trajnimit dhe arsimimit të vazhdueshëm;
- d) Të fuqizojnë, ku është e nevojshme, legjislacionin që qeverisë punën e fëmijëve dhe siguron dënimet e përshtatshme ose sanksione të tjera për të garantuar zbatimin efektiv të legjislacionit;
- e) Të përdorin standardet ekzistuese ndërkombëtare të punës, përfshirë, sipas nevojës, standardet e ILO-s për mbrojtjen e fëmijëve punonjës, për të udhëhequr formulimin e legjislacionit dhe politikave kombëtare të punës.

Objektivi Strategjik, L.7.

Të zhduket dhuna kundër vajzave të mitura

Aksionet që duhen ndërmarrë

283. Nga Qeveritë dhe, sipas nevojës, organizatat ndërkombëtare dhe joqeveritare:

- (a) Të ndërmarrin veprime dhe masa efektive për të dekretuar dhe zbatuar legjislacionin për të mbrojtur sigurinë e vajzave nga të gjitha format e dhunës në punë, përfshirë programe trajnimi dhe programe përkrahëse, si dhe të marrin masa për të eliminuar incidentet e ngacmimit seksual të vajzave në institucionet e edukimit dhe në institucionet tjera;
- (b) Të marrin masa të duhura ligjore, administrative, shoqërore dhe arsimore, për të mbrojtur vajzat e mitura, në ekonomitë shtëpiake dhe në shoqëri, nga të gjitha format e dhunës fizike dhe mendore, nga lëndimi apo keqtrajtimi, nga moskujdesi ose trajtimi i pakujdesshëm, keqtrajtimi ose shfrytëzimi, përfshirë keqtrajtimin seksual;
- (c) Të ndërmarrin trajnime për ndjeshmërinë gjinore për ata individë të përfshirë në programet e shërimit dhe rehabilitimit ose programe të tjera asistence për vajzat viktime të dhunës, si dhe të promovojnë programe informimi, mbështetjeje dhe trajnimi për vajza të tilla;
- (d) Të dekretojnë dhe zbatojnë legjislacionin për mbrojtjen e vajzave nga të gjitha format e dhunës, përfshirë vrasjen e

fëmijëve femra dhe përzgjedhjen e gjinisë para lindjes, gjymtimin gjenital, incestin, keqtrajtimin seksual, shfrytëzimin seksual, prostitucionin e fëmijëve dhe pornografinë e fëmijëve, si dhe të zhvillojnë programe dhe shërbime mbështetëse mjekësore, shoqërore dhe psikologjike të sigurta dhe të besueshme të përshtatshme sipas moshës, të për të asistuar vajzat që i janë nënshtruar dhunës.

Objektivi Strategjik L.8.

Të promovohet ndërgjegjësimi i vajzave të mitura lidhur me dhe për pjesëmarrje në jetën shoqërore, ekonomike dhe politike

Aksionet që duhen ndërmarrë

284. Nga Qeveritë, në bashkëpunim me organizatat ndërkombëtare dhe joqeveritare:

- (a) T'u sigurojnë vajzave qasje në trajnime, informata dhe media për çështjet shoqërore, ekonomike e politike, si dhe t'u bëjë të mundur të shprehin pikëpamjet e tyre;
- (b) Të mbështesin organizatat joqeveritare, në veçanti organizatat joqeveritare të rinjve, në përpjekjet e tyre për të nxitur barazinë dhe pjesëmarrjen e vajzave në shoqëri.

Objektivi strategjik L.9.

Të fuqizohet roli i familjes në përmirësimin e statusit të vajzave të mitura

Aksionet që duhen ndërmarrë

285. Nga Qeveritë, në bashkëpunim me organizatat joqeveritare:

- (a) Të formulojnë politika dhe programe për të ndihmuar familjen, siç është e përshkruar në paragrafin 30, në rolin që ka në mbështetje, edukim dhe ushqim, me theks të veçantë në eliminimin e diskriminimit kundër vajzave të mitura brenda familjes;
- (b) Të sigurojnë një mjedis që është nxitës për fuqizimin e familjes, siç është e përshkruar në paragrafin 30, me qëllim ofrimit të masave mbështetëse dhe parandaluese që mbrojnë, respektojnë dhe promovojnë potencialin e vajzave të mitura;

- (c) Të edukojnë dhe inkurajojnë prindërit dhe kujdestarët për trajtimin e barabartë të vajzave dhe djemve, si dhe për të siguruar përgjegjësitë e ndara midis djemve e vajzave në familje, siç është e përkrahur në paragrafin 30.

KAPITULLI V - MARRËVESHJET INSTITUTIONALE

286. Platforma për Veprim vendos një numër veprimesh që do të shpjerë drejt ndryshimit themelor. Veprimi i menjëhershëm dhe përgjegjshmëria janë qenësore nëse dëshirojmë të arrijmë synimet deri në vitin 2000. Zbatimi është para së gjithash përgjegjësi e Qeverive, por gjithashtu varet nga një varg i gjerë institucioneve në sektorët publikë, privatë dhe joqeveritarë në nivelin e komunitetit, atë kombëtar, nën-rajonar/rajonar dhe ndërkombëtar.

287. Gjatë Dhjetëvjeçarit të Kombeve të Bashkuara për Gratë (1976-1985), u krijuan shumë institucione në nivele kombëtare, rajonale dhe ndërkombëtare të kushtuara në mënyrë specifike përparimit të grave. Në nivel ndërkombëtar u krijuan Instituti Ndërkombëtar për Hulumtime dhe Trajnime për Përparimin e Grave (INSTRAW), Fondi për Zhvillim të Grave i Kombeve të Bashkuara (UNIFEM) dhe Komiteti për monitorimin e Konventës për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit kundër Grave. Këto entitete, bashkë me Komisionin për Statusin e Grave dhe sekretariatit e tij, Divizionin për Përparimin e Grave, u bënë institucionet kryesore në Kombet e Bashkuara kushtuar veçanërisht përparimit globalisht të grave. Në nivel kombëtar, një numër vendesh krijuan ose fuqizuan mekanizmat kombëtarë për të planifikuar, mbrojtur dhe monitoruar progresin në përparimin e grave.

288. Zbatimi i Platformës për Veprim nga institucionet kombëtare, nën-rajonale/rajonale dhe ndërkombëtare, si publike ashtu edhe private, do të udhëhiqeshin nga transparenca, nga lidhjet e shtuara ndërmjet rrjeteve dhe organizatave, si dhe nga një rrjedhje e qëndrueshme e informatave ndërmjet të gjitha palëve të përmendura. Gjithashtu nevojiten edhe objektiva të qarta dhe mekanizma të llogaridhënies. Nevojiten edhe lidhjet me institucionet e tjera në nivel kombëtar, nën-rajonar/rajonar dhe ndërkombëtar si dhe me rrjetet e organizatat që janë të përkushtuara përparimit të grave.

289. Organizatat joqeveritare dhe ato që punojnë me gratë në terren, luajnë një rol specifik në krijimin e një klime shoqërore, ekonomike, politike dhe intelektuale të bazuar në barazinë midis grave dhe burrave. Gratë duhet të përfshihen aktivisht në zbatimin dhe monitorimin e Platformës për Veprim.

290. Zbatimi efektiv i Platformës do të kërkojë gjithashtu ndryshime në dinamikën e brendshme të institucioneve dhe organizatave,

përfshirë vlerat, sjelljet, rregullat dhe procedurat, që janë në kundër përparimit të grave. Ngacmimi seksual duhet të eliminohet.

291. Institucionet kombëtare, nën-rajonale/rajonale dhe ndërkombëtare duhet të kenë mandate të fuqishme dhe të qarta dhe autoritet, resurse dhe mekanizma të llogaridhënies që janë të nevojshëm për detyrat e kërkuara nga Platforma për Veprim. Duhet të ketë një zotim të qartë ndaj normave dhe standardeve ndërkombëtare të barazisë midis grave dhe burrave si një bazë për të gjitha veprimet.

292. Për të siguruar zbatimin efektiv të Platformës për Veprim dhe zgjerimit të punës për përparimin e grave në nivel kombëtar, nën-rajonar/rajonar dhe ndërkombëtar, Qeveritë, sistemi i Kombeve të Bashkuara dhe të gjitha organizatat e tjera relevante, duhet të promovojnë një politikë aktive dhe të dukshme të integritetit të perspektivës gjinore, midis tjerash, në monitorimin dhe vlerësimin e të gjitha politikave dhe programeve.

A. NIVELI KOMBTAR

293. Qeveritë kanë përgjegjësinë primare të zbatimit të Platformës për Veprim. Zotimi në nivelin më të lartë politik është thelbësor për zbatimin e saj, dhe Qeveritë duhet të marrin rolin udhëheqës në koordinimin, monitorimin dhe vlerësimin e progresit të bërë në përparimin e grave. Konferenca e Katërt Botërore për Gratë është një konferencë e zotimit dhe veprimit kombëtar dhe ndërkombëtar. Kjo kërkon zotimin e Qeverive dhe të komunitetit ndërkombëtar. Platforma për Veprim është pjesë e procesit të vazhdueshëm dhe ka një efekt katalizator pasi kontribuon për programet dhe rezultatet praktike për vajzat dhe gratë e të gjitha moshave. Shtetet dhe komuniteti ndërkombëtar inkurajohen që t'i përgjigjen kësaj sfide duke u zotuar për të vepruar. Si pjesë e këtij procesi, shumë Shtete janë zotuar të veprojnë siç është e pasqyruar, midis tjerash, edhe në deklaratat e tyre kombëtare.

294. Mekanizmat dhe institucionet kombëtare për përparimin e grave duhet të marrin pjesë në formulimin e politikave publike dhe të inkurajojnë zbatimin e Platformës për Veprim përmes organizmave dhe institucioneve të ndryshme, përfshirë sektorin privat, dhe, ku është e nevojshme, duhet të veprojnë si një katalizator në zhvillimin e programeve të reja deri në vitin 2000 në fushat që nuk mbulohen nga institucionet ekzistuese.

295. Duhet të inkurajohet mbështetja aktive dhe pjesëmarrja e një vargu të gjerë dhe të ndryshëm të aktorëve të tjerë institucionalë, duke përfshirë trupat legjislative, institucionet akademike dhe ato kërkimore, shoqatat profesioniste, sindikatat e punës, kooperativat, grupet lokale të komunitetit, organizatat joqeveritare, duke përfshirë

organizatat e grave dhe grupet feministe, mediat, grupet fetare, organizatat rinore dhe grupet kulturore, si dhe organizatat financiare dhe ato jofitimprurëse.

296. Me qëllim që të zbatohet Platforma për Veprim, do të jetë e nevojshme që Qeveritë të krijojnë ose të përmirësojnë efektivitetin e makinerive kombëtare për përparimin e grave në nivelin më të lartë politik, procedurat dhe stafin e përshtatshëm ndërministror dhe brenda ministrive, si dhe institucionet e tjera me mandate dhe kapacitet për të zgjeruar pjesëmarrjen e grave dhe për të integruar analizat gjinore në politikat dhe programet. Hapi i parë në këtë proces për të gjitha institucionet duhet të jetë të rishikojnë objektivat, programet dhe procedurat operacionale të tyre në relacion me veprimet e parashikuara në Platformë. Një veprimtari kyçe duhet të jetë promovimi i ndërgjegjësimit publik dhe mbështetjes publike për synimet e Platformës për Veprim, ndër të tjera, përmes masmediave dhe edukimit publik.

297. Sa më shpejt të jetë e mundur, e preferueshme deri nga fundi i vitit 1995, Qeveritë, në konsultim me institucionet relevante dhe organizatat joqeveritare, duhet të fillojnë të zhvillojnë strategjitë për implementim për Platformë, dhe, preferueshëm deri në fund të vitit 1996, do të kenë zhvilluar strategjitë e tyre ose planet e veprimit. Ky proces i planifikimit duhet të shfrytëzojë personat në nivelin më të lartë të autoritetit në Qeveri dhe aktorët relevantë në shoqërinë civile. Këto strategji implementimi duhet të jenë gjithëpërfshirëse, të kenë afate kohore për të arriturat dhe standardet për monitorim, si dhe të përfshijnë propozimet për shpërndarjen dhe rishpërndarjen e resurseve të zbatimit. Ku është e nevojshme të rekrutohet mbështetja e komunitetit ndërkombëtar, përfshirë resurset.

298. Organizatat joqeveritare duhen të inkurajohen që të kontribuojnë në projektimin dhe zbatimin e këtyre strategjive ose planeve kombëtare të veprimit. Ato duhet gjithashtu të inkurajohen që të zhvillojnë programet e tyre vetanake për të plotësuar përpjekjet e qeverisë. Organizatat e grave dhe grupet feministe, në bashkëpunim me organizatat tjera joqeveritare, duhet të inkurajohen që të organizojnë rrjete, ku është e nevojshme, dhe të avokojnë dhe mbështetin zbatimin e Platformës për Veprim nga Qeveritë dhe organizmat rajonale dhe ndërkombëtare.

299. Qeveritë duhen të zotohen për balancën gjinore, midis tjerash edhe përmes krijimit të mekanizmave specialë, në të gjitha komitetet, bordet dhe organizmat tjerë relevantë zyrtarë të caktuar nga qeveria, si dhe në të gjitha organizmat, institucionet dhe organizatat ndërkombëtare, duke prezantuar dhe duke promovuar më shumë kandidate gra.

300. Organizatat rajonale dhe ndërkombëtare, sidomos institucionet e zhvillimit, veçanërisht INSTRAW, UNIFEM dhe donatorët bilateralë,

duhet të sigurojnë asistencën financiare dhe këshilluese për makinerinë kombëtare me qëllim të ngritjes së aftësive së saja për të mbledhur informata, për të zhvilluar rrjete dhe për të zbatuar mandatin e vet, përveç fuqizimit të mekanizmit ndërkombëtar për të promovuar përparimin e grave përmes mandateve përkatëse, në bashkëpunim me Qeveritë.

B. NIVELI NËN-RAJONAL/RAJONAL

301. Komisionet rajonale të Kombeve të Bashkuara dhe strukturat tjera nën-rajonale/ rajonale duhet të promovojnë dhe asistojnë institucionet kombëtare përkatëse në monitorimin dhe zbatimin e Platformës globale për Veprim brenda mandatit të tyre. Kjo duhet të bëhet në koordinim me zbatimin e platformave përkatëse rajonale ose planeve të veprimit dhe në bashkëpunim të ngushtë me Komisionin për Statusin e Grave, duke marrë parasysh nevojat për të ndjekur zbatimin e objektivave të konferencave të Kombeve të Bashkuara në fushat përkatëse ekonomike, shoqërore, dhe të të drejtave të njeriut.

302. Me qëllim që të lehtësojë procesin rajonal, të zbatimit, monitorimit dhe vlerësimit, Këshilli Ekonomik Social do të konsiderojë rishikimin e kapacitetit institucional të komisioneve rajonale të Kombeve të Bashkuara brenda mandateve të tyre, përfshirë njësitë ose pikat fokale që kanë për gratë, për t'u marrë me çështjet gjinore në relacion me Platformën për Veprim, si dhe për platformat rajonale ose planet e veprimit. Konsideratë duhet dhënë, midis tjerash, ku është e nevojshme, fuqizimit kapacitetin në këtë drejtim.

303. Brenda mandateve dhe veprimtarive të tyre ekzistuese, komisionet rajonale duhet të integrojnë çështjet e grave dhe perspektivat gjinore dhe gjithashtu të marrin në konsiderim krijimin e mekanizmave dhe proceseve për të siguruar zbatimin dhe monitorimin e Platformës për Veprim dhe të planeve dhe platformave rajonale për veprim. Komisionet rajonale duhet, brenda mandateve të tyre, të bashkëpunojnë me organizatat tjera rajonale ndërqeveritare, organizatat joqeveritare, institucionet financiare dhe ato kërkimore dhe sektorin privat për çështjet gjinore.

304. Zyrat rajonale të agjencive të specializuara të sistemit të Kombeve të Bashkuara duhet, sipas nevojës, të zhvillojnë dhe botojnë një plan veprimi për zbatimin e Platformës për Veprim, përfshirë edhe identifikimin e afateve kohore dhe resurseve. Asistenca teknike dhe veprimtaritë operationale në nivelin rajonal duhet të vendosin caqet e identifikuar mirë për përparimin e grave. Për të arritur këtë qëllim duhet të bëhet koordinimi i rregullt ndërmjet organeve dhe agjencive të Kombeve të Bashkuara.

305. Organizatat joqeveritare brenda rajonit duhet të mbështeten në përpjekjet e tyre për të zhvilluar rrjete për të koordinuar avokimin dhe përhapjen e informatave rreth Platformës globale për Veprim dhe platformave përkatëse rajonale ose planeve përkatëse të veprimit.

B. NIVELI NDËRKOMBËTAR

Kombet e Bashkuara

306. Platforma për Veprim duhet të zbatohet përmes punës së të gjithë organizmave dhe organizatave të sistemit të Kombeve të Bashkuara gjatë periudhës 1995-2000, në veçanti dhe si një pjesë përbërëse e programimit më të gjerë. Një kornizë e zgjeruar për bashkëpunimin ndërkombëtar për çështjet gjinore duhet të zhvillohet gjatë periudhës 1995-2000 me qëllim që të sigurojë zbatimin, përcjelljen dhe vlerësimin e integruar dhe gjithëpërfshirës të Platformës për Veprim, duke marrë parasysh rezultatet e samiteve dhe konferencave globale të Kombeve të Bashkuara. Fakti që në gjithë këto samite dhe konferenca, Qeveritë janë zotuar për fuqizimin e grave në fusha të ndryshme, e bën koordinimin qenësor për strategjitë pasuese të kësaj Platforme për Veprim. Agjenda për Zhvillim dhe Agjenda për Paqe duhet të marrin në konsideratë Platformën për Veprim të Konferencës së Katërt Botërore për Gratë.

307. Kapaciteti institucional i sistemit të Kombeve të Bashkuara për të zbatuar dhe koordinuar përgjegjësinë e sajë për zbatimin e Platformës për Veprim, si dhe ekspertiza e sajë dhe metodat e saja të punës për promovimin e përparimit të grave, duhet të përmirësohen.

308. Përgjegjësia për sigurimin e zbatimit të Platformës për Veprim dhe integrimin e perspektivës gjinore në të gjitha politikatat dhe programet e sistemit të Kombeve të Bashkuara, duhet të mbetet në nivelet më të larta.

309. Për të përmirësuar efikasitetin dhe efektivitetin e sistemit në sigurimin në ofrimin e mbështetjes për barazi dhe fuqizimin e grave në nivel kombëtar dhe për të zgjeruar kapacitetin e tij për të përmbushur objektivat e Platformës për Veprim, duhet të rinovohen, reformohen dhe revitalizohen pjesët e ndryshme të sistemit të Kombeve të Bashkuara. Kjo do të përfshinte rishikimin dhe fuqizimin e strategjive dhe metodave të punës të mekanizmave të ndryshme të Kombeve të Bashkuara për përparimin e grave me qëllim të racionalizimit, dhe ku është e nevojshme, fuqizimit të funksioneve të tyre këshilluese, katalitike dhe monitoruese në lidhje me organizmat dhe agjencitë themelore. Njësitë për gratë/çështjet gjinore janë të rëndësishme për integrimin efektiv gjinor, por strategjitë duhet të zhvillohen më tej për të parandaluar marginalizimin e paqëllimshëm, që është e kundërta e integritit të dimensionit gjinor përgjatë të gjitha operacioneve.

310. Si pjesë pasuese e Konferencës së Katërt Botërore për Gratë, të gjitha njësitë e sistemit të Kombeve të Bashkuara që fokusohen në përparimin e grave duhet të kenë resurset dhe përkrahjen e nevojshme për të zbatuar veprimtaritë e planifikuara. Përpyekjet e pikave fokale gjinore përbrenda organizatave duhet të jenë mirë të integruara në tërë politikat, planifikimin, programimin dhe buxhetimin.

311. Kombet e Bashkuara dhe organizatat e tjera ndërkombëtare duhet të ndërmarrin veprime për të eliminuar barrierat në përparimin e grave brenda organizatave të tyre në pajtim me Platformën për Veprim.

Asambleja e Përgjithshme

312. Asambleja e Përgjithshme, si trupi më i lartë ndërqeveritar në Kombet e Bashkuara, është organ kryesor politikëbërës dhe vlerësues për çështjet që kanë të bëjnë me rezultatet e Konferencës, dhe si i tillë, duhet të integrojë çështjet gjinore në tërë punën e sajë. Ajo duhet të vlerësojë progresin në zbatimin efektiv të Platformës për Veprim, duke njohur që këto çështje janë të ndërlidhura me politikat sociale, ekonomike dhe politike. Në sesionin e sajë të pesëdhjetë, të mbajtur në vitin 1995, Asambleja e Përgjithshme do ta ketë përpara vetes raportin e Konferencës së Katërt Botërore për Gratë. Në pajtim me rezolutën e saj 49/146, ajo gjithashtu do ta shqyrtojë edhe një raport të Sekretarit të Përgjithshëm si pasim i rezultateve të Konferencës, duke marrë në konsiderim rekomandimet e Konferencës. Asambleja e Përgjithshme duhet të përfshijë pjesën pasuese të Konferencës si pjesë të punës së sajë të vazhdueshme për përparimin e grave. Në vitin 1996, 1998 dhe 2000, ajo duhet ta ketë rishikuar zbatimin e Platformës për Veprim.

Këshilli Ekonomik dhe Social

313. Këshilli Ekonomik dhe Social, në kontekstin e rolit të tij sipas Kartës së Kombeve të Bashkuara dhe në përputhje me rezolutat 45/264, 46/235 dhe 48/162 të Asamblesë e Përgjithshme, do të mbikëqyrte koordinimin përgjatë tërë sistemit të zbatimit të Platformës për Veprim dhe do të bënte rekomandime në lidhje me të. Këshilli do duhej të ftohej që të rishikojë zbatimin e Platformës për Veprim, duke dhënë konsideratën e duhur raportit të Komisionit për Statusin e grave. Si trup koordinues, Këshilli do të duhej të ftohej të rishikojë mandatin e Komisionit për Statusin e Grave, duke marrë parasysh nevojat për koordinim efektiv me komisionet e tjera përkatëse dhe rezultatet pasuese të Konferencës. Këshilli do të përfshijë çështjet gjinore në diskutimet e tij lidhur me të gjitha çështjet e politikave,

duke i përkushtuar konsideratën e duhur rekomandimeve të përgatitura nga Komisioni. Ai duhet të konsiderojë që para vitit 2000 të dedikojë të paktën një segmenti në nivel të lartë për përparimin e grave dhe zbatimin e Platformës për Veprim me përfshirjen dhe pjesëmarrjen aktive, midis tjerash, të agjencive të specializuara, duke përfshirë Bankën Botërore dhe Fondin Monetar Ndërkombëtar.

314. Këshilli duhet të konsiderojë dedikimin e së paku një segmenti koordinues para vitit 2000 për koordinimin e përparimit të grave, bazuar në planin e rishikuar afatmesëm të sistemit të gjerë për përparimin e grave.

315. Këshilli duhet të marrë në konsiderim dedikimin e së paku një segmenti të veprimtarive operacionale para vitit 2000, për koordinimin e zhvillimit të veprimtarive lidhur me gjininë, bazuar në planin e rishikuar afatmesëm të sistemit të gjerë për përparimin e grave, me qëllim të themelimit të udhëzimeve dhe procedurave për zbatimin e Platformës për Veprim nga fondet dhe programet e sistemit të Kombeve të Bashkuara.

316. Komiteti Administrativ për Koordinim (ACC) duhet të marrë në konsiderim se si entitetet e saja pjesëmarrëse do të mund të koordinonin më së miri aktivitetet e tyre, midis tjerash, përmes procedurave ekzistuese në nivelin ndërmjet agjencive për sigurimin e koordinimit të të gjithë sistemit për të zbatuar e për të ndihmuar ndjekjen e objektivave të Platformës për Veprim.

Komisioni për Statusin e Grave

317. Asambleja e Përgjithshme dhe Këshilli Ekonomik Social, në përputhje me mandatet e tyre përkatëse, ftohen që të rishikojnë dhe të fuqizojnë mandatin e Komisionit për Statusin e Grave, duke marrë në konsideratë Platformën për Veprim si dhe nevojën për sinergji me komisionet tjera përkatëse dhe përcjellja e rezultateve të Konferencës, si dhe nevojën për një qasje të sistemit në tërësi për zbatimin e Platformës.

318. Si një komision funksional që ndihmon Këshillin Ekonomik Social, Komisioni për Statusin e Grave duhet të ketë një rol qendror brenda Kombeve të Bashkuara në monitorimin e zbatimit të Platformës për Veprim dhe po ashtu këshillimin e Këshillit. Ai do të ketë një mandat të qartë me resurse të mjaftueshme njerëzore dhe financiare, përmes rishpërndarjes së resurseve brenda buxhetit të rregullt të Kombeve të Bashkuara, për ta zbatuar atë.

319. Komisioni për Statusin e Grave duhet të asistojë Këshillin Ekonomik dhe Social në koordinimin e raportimit të saj për zbatimin e Platformës për Veprim me organizatat relevante të sistemit të Kombeve

të Bashkuara. Komisioni duhet të shfrytëzojë rezultatet nga organizatat e tjera të sistemit të Kombeve të Bashkuara dhe burime të tjera, sipas nevojës.

320. Komisioni për Statusin e Grave, në zhvillimin e programit të punës së tij për periudhën 1996-2000, do të shqyrtojë fushat kritike të interesit në Platformën për Veprim dhe do të konsiderojë se si të integrojë në agjendën e vet aktivitetet pasuese të Konferencës së Katërt Botërore për Gratë. Në këtë kontekst, Komisioni për Statusin e Grave duhet të konsiderojë se si mund të zhvillohet më tej roli i tij si katalizator në integrimin e një perspektive gjinore në veprimtaritë e Kombeve të Bashkuara.

Komisionet tjera funksionale

321. Brenda mandateve të tyre, komisionet e tjera funksionale të Këshillit Ekonomiko Social duhet të marrin parasysh Platformën për Veprim dhe do të sigurojnë integrimin e aspekteve gjinore në punën e tyre përkatëse.

Komiteti për Eliminimin e Diskriminimit kundër Grave dhe organizmat tjerë të marrëveshjeve

322. Në zbatim të përgjegjësiave të saja sipas Konventës për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit kundër Grave, Komiteti për Eliminimin e Diskriminimit kundër Grave, do të duhej që, brenda mandatit të vet, të marrë parasysh Platformën për Veprim kur të vlerësojnë raportet e pranuar nga Shtetet palë.

323. Shtetet palë të Konventës për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit kundër Grave, ftohen që kur të raportojnë sipas nenit 18 të Konventës të përfshijnë informata mbi masat e marra për të zbatuar Platformën për Veprim me qëllim të ndihmës së Komitetit për Eliminimin e Diskriminimit kundër Grave në monitorimin efektiv të aftësiave të grave për të gëzuar të drejtat e garantuara nga Konventa.

324. Aftësia e Komitetit për Eliminimin e Diskriminimit kundër Grave, për të monitoruar zbatimin e Konventës duhet të fuqizohet përmes sigurimit të resurseve njerëzore dhe financiare nga buxheti i rregullt i Kombeve të Bashkuara, përfshirë asistencën me ekspertizë ligjore dhe, në përputhje me rezolutën 49/164 të Asamblesë së Përgjithshme dhe të vendimit të marrë në mbledhjen e shteteve palë për Konventën mbajtur në maj 1995, kohës së mjaftueshme për takime të Komitetit. Komiteti duhet të rrisë koordinimin e tij me organizmat e tjerë të marrëveshjeve për të drejtat e njeriut, duke

marrë parasysh rekomandimet e Deklaratës së Vjenës dhe Programin për Veprim.

325. Organizmat tjera të marrëveshjeve, brenda mandatit të tyre, duhet të marrin parasysh në masë të duhur zbatimin e Platformës për Veprim dhe të sigurojnë integrimin e statusit të barabartë dhe të drejtave njerëzore të grave në punën e tyre.

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara

326. Nga Sekretari i Përgjithshëm kërkohet të marrë përgjegjësinë për koordinimin e politikave përbrenda Kombeve të Bashkuara për zbatimin e Platformës për Veprim dhe për integrimin e një perspektive gjinore në të gjitha veprimtaritë e Kombeve të Bashkuara, duke marrë parasysh mandatet e organizmave përkatës. Sekretari i Përgjithshëm duhet të marrë në konsideratë masat specifike për sigurimin e koordinimit efektiv për zbatimin e këtyre objektivave. Për të arritur këtë qëllim, Sekretari i Përgjithshëm u ftua të krijojë një post të nivelit të lartë në zyrën e Sekretarit të Përgjithshëm, duke shfrytëzuar resurset ekzistuese financiare dhe njerëzore, për të vepruar si këshilltar i Sekretarit të Përgjithshëm për çështjet gjinore dhe për të ndihmuar në sigurimin e zbatimit të një sistemi të gjerë të Platformës për Veprim në bashkëpunim të ngushtë me Seksionin për Përparimin e Grave.

Seksioni për Përparimin e Grave në Sekretariatit e Kombeve të Bashkuara

327. Funkzioni kryesor i Seksionit për Përparimin e Grave, Departamentit për Koordinimin e Politikave dhe Zhvillimin e Qëndrueshëm është për t'i siguruar shërbim thelbësor Komisionit për Statusin e Grave dhe organizmave të tjerë ndërqeveritarë kur kanë të bëjnë me përparimin e grave, si dhe Komitetit për Eliminimin e Diskriminimit kundër Grave. Është caktuar një person kontakti për zbatimin e Strategjive për të Ardhmen të Najrobit për Përparimin e Grave. Në dritën e shqyrtimit të mandatit të Komisionit për Statusin e Grave, siç është parashtruar në paragrafin 314, gjithashtu është e nevojshme të vlerësohen edhe funksionet e Seksionit për Përparimin e Grave. Nga Sekretari i Përgjithshëm kërkohet të sigurojë funksionim më efektiv të Seksionit, midis tjerash, duke siguruar resurse të mjaftueshme njerëzore e financiare brenda buxhetit të rregullt të Kombeve të Bashkuara.

328. Seksioni duhet të shqyrtojë pengesat për përparimin e grave përmes zbatimit të analizës së ndikimit gjinor në studimin e politikave për Komisionin mbi Statusin e Grave dhe përmes mbështetjes së

organizmave të tjera plotësuese. Pas Konferencës së Katërt Botërore për Gratë, ai duhet të luajë një rol koordinues në përgatitjen revizionimit të planit afatmesëm të sistemit të plotë për përparimin e grave për periudhën 1996-2001 dhe duhet të vazhdojë të shërbejë si sekretariat për koordinimin ndërmjet agjencive për përparimin e grave. Ai do të vazhdojë të mirëmbajë rrjedhjen e informatave me komisionet kombëtare, institucionet kombëtare, për përparimin e grave dhe organizatave joqeveritare në lidhje me zbatimin e Platformës për Veprim.

Njësi të tjera të Sekretariatit të Kombeve të Bashkuara

329. Njësitë e ndryshme të Sekretariatit të Kombeve të Bashkuara duhet të shqyrtojnë programet e tyre për të përcaktuar se si mund të kontribuojnë më mirë në zbatimin e koordinuar të Platformës për Veprim. Propozimet për zbatimin e Platformës duhet të pasqyrohen në rishikimin e planit afatmesëm të sistemit të gjerë për përparimin e grave për periudhën 1996-2001, si dhe në planin afatmesëm të propozuar nga Kombet e Bashkuara për periudhën 1998-2002. Përmbajtja e veprimeve do të varet nga mandatet e organizmave të ndërlidhura.

330. Lidhjet ekzistuese dhe ato të reja duhet të zhvillohen përgjatë tërë Sekretariatit me qëllim për t'u siguruar që perspektiva gjinore të prezantohet si një dimension qendror në të gjitha aktivitetet e Sekretariatit.

331. Zyra e Menaxhimit të Resurseve Njerëzore në bashkëpunim me menaxherët e programeve në mbarë botën, dhe në përputhje me planin strategjik të veprimit për përmirësimin e statusit të grave në Sekretariat (1995-2000), do të vazhdojë t'i jap prioritet rekrutimit dhe promovimit të grave në poste të larta të politikë-bërjes dhe të vendim-marrjes, varësisht nga shpërndarja gjeografike, me qëllim të arritjes së synimeve të vendosura në rezolutat 45/125 dhe 45/239 C të Asamblesë së Përgjithshme, dhe të ripohuara në rezolutat 46/100, 47/93, 48/106 dhe 49/167 të Asamblesë së Përgjithshme. Shërbimi i trajnimit duhet të hartojë dhe të udhëheqë trajnime të rregullta për ndërgjegjësimin gjinor ose të përfshijë trajnim për ndërgjegjësimin gjinor në të gjitha veprimtaritë e saja.

332. Departamenti i Informimit Publik duhet të kërkojë të integrojë një perspektivë gjinore në veprimtaritë e saja të përgjithshme të informimit, dhe, përbrenda resurseve ekzistuese, të fuqizojë dhe të përmirësojë programet e saja për gratë dhe vajzat e mitura. Si përfundim, Departamenti do të formulojë një strategji komunikimi multimediale për të mbështetur zbatimin e Platformës për Veprim, duke marrë plotësisht në konsideratë teknologjitë e reja. Rezultatet e

rregullta të Departamentit duhet të promovojnë synimet e Platformës, veçanërisht në vendet në zhvillim.

333. Seksioni i Statistikave i Departamentit për Informim Ekonomik dhe Social dhe për Analizat Politike duhet të luajnë një rol të rëndësishëm koordinues në punën ndërkombëtare në statistika, siç është e përshkruar në seksionin IV më lart, objektivi strategjik H.3.

Instituti Ndërkombëtar për Kërkim dhe Trajnim për Përparimin e Grave (INSTRAW)

334. Instituti Ndërkombëtar për Kërkim dhe Trajnim për Përparimin e Grave, INSTRAW, ka një mandat për promovimin e kërkimeve dhe trajnimin lidhur me situatën dhe zhvillimin e grave. Duke e shikuar nga pikëvështrimi i Platformës për Veprim, Instituti Ndërkombëtar për Kërkime dhe Trajnime për Përparimin e Grave, duhet të rishikojë programin e saj të punës dhe të zhvillojë një program për zbatimin e atyre aspekteve të Platformës për Veprim që janë pjesë e mandatit të saj. Ajo duhet të identifikojë ato lloje të kërkimeve dhe metodologjive kërkimore të cilave duhet dhënë përparësi, të fuqizojë kapacitetet kombëtare për të hartuar studime për gratë dhe kërkime gjinore, përfshirë ato mbi statusin e vajzave të mitura, dhe për të zhvilluar rrjete institucionesh kërkimore që mund të mobilizohen për këtë qëllim. Ajo gjithashtu duhet të identifikojë ato lloje të arsimimit e trajnimit që mund të mbështeten dhe të promovohen në mënyrë efektive nga instituti.

Fondi për Zhvillim për Gratë i Kombeve të Bashkuara (UNIFEM)

335. UNIFEM ka një mandat për të rritur opsionet dhe mundësitë për zhvillimin ekonomik dhe social të grave në vendet në zhvillim duke ofruar asistencë teknike e financiare për të inkorporuar dimensionin e grave në zhvillimin në të gjitha nivelet. Prandaj, UNIFEM duhet të shqyrtojë dhe të përforcojë, sipas nevojës, programin e saj të punës nga pikëvështrimi i Platformës për Veprim, duke u fokusuar tek fuqizimi politik dhe ekonomik i grave. Roli i sajë avokues duhet të përqendrohet në zhvillimin e një dialogu multilateral të politikave për fuqizimin e grave. Duhet të vihen në dispozicion resurset adekuate për zbatimin e funksioneve të sajë.

1. Agjencitë e specializuara dhe organizatat tjera të Kombeve të Bashkuara

336. Të fuqizohet mbështetja e tyre për të vepruar në nivel kombëtar dhe për të rritur kontributet e tyre në projektet përcjellëse të

koordinuara nga Kombet e Bashkuara, çdo organizatë duhet të vendosin për veprimet specifike që do t'i ndërmarrin, përfshirë synimet dhe caqet për të rishtruar prioritetet dhe ridrejtuar resurset për të përmbushur prioritetet globale të identifikuara në Platformën për Veprim. Duhet të bëhet një përvijim i qartë i përgjegjësisë dhe llogaridhënies. Këto propozime duhet pastaj të pasqyrohen në planin afatmesëm të sistemit të gjerë për përparimin e grave për periudhën 1996-2001.

337. Çdo organizatë duhet të angazhohet në nivelin më të lartë dhe, gjersa ndjekin synimet e tyre, duhet të ndërmarrin masa për të zgjeruar dhe përkrahur rolet dhe përgjegjësitë e pikave fokale për çështjet e grave.

338. Përveç kësaj, agjencitë e specializuara që kanë me mandat për të siguruar asistencën teknike në vendet në zhvillim, veçanërisht në Afrikë dhe në vendet më së paku të zhvilluara, duhet të bashkëpunojnë më shumë për të siguruar promovimin e vazhdueshëm të përparimit të grave.

339. Sistemi i Kombeve të Bashkuara duhet të marrë në konsiderim dhe të ofrojë asistencën e duhur teknike dhe format tjera të asistencës për vendet me ekonomi në tranzicion, me qëllim që të ndihmojnë në gjetjen e zgjidhjes për problemet e tyre specifike lidhur me përparimin e grave.

340. Çdo organizatë duhet t'i dedikojë një prioritet më të lartë rekrutimit dhe promovimit të grave në nivel Profesional për të arritur balancën gjinore, veçanërisht në nivelet e vendimmarrjes. Konsiderata kryesore në punësimin e stafit dhe në vendosjen e kushteve të shërbimit, duhet të jetë nevoja e sigurimit të standardeve më të larta të efikasitetit, kompetencës dhe integritetit. Duhet t'i kushtohet vëmendja e duhur rëndësishme së rekrutimit të stafit mbi një bazë sa më të gjerë gjeografike po që është e mundur. Organizatat duhet të raportojnë rregullisht tek organet e tyre qeverisëse mbi progresin e bërë për këtë qëllim.

341. Koordinimi i veprimtarive operacionale të Kombeve të Bashkuara për zhvillim në nivel vendor duhet të përmirësohet përmes sistemit rezident koordinues në përputhje me rezolutat e Asamblesë së Përgjithshme, në veçanti me rezolutën e Asamblesë së Përgjithshme 47/199, për të marrë plotësisht në konsideratë Platformën Për Veprim.

2. *Institucione dhe organizatat tjera ndërkombëtare*

342. Në zbatimin e Platformës për Veprim, institucionet ndërkombëtare financiare janë inkurajuar për të rishikuar dhe për të

revizionuar politikat, procedurat dhe emërimin e stafit për të siguruar që kështu nga investimet dhe programet do të përfitojnë gratë dhe kështu të kontribuojnë në zhvillimin e qëndrueshëm. Ato janë gjithashtu të inkurajuar për të rritur numrin e grave në pozita në nivel të lartë, për të rritur trajnimin e stafit për analizat gjinore dhe për të krijuar politika dhe udhëzime për të siguruar konsideratën e plotë të ndikimit të ndryshëm të programeve të huasë dhe veprimtarive të tjera në gratë dhe burrat. Në lidhje me këtë, institucionet e Bretton Woods, Kombet e Bashkuara, po ashtu edhe fondet dhe programet dhe agjencitë e specializuara të tij, duhet të vendosin dialog të rregullt dhe substantiv, përfshirë në nivel të terrenit, për koordinim më efikas dhe efektiv të asistencës së tyre me qëllim që të fuqizojnë efektivitetin e programeve të tyre për përfitim të grave dhe familjeve të tyre.

343. Asambleja e Përgjithshme duhet të përkushtojë më shumë konsideratë për të ftuar Organizatën Botërore të Tregtisë që të konsiderojë se si mund të kontribuojë për zbatimin e Platformës për Veprim, duke përfshirë aktivitetet në bashkëpunim me sistemin e Kombeve të Bashkuara.

344. Organizatat ndërkombëtare joqeveritare luajnë një rol të rëndësishëm në zbatimin e Platformës për Veprim. Duhet t'i jepet konsideratë krijimit të një mekanizmi për bashkëpunim me organizatat joqeveritare për të promovuar zbatimin e Platformës në nivele të ndryshme.

KAPITULLI VI - MARRËVESHJET FINANCIARE

345. Resurset financiare dhe njerëzore përgjithësisht kanë qenë të pamjaftueshme për përparimin e grave. Kjo ka kontribuar në progresin e ngadaltë deri më sot në zbatimin e Strategjive të Najrobit për të Ardhmen për Përparimin e Grave. Zbatimi i plotë dhe efektiv frytshëm i Platformës për Veprim, përfshirë zotimet relevante të bëra në konferencat dhe samitet e mëparshme të Kombeve të Bashkuara, ka nevojë për një zotim politik për të vënë në dispozicion resurset njerëzore dhe financiare për fuqizimin e grave. Kjo do të kërkojë integrimin e një perspektive gjinore në vendimet buxhetore për politikat dhe programet, si dhe financimin e mjaftueshëm të programeve specifike për sigurimin e barazisë midis grave dhe burrave. Për të zbatuar Platformën Për Veprim, do të duhet të identifikohen dhe të mobilizohet financimi nga të gjitha burimet dhe përgjatë të gjithë sektorëve. Reformulimi i politikave dhe rishpërndarja e resurseve mund të jetë e nevojshme brenda programeve dhe ndërmjet tyre, por disa ndryshime të politikave jo gjithmonë kanë implikime financiare. Mobilizimi i resurseve plotësuese, publike e private, përfshirë resurset nga burimet novatore të financimit, mund të jetë gjithashtu i nevojshëm.

A. NIVELI KOMBËTAR

346. Përgjegjësia primare për zbatimin e objektivave strategjike të Platformës për Veprim u mbetet Qeverive. Për të arritur këto objektiva, Qeveritë duhet të bëjnë përpjekje për të shqyrtuar sistematikisht se si përfitojnë gratë nga shpenzimet e sektorit publik; të përshtatin buxhetet për të siguruar barazinë në qasjen ndaj shpenzimeve të sektorit publik, edhe për zgjerimin e kapacitetit prodhues edhe për përmbushjen e nevojave sociale; dhe të përmbushin zotimet e tyre lidhur me përkatësinë gjinore të bëra në samitet dhe konferencat e tjera të Kombeve të Bashkuara. Për të zhvilluar me sukses zbatimin e strategjive kombëtare për Platformën për Veprim, Qeveritë duhet të ndajnë resurse të mjaftueshme, përfshirë resurset për të ndërmarrjen e analizave mbi ndikimin nga këndvështrimi gjinor. Qeveritë duhet gjithashtu të inkurajojnë organizatat joqeveritare dhe sektorin privat si dhe institucionet e tjera për të mobilizuar resurset shtesë.

347. Duhet të ndahen resurse të mjaftueshme për përparimin e grave makinerive kombëtare si dhe të gjitha institucioneve, sipas nevojës, të cilat mund të kontribuojnë në zbatimin dhe monitorimin e Platformës për Veprim.

348. Atje ku makineritë kombëtare për përparimin e grave nuk ekzistojnë ende ose ku nuk janë vendosur në një bazë të përhershme, Qeveritë duhet të përpiqen të bëjnë të vënë në dispozicion resurset e mjaftueshme dhe të vazhdueshme për makineri të tilla.

349. Për të ndihmuar në zbatimin e Platformës për Veprim, Qeveritë duhet të zvogëlojnë, sipas nevojës, shpenzimet e tepërta ushtarake dhe investimet për prodhimin dhe blerjen e armëve, në pajtim me kërkesat e sigurisë kombëtare.

350. Organizatat joqeveritare, sektori privat dhe aktorët tjerë të shoqërisë civile, duhen të inkurajohen që të marrin në konsiderim ndarjen e resurseve të nevojshme për zbatimin e Platformës për Veprim. Qeveritë duhet të krijojnë një mjedis përkrahës për mobilizimin e resurseve nga organizatat joqeveritare, veçanërisht organizatat dhe rrjetet e grave, grupet feministe, sektori privat dhe aktorët tjerë të shoqërisë civile, për t'u mundësuar që të kontribuojnë për arritjen e këtij qëllimi. Kapaciteti i organizatave joqeveritare lidhur me këtë duhet të fuqizohet e të zgjerohet.

B. NIVELI RAJONAL

351. Bankat rajonale të zhvillimit, shoqatat rajonale të biznesit dhe institucionet tjera rajonale, duhet të ftohen të kontribuojnë dhe të

ndihmojnë për të mobilizuar resurset për veprimtarinë e tyre të huazimit dhe veprimtaritë tjera për zbatimin e Platformës për Veprim. Ato gjithashtu duhet të inkurajohen që të marrin parasysh Platformën për Veprim në politikat e tyre dhe modalitetet e financimit.

352. Organizatat nën-rajonale dhe rajonale, si dhe komisionet rajonale të Kombeve të Bashkuara duhen, ku është e mundur dhe ua lejon mandati i tyre ekzistues, të ndihmojnë në mobilizimin e fondeve për zbatimin e Platformës për Veprim.

C. NIVELI NDËRKOMBËTAR

353. Duhet të zotohen resurse të mjaftueshme financiare në nivelin ndërkombëtar për zbatimin e Platformës për Veprim në vendet në zhvillim, veçanërisht në Afrikë dhe vendet më së paku të zhvilluara. Fuqizimi i kapaciteteve kombëtare në vendet në zhvillim për të zbatuar Platformën për Veprim do të kërkojë përpjeke për përmbushjen e synimeve të pajtuara prej 0.7% të bruto prodhimit kombëtar të vendeve të zhvilluara për asistencën e përgjithshme zyrtare të zhvillimit sa më shpejt të jetë e mundur, po ashtu të rritet sasia e ndarë e fondeve për veprimtaritë të projektuara për zbatimin e Platformës për Veprim. Për më tepër, vendet e përfshira në bashkëpunimin për zhvillim, duhet të bëjnë një analizë kritike të programeve të tyre të asistencës në mënyrë që të përmirësojnë cilësinë dhe efektivitetin e ndihmës përmes integritit të një qasjeje gjinore.

354. Institucionet ndërkombëtare financiare, përfshirë Bankën Botërore, Fondin Monetar Ndërkombëtar, Fondin Ndërkombëtar për Zhvillim Bujqësor dhe bankat rajonale të zhvillimit, duhet të ftohen të shqyrtojnë grantet dhe huatë e tyre, dhe t'ua ndajnë huatë dhe grantet programeve për zbatimin e Platformës për Veprim në vendet në zhvillim, veçanërisht në Afrikë dhe në vendet më së paku të zhvilluara.

355. Sistemi i Kombeve të Bashkuara duhet t'u ofrojë bashkëpunim teknik dhe forma të tjera të asistencës vendeve në zhvillim, në veçanti në Afrikë dhe në vendet më pak të zhvilluara, në zbatimin e Platformës për Veprim.

356. Zbatimi i Platformës për Veprim në vendet me ekonomi në tranzicion kërkon bashkëpunimin dhe asistencën e vazhdueshme ndërkombëtare. Organizatat dhe organizmat e sistemit të Kombeve të Bashkuara, përfshirë agjencitë teknike dhe sektoriale, do të ndihmojnë përpjekjet e këtyre vendeve në hartimin dhe zbatimin e politikave dhe programeve për përparimin e grave. Për të arritur këtë, Fondi Monetar Ndërkombëtar dhe Banka Botërore duhen të ftohen për të asistuar në këto përpjekje.

357. Rezultati i Samitit Botëror për Zhvillimin Social i Kombeve të Bashkuara lidhur me menaxhimin dhe zvogëlimin e borxhit, si dhe samitet dhe konferencat e tjera botërore të Kombeve të Bashkuara, duhen të zbatohen me qëllim që të ndihmojnë në përpjekjet për realizimin e objektivave të Platformës për Veprim.

358. Për të ndihmuar përpjekjet për zbatimin e Platformës për Veprim, vendet e interesuara partnere, të zhvilluara dhe në zhvillim, që pajtohen për një zotim reciprok për të ndarë mesatarisht 20 përqind të asistencës zyrtare për zhvillim dhe 20 përqind të buxhetit kombëtar për programe themelore sociale, duhen të marrin në konsiderim perspektivën gjinore.

359. Fondet dhe programet zhvillimore të sistemit të Kombeve të Bashkuara duhet të ndërmerren një analizë të menjëhershme të masës deri në të cilën programet dhe projektet janë orientuar drejt zbatimit të Platformës për Veprim dhe, për ciklin e ardhshëm të programimit duhet të sigurojnë që resurset e synuara drejt zhdukjes së pabarazive midis grave e burrave në asistencën e tyre teknike dhe në veprimtaritë financuese janë adekuate.

360. Duke njohur rolet e fondeve, programeve dhe agjencive të specializuara të Kombeve të Bashkuara, në veçanti rolet speciale të UNIFEM dhe INSTRAW, në promovimin e fuqizimit të grave, dhe kështu edhe në zbatimin e Platformës për Veprim përbrenda mandateve të tyre përkatëse, midis tjerash, në veprimtari kërkimore, trajnimi dhe informimi për përparimin e grave, si dhe ofrimin e asistencës teknike dhe financiare për të inkorporuar një perspektivë gjinore në përpjekjet për zhvillim, resurset e ofruara nga komuniteti ndërkombëtar duhet të jenë të mjaftueshme dhe të mirëmbahen në një nivel adekuat.

361. Për të përmirësuar efikasitetin dhe efektivitetin e sistemit të Kombeve të Bashkuara në përpjekjet e saja për të promovuar përparimin e grave dhe për të zgjeruar kapacitetin e sajë për të zhvilluar më tej objektivat e Platformës për Veprim, është e nevojshme të rinovohen, të reformohen dhe të revitalizohen pjesët e ndryshme të sistemit të Kombeve të Bashkuara, veçanërisht Seksionit për Përparimin e Grave të Sekretariatit të Kombeve të Bashkuara, si dhe njësisive tjera dhe organizmave vartëse që kanë një mandat specifik për të promovuar përparimin e grave. Në lidhje me këtë, organizmat qeverisëse relevante përbrenda sistemit të Kombeve të Bashkuara inkurajohen që të japin konsideratë të veçantë zbatimit efektiv të Platformës për Veprim dhe për të rishikuar politikën, programet, buxhetet dhe veprimtaritë e tyre me qëllim që të arrihet shfrytëzimi më efektiv dhe efikas i fondeve për këtë qëllim. Do të jetë gjithashtu e nevojshme shpërndarja e resurseve shtesë nga buxheti i rregullt i Kombeve të Bashkuara me qëllim që të zbatohet Platforma për Veprim.